

ISTORIA

E SHKRONJËSË SHËNJTËRUARË

për diem.

Përmbëledhurë

nga Dhiata e Vietërë edhe nga historia e botësë,
edhe këthyerë shqip ndë gjuhë Toskërishte

prej

KONSTANTINIT KRISTOFORIDHIT, ELBASANASIT.

(Perëndia) ngriti deshmim te Iakovi,
Edhe vuri nom ndë Israil,
(Për) sa urdhëroi atëritë t'ënë,
Që të ua bënë të ngjohurë bijvet tyre,
Që t'i ngjohë brezi tiatërë, bijtë që kanë për të lindurë.
Do të rriten' e do t'ua tregonjënë bijvet tyre,
Që të vënë shpëresën' e tyre mbë Perëndinë,
Edhe të ruanjën' urdhërimet' e ati. (Psallmë 78.. 5-7.)

KONSTANTINOPOLË.

Ndë Shtypa-shkronjë të A. H. Bojaxhianit.

1872.

TRUVEZA

Kryetë.	Faqeja
1. Krijesa	1
2. Të rënë të poshtë	3
3. Vrasëja e vëllait	5
4. Enohu	6
5. Përmbytëja	7
6. Profitia e Noesë	10
7. Pyrgu i Vavelit	11
8. Të thirrët' e Avramit	12
9. Avrami edhe Melhisedheku	13
10. Besa e Avramit	14
11. Sodhoma e Gomorra	15
12. Ismaili	17
13. Isaaku	18
14. Vdekëja e Sarrësë, edhe të varruarët' e asai	20
15. Martesa e Isaakut	20
16. Iakovi edhe Isafi	21
17. Udhë që bëri Iakovi	24
18. Të shiturit' e Iosifit	27
19. Iosifi ndë Misir	28
20. Të lartuarët' e Iosifit	29
21. Të vëllezërit' e Iosifit vinjënë ndë Misir	31
22. Udhë' e dytë që bënë të vëllezërit' e Iosifit	32
23. Iakovi vete ndë Misir	35
24. Provimi i Iovit	37
25. Iovi edhe miqt' e ti	38
26. Egjypti a Misiri	40
27. Moisiu	45
28. Moisiu përpara Faraonit	47
29. Pashka edhe të ikuritë nga Egjypti	51
30. Israili ndë shkretëtirët	53
31. Të dhënë të Ligjësë	55
32. Ligja qytetore	57
33. Ligja e lutëjesë	59
34. Mali i Sinait edhe Shkretëtira	63
35. Varret' e atyre që dëshëruanë të ngrëna	65
36. Përgjonjësitë	66
37. Murmurimi i Israilit	67
38. Gjarpëri i ramtë.	68
39. Vdekëja e Aaronit.- Vallaami.	69
40. Vdekëja e Moisiut.	70
41. Iisui, edhe të shkelurit' e Ierihosë.	72
42. Gavaonitëtë.	73
43. Të pushtuarët' e Hanaanitëvet.	73

44. Gjykatësitë. – Gjedheoni.	75
45. Rutha.	77
46. Ilei u edhe Samuilli.	78
47. Samuilli edhe Saulli.	81
48. Dhavidhi kur ishte bari.	82
49. Dhavidhi edhe Goliathi.	84
50. Të ndiekurit' e Dhavidhit.	85
51. Vdekëj' e Saullit. – Dhavidhi bënë të mbëret.	88
52. Uria u vra.	89
53. Avessallomi	91
54. Murtaja ndë Israil.	93
55. Sollomoni.	95
56. Të ndarët' e mbëretërisë.	97
57. Ierovoami edhe profiti.	98
58. Profiti Ili.	99
59. Ohozia edhe krye-ushtëtorët' e ti.	102
60. Elisseu.	103
61. Neemani	104
62. Profiti Iona.	106
63. Mbëretëria e Assyrisë. – Ninevia.	109
64. Ropëria e të dhietë faravet Israilit.	113
65. Mbëretërit' e herëshim të Iudhësë.	114
66. Të pastaimitë mbëretërit' e Iudhësë.	117
67. Profitëritë.	119
68. Ropëria e Israilitëvet ndë Vavyllonë.	122
69. Dialoshat' e Evrevet.	123
70. Mbëretëria e Halldhesë. - Vavyllona.	125
71. Dhaniili.	129
72. Mbëretëresha Esthirë.	131
73. Të ndërtuarët' e Ierusalimësë për së dyti.	134
74. Që prei Dhiatësë Vietërë ngjer mbë kohë të Krishtit.	136
75. Gjëndëja e Israilit.	138
76. Vivlla, a Shkronja e Shënjtëruarë.	140

LËGJIRAT' E DHIATËSË VIETËRË.

P.K. do me thënë, Para Krishtit, a kaqë viet përpara të lindurit Krishtit.

1. Krijesa 4004 P. K.

Perëndia krijoi (bëri) qiejtë edhe dhenë prej fjalësë ti, edhe kështu i pëlqeu që të mos bënenë të gjitha për-një-herë, po dalë nga dalë, ndonëse ay pat urdhëruarë, që së kreisë here, numërin' edhe formën' e gjithë kafshëve.

Ndashti pa dëgjo se si Perëndia bëri qiejtë edhe dhenë për gjashtë ditt.

Perëndia tha: “U bëftë dritë, edhe u bë dritë”. (Gjen. 1.. 3.) Atëhere “Perëndia ndau dritënë nga errësira”. (Gjen. 1.. 4.) Ajo qe e para natë, edhe e para ditë.

Tietëra kafshë nga ato që bëri Perëndia qe qëndresa e qiellit që rrethon dhenë. “Perëndia ndau ujëratë që ishinë ndënë qëndresënë nga ujëratë që ishinë mbi qëndresët. Edhe Perëndia qjuaiti qëndresënë qiell”. (Gjen. 1.. 6-8.) Ajo qe e dyta ditë.

Të tretënë ditë Perëndia ndau tokënë nga ujëratë që ishinë mbi faqet të dheut, edhe tha të mbinjë nga dheu bar e drurë që bënë pemë.

Të katrënë ditë Perëndia bëri dritarëtë ndë qëndresë të qiellit, që të jenë për shenje ndë dhe, edhe për kohëra, edhe për ditt, edhe për viet, do me thënë “dritarin' e math për të zotëruarë mbi ditët, edhe dritarin' e vogëlë për të zotëruarë mbi natët”, edhe yjetë. (Gjen. 1.. 14-16).

Të pesëtënë ditë Perëndia bëri peshqetë të mëdhenj, edhe ç' do gjë të gjallë që livis ndëpër ujërat, edhe gjithë ç'farë zoqsh, edhe u dha atyre këtë bekim: “U shtofshi e u shumofshi”. (Gjen.1.. 22).

Të gjashtë ditë Perëndia bëri gjithë bishat' (egërsirat') e dheut, e gjithë shtësëtë, e gjithë shtërpinjtë që lindnjënë pas farësë tyre. Atëhere Perëndia tha: “Le të bëjmë njerinë pas të gjajturit t'ënë, edhe pas të shëmbëlyerit t'ënë; edhe le të zotëronjë mbi peshqet e detit, edhe mbi shpesët e qiellit, edhe mbi shtësët, edhe mbi gjithë dhenë, edhe mbi gjithë shtërpinjtë që hiqenë barkazi mbi dhet. Kështu Perëndia bëri njerinë pas të gjajturit ti”. (Gjen. 1.. 26, 27.) Ay bëri një burrë e një grua, edhe i bekoj e u tha: “U shtofshi, e u mblofshi, e mbushçi dhenë, edhe e zotërofshi”. (Gjen.1.. 28.) Ajo qe e gjashtë ditë. “Edhe Perëndia pa gjithë sa bëri, edhe ja tek ishinë fort të mira”. (Gjen.1.. 31.)

Ndashti pa vërë re, o dialëthi im që je tuke kënduarë, se ç' bëri Perëndia të shtattënë ditë. Ay urdhëroi atë ditë për të kremte, edhe e bëri një ditë pushimi për ne, sepse “Ay pushoi të shtattënë ditë nga gjithë punërat' e tia që krijoi e bëri Perëndia”. (Gjen. 2.. 2, 3.)

E shtatta ditë u qjuaiti “Savvatë”, që do me thënë pushim; edhe një e këtillë ditë pushimi është fort e mirë për njerinë, edhe për gjithë gjët' e gjalla që punonjë për njerinë. Dit' e Savvatësë është një dëftim i math dashurisë Perëndisë, edhe se: “Gjithë përdëllimet' e ati janë mbë gjithë punët e ati”. (Psallmë 145.. 9.)

Për gjithë monë kur sbarth dit' e Savvatësë, a nuk' është për të përmëdurë na fuqin' e diturin' e të mirën' e Perëndisë, që ka dëfyerë ndë krijesët të botësë, edhe për kujdest që ka pasurë për ndërtesat' e tia që atëhere ngjer mbë sot; posi edhe na duhetë të përmëdmë edhe përdëllimet' e Perëndisë të mëdhatë, kur shpërbleu njerëzitë me anë të dashurit Birit ti, Zotit Iisu-

Krisht; edhe për atë krijesë të re mbë Iisu-Krishtinë, që duhetë të punonetë ndër shpirtërat t'anë të fajtorëvet, para se të bënemi të vëjëturë për qiellinë, edhe për atë Savvatën' e pa-mbaruarë që është për gjëndëjen' e Perëndisë.

2. Të rënë të poshtë. 4004 P.K.

Ishte një kopësht'i i bukurë që e kishte mbiellë Perëndia, edhe nd' atë vuri njerinë. Ndë këtë kopështë ishinë gjithë ç'farë drurësh të pëlqyerë për të parë, edhe të mirë për të ngrënë. Ndë mest të kopështit ishinë dy drurë që ndaninë njëri nga jatri: Drur' i jetësë, "edhe druri të ngjohurit së mirës' edhe së keqesë". Për njërinë nga këta Perëndia urdhëroi njerinë të mos hajë, tuke thënë: "prei gjithë ç'do druri të kopështit munt të hash liruarë, po prei drurit të ngjohurit së mirës' edhe së keqesë s'ke për të ngrënë nga ay, sepse atë ditë që të hash nga ay, ke për të vdekurë fare". (Gjen. 2.. 16, 17.)

Ndashti gjarpëri ishte fort i mënçim, edhe i thotë gruasë: "A me të vërtetë tha Perëndia: Mos hajni prei gjithë ç'do druri të kopështit? Edhe gruaja i tha gjarpërit: Muntmë të hamë prei pemësë drurëvet kopështit, po prei pemësë drurit që është ndë mest të kopështit, Perëndia tha: Mos hajni nga ay, as mos i përkitni, që të mos vdisni. Edhe gjarpëri i tha gruasë: Me të vërtetë s'keni për të vdekurë, po Perëndia e di, se atë ditë që të hajni nga ay, do t'u hapenë sytë tuaj, edhe do t'ini posi perëndirra, tuke ngjohurë të mirën' edhe të keqenë. Edhe gruaja pa, se druri ishte i mirë mbë të ngrënë, edhe se ishte i pëlqyerë ndë syt, edhe drur' i dëshëruarë që ep mënt; edhe ajo mori prei asai peme, edhe hëngri; edhe i dha edhe burrit sai bashkë me vetëhenë, edhe ay hëngri. E u hapnë sytë të dyve, edhe e ngjohën se ishinë sveshurë; edhe qepnë gjethe fiku, edhe ngjeshnë për qark vetëvetëhenë.

Edhe dëgjuanë zën' e Zotit Perëndisë, tuke ecurë ndë kopështë ndë erë të ditësë, edhe u fshehnë Adhami edhe gruaja e ti prei faqesë Zotit Perëndisë ndër mest drurëvet kopështit.

Edhe Zoti Perëndia thërriti Adhamnë, e i tha: Ku je? Edhe ay tha: Dëgjova zënë tënt ndë kopështë, edhe u frikësuashë, sepse jam sveshurë, edhe u fsheha. Edhe Perëndia tha: Kush të dëfteu se je sveshurë? Mos hëngre nga druri, që të urdhërova të mos hash nga ay? Edhe Adhami tha: Gruaja që më dhe të jetë bashkë me mua, më dha nga druri, edhe hëngra. Edhe Zoti Perëndia i tha gruasë: Ç'është këjo që bëre? Edhe gruaja tha: Më gënjeu (kënditi) gjarpëri, edhe hëngra.

Edhe Zoti Perëndia i tha gjarpërit: Sepse bëre këtë, qofsh i mallëkuarë ndër mest të gjithë bagëtivet, edhe ndër mest të gjithë shtësëvet fushësë: do të ecnjë barkazi, edhe do të hash dhe gjithë ditët' e jetësë s'ate, edhe do të vë armiçësi ndër mest teje edhe gruasë, edhe ndër mest të farësë s'ate edhe të farës asai, ajo do të dërrmonjë kryet, edhe ti do t'i çupiç thembrënë". (Gjen. 3.. 1-15.)

Për këtë farë që u zotua, shënohei Zoti Krisht, i Bir' i Perëndisë, që kish për t'ardhurë ndë botët, edhe për të bërë njeri, që të shpëtonte fajtorët. Satanai fitoi shumë mbë të rrëzuarët e njeriut, sepse prishi mendimet' e Perëndisë, po pak të mendonemi, merretë vesh se do j bërë për të madhenë lavdin' e Perëndisë, edhe për të prishurit' e diallit mbë së fundi.

"Edhe gruas' i tha: Do të shtonj tepërë të dhëmburat' e tua, edhe të dhëmburat' e të piellit tat; me të dhëmbura do të piellsh djem, edhe dëshërimi yt do të jetë te burri yt, edhe ay do të të urdhëronjë.

Edhe burrit i tha: Sepse dëgjove fjalën' e gruasë s'ate, edhe hëngre nga druri, që t'urdhërova tuke thënë: Mos hash nga ay, qoftë mallëkuarë dheu për punët tënde: me të dhëmbura do të hash nga pemërat' e ati gjithë ditët' e jetësë s'ate; edhe ferra e driza do të mbinjënenë për ty, edhe do të

hash barn' e fushësë; edhe me diersët të faqesë s'ate do të hash bukënë, ngjer sa të këtheheshë ndë dhet që prei ati u more, sepse je dhe, edhe do të këtheheshë ndë dhet". (Gjen. 3.. 16-19).

Pastai u dëbua njeriu nga kopështi, edhe u vu një Heruvim me shpatë flake që të ruante udhën' e drurit jetësë.

Po ndonëse u dëbuanë nga paradhisi, Adhami edhe Eva s'qenë harruarë prei së mirës' e prei përdëllimit Krijetarit tyre. Ay u dha atyre të veshurë, që ngjer mb'atë here s'kishinë pasurë nevojë as për të mbuluar' as për stoli. "Edhe Zoti Perëndia i bëri Adhamit edhe gruas' ati rroba të lëkurëta, edhe i veshi ata". (Gjen. 3..21). Këto rroba munt të kenë qenë lëkurra shtësësh që pat urdhëruarë Perëndia Adhamnë t'i vriste, e t'ia bënte kurban, për shenjën' e shpërblimit që ishte për të bërë ndë kohëra të pastaime, me anë të kurbanit të Birit Perëndisë.

Për këtë të koditurë të zi që hyri faji ndë botët, edhe nga faji erdhi vdekëja, shkurt me thënë, gjithë kombetë kanë lënë ca fjalë të moçime. Ata flasënë për krein' e botësë, se ishte një jet' e artë, që rroninë njerëzitë shumë viet me dashuri, edhe hajnë mjaft nga pemët' e dheut; edhe ata thonë se ajo lumëri u vdular (u prish) nga të pa-dëgjuarët' e ca vetëve, që u gënjenë prei një gjarpëri, edhe hëngrë pemë që s'kishin' urdhërë. Të tierë flasënë për ca pemë të arta që ruheshinë prei një gjarpëri. Fort për të shënuar' është një fjal' e moçime që kanë Indhianëtë, ata shkruanjënë Krishnanë, një nga perëndirrat' e tyre , tuke shkelurë mbi kryet të një gjarpëri, edhe tuke mbajturë trupin' e ati me duart mbi kryet të ti. Sa të lumurë jemi na që kemi ndër duart t'ona Fjalën' e Perëndisë, që na dëften istorin' e vërtetë këti të kodituri të zi. Sa-do-mos këto fjalë të moçime që kanë lënë të vietëritë, dëftenjënë se gjithë njerëzitë janë të bijt' e Adhamit, sepse tiatrasi, këta kombe përndarë mbë të katër' anët e botësë, edhe tuke mos pasurë të marr' e të dhënë njëri me jatinë, si munt të kenë si-një-një ato fjalë të moçime të kësai istorie të shënuarshime?

3. Vrasëja e vëllait. 3875 P.K.

Prei të bijet Adhamit njëri qjuhei Kain edhe tiatëri Avel. Kaini ishte bulk, edhe Aveli ishte bari dhensh. Një ditë të dy vëllezërit'i prunë dhuratë Zotit. Kaini i pru nga pemët'e dheut, edhe Aveli nga kërthinjat' e dhenet. Edhe Perëndisë i pëlqeu dhurat'e Avelit, po jo edhe e Kainit, sepse Aveli ia pru dhuratënë me gjithë zëmërë. Me këtë kurbanin' e qengjit ay nukë ngjihte Perëndinë vetëmë për Krijetar edhe për Dhanës gjithë ç'do gjëje të mirë, po ay rrëfente edhe vetenë se ishte fajtuar i vdierrë, edhe mbesonte se fajet' e ti lypëninë vdekëje, edhe ndë dashtë të ndëjehetë një fajtuar, duhetë të vritetë një tjatërë ndë vënt të ati. Po Kaini ishte zëmër-ashpërë, e i pa-besë, e madhështuar. Ay s'rrëfente vetenë për fajtuar përpara Perëndisë, me të prurët'e kafshësë për kurban që kërkonte Perëndia, përandai Perëndia me udhë nuk' e pëlqente. "Edhe Kaini u zemërua fort, edhe vvaroi faqen' e tij. Edhe Zoti i tha Kainit: Përse u zemërove? Edhe përse vvarove faqenë tënde? Ndë bëfsh mirë, a s'po do të priteshë? Edhe ndë mos bëfsh mirë, faji të mbet ndë derët".

"Edhe Kaini i foli të vëllait; edhe kur ishinë ndë fushët, u ngrit Kaini përmbi Avelnë të vëllan' e tij, edhe e vrau. Edhe Zoti i tha Kainit: Ku është Aveli yt-vëlla? Edhe ay tha: Nukë di, sos jam unë ruaitës' i tim-vëllai? Edhe Perëndia i tha: Ç'bërë? Zër' i gjakut t'yt-vëlla bërtet tek unë prei dheut, edhe ndashti qofsh i mallëkuarë nga dheu që hapi gojë të presë gjakn' e t'yt-vëllai prei dorësë s'ate: kur të punojsh dhenë, paskëtaj s'ka për të dhënë pemën' e tij; i ikur' e i dëbuarë do të jesh mbi dhet. Edhe Kaini i tha Zotit: Mundimi im ështëëmë i math, se sa munt ta mbaj.- (Faji im është më i math, se sa munt të më ndëjehetë.)- Edhe gjithë kush të më gjenjë, do të më vrasë. Po Zoti i tha: Jo, edhe i bëri një shenjë Kainit, që të mos e vrasë gjithë-se-cili ta

gjenjë”. (Gjen. 4.. 3-17). Edhe Kaini iku prei faqesë Zotit bashkë me gruan’ e tij edhe me fëmijët, edhe ndërtoi një qytet.

Adhami qe një qint e dhietë vieç i vietërë kur koditi këjo punë. Edhe Eva polli një tjetërë bir, edhe e qjuaiti Sith, që do me thënë “I vënë në vënt” (të tiatërit që u vra).

Leta shtijemë ndër mënt këtë prishëje që i gjau Kainit për punë të cmirit edhe të madhëstisë, edhe letë rruhemi mos lëshoimë vetenë ndonjë herë ndë zemërat’ e ndë mëri, që munt të bëjmë gjak e vrasëje, ndë mos i ndaltë këto të këqia kujdesi i Perëndisë.

4. Enohu. 3382-3017 P.K.

Ju mbajni mënt se u thashë juve, se Eva pat një bir, që qjuhei Sith. Ajo pat pasur’ edhe të tierë djem, që nukë zihenë n’ gojë ndë Shkronjë, po Sithi zihetë n’ gojë, sepse nga fëmijët’ e ati më parë ishte për të ruaitur’ e vërteta besë e Perëndisë, edhe nga fara e ati ndë motet të pastaim kishte për të dalë Zot’ i lavdisë, Shpërblimtar’ i botësë. Sa për fëmijët’ e Kainit, edhe të tierët djemt’ e të parëvet përintvet t’anë, ata shpeit zunë të dëfteninë punëra të këqia që dalënë nga të rrëzuarët’ e njeriut. Ata nukë deshënë ta kenë ndër mënt Perëndinë, përandai edhe ay i harroi, edhe i la të bijenë pas të këqiash që shpifinë me mënt.

Kështu edhe ndër ato motet e para ishinë dy duar njerëzish ndë botët: - ata që druaninë Perëndisë, edhe ata që nuk’ i druaninë. Ata që i besoninë Shpëtimtarit që u pat zotuar’ atyre Perëndia, edhe shkoninë një jetë me besë mbi atë, këta ishin’ atëhere qisha e Perëndisë, sikundrë janë edhe sot; po ajo dora tiatër’ e botësë ishinë plot me pa-besëri e me të keqe. Fëmijët’ e besëtarit Sith gjanë të kishinë qenurë një pies’ e vogëlë nga vëndësit’ e botësë, edhe ndër mest të këtyre të pakëve, shumë vetë harruanë Perëndinë’ e atërvet tyre, edhe upuqnë me njerës të këqij, sepse “edhe kur zunë njerëzitë të shtoneshinë mbi faqet të dheut, edhe lintnë bija ndër ata, të bijt’ e Perëndisë kur panë bijat’ e njerëzëvet, se ishinë të bukura, muarrë për gra prei së gjithash sa sjothnë”. (Gjen. 6.. 1-2.)

Po, për përdëllimin’ e math, edhe për të bërë hir njerëzisë, Perëndia ruaiti ca besëtarë për vetëhenë, edhe ndër mest të këtyre qe Enohu, që ay ishte i shtatti bres pas Adhamit. Ay ishte fort njeri i shënjtëruarë: “ay eci bashkë me Perëndinë, edhe s’gjëndei më, sepse Perëndia e mori”, (Gjen. 5.. 24.) do me thënë, e ngriti me mish e me shpirt, edhe e pru ndë qiell pa vdekurë. Nga këjo e çudiçime punë e shpërblimit u dëftye më tepërë ndë botët e ndë qishët nga pat qenurë dëftyerë përpara. Këjo dëften se jo vetëmë shpirtet’ e shënjtorëvet shpërblyerë, po edhe mish’ i atyre duhetë të lavdonetë ndë qiell.

5. Përmytëja. 2348 P.K.

Njerëzit e parë ndë botët ishinë më të shëndoshë, edhe rroninë dhietë herë më shumë se njerëzit’ e sorm. Adhami ishte nëntë qint e tri-dhietë vieç plak, edhe kur vdiq, la bij e bija e prei Sithit ngjer mbë të nënttinë bres, edhe prei Kainit ngjer mbë të dhiettinë bres. Kështu ishinë jetë-gjatë njerëzitë atëhere. Mathusalla rroi nëntë qint e gjashtë-dhietë viet, Noeja rroi nëntë qint e pesë-dhietë viet. Numëri i fëmijvet Adhamit prei të bijvet do të pat qenurë fort i math. Po sa më shtoneshinë njerëzitë mbi dhet, kaqë shtonei edhe e keqeja.

“Edhe zoti tha: Nukë ka për të mbeturë përherë fryma ime bashkë me njerinë, sepse është mish, ditt’ e ati do të jen’ edhe një qint e njëzet viet”. (Gjen. 6.. 3.) Nd’atë kohë s’ishte shkruarë nom’ i Perëndisë, as Vivlla, po njerëzitë qërtoneshinë nga fryma e Perëndisë.

“Edhe Zoti tha: Do të shuanj njerinë që bëra nga faqeja e dheut”. “Po Noeja gjeti hir përpara Zotit”, (Gjen. 6.. 7,8.) edhe ay ishte një njeri i drejtë. Edhe Perëndia i tha Noesë: Bën një arkë tre qint kut të gjatë, pesë-dhietë të gjerë, edhe tri-dhietë kutë të lartë (posi një shtëpi të madhe), edhe bën kamare nd’atë. “Sepse na unë te do të bije përmytëje ujërash mbi dhet,për të prishurë ç’do mish që ka frymë të gjallë ndë vetëhet, ndënë qiell: gjithë ç’është mbi dhet,do të vdesë. Edhe do të vë dhiatënë t’ime te ti, edhe do të hyjsh nd’arkët ti, edhe bijt’ e tu,edhe gruaja jote, edhe grat’ e bijvet tu bashkë me ty. Edhe prei ç’do shtëse prei ç’do mishi, nga dy prei së gjithash ke për të prurë nd’arkët, që t’i ruanjç të gjallë bashkë me ty”.(Gjen. 6.. 17-19.)

- “Edhe ti merr me vetëhe prei ç’do të ngrëni që hahetë, edhe do të jetë për ushqim për ty edhe për ato”. (Gjen. 6.. 21.)

Ndashti Noeja ishte gjashtë qint vieç plak kur hyri nd’arkët, edhe ujërat’ e përmytëjesë erthnë mbi dhet. Atëhere plasnë gjithë kronjet’ e avyssit math, edhe uhapnë dyert’ e ujëravet nga qijetë. Edhe ra shi mbi dhet dyzet ditt e dyzet net. –Edhe ushtuan’ ujëratë, edhe ngritnë arkënë, kështu që arka sillei mbi faqen’ e ujëravet. “Edhe ujërat’ ushtuan kaqë fort mbi dhet,sa u mbuluanë gjithë malet’ e lartë që ishinë ndënë gjithë qiellinë. Pesë-mbë-dhietë kutë përsipërë hipnë ujëratë, edhe u mbuluanë maletë”. (Gjen. 7.. 6-24.) Edhe ujëratë ndënjnë mbi dhet një qint e pesë-dhietë ditt, edhe pastai zunë të shtëroninë. Noeja hyri nd’arkët mbë dhietëditt të muajit dytë, edhe mbë të shtatë-mbë-dhiettënë ditë plasnë kronjet’ e avyssit math.

Kështu Perëndia prishi gjithë farën’ e njeriut, përveç Noes’ edhe fëmijevet ati, edhe mbë këtë punë të frikëshime që gjau, shofëmë të madhinë përdëllim edhe të madhenë drejtëri të Perëndisë që dëfteu. Na e dimë, se “dheu qe mbushurë me pa-udhëri”, edhe ajo pa-udhëri bëhei kundrë llauzit Perëndisë,që të mbaronei ajo që qe thënë përpara, se do të jetë armiçësi ndër mest të farësë gjarpërit edhe ndër mest të farësë gruasë: - a sikurse me thënë, ndër mest të atyreve që i besoninë fjalësë Perëndisë, edhe e dojnë, edhe i shërbeninë, edhe ndër mest të atyre që nuk’ i besoninë, po kishinë mëri të drejtit edhe shënjtit Shpëtimtarit e të gjithave.

Këjo arëmiçësi edhe pa-udhëri ishte kaqë e madhe, edhe arëmiqt’ e llauzit Perëndisë ishinë kaqë shumë, sa nukë ncihtej më. Qërtimet’ edhe të luturat’ e Noesë për drejtëri s’dëgjoneshinë asfare. Frym’ e Perëndisë hahei me njerëzit për një qint e njëzet viet, kur ishte tuke ndërtuar’ arka, po kot. Qish’ e Perëndisë ishte vogëluarë kaqë fort, sa s’kishte të tierë, veç një shtëpi që i besoninë. As ishte më tiatërë shpëresë, veçe se për të përpërë të gjithë për pak kohë, edhe kështu do të prishei e tërë edhe ajo rrënjë e vogëlë, që prei asai kish për të dalë Shpërbliimtari. Po me anë të kësai përmytëje upërpinë pënjëherë gjith’ arëmiqt’ e qishësë Perëndisë, edhe gjithë dheu iudha Noes’ edhe fëmijvet ati për të gëzuarë.

Edhe të parënë ditë e të nënttit muaj, uduknë për-së-ri majat’ e malevet. Po Noeja priti edhe dyzet ditt të tiera, pastai hapi parathirenë. Atëhere ay dërgoi jashtë një korp, i cili fluturoi andej e këtej, edhe nuk’ ukëthye më prapë. Pastai ay dërgoi jashtë një pullumb, po pullumbi ukthye tek ay nd’arkët. Pas shtatë ditç, ay dërgoi jashtë për-së-ri pullumbinë prei arkësë, edhe ay ukëthye për-së-ri ndajë mbrëma, edhe kishte një gjethe ulliri të ngjomë ndë qept. Atëhere pas shtatë ditç, ay dërgoi jashtë për-së-ri pullumbinë,edhe ay s’ukëthye më prapë tek ay. Këjo qe të parënë ditë të muajit parë. Edhe ndashti Noeja sbuloi arkënë, edhe pa se faqeja e dheut ishte e thatë. Noeja mbeti ngjer mbë njëzet e shtatë ditt të muajit dytë, ngjer sa utha mirë toka, që të munte të dilte prei arkësë. Atëhere Noeja i bëri kurban Zotit që e shpëtoi. Edhe Zoti tha: “S’kam për të mallëkuarë më dhenë për punët të njeriut, sepse mendim’ i zemërësë njeriut është’i keq që prei foshnjëris’ ati, as s’kam për të vrarë më gjithë shtësëtë, sikundrë bëra; ngjer sa të jetë dheu, far’ e të korrë, e të ftohët’ e vapë, e ver’ e dimërë, e dit’ e natë, s’do të pushonjëne”.(Gjen. 8.. 21,22.)

Edhe Perëndia bekoi Noenë, edhe bëri dhiatë me atë, edhe vuri yl-verinë ndë ret për shenjë të dhiatësë që bëri me atë. “Edhe Perëndia i tha Noesë: Këjo është shenja e dhiatësë, që vura ndër mest meje edhe gjithë ç’do mishi që është mbi dhet”. (Gjen. 9.. 17.)

Kështu shkoi përmytëja, 1656 viet pas së krijuarit Adhamit, si mbaiti një vit të tërë. Për përmytëjenë sikundrë edhe për të rrëzuarët të Adhamit gjithë kombet’ e zënë n’gojë, ndonëse ishinë fort të pa-diçim. Let’i kemi frikë Perëndisë gjithë monë, sepse është’i zoti të prishnjë ata që ngrenë krye kundrë ati.

6. Profitia e Noesë. 2347 P.K.

Pas kësai Noeja mbolli një vëreshtë, edhe udeit nga vera. Hami, i biri më i vogëli, e përqeshi. Po Simi edhe Iafethi, dy të bijt’ e tierë, e nderuanë. Ani si usgjua Noeja foli këtë profiti me anë të Frymësë Perëndisë: - “Qoftë mallkëuarë Hanaani: do të jetë shërbëtori i shërbëtorëvet ndër vëllazërit ti. Edhe qoftë bekuarë Zoti Perëndia i Simit: edhe Hanaani dot’i bënetë shërbëtuar; Perëndia ka për të sgjëruarë Iafethnë, edhe ka për ta bërë të rrinjë ndë tendat të Simit, edhe Hanaani dot’i bënetë shërbëtuar”. Hanaani ishte i bir’ i Hamit, edhe të bijt’i gjajtnë t’et mbë punëra të këqia. Të bijt’ e Hamit ndenjnjë nd’ Afriqi, e të bijt’ e Simit ndenjnjë nd’ Asi, do me thënë ndëpër Assyri, e ndëpër Vavylloni, e ndëpër Aravi, e ndëpër Syri; edhe të bijt’ e Iafethit ndenjnjë nd’ Evropë, e së andejmi kapërcyenë mb’-at’-anë dhenë ndë Ameriqi e ndëpër ujdhesat. Kështu Perëndia i dha bekimnë Iafethit të shtonetë. Po tuke qjuaiturë Zotin’ e Simit, Noeja donte me thënë për të mirënë që dot’i bënte Perëndia fëmijvet ati më përpara, edhe këjo u mbush kur iudha nomi (ligja) llauzit Israilit, edhe vetë Zoti Krisht lindi prei ati kombi. Po të mjerëtë të bijt’ e Hamit që janë të zest’ e Afriqisë, që atëhere, e ngjer mbë sot i rrëmbenjën’ e i shesinë shërbëtorë ndëpër kombet e tierë. Kështu pra ishte mbushur’ ajo profiti e vietërë.

7. Pyrgu i Vavelit. 2247 P.K.

Noejarroi pas përmytëjesë tre qint e pesë-dhietë viet. Ky qe i pastaimi njeri që i harriu kësai moshe. I bir’ i ati Simirro i pas përmytëjesë pesë qint viet, edhe pa shumë fëmijë. Po veç Arfaksadhi, i nipi Noesë, rroi katrë qint e tri-dhiet’ e tetë viet, edhe i bir’ i ati katrë qint e tri-dhiet’ e tre. Everi, i nipi, rroi katrë qint e gjashtë-dhiet’ e katrë viet. Po që atëhere fuqia e njerëzet uvogëlua kaqë shpejt, sa asnjë nga të vonëtë nuk’ i harrinë më as dy qint e pesë-dhietë viet. Simi harriu e pa bij e nipërë, e stërnipërë, ngjer mbë të dhietinë bres. Nd’ atë kohë zunë njerës të fortë të vininë ndën’ urdhërë të tyre llauzëra. I pari mbëret qe Nevrodhi, i nipi i Hamit, edhe i stërnipi Noesë; edhe të nisurit’ e mbëretëris’ ati qe Vavyllona.

Nd’ atë kohë gjithë bota fliste një gjuhë. Ata vunë ndër mënt të ndërtoninë një qytet ndë fushë të Shennaarit, për-anë lumit Evfratit, edhe të ndërtoninë nd’ atë një pyrg, të cilit maja t’i harrinte ngjer ndë qiell, që të fitoninë emërë për vetëvetëhen’ edhe të mos përndaheshin’ andej e këtej ndëpër gjithë dhenë. Po mendim i atyre s’i pëlqeu Perëndisë. Edhe Zoti tha: “Ejani, letë sbresmë, edhe le t’u përziejm’ atie atyre gjuhënë, që të mos kupëtonjë njëri gjuhën’ e tiatërit. Edhe Zoti përndau ata prei andy mbi faqen’ e gjithë dheut, edhe ata pushuanë tuke ndërtuarë qytetnë”. (Gjen. 11.. 7,8.) T’u pat vaturë mbarë puna atyre për të ndërtuar’ atë qytet edhe atë pyrg, edhe të përmbëlidheshinë nd’ atë sikundrë e patnë ndër mënt, atëhere s’do të qe ruajturë bota prei njerëzish këqij që ishin’ arëmiqt’ e llauzit Perëndisë. Ata do të kishinë ndenjnjë të gjithë bashkë, e dot’ishinë bërë një gjëndëje e madhe, kundrë qishësë Perëndisë. Kështu u bë për të mirën’ e

qishësë ti ndë dhet, edhe për atë shpëblimn' e math që e kishte ndër mënt, përandai Perëndia ndali të ndërtuarët' e qytetit edhe të pyrgut Vavelit.

Po ndonëse të ndërtuarët' u ndal mb'atë kohë, pastai qyteti edhe pyrgu umbaruanë prei Nevrodhit, të nipit Hamit, i cili e bëri krye-qytetin' e mbëretërisë ti. Për qyten' e Vavelit a të Vavyllonësë, do të shkruajmë pastai, po për pyrgunë munt të themi këtu, se qe ndërtuarë me tetë pate 500 këmbë i lartë, edhe se ndë majë të pyrgut ishte tempull' i Vellit a i Vaallit, idhullësë Vavyllonaset.

8. Të thirrët' e Avramit. 1921 P.K.

Pak kohë përpara vdekësë Noesë, Avrami kishte lindurë, mbë të dhiettinë bres prei Simit. Atëhere njerëzit' ishinë ndarë mbë shumë kombe, edhe kishinë rënë pas idhullatrisë.

“Atëhere Zoti i tha Avramit: Dil prei dheut tënt edhe prei fisit tënt, edhe prei shtëpisë t'yt-et, nd'atë dhe që kam për të dëftuarë ty, edhe kam për të bërë ty komp të math, edhe kam për të bekuarë ty, edhe kam për të madhëruar' emërinë tënt, edhe do të jesh për bekim, edhe do të bekonj ata që të bekonjëny, edhe do të mallëkonj ata që të mallëkonjëny ty, edhe gjithë kombet' e dheut do të bekonenë te ti”. (Gjen. 12.. 1-3.) Atëhere Avrami doli jashtë, kur ish shtatë- dhiet' e pesë vieç plak, bashkë me Llotnë, të nipnë.

Po pastai, “gjaiti një qartë ndër mest barinjet bagëtivet Avramit, edhe ndër mest barinjet bagëtivet Llotit”, (Gjen. 13.. 7.) sepse të dy ata kishinë shumë gjë të gjalla, edhe nuk' i nxinte vëndi të rrininë të dy bashkë. Edhe Avrami i tha Llotit: Të lutem, letë mos jetë qartë ndër mest meje, edhe ndër mest teje, edhe ndër mest barinjet mi, edhe ndër mest barinjet tu, sepse jemi vëllazërë. A po nuk' është gjithë dheu përpara teje? Ndahu pra prei meje; ndë vafsh ti mbë të mëngjërë, unë vete mbë të diathtë, edhe ndë vafsh ti mbë të diathtë, unë vete mbë të mëngjërë”. (Gjen. 13.. 8,9.)

Atëhere Lloti sgjodhi fushën' e Sidhdimit, atie ku ish ngulurë qyteti i Sodhomës' e i Gomorësë. Po Avrami ndenji ndë dhe të Hanaanit.

9. Avrami edhe Melhisedheku. 1913 P.K.

Pesë viet pas kësai erthnë katrë mbëretërë, edhe luftuanë me mbëretn' e Sodhomës' edhe me katrë mbëretërit' e tierë të qytetevet fushësë, edhe i pushtuanë, edhe plaçkitnë gjithë Sodhomën' e Gomorënë, edhe muarnë rop gjithë llauzë edhe Llotnë të nipn' e Avramit me gjithë gjën' e ti, edhe iknë. Kur dëgjoji këtë Avrami, armatosi shërbëtorët e ti, 318 vetë që kishinë lindurë ndë shtëpi të ti, edhe i ndau mbë trish, edhe ndoq arëmiqtë. Edhe u ra natën' e i mudi, edhe pruri me vetëhe gjithë gjënë, edhe të vëllanë Llotnë me gjën' e ati, edhe me grat' e ati, edhe me gjëndëjen e ati.

“Edhe Melhisedheku, mbëret'i Salimit, nxori përpara buk' e verë, edhe ishte krye-prift'i Perëndisë lartë. Edhe e bekoi e tha: Qoftë bekuarë Avrami nga Perëndia i lartë që ka ndërtuarë qiellin' e dhenë, edhe qoftë bekuarë Perëndia i lartë që të dha ndë dorë arëmiqt' e tu. Edhe Avrami i dha të dhiettin' e gjithë gjësë. Edhe mbëret'i Sodhomëvet i tha Avramit: Ep-më njerëzitë, edhe gjënë që more për vetëhe. Edhe Avrami i tha mbëretit Sodhomëvet: Unëngrita dorënë te Zoti Perëndia i lartë që ka ndërtuarë qiellin' e dhenë, se s'kam për të marrë asgjë nga gjëja jote që prei fillit ngjer mbë rryp të shollësë, që të mos thuash, se: Unë bëra të pasur' Avramnë”. (Gjen. 14.. 17-24.) Kështu Avrami s'donte të ketë miqësi me njerëzit e këqij që ishinë qark ati. Po me Melhisedheknë u suall tietërazi, i cili ishte shërbëtor' i të vërtetit Perëndi, edhe

sepse ishte mbëret edhe prift, edhe për tiatërë punë ay qe sgjedhurë prei Frymësë Perëndisë për shëmbëllesën' e Mesisë, posikur është shkruarë mbë 110 Psallmë mbë 4 sërë: - “Zoti bëri be edhe s’do të pendonetë: Ti je prift për të gjithë jetënë pas taksit Melhisedhekut”. Kështu pra gjënjdeshinë njerës të mirë që i shërbeninë të gjallit Perëndi edhe ndër mest të Hanaanitëvet.

10. Besa e Avramit. 1913-1798 P.K.

Edhe Perëndia bekoi Avramnë, e i tha: “Mos ki frikë, Avram: unë jam mburonjësi yt, paga jote do të jetë fort e shumë”. (Gjen. 15.. 1-6.) Po Avrami rëkonej se s’kish dialë. “Edhe Zoti e pru jashtë, edhe i tha: Shtierë sytë ndë qiell tani, edhe numëro yjetë ndë muntç t’i numërojsh; edhe i tha: Kështu do të jetë fara jote. Edhe ay i zu besë Zotit, edhe iungjoh për dreitëri”. (Gjen. 15.. 5,6.)

“Avrami kur ish nëntë-dhiet’ e nëntë vieç plak, iu duk Zoti, e tha: Unë jam Gjithë-pushtetësi Perëndi, ecë përpara meje, edhe ke për të qënur’ i kulluarë. Edhe do të bënj dhiatënë t’ime ndër mest meje edhe ndër mest teje, edhe do të të shumonj fort tepërë”. (Gjen. 7.. 1,2.) “Edhe s’do të qjuhëtë më emëri yt Avram, po emëri yt do të jetë Avraam, sepse të bëra atë shumë kombesh”. (Gjen. 17..5.) Edhe Perëndia vuri rreth-presëjenë për shenjë të dhiatësë ti.

“Pastai Zoti iuduk Avraamit ndë fushat të Mamvrit, atie ku po rrinte ndë derët të tendësë prei vapësë ditësë. Edhe ay ngriti syt’, e pa: edhe ja te po rrininë tre burra përpara ati, edhe kur pa ata, vrapëtoi t’udalë përpara atyre prei derësë tendësë, edhe ungji vetëhenë ngjer për dhe e tha: O im-Zot, ndë gjeta hir ndër syt të tu, të lutem, mos ikë prei shërbëtorit t’ënt; të lutem, letë bijenë pak ujë, edhe lani këmbëtë tuaj, edhe prëhi ndënë list”. (Gjen. 18.. 1-4.) “Atëhere Avraami vate me vrap ndë tendët te Sarra, e tha: Nxito shpejt, e ngjish tre matësë mielli të imëtë, edhe bën kuleç ndë vatërët”. (Gjen. 18.. 6.) Edhe ay vate e mori një viç të but’ e të mirë, edhe e bëri gati; pastai muar gjalpë edhe qjumështë, edhe viçnë që bëri gati, e ua vuri përpara atyre. Edhe ata hëngre”. (Gjen. 18.. 7,8.) “Atëhere Zoti i tha: Me të vërtetë do të këthenem te ti vitnë që vien posi mbë këtë kohë, edhe ja Sarra gruaja jote te do të ketë bir”. (Gjen. 18..10.) “Edhe njerëzit ungritnë andej, edhe mbajtnë dreitë nga Sodhoma, edhe Avraami vate bashkë me ata, për të persiellë ata. Edhe Zoti tha: A duhetë ta fsheh unë nga Avraani, atë punë që bënj? Sepse un’ e ngjoh atë, se dot’ urdhëronjë bijt’ e ti, edhe shtëpin’ e ti, bashkë me atë edhe do të ruanjën’ udhën’ e Zotit, për të bërë dreitëri e gjyq, që të bierë Zoti mbë Avraamnë ato që i foli”. (Gjen. 18.. 16-19.)

Atëhere Zoti i dëfteu Avraamit se po shkonte ndë Sodhom’ e ndë Gomorrë për të munduarë vendësit’ e atyre qyteteve për fajet. “Sepse tha, faji i atyre është fort i rëndë”. (Gjen.18.. 20.) Edhe Avraami iu lut për llauzinë, e i tha: “Ndë qofshinë pesë-dhietë të dreitë ndë qytet, vall’ i ke për të prishurë? Edhe nukë do të falnje vëndinë për të pesë-dhietët të dreitë që janë nd’atë? Qoft lark prei teje! Kurrë mos bënjç t’atillë punë, të vraç të drejtinë bashkë me të shtrëmbërinë, edhe të jet’i drejti posi i shtrëmbëri! Qoftë lark prei teje! Ti që gjykon gjithë dhenë, s’ke për të bërë gjyq? Edhe Zoti tha: Ndë gjeça ndë Sodhomë pesë-dhietë të dreitë brenda ndë qytet, do të fal gjithë vëndinë për ata”. Edhe Avraami tha për-së-ri: “Po ndë umefshinë pesë vetë nga të pesë-dhietët e dreitë, do të priç gjithë qytetnë për punë të pesëvet?”. Edhe kështu shkonte tuke e pyeturë gjithë-një: “Po nd’ ugjeçin’ atie dyzet vetë, a tri-dhietë vetë, a njëzet vetë, a dhietë vetë?”. Edhe Zoti tha: “S’ kam për të prishur’ atë për punë të dhietë vetëvet”. “Edhe Zoti shkoi udhësë ti, edhe Avraami ukëthye ndë vënt të ti”. (Gjen. 18.. 23-33.)

Letë mendonemi pakzë herë, si ungji vetëhenë kaqë poshtë i madhi Jehova, sa të duketë ndë shëmbëllim të njeriut, e të flasë sy ndër sy me shërbëtorin’ e ti Avraamnë, posi një njeri që flet me mikn’ e ti. Po sa më çudi e madhe është, kur vetë ay Zoti i të gjithëve, që iuduk kështu

Avraamit, kishte për të ndenjurë, pas motesh, bashkë me njerëzitë ndë dhet, jo për të munduar' e për të prishurë, sikundër uduk ndashti, po për të falur' e për të shpëtuarë – e “për të dhënë jetën’ e ti shpërblim për shumë vetë!” (Matth. 20.. 28.)

11. Sodhoma e Gomorra. 1898 P.K.

Ishte mbrëmje kur erthnë të dy ëngjëjtë ndë Sodhomë. Lloti u dolli përpara atyre, tuke kujtuarë se janë udhëtarë, edhe iulut atyre miqësisht të rrinjën’ atë natë tek ay, edhe ata i ndigjuanë. Po njerëzit e Sodhomësë gjithë natën’ e gjatë vijnë pas punësh të ndyra, prapa meshkujsh, ngjer së pastaimi ënjgëjt’ u verbuan’ atyre sytë, që të mos mundinë të gjeninë derën’ e shtëpisë Llotit. “Edhe njerëzit’ i thanë Llotit: A ke ti këtu tiatërë njeri? Nxir-i jashtë këti vëndi, sepse do ta prishmë këtë vënt”. Edhe Lloti u tha dhandurrëvet ti, po ata qeshinë me atë.

Edhe kur sbardhi drita ënjgëjjetë ngutnë Llotinë. Edhe ay passi mënoi, njerëzitë rroknë për dore atë, edhe gruan’ e ati, edhe dy të bijat’ e ati, edhe i nxuarrë jashtë qytetit. Atëhere ëngjëll’ i Zotit tha: “Shpëto jetënë tënde, mos vështro prapa teje, as mos rri ndëpër gjith’ atë vënt”. “Edhe kishte lerë dielli, kur hyri Lloti ndë Sigor. Atëhere Zoti lëshoi shi squfuri e ziarmi nga Zoti prei qiellit mbi Sodhomët e mbi Gomorrët, edhe prishi gjith’ atë vënt”. (Gjen. 29.. 12-24.) Edhe ay vëndi ku kanë qënë këto qytete, është tani Det’i Vdekurë. Ngjer sot mbë këtë ditë ay vënt, me atë të parë të shumtuarë, na bën të dimë, se si mundon Perëndia të pa-besëtë. Po e shoqeja e Llotit vuri re prapa, “edhe ubë shtyllë krye”. (Gjen. 29.. 26.)

Kur qe ndë dhet Zoti Iisu-Krisht, foli për fajet e qytetit Sodhomësë, edhe për mundimin’ e asai. Edhe kështu tha për atë, se ndë dhe të Sodhomësë do të jetë mundimi më i duruarshim ndë ditë të gjyqit, se ndë dhe të Kapernaumit, atie ku bëri kaqë çudirra. Edhe për ç’punë këjo? Sepse, ndonëse gjëndëja e Kapernaumit pa çudirrat’ e ati, edhe ndigjoi fjalët’ e ati, po uashpëruanë kundërë ati, edhe nukë deshë të pendoneshinë për fajet e tyre.

Këjo na bën të dimë, o djemthit’ e mi, neve që kemi dëgjuarë të bukurinë zë të ungjillit, edhe na është dëftyer’ udha e Perëndisë që hapi për ndëjesën’ e fajevet t’ona, edhe për shpëtimn’ e shpirtëravet t’ona me anë të vdekëjesë të Birit ti. Ndë mos i rafshim prapa këti shpëtimit math, do të bëhetë më keq për ne ndë ditë të gjyqit, se për ata fajtorët e atyre qytetevet që zum n’gojë.

Ay det që mbulon këta qytete qjuhetë Det’i Shëllirtë a Det’i Vdekurë, sepse ujëratë janëkaqë të shëllirta, sa s’munt të rronjë gjë e gjallë brënda. Mbë ca vënde është 1300 këmbë i thellë, e mbë ca vënde të tierë vetëmë 13, po faqeja e ujëravet këti deti është më tepërë se 1300 këmbë më i ulëtë se detëret’ e mëdhenj të gjithë botësë. Më shumë vënt i lartë ngrihetë prei fundit ati deti, përandai thohetë Asfalltë.

Lloti kishte dy bij, Moavin’ edhe Ammonë, prei këtyre duallë kombet’ e Moavitëvet edhe të Ammonitëvet. Këta kombe pastai ranë pas idhullatrisë, edhe të gjith’ ishin’arëmiqt’ e Israilitëvet.

12. Ismaili. 1910-1892 P.K.

Avraami pat një bir nga Agara, që e kishte emërin’ Ismail, ay i pat lindur’ Avraamit kur ishte tetë-dhiet’ e gjashtë vieç plak.

Për këtë dialë, përpara se të lindte, ëngjëll’ i Zotit i tha Agarësë, kur iku ndënë shkretëtirët nga Sarra: - “Këthehu te jot-zonjë, edhe përungju ndënë duart t’asai. Kam për të shumuarë farënë tënde fort shumë, kaqë sa s’do të numëronetë nga të shumëtë. Ja te do të mbarsesh, edhe do të piellç bir, edhe do t’ia vësh emërin’ Ismail, sepse Zoti ndigjoi shtrëngimnë tënt. Edhe do të bëhetë një njeri posi gomar i egrë; dora e ati do të jetë kundërë gjithë njeriu, edhe gjithë dora e

njeriut (do të jetë) kundër ati, edhe ay do të rrijë përpara gjithë vëllezërëvet ti”. Edhe Agara thirri emërin’ e Zotit, që i foli asai: Ti, o Perëndi, që më pe, edhe emërin’ e pusit që qe ajo afër’ ati, Vir-Ilahai-roi, që do me thënë, posi i të gjallit që më pa”. (Gjen. 16.. 5-14. Jovi 39.. 5-8.)

Edhe tani Zoti vuri re Sarrënë, edhe ajo i polli Avraamit një bir, kur ishte një qint vieç plak, edhe ia vuri emërin’ Isaak. Edhe Sarra pa se Ismaili ishte përqeshës: “edhe ajo i tha Avraamit: Dëbo këtë shërbëtore edhe birin’ e asai”. Avraamit i erdhi fort keq për këtë fjalë: “Po Perëndia i tha Avraamit: Letë mos të vinjë keq për dialënë, edhe për shërbëtorenë tënde, edhe gjithë ç’të thotë Sarra, ndigjoja fjalëtë, sepse fara jote do të qjuhetë mbë Isaaknë, edhe birin’ e shërbëtorese s’ate do ta bën një komb, sepse është fara jote. Edhe Avraami u ngrit heret me natë, e muar bukë, edhe një lëkurë me ujë, edhe ia dha Agarësë, edhe ia vuri ndë kraha, edhe dialënë, edhe e dërgoi tej, edhe ajo iku, e sillej andej e këtej ndëpër Shkretëtirët të Veershevasë. Edhe si umbarua ujët’ e lëkurësë, hodhi dialënë ndënë një lis, edhe erdhi e ndenji përtej mazi për së largu, sa një të hedhurë hargu, sepse tha: Mos shoh vdekëjen’ e dialit. Edhe ndenji mbë të përtej, edhe ngriti zën’ e saj, e qjau. Edhe Perëndia ndigjoi zën’ e dialit, edhe ëngjëll i Perëndisë i thërriti Agarësë nga qielli, e i tha: Ç’ke Agarë? Mos ki frikë, sepse Perëndia ndigjoi zën’ e dialit nga vëndi ku dergjetë; ngreu e merr dialënë, e mbaje për dore, sepse kam për të bërë atë një komp të math. Edhe Perëndia i hapi syt’ asai, edhe pa një pus uji, edhe vate, e mbushi lëkurënë me ujë, edhe ia dha dialit të pij. Edhe Perëndia ishte bashkë me dialënë, edhe urrit, e zuri vënt ndë shkretëtirët, edhe u bë një harkëtuar”. (Gjen. 21.. 9-20.)

Prej këti Ismailit lindnë dy-mbë-dhietë zotërinj, edhe nga far’ këtyre kanë dalë Ismailitët edhe Arapëtë.

Ndë Istori të Arapëvet, që kur janë zënë fillë e ngjer mbë këtë ditë të sotme, është mbushur’ e çudiçimeja profiti e Perëndisë për Agarënë. Arapëtë gjithë-një janë tuke luftuarë njëri me jatërinë, edhe me gjithë fëqinjët e tyre, edhe asnjë s’ka mundurë të pushtonjë ata. Nga këjo gjëndëje doli Muhameti profiti i Islamëvet, 600 viet pas Iisu-Krishtit. Të parët’ e ati që la mbë këmbë të ti qjuheshinë Halifë, nga ata ugreh e madheja mbëretëri e Saraqinëvet. A do të ndigjonet’ urat’ e Avraamit për Ismailinë, që u lut: “Rroftë Ismaili përpara teje, (o Perëndi!)” (Gjen. 17.. 18.) po do t’i ndigjonet’ ajo uratë, “sepse do të mbushetë me të ngjohurën’ e Perëndisë, posi ujëratë që mbulonjënë denë”. (Isaia 11..9.)

13. Isaaku. 1872 P.K.

Pas këtyre punëve Perëndia desh t’i sgjithte zemrën’ Avraamit, edhe i tha: Merr tani t’ët-bir, Isaaknë, birin’ e vetëmë që do, edhe shko ndë dhe të Moriahut, edhe bën-e kurban të diegur’ atie përmbi atë mal që do të thom ty. Edhe Avraami ungrit heret me natë, edhe i vuri samarë gomarit, edhe mori me vete dy shërbëtorë, edhe Isaaknë birin’ e ti. Edhe të tretënë ditë kur pa vëndinë për së largu, utha shërbëtorëvet të rrijnë mbë-nj’-anë me gomarë: “edhe Avraami mori drut’ e ia vuri mbë krahë Isaakut birit ti, edhe ay mori ziarrë mbë dorë, edhe thikënë, edhe vanë të dy bashkë”. Avraami e dinte se Perëndia munt ta ngjallte Isaaknë edhe prei së vdekurish. Edhe Isaaku tha: “Ata im, ja ziarrë edhe drutë, po ku është dashi për kurban?” Edhe Avraami tha: “Biri im, Perëndia do të gjenjë për vete dashnë për kurban. Edhe kështu shkoninë të dy bashkë”.

“Edhe passë e harrinë mb’ atë vënt që u pat thënë Perëndia, Avraami ndërtoi atie një therore, edhe vuri drutë, edhe lidhi Isaaknë birin’ e ti, edhe e vuri mbi theroret sipër drurëvet; edhe Avraami ndejti dorën’ e ti, e mori thikënë. për të therurë birin’ e ti. Po ëngjëll’ i Zotit i thirri nga qielli, e i tha: Avraam, Avraam, mos verë dorë mbi dialënë, edhe mos i bën gjë, sepse tani e ngjoha, se ti ke frikë Perëndisë, sepse nukë t’udhëmb yt-bir i vetëmi për mua. Edhe Avraami kur

ngriti sytë, pa një dash prapa ti, tek ishte zënë për brirësh ndër degat të një druri; edhe Avraami erdhi e mori dashnë, edhe e bëri kurban të diegurë ndë vënt të birit ti. - Edhe ëngjëll' i Zotit i thirri Avraamit për së dyti nga qielli, e i tha: Bëra be mbë vetëhenë t'ime, tha Zoti, sepse bëre këtë punë, edhe nukë t'udhëmp yt-bir i vetëmi, përandai me bekim, do të bekonj ty, edhe me të shtuarë do të shtonj farënë tënde posi yjet' e qiellit, edhe posi rërënë që është për-anë buzësë detit, edhe fara jote do të pushtonjë dyert' e arëmiqet saj, edhe ndë farët tënde do të bekonenë gjithë kombet' e dheut: sepse e ndigjove zënë t'im". (Gjen. 22.. 1-18.) Këjo qe një sbulesë e këthiellëtë për Krishtinë, që kishte për t'ardhurë, sikundrë i qe zotuarë më përpara. Tani usbulua, se ay kishte për të lindurë nga fara e Avraamit, edhe se gjithë kombet' e dheut do të bekoneshinë prei ati.

Këjo historia e Isaakut që i ndigjoi të i atit, edhe desh të vdesë pas urdhërit Perëndisë, na bije ndër mënt dashurin' e ati "që ungji kryetë ngjer mbë vdekëjet, edhe mbë vdekëjet të kryqit", edhe vdiq për fajtorët, që t'u apë jetë atyre me anë të vdekëjesë ti.

14. Vdekëja e Sarrësë, edhe të varruarit' e asai. 1860 P.K.

Kur ishte Avraami një qint e tri-dhiet' e shtatë vieç plak, vdiq Sarra ndë Hevron. Avraami pat ndënjurë gjashtë-dhietë viet ndë dhe të Hanaanit, po ngjer mbë këtë kohë ay s'pat pushtuarë as një pëllambë vënt mb' atë dhe; ay pat kulloturë grigjën' e ti ndëpër fushat, edhe rrinte si i huaj ndër mest të Hanaanitëvet. Ay shikonte për një vënt më të mirë, do me thënë për qiellinë. Tani ay dëshëronte për të blerë një copë vënt për vete, që të varronte (të vij ndë dhet) të vdekurit' e njerëzisë ti. Edhe kështu vate e foli me të parët' e Hittitëvet. Edhe djemt' e Hetit iu përgjeqnë Avraamit, e i thanë: "Pa na ndigjo, zoti im: ti je një zotëri i math ndër mest nesh, varro të vdekurinë tënt ndër varret t'anë mbë më të mirinë që të pëlqenjë, asndonjë prei nesh s'ka për të thënë se nuk' ep varr' e ti, që të varrojsh të vdekurinë tënt". Avraami lypi të blinte arën' e Mahpellahit, që ishte e Efronit, njërit të parëvet të Hittitëvet. Efroni iulut ta marrë dhuratë, po Avraami donte ta blinte, edhe së pastaimi Efroni mori katërë qint shiklla argjëndi. Edhe Avraami varroi Sarrënë të shoqenë ndë shpellët të arësë Mahpellahit ndë Hevron përtej Mamvrisë. (Gjen. 23.)

15. Martesa e Isaakut. 1857 P.K.

Avraami kur ishte fort plak dërgoi më të vietërinë shërbëtorin' e shtëpisë ti ndë Mesopotami, atie ku rrininë njerëzia e ti, për të marrë nuse për Isaaknë të birin' e ti. Shërbëtori muar me vetëhe dhietë kamilla ngarkuarë me gjithë ç'farë plaçëkash për dhurëti t'asai nusesë që kishte urdhëruarë Zoti për Isaaknë. "Edhe ay erdhi ndë qytet të Nahorit, edhe uli mbë gjunjë kamillatë përjashta qytetit ndaj një pus uji, ndë kohë të mbrëmëjesë kur vininë gratë të mbushinë ujë. Edhe ay tha: o Zot Perëndia i Avraamit t'im zot, të lutem, ep-më një të qëlluarë të mirë sot, edhe përdëlle Avraamnë t'em zot: ja unë te po rri afërë kroit ujit, edhe të bijat' e njerëzet qytetit vinjënë të mbushnjënë ujë; edhe asai vajzësë që t'i thom: Të lutem, sbrit shtëmbënë tënde që të pi ujë, edhe ajo të thotë: Pi, edhe do t'u ap ujë edhe kamillavet tua, ajo le të jet' ajo që ke bërë gati për shërbëtorinë tënt Isaaknë".

Posa nxori ay këto fjalë, na Reveka e bija e Vathuillit tek erdhi me shtëmbën' e saj mbë krahë, edhe ajo vate ndë pust, edhe mbushi shtëmbënë, edhe u kthye prapë. "Edhe shërbëtori usul të piqetë me atë, edhe i tha: Të lutem, ep-më pakëzë ujë të pi nga shtëmba jote. Edhe ajo tha: Pi, o zoti im, edhe do të nxier ujë edhe për kamillat e tua". Edhe ajo vate nxori ujë edhe për gjithë

kamillat e ati. Edhe njeriu u çudit për bukurin' e asai. Edhe ay mori një palë vathë t'artë, edhe dy rrathë duarsh t'artë, edhe ia vuri asai. “Edhe i tha: E bij' e kujt je ti”? Edhe ajo u përgjeq: “Jam e bij' e Vathuillit, të birit Nahorit” (që ishte i kushërir' i Avraamit). “Edhe njeriu ungji kryetë, e adhurroi Zonë, edhe tha: I bekuarë qoftë Zoti Perëndia i Avraamit t'im-zot, që s'i hoqi përdëllimin' e ti edhe të vërtetën' e ti t'im-zoti; Zoti më hoqi udhënë ndë shtëpi të vëllezëret t'im-zot”.

Nesrëmet, ay tha: “Më leri të vete tek im-zot, edhe mos më ndalni. Atëhere ata pyetnë Revekën', e i thanë: “A do të veç me këtë njeri?” Edhe ajo tha: Dua. Edhe ata e bekuan' e i thanë: “Ti je motëra jonë, u bëfsh ëmë mbi mijëra e dhietë mijëra”. Edhe kështu Isaaku ungushullua pas vdekëjesë s'ëmësë. (Gjen. 24.. 10-67.)

16. Iakovi edhe Isafi. 1837-760 P.K.

Isaaku qe dyzetvieç kur mori Revekënë për grua. Edhe kur ubë gjashtë-dhietë vieç plak, i lintnë dy binjakë. Këta të dy vëllezërë s'i gjaninë njëri jatërit: i pari ishte i egrë si mbë të parët, kështu edhe mbë punët; i dyti ishte i butë e i bekuarë. Të parit ia thoshin' emërin' Isaf, edhe tiatërit Iakov. Si urritnë ata, Isafi ubë gjetuar, një njeri i fushavet, po Iakovi i gjaiti t' et, edhe ubë bari dhësh, e rrinte ndër tenda. Isaaku sa-do-mos, donte Isafn' e egrë,po Reveka donte më fort Iakovn' e butë.

Një ditë Iakovi pat zierë groshë, edhe Isafi erdhi ndë shtëpi lodhurë, e i tha Iakovit: “Të lutem, ep-më të ha nga ato groshë, sepse jam lodhurë”. Edhe Iakovi i tha ati: “Shit-më sot parësin' e birërisë s'ate”. Edhe Isafi tha: “Ja unë te po vdes, ç'dobi më bën këjo parësia e birërisë”? Edhe kështu Isafi i shiti parësin' e birërisë, edhe i bëri be. Po i ati nukë undoth aty, kur lithnë atë fjalë, përandai munt t'ia ipte bekimmë Isafit.

Isaaku si ubë plak, nukë shihte mirë me sy, përandai ay ukujtua se kish për të vdekurë shpejt; edhe ay thirri Isafnë, e i tha: “Ja unë tani tek uplaka, edhe nuk' e di ditën' e vdekëjesë s'eme, të lutem pra, merr armët' e tua, kuletënë tënde, edhe harknë tënt, edhe dil fushësë, e më gjuaj për gjah, edhe më bën gjellë sikundrë dua unë, edhe bier-më të ha, që të bekonjë ty shpirti im para se të vdes”.

Passi iku Isafi, Reveka muar dy kedha, edhe bëri gjellë të shishime, posikur donte Isaaku, edhe dërgoi Iakovnë, që të marrë bekimm' e t'et. Atëhere Iakovi erth, e i tha: “Ata im”, edhe Isaaku u përgjeq: “Cili je ti, biri im?” Iakovi i tha: “Jam unë Isafi yt-biri i pari, bëra sikundrë më the, ngru pra, rri e ha prei gjahut t'im, që të më bekonjë shpirti yt”. Atëhere i ati e përkau me dorë, sepse Isafi i kishte duartë të ashpëra, po Iakovi i kishte të buta. Po Reveka ia kishte mbështuellëme lëkura të ashpëra. Atëhere Isaaku tha: “Zëri është posi i Iakovit, po duartë janë posi të Isafit”. Edhe ay e pyeti për-së-ri: “Ti je biri im vetë Isafi”? Edhe ay tha: “Unë jam”. Atëhere ay hëngri edhe passi hëngri e piu, i tha Iakovit: “Afrohu tani, edhe puth-më, biri im”. Atëhere ay e bekoi edhe tha: “Perëndia të dhashtë nga vesa e qiellit, edhe nga të maiturit' e dheut, edhe mjaft grur' e verë; të shërbefshinë llauzëra, edhe të adhurrofshinë kombe, qofsh zot mbi vëllezërit e tu, edhe të bijat' e sat-ëmë të adhurrofshinë; qoftë mallëkuar' ay që të mallëkonjë ty, edhe qoftë bekuar' ay që të bekonjë ty”! (Gjen.27.. 1-29.)

Edhe posa dolli Iakovi e harriu Isafi ndë shtëpi nga të gjuajturitë, tuke mbajturë ndë dorë ca gjellë të shishme, edhe tha: “Ngru, ata im, edhe ha nga gjahu i t'yt biri, që të më bekonjë shpirti yt”. Edhe Isaaku u habit e tha: “Kush qe pra ay që gjuajti gjah, edhe më pruri, e hëngra nga të gjitha përpara se të vijsh ti, edhe e bekova atë, edhe qoftë bekuarë”. Edhe Isafi kur ndigjoi fjalët' e t'et, bërtiti me zë fort të math e fort të idhëtë, edhe i tha t'et: Beko-më edhe mua, o ata im!

Edhe ay tha: Yt-vëlla erdhi me gënjeshtëri, edhe mori bekimnë tënt”. Atëhere Isafi qjau me vajë të madhe. Edhe Isaaku tha: “Na të ndënjuritë t’at te do të jetë ndë dhe të maiturë, edhe ndë vesë të qiellit së sipërmi, edhe do të rronjë me thikët tënde, edhe do t’i shërbenjë t’yt-vëllai, po kur të bëhesh më i fortë, do të thyenjë sgjedhën e ati nga qafa jote”.

Prei këti Isafit kanë dalë Idhumenët’ e vietërë a Edhomët’, edhe Beduinët’ e Arabisë që gjendenë sot mbë këtë ditë. Idhumenëtë pas ca brezash ubënë Idhullatrë, edhe pastai qenë pushtuarë nga mbëreti Dhavidh, po sikundrë profitepsi Isaaku, ata ubënë të fortë, edhe shpëtuanë nga sgjedha ndë ditt të Ioramit, mbretit Iudhësë, edhe u bën’ arëmiqt’ e Israilit. Sëpastaimi ata muarrë besën’ e vërtetë, edhe Irodh Edhomiti qe mbëreti i Iudhevet, kur lindi Iisu-Krishti. Kryeqyteti i Idhumesë qjuhej Sella, a Petra, që do me thënë, shkëmb guri, edhe të rrënuarat’ e qytetit dukenë ngjer sot. Po vëndi është’i shkretë pa njerës. Kështu umbush profitia e Zotit me anë të Avdhiut e të tierëve profiteve.

Edhe Isafi e kishte mëri Iakovnë për punët të bekimit, edhe iupërgjërta se e kishte për të vrarë. Përandai e ëma e ngriti të birinë të ikëte nga shtëpi e ti, e tëvij tek i vëlla’ i sai Llavani, ndë dhe të Harranit. (Gjen. 27.. 30-45.)

Ndë këtë të ikurë Iakovi kishte për të hequrëshumë të këqia, që bijenë mbë kryet t’ati që gënjen tjetërinë. Kishte për të shëfryerë shumë të vështira mb’ udhë, do të linte të mirat’ e shtëpisë ti, e do të bëhej shërbëtuat ndë një gjëndëje të huaj; ay s’kish për të parë kurrë më t’ëmënë, edhe gjithë-një do t’i kishte frikë të vëllatë se mos ia shpaguante ndonjë herë për të gënjerët që i bëri. Edhe kur uplak ay, djemt’ e ati e mirrinë ndëpër këmbë, posi ay vetë pat gënjerët t’anë Isaaknë. Sa e vërtetë është këjo fjal’ e Shkronjëse: “Mjeri ti që prish, e nuk’ u prish; edhe mundon, e nuk’ umundove! Kur të pushojsh së prishuri, do të prishesh; kur të pushojsh së munduari, do të mundonesh”. Mos kujtoni, o djemthit’ e mi, se i pëlqeu Perëndisë gënjimi i Iakovit e i Revekësë: po ta març vesh nga këjo shëmbëllesë të mos bënë ndonjë punë që ta merr mëndëja se është’ e keqe, ndonëse ndë paç për të fituarë ndonjë gjë të madhe.

17. Udha që bëri Iakovi. 1760-1739 P.K.

Iakovi mori të lirë nga i ati, që i pat lënë fjalë të mos marrë grua nga të bijat’ e Hanaanit, po të vejë ndë Padhan-aram, e të marrë grua nga të bijat’ e Llavanit, të vëllait s’ëmësë. Ay tuke marrë udhë gjithë ditënë, mbrëmanet ndaloi në një vënt, edhe vuri një gur ndënë krye për të fjeturë, edhe si e zu gjumi, pa nd’ëndërrë një palë shkallë të gjata që harrininë nga dheu e ndë qiell, edhe ëngjëjt’ e Perëndisë tuke hipur’ e tuke sbraturë mb’ ato. Edhe ja Zotite po rrinte lart mb’ ato, edhe tha: “Unë jam Zoti Perëndia i Avraamit t’yt et, edhe Perëndia i Isaakut: këtë dhe që po fle përmbi atë kam për të dhënë ty, edhe farësë s’ate; edhe fara jote do të jetë posi rëra e dheut, edhe do të shtrihesh nga të perënduarit e nga të lindurit, e nga an’ e borësë, e nga an’ e mes-ditësë, edhe gjithë farat’ e dheut do të bekonenë te ti e te fara jote; edhe ja unë tek jam bashkë me ty, edhe do të të ruanj, ku-do që të veç, edhe do të të bije për-së-ri ndë këtë dhe, sepse nukë do të heq dorë prei teje, ngjer sa të bënë ato që të thashë”.

“Edhe Iakovi kur u sgjua nga gjumi, tha: Me të vërtetë Zoti qenëka mbë këtë vënt, edhe unë nuk’ e ditëkam. Edhe e muar frika, e tha:Sa i frikëshim qenëka ky vënt! Nuk’ është tiatërë gjë, veç shtëpia e Perëndisë, edhe këjo është dera e qiellit. Edhe Iakovi mëngoi që me natë, edhe mori gurrë që kishte vënë ndënë krye, edhe e ngrëhu për shtyllë, edhe derdhi vaj ndë majët t’ asai. Edhe ia vu emërin’ ati vëndi “Vethill” do me thënë, “shtëpia e Perëndisë”. (Gjen. 28.. 13-19.)

Passi bëri një udhë të gjatë, Iakovi erdhi ndë Harran, atie ku rrinte Llavani, edhe sikundrë Eliezeri upoqpërpara me Revekënë, kështu edhe ay upoq me Rahilën’ e bukurë ndaj pusin’ e ujit.

Ay e deshi atë, edhe i shërbeu Lllavanit shtatë viet për atë. Po Lllavani e gënjeu Iakovnë, e i dha Leahënë për grua ndë vënt të Rahilësë, edhe i tha të shërbenjë edhe shtatë viet të tiera për Rahilënë. Iakovi pat dy-mbë-dhietë djem, të cilët'ishin' atërit' e dy-mbë-dhietë faravet Israilit. Emërat' e atyreve ishinë: Ruvini, Simeoni, Levi, Iudhë, Dhan, Nafthali, Gadhi, Asiri, Issahar, Zavulon, Iosifi, edhe Veniamini.

Passi umbaruanë katërë-mbë-dhiet viet që pat shërbyerë, Iakovini ndenji edhe gjashtë viet të tiera bashkë me Lllavanë. Edhe Perëndia i bekoi, kaqë sa u bë fort i pasurë me shërbëtor' e me shërbëtore, e me kamilla, e me lopë, e me dhen. Për punë të gjësë që iushtua, Lllavani e kishte cmir të dhëndërrinë. Edhe Iakovini u dërgoi fjalë të dy të shokëvet tija, edhe djemvet tija, të vininë tek ay ndë fushët, edhe pasi ua pruri ndër mënt sa keq ia pat bër'i atij, u tha atyreve se ëngjëll' i Zotit i foli nd' ëndërrë, e i tha: Iakov! Edhe ay iu përgjeq: Ja te jam këtu. Atëhere ëngjëlli i tha – Unë pashë gjithë ç'të ka bërë ty Lllavani. “Unë jam Perëndia i Vethilësë, që leve shtyllënë, edhe më urove me uratë; tani ngreu, e dil prej këti dheu, edhe ukëthe ndë dhet të gjëndëjesë s'atë”. Edhe Rahila edhe Leahë iupërgjeqnë atij – Bën ç'të ka thënë Zoti ty. Atëhere Iakovini ungrit, edhe iku bashkë me gjithë grigjën' e kafshavet e me gjithë gjën' e tij, pa thënë gjë Lllavanit. Kur e mori vesh Lllavani, pastriti ditç, se kishte ikurë Iakovin, ay e ndoq prapa, edhe pas shtatë ditç udhë e zu. Po Perëndia iuduk nd' ëndërrë Lllavanit, e i tha: “Ruhu mos i flaç keq Iakovit”. Atëhere Lllavani bëri dhiatë bashkë me Iakovnë ndë mal të Galleedhit, edhe i lanë shëndet njeri jatrut, e undanë.

Iakovini i dërgoi laimësë Isafit, t'i epinë zë, se po vien. Edhe Isafini i doli përpara me katërë qint vetë, që të piqei me atë. “Edhe Iakovini ufrikësua fort, edhe ishte habiturë; edhe ndau gjëndëjenë që kishte me vete, edhe grigjën' e dhenet, edhe qetë, edhe kamillatë mbë dy tufë, e tha: Nd' arthtë Isafini mbi njërenë tufë, e t'i bierë, do të shpëtonjë tufa tiatërë. Edhe Iakovini tha: O Perëndia e t'im-eti Avraamit, edhe Perëndia i t'im-eti Isaakut, o Zot, ti që më the: Këthehu ndë dhet tënt, edhe ndë gjëndëjet tënde, edhe do të të bënj mirë. Shum' i vogëlë jam për gjithë përdëllimet, e për gjithë të vërtetënë që i ke bërë shërbëtorit tënt, sepse me shkoprë t'im kapërceva Iordhanë, edhe tani u bëshë dy tufash; të lutem, shpëto-më prej dorësë t'im vëllait, prej dorësë Isafit, sepse kam frikë mos vinjë të më bierë mua, edhe s'ëmësë djemet. Ti vetë the: Me të vërtetë do të të bënj mirë, edhe do të bënj farënë tënde posi rërën' e detit që s'munt ta numëronjë nga të shumëtë”. (Gjen. 32.. 7-12.) Edhe i dërgoi dhuratë Isafit të vëllait, nga më të miratë kafshat' e tija, e nga dhëntë, e nga kamillatë. Edhe u tha shërbëtorëvet që muarrë ato, t'i thonë Isafit, kur t'i pyesë: Të kujt janë këto? Se janë të Iakovit shërbëtorit t'yt: dhuratë dërguarë t'im-zot Isafit”. Edhe ay mori gjëndëjen' e tij ndë purrua të Iakovit, edhe Iakovini mbeti vetëmë natënë: “edhe përpiquej me një njeri bashkë me atë ngjer mbë të sbardhëlyerët”. Edhe si u sbardhëlye, i tha atij njeriu: “Le t'ikënj se usbardhëlye”. Edhe si u sbardhëlye, i tha atij njeriu: “Nukë të lë të ikësh, ndë mos më bekojsh”. Edhe ay tha: “Nukë do ta thonë më emërinë tënt Iakov, po Israil” (do me thënë, Fuqia e Perëndisë); sepse dole i fortë me Perëndinë, edhe me njerëzit do të jesh' i fortë”. (Gjen. 32.. 24-28.)

Iakovini kur pa të vëllanë Isafnë tike ardhurë, ungjii kryetë ngjer mbë dhe shtatë herë. Edhe Isafini ulëshua të piqetë me atë, edhe e rroku për qafe edhe qjau. Perëndia i këtheu zëmëren' Isafit, ndë vënt të arëmikut të bëhei mik. Përpara Isafini nukë donte të mirrte dhurëtit' e Iakovit, po Iakovini e nguti t'i marrë. Ani Isafini iku, e Iakovini erdhi për-së-ri ndë dhe të Hanaanit.

Ay njeriu që upërpoq Iakovin me atë, edhe doli i fortë, nuk' ishte si ç'do njeri, po ay ishte i Biri i Perëndisë, i cili, përpara se të vinte ndë botët, të rrinte bashkë me njerëzit, shumë herë u dëftye ndë fytyrë të njeriut mb'ata që i donte, për të shpëtuarë nga shtrëngimetë, e për të forcuarë ndë

besët. Nd' atë të përpiekur' ay e la Iakovnë të dalë i fortë, edhe të marrë bekim nga ay, që t'u apë zëmërë llauzit ti ngjer mbë kohë të pastaimë të qëndronjën' e të jenë të nxehëtë mbë lutjet.

Edhe Iakovi ia vuri emërin' ati vëndi Fanuil, tuke thënë, "se pashë Perëndinë faqe ndër faqe, edhe m'uruajt jeta". Që atë herë Iakovi çalonte me një këmbë.

18. Të shiturit' e Iosifit. 1729 P.K.

Nga gjithë të bijt' e Iakovit që kishinë lindurë ndë Padhan-aram, Iosifi ishte më i vogëli, të cilin' e kishte piellë Rahila; Veniamini që kishte lindurë ndë Hanaan ishte i dy-mbë-dhiet. Edhe Israili donte Iosifnë më fort se djemt' e tierë, edhe i kishte dhënë një rrobë të bukurë. Përandai të vëllazërit' e ati i kishinë cmir, edhe i kishinë mëri, kaqë sa nuk' i flisinë kurrë me të mirë. Edhe Iosifi pa një ëndërrë sikur ishinë ndë fushët, e po lidhinë dorëza, edhe dorëzat' e të vëllazëret i ulnë kryetë dorëzësë ti. Kur u dëfteu atyre këtë ëndërrë, ata i zunë mëri më tepërë. Pastai një tiatërë herë u tha atyre: "Na te pashë një tiatër' ëndërrë: edhe na dielli edhe hëna edhe të një-mbë-dhiet' yjetë më adhuroninë".

"Edhe i ati e qërtoi atë, edhe i tha: Ç' ishte këjo ëndërrë që pe? Vallë do të vimë, un' edhe jot-ëmë, edhe t'ët vëllezërë, që të adhurojmë ty ngjer për dhe? " (Gjen. 37.. 9,10.) Po i ati i ruante këto fjalë.

Një ditë Iakovi dërgoi Iosifinë të shohë të vëllezëritë, atie ku po kullojnë dhëntë, mbë një vënt ca ditt lark nga Hevroni. Ay i gjet ata ndë Dhothan. Ata kur pan' atë tuke ardhurë, i thanë njëri jatrit: "Ja te po vien ay që pa ëndërratë: - leta vrasëmë, - edhe do të shohëmë ç' do të bëhen' ëndërrat' e ati". Po Ruvini më i madhi vëllazëret tha: Mos derthni gjak, hidheni ndë këtë gropë", sepse ay e kishte ndër mënt të vinte pastai fshehuraj ta nxirte.

Passi e hothnë ndë gropët, ata panë ca tregëtarë Ismailitë te po shkonin' udhësë për ndë Misir. Atëhere ata e nxuarrë nga grupa, edhe ua shitnë Ismailitëvet për njëzet copë argjent. Edhe ata muarrë rrobën' e ati, edhe thernë një keth, edhe ngjyenë rrobënë ndë gjakt, edhe ia prunë t' et, e i than: "Kemi gjeturë këtë: ngjih-e tani, vallë mos është rroba e t'yt-bir, apo jo? Edhe ay e ngjohu, edhe tha: Është rroba e t'im-biri, bish' e keqe e pasëka ngrën' atë, Iosifi qënëka copëtuarë fare". "Edhe u ngritnë gjithë të bijtë, edhe gjithë të bijatë për të ngushulluar' atë, po ay nukë ngushullonei, e thoshte, se tuke mbajturë zi do të sbres ndë varrt tek im-bir". (Gjen. 37.. 23-35.)

19. Iosifi ndë Misir. 1729-1716 P.K.

Ismailitëtë muarrë Iosifnë ndë Misir, edhe ia shitnë Petefriut për shërbëtuar, i cili ishte njeriu i Faraonit, i pari ushtëtorëvet. Edhe i zoti kur pa se Iosifi ishte i mënçim edhe i dreitë, edhe pa se Perëndia ia bënte mbarë gjithë punëtë, ay e vuri kujdestar përmbi shtëpit, edhe ia la në dorë të gjitha. Kështu Iosifi shkoi ditt të mira edhe kur ishte shërbëtuar.

Petefriu kishte një grua të keqe, ajo nguti Iosifnë mbë punë të keqe edhe mbë fëlliqëri, po Iosifi nukë ndigjoi, edhe i tha asai: "Qysh të bënj këtë punë të keqe, edhe të fëjnj kundër Perëndisë?"

Kur e pa gruaja se s'munt ta bënte Iosifnë të fëjnjë, ajo shpifi fjalë të këqia për Iosifnë tek i shoqi. Atëhere Petefriu e vu ndë burk. "Po Zoti ishte bashkë me Iosifnë, edhe bëri përdëllimtek ay, edhe i dha hir ati përpara ruanjësit parë".

Nd' atë kohë ishinë brenda ndë burk dy vetë nga njerëzit' e mbëretit, bukë-piekës' i parë, edhe verë-qitës i parë. Një ditë ndë mëngjes Iosifi sheh këta se ishinë fort idhëruarë, edhe i pyeti

për ç'punë ishin' idhëruarë, ata i thanë se të dy atë natë panë ëndërra, edhe s'gjëndetë njeri t'i s'gjithnjë. Edhe Iosifi u përgjeq: "A nuk' i përkasnjënë të s'gidhuratë Perëndisë? Më dëfteni, u lutem juve".

Edhe verë-qitës' i parë tha: "Pash nd' ëndërrë, sikur ishte një hardhi përpara meje, edhe ndë hardhit ishinë tri dega, edhe dukej sikur po mbinte, edhe sbërthyenë lulet' easai, edhe u poqnë pupat' e rrushit; edhe potiri i Faraonit ishte përpara meje, edhe mora rrushtë, e i shtrydha ndë potir të Faraonit, edhe ia dhashë potirnë ndë dorë Faraonit". Edhe Iosifi i tha: "Të tria degatë janë tri ditt; pas tri ditç Faraoni do të ngrerë kryetë tat, edhe do të të vërë ndë punët tënde, edhe do t'i apç' potirnë ndë dorë Faraonit posi përpara, kur ishnje verë-qitës' i ati; po kujto-më, kur të bëhetë këjo e mirë ty, edhe ia zërë n'gojë Faraonit për mua, edhe nxir-më nga këjo shtëpi".

Kur pa bukë-piekës' i parë se ia s'gidhi mirë ëndërrënë verë-qitësit parë u gëzua, edhe i tha Iosifit: "Edhe unë pashë nd'ëndërrë, sikur kishnjem tri kanistra të bardha mbi kryet t'im, edhe ndë kanistrët të sipërme ishinë nga gjithë gjellët' e Faraonit, të mieshtërisë bukë-piekësit, edhe zoqt' i hëngrë ato nga kanistratë që kishnjem përmbi krye". Edhe Iosifi i tha: "Të tri kanistratë janë tri ditt, pas tri ditç Faraoni do të ngrerë kryetë tat sipërë teje, edhe do të të varnjë mbë drut, edhe zoqtë do të hanë mishtë tat përsipërë teje".

Edhe qilloi mbë të tretënë ditë, Faraoni kur po kremtëronte ditën' e të lindurit ti, i ra ndër mënt për ata të dy që i kishte vënë brenda, edhe ay vuri për-së-ri mbë këmbë të parë verë-qitësinë, po bukë-piekësin' e vari, sikundrë u pat thënë atyre Iosifi, po verë-qitësi nuk' e pru ndër mënt Iosifnë, po e harroi, edhe kështu ay bëri edhe dy viet të tierë ndë burk. – Perëndia e di se kurë është koh' e mirë për shpëtim.

20. Të lartuarët' e Iosifit. 1715 P.K.

Pas dy vieç Faraoni pa një ëndërrë, edhe asnjeri s'qe i zoti t'ia s'gjithte. Tani verë-qitësit parë i ra ndër mënt ç'i qe zotuarë Iosifit. I tha mbëretit se ishte një dialosh ndë burk, që na pat s'gidhur' ëndërratë mua edhe bukë-piekësit parë. Përnjëherësh nxuarnë Iosifnë nga burgu, edhe e prunë përpara mbëretit. "Faraoni i tha Iosifit: Pashë një ëndërrë, edhe s'gjëndetë njeri të ma s'gjithnjë, edhe ndigjova se thonë për ty, se di të s'gjithç ëndërratë. Edhe Iosifi u përgjeq: Jo unë po Perëndia do t'i apë Faraonit një të përgjegjurë shpëtimi. Edhe Faraoni i tha Iosifit: Pashë nd'ëndërrët t'ime sikur po rrinjam mbë buzë të lumit, edhe ja shtatë dema të ushqyershim e të bukurë te po hipëninë nga lumi, edhe po kullotinë ndë livath; edhe ja shtatë dema të tierë te po hipëninë prapa atyre, të ligëtë, e shumë të shëmëtuarë, e të thatë, sa s'kam parë kurrë më të shëmëtuarë ndëpër gjithë dhen' e Misirit; edhe këta demat' e hollë edhe të shëmëtuarë hëngrë ata të shtatë demat' e parë të majturitë; edhe si hynë ndë barkt t'atyre, nukë dukeshinë se hynë ndë barkt t'atyre, po të parët' e atyre ishte të shëmëtuarë posi përpara; atëhere u s'gjova. Pastai pashë nd' ëndërrët t'ime shtatë kallinj te po hipëninë prei një kallami të plotë edhe të mirë; edhe ja shtatë kallinj të tierë të thatë e të hollë, e të diegurë nga era e diellit te mbinë prapa atyre, edhe këta kallinj' e hollë përpinë ata kallinj' e mirë":

"Edhe Iosifi i tha Faraonit: Ëndërra e Faraonit është një: Perëndia i dëftoi Faraonit sa ka për të bërë. Të shtatë demat' e mirë, janë shtatë viet, edhe të shtatë kallinj' e mirë janë shtatë vietë, ëndërra është një. Edhe të shtatë demat' e hollë e të shëmëtuarë që hipëninë prapa atyre, janë shtatë viet; edhe të shtatë kallinj' e pa-mbushurë, edhe të diegurë nga era e diellit do të jenë shtatë viet urie. Këjo është puna që i thashë Faraonit: Perëndia ia dëftoi Faraonit sa ka për të bërë. Ja te vinjënë shtatë viet plot me të mira ndëpër gjithë dhen' e Misirit; edhe do të vinjënë pastai shtatë viet urie, edhe gjithë të mirat do të harronenë ndë dhet të Misirit, edhe uria ka për të

prishurë dhenë, edhe s'kanë për të ngjohurë të miratë mbi dhet për punë t'asai urie që do të vinjë prapa, sepse do të jetë fort e rëndë. Edhe se iu duk dy herë ëndërra Faraonit, dëften se puna është urdhëruarë nga Perëndia, edhe Perëndia e ka për të bërë së shpejti. Tani pra Faraoni letë gjenjë një njeri të mençim e të urtë, edhe leta verë përmbi dhet të Misirit: letë bënë Faraoni, edhe le t'urdhëronjë kujdestarë mbi dhet, edhe letë marrë të pesëtën' e dheut Misirit, nd' ato të shtatë vietë plot me të mira, edhe letë mbëledhënë gjith' ushqimet' e atyre të shtatë vietet mirë që vinjënë; edhe letë mbëledhënë drithë ndënë dorët të Faraonit, për ushqime të qytetevet, edhe le ta ruanjënë; edhe ushqimetë të ruhenë për dhenë për ato të shtatë viet' e urisë që kanë për t'ardhurë prapa ndë dhet të Misirit, që të mos humbasnjë vëndi nga uria.” (Gjen. 41.. 1-36).

Edhe Faraonit i pëlqeu të sgjidhurit' e ëndërrësë, edhe këshilleja e mirë që i dha. “Edhe Faraoni u tha shërbëtorëvet: A munt të gjejmë posi këtë njeri që ka frymën' e Perëndisë?” Kështu Faraoni vu Iosifnë përmbi gjithë dhenë, edhe i tha: “Veç mbë shkëmbt unë do të jem më i mathse ti”. Edhe ay nxori unazënë nga dora e ti, edhe ia vuri ndë dorë Iosifit, edhe e veshi me rroba të kuqe, edhe i vari një vark t'artë ndë qafët, edhe e hipi ndë qerret të ti të dytënë, edhe leçitinë përpara ati: “Biri mbë gjunjë”. Edhe Faraoni i tha Iosifit: Sa të jem unë Faraoni, pa ty asnjeri s'ka për të ngriturë dorën' e ti a këmbën' e ti ndëpër gjithë dhen' e Misirit”. (Gjen. 41.. 37-44.)

Kështu Perëndia mori prapë Iosifnë nga shtëpia e t'et ndë gropët – ngagropa ndë shërbëtyrë e ndë burk – edhe nga burgu ndë pallatet të mbëretit. Iosifi qe afëro shtatë-mbë-dhietë vieç kur ushit ndë Misir, edhe tri-dhietë vieç kur doli përpara mbëretit.

21. Të vëllezërit' e Iosifit vinjënë ndë Misir. 1708 P.K.

Sikundrë i pat dëfyerë përpara Perëndia, kështu qëllloi. Erthnë të shtatë vietë plot me të mira, edhe Iosifi mbëlodhi të pesëtën' e gjithë grurit ndëpër gjithë dhen' e Misirit; edhe kaqë shumë mbëlidhinë, sa më e lanë mbë-nj-anë të maturitë. Kështu pasandaj erthnë edhe të shtatë viet' e zisë; edhe vitn' e parë që s' gjëndej drithë, kaqë një zi e madhe ubë ndëpër gjithë dherat, sa gjithë blerë drithë nga Iosifi.

Kishte rënë zia edhe ndë dhet të Hanaanit. Atëhere Israili u thotë të bijet: “Ç'viri re ndër sy njëri jatinë? Ja te kam ndigjuarë, se gjëndetë drithë ndë Misir: sbritni atie, edhe blini për ne andej që tërroimë e të mos vdesmë”. Kështu të dhietë vëllezërit vanë ndë Misir. Vetëmë Veniamini mbeti bashkë me tanë. Ata i duallë përpara Iosifit, edhe i ulnë kryetë ngjer për dhe, posi përpara një Misirasi të math. Ay ndonëse i ngjohu ata, po shtiu vetëhenë për të huaj tek ata, edhe u foli vrazhëtë, e u tha: “Nga vini?”. Edhe ata u përgjeqnë: “Nga dheu i Hanaanit, për të blerë drithë”. Iosifi tha: Ju ini përgjonjës, kini ardhurë për të vënë re të sveshurat' e vëndit. Edhe ata i thanë: Na të gjithë jemi të bijt' e një njeriu, jemi njerës të mirë, na shërbëtorët' e tu nukë jemi përgjonjës”. Edhe Iosifi u tha atyre: Me këtë ini për të marrë vesh. Dërgoni një prei jush, edhe letë bierë vëllanë tuaj, edhe ju të tierëtë do të mbetni këtu lidhurë”.

Edhe ay i vuri mbë-nj-anë të ruhenë, edhe i la atie tri ditt. Të tretënë ditë i pruri përpara përsë-ri, edhe u tha: “Këtë bëni ndë dashi të rroni, sepse unë kam frikë Perëndisë: ndë qofshi njerës të mirë, njëri nga vëllezëritë tuaj letë mbesë lidhurë ndë burk, aty ku ini, edhe shkoni, merrni grurë për urin' e shtëpivët tuaj, po më birni vëllanë tuaj më të vogëlinë; kështu atëhere do të dalënë të vërteta fjalëtë tuaj, edhe s'kini për të vdekurë”. Atëhere vëllazëritë thonë njëri jatrit mbë gjuhë të tyre: “Me të vërtetë jemi fajtorë për vëllanë t'ënë, sepse pam shtrëngimn' e shpirtit ati, kur na lutej, e nuk' e ndigjuam, përandai na ra ky shtrëngim mbi kryetë”. Ata nukë dijnë se Iosifi i merrte vesh, ata kujtoninë, se ay ishte një Misiras, po ay kur dëgjoji këto fjalë, këtheu vetëhenë mbë-nj-anë nga ata, edhe qjau. Atëhere ay urdhëroi të lidhetë Simeoni përpara syvet

atyre, e të vihete në burk, edhe të tierëte vanë në shtëpi te Iakovi në Hanaan. Po kur dëgjoji plaku gjithë këto punë, u pikllua fort, e tha: “Më latë pa dialë: Iosifi nuk’ është, edhe Simeoni nuk’ është, doni të merrni edhe Veniaminë, të gjitha këto ranë mbi kryetë t’im”. (Gjen. 42.. 1-21, 36, 38.) Edhe ay nukë deshi të lirte Veniaminë të vij bashkë me ata.

22. Udh’ e dytë që bënë të vëllezërit’ e Iosifit. 1708 P.K.

Po zia për bukë ishte kaqë e madhe në dhe të Hanaanit, sa të bijt’ e Iakovit ushtrënguanë të vininë në Misir për-së-ri. Iakovi s’donte t’u ipte Veniaminë të vinte bashkë me ata, po s’kishte se ç’të bënte. Ay u dha atyre edhe dhurëti të mira nga ato që nxirte vëndi i Hanaanit, ballsam e mialtë, erëra të mira e mirrë, arra e mandorlë, edhe tha: “Perëndia fuqi-madhi u dhashtë hir përpara njeriut, që t’u lëshonjë vëllanë tiatër’ edhe Veniaminë, edhe unë letë mbes pa dialë, letë mbes pa dialë”.

Iosifi kur e muar vesh se harrinë, urdhëroi, e i prunë përpara ati, edhe u foli ëmbëlë: “Është shëndoshë ata i uaj, ay plaku që më pattë thënë? Ky është vëllai juaj më i vogëli, që më pattë thënë? Edhe tha: Perëndia të përdëlleftë diali im”. Ay kur pa Veniaminë, s’mundi më të mbante vetëhenë. Po i përvëlonei zëmëra për të vëllezërit, edhe ay hyri brenda, e qjau. (Gjen. 43.. 26-30.)

Atëhere si lau sytë, duall përjashta për-së-ri, edhe mbajti vetëhenë. Ay i thirri ata të drekonjë në bashkë me atë, edhe urdhëroi të vënë bukë, edhe vuri një truvezë veç për atë, edhe një tiatërë veç për ata, pas zakonit dheut atyre. Vëllezërit’ uçuditë fort, kur panë se i vu të rrinë në truvezët gjithë-se-cilinë pas moshës atyre, edhe ata ugëzuanë fort.

Atëhere Iosifi urdhëroi t’u mbushinë thasëtë me grurë, edhe gjithë-se-cilit t’ia vënë argjëndinë në grykë të thesit, po në thes të Veniaminit të vënë edhe potir’ e verësë të argjëntinë që pinte Iosifi me atë. Posa kishinë dalurë jashtë, Iosifi dërgoi prapa atyreve kujdestarin’ e ti e u thot’ atyre: “përse bëtë keq në vënt të së mirësë?” Vëllezëritë vunë re ndër sy njëri jatinë, edhe s’ po mirrinë vesh, përse thot’ ashtu. Edhe kujdestari u thot’ atyre: “Nuk’ është ky potiri, që pi im-zot’ me atë, kush e ka viedhur’ atë?” Edhe ata thanë: “Përse flet këto fjalë, zoti im? Na jemi njerës të mirë: ati shërbëtori prei nesh që t’i gjëndetë potiri, letë vritetë, edhe na do t’i bëhemi shërbëtorë zotit t’ynë”. Përnjëherë sgjithnë thasëtë, edhe shikuanë, edhe potiri u gjënt në thes të Veniaminit. Atëhere ata grisenë rrobatë, edhe ukëthyenë në qytet.

Passi i prunë për-së-ri përpara Iosifit, ay i pyeti shumë mëndyrësh për potirinë. Atëhere Iudha zu të flasë: “Ç’t’i themi zotit t’ynë? Ç’të flasëmë? A qysh do të lajmë vetëhenë? Perëndia gjeti të shtrembërën’ e shërbëtorëvet tu: ja te jemi shërbëtorët’ e zotit t’ynë edhe na, edhe ay që iugjënt potiri”. Iosifi tha: Qoftë lark, të bënë unë këtë punë; ati njeriu që iugjënt potiri, ay do të bëhetë shërbëtori im, po shkoni në paqtim tek ata juaj”. (Gjen. 4.. 1-17.)

Atëhere Iudha zu e foli, edhe iu lut fort, që të mos bëhetë këjo punë. “Tani pra kur të vete te shërbëtori yt im-atë, e të mos jetë çuni bashkë me mua, (sepse jeta e ati varetë në jetët të dialit.) posa të shohë se nuk’ është çuni, do të vdesë, edhe shërbëtorët’ e tu do të sbresënë në varr qimet’ e bardha të shërbëtorit t’yt atit t’ynë bashkë me idhërim. Sepse unë shërbëtori yt ubëshë dorë-zënës për çunë tek im-atë, e i thashë: Në mos ta prufsha atë, do të jem fajtuar tek im-atë gjithë monë. Tani pra të lutem, letë mbesë shërbëtori yt tek im-zot në vënt të çunit, edhe çuni le të vejë bashkë me vëllezërit e ti. Sepse qysh të vete tek im-atë pa çunë? Që të shoh të keqenë që e ka për të gjeturë te m-atë”. (Gjen. 44.. 16-34.)

Tani Iosifi pa se të vëllezërit’ ishinë përungjurë për fajinë, edhe i hante zëmëra për tanë, edhe donte Veniaminë; edhe ay s’mundi më të mbante vetëhenë; ay bërtiti të dalënë jashtë gjithë Misirasitë, as ndonjë i huaj mos jetë, kur nxuar për faqe vetëhenë Iosifi te të vëllezërit. Atëhere

ay derdhi lott pas faqesë, edhe bërtiti me zë të math tuke qjarë: “Unë jam Iosifi, është gjall im-atë?” Edhe të vëllezëritë s’ mundinë t’i përgjegjëshinë, sepse upërzienë prej sysh ati. Turp e frikë upërzienë bashkë me gëzim e me çudi, kaqë sa të gjithë ndënjnë si të ngrirë. Atëhere ay u tha të vëllezëret: “Afrohi për-anë meje, u lutem”. “Edhe ata u afruanë. Ani u tha atyre: Unë jam Iosifi vëllai juaj që shittë ndë Misir. Tani pra mos hidhërohi, as mos u vinjë keq, se më shittë këtu, sepse Perëndia më dërgoi përpara jush që t’u ruanj jetënë. Edhe epni zët’im-et për gjithë lavdinë t’ime ndë Misir, edhe gjithë sa patë, edhe nxitoni të bini t’em-atë këtu”. (Gjen. 45.. 1-24.)

Edhe ay qafoi Veniaminë të vëllanë, edhe qjau, edhe Veniamini qjau mbë qafë t’ati. Po ay puthi të vëllezëritë, edhe qjau mbi ata; ani më të vëllezëritë folnë bashkë me atë. Vetë mbëreti dërgoi të thërresë Iakovnë që të vinjë ndë Misir, edhe Iosifi i dërgoi t’et qerre për udhënë, edhe të tiera dhurata të vëjyera.

Edhe Iosifi kur u la shëndet të vëllezërvet, u tha: “Shikoni mos hidhërohi mb’udhë”, edhe ukëthyenë ndë Hanaan plot me gëzim.

23. Iakovi vete ndë Misir. 1706 P.K.

Posa ukëthyenë djemtë tek i ati bërtitnë: “Iosifi është gjallë, edhe ay është i pari gjithë dheut Misirit. Po Iakovi nuk’ u zinte besë atyre. Po ata passi i dëftyenë gjithë fjalëtë që u pat thën’ atyre Iosifi, edhe kur pa qerretë që kishte dërguarë Iosifi, iungjall shpirti Iakovit, edhe bërtiti: “Mëjaft, Iosifi im-bir rruaka: do të vete, e do ta shoh, përpara se të vdes”. (Gjen. 45.. 28.)

Kështu Jakovi vate ndë Misir bashkë me djemt e me të nipërit, gjashtë-dhiet’ e gjashtë vetë, dhe bashkë me gjithë gjën’ e ti, edhe me gjithë shërbëtorët e me gjithë shërbëtoret. Edhe Iosifi doli përpara mbë qerret të ti të presë t’anë, edhe iu lëshua mbë qafë edhe qjau shumë mbë qafë t’ati.

Edhe Israili i tha Iosifit: “Tani letë vdes, se të pashë sytë, sepse ti qënëke gjallë”. Edhe nxori përpara Faraonit Iakovnë tanë. Mbëreti e pyeti: “Sa vieç je ti?” “Edhe Iakovi i tha Faraonit: Ditt’ e vietet mi ndë dhe të huaj janë një qint e tri-dhietë viet; ditt’ e vietet jetësë s’ime qenë të paka edhe të këqia, edhe nukë harrinë ditt’ e vietet jetësë përingëvet mi ndë ditt t’atyre ndë dhe të huaj”. (Gjen. 47.. 1-9.)

Iakovirro i shtatë-mbë-dhietë viet ndë Misir. Kur i erdhi e pastaimeja ditë, Iosifi erdhi bashkë me të dy bijt, Efraimn’ edhe Manasinë, për të parë tanë te po vdiste. “Edhe Israili i tha Iosifit: Nukë shpërenjem të shihnjem ty sytë, edhe ja Perëndia te më dëftoi edhe farënë tënde”. Edhe Iosifi mori të bijt’ e i vuri përpara t’et që të verë duartë mbi ata, e t’i bekonjë. Edhe Israili vu dorën’ e diathtë mbë krye të Efraimit më të vogëlit, edhe të mëngjërënë mbi krye të Manassiu dialit parë, edhe i bekoi e tha: “Perëndia, përpara të cilit ecnë atërit’ e mi Avraami edhe Isaaku, Perëndia që më kulloti që kur linda ngjer mbë këtë ditë, që më shpëtoi nga gjithë të këqiatë, bekoftë këta çuna, edhe uqjuajtë emëri im mbi ata, edhe emëri i atërvet mi Avraamit edhe Isaakut, edhe ushtofshinë fort shumë mbi dhet”! (Gjen. 48.. 5-16.) Kështu ay u dha atyre një bekim bashkë me djemt e ti, kështu pra nga Efraimi edhe nga Manassiu duallë të dy farat’ e llauzit Israilit; ani u tha edhe më se “Kur të bekonjë ndonjë nga Israili, le të thotë: Perëndia të bëftë posi Efraimin’ e posi Manasinë”.

Ani Iakovi, kur po vdiste, mbëloth gjithë të bijtë rreth shtratit, edhe gjithë-se-cilin’ e bekoi veç e veç.

Atëhere kur bekoi Iudhënë, Iakovi foli atë profiti të shënuarshime për Shpërblimtarinë, se kish për të lindurë nga fara e Iudhësë, edhe se kish për të mbëretëruarë jo vetëmë mbi Israilinë, po mbi gjithë kombet: - “S’është për të ngriturë shkopi nga Iudha, as ligjë-dhënësi nga mesi

këmbëvet ati, ngjer sa të vinë Shillohu edhe mb' atë do të shpërenjënë kombetë” (Gjen. 49.. 10.) Tuke parë kohënë që kishte për t'ardhurë me anë të Frymësë Perëndisë, ay u dëfteu të bijet se ç'do të bënei pas fëmijvet atyre; edhe pastai porositi ata ku ta vënë ndë varr, pasandy hoqi këmbëtë ndë shtrat, edhe dha shpirtinë.

Pas vdekëjesë Iakovit, Iosifi edhe të vëllezëritë, bashkë me gjithë krerët e Misiraset, e me qerre e kalëri, ngritnë të vdekurinë, edhe e prunë ndë dhe të Hanaanit, edhe e vunë ndë varrt, ndë shpellë të Mahpellahut ndaj Avraamnë. Passi ukëthyenë prapë ndë Misir, të vëllezërit' e Iosifit kishinë frikë tani që u vdiq i ati, mos ua shpaganjë atyre për të keqenë që i patnë bërë. Po Iosifi u tha atyre:“Mos kini frikë, sepse unë nukë jam ndë vënt të Perëndisë. Ju bëtë këshille të keqe kundrë meje, po Perëndia deshi ta këthenjë këtë për të mirë, që të bëhetë posi sot, që të shpëtonjë jetën' e shumë llauzi”. (Gjen. 50.. 15-21.)

Tani ju do ta merrni vesh, për ç'punë Iosifi i shtrëngonte kaqë fort të vëllezëritë, përpara se të shpërfaqej tek ata. Jo se e kishte ndër mënt që t'u bënte keq atyre, po Iosifi bëri kështu, për të marrë vesh mëndien' e të vëllezërëvet, se si e kishinë njëri mbë tiatrinë, e mbë tanë, e mb' atë vetë, sepse ishte nevojë që ta dinte këtë, që të munte t'u bënte mirë atyre. Kështu Iosifirroi bashkë me të vëllezërit, edhe pa djem e nipërë e stërnipërë.

Edhe Iosifi ndenji ndë Misir bashkë me njerëzit e shtëpisë t'et. “Edhe Iosifirroi një qint e dhietë viet. Edhe Iosifi u tha të vëllezëret: Unë po vdes, po Perëndia me të vërtetë do t'u vështronjë juve, edhe do t'u shpjerë juve nga ky dhe nd' atë dhe që upërbetua Avraamit e Isaakut e Iakovit. Edhe Iosifi i vuri mbë be të bijt' e Israilit, e u tha: Perëndia me të vërtetë do t'u vështronjë juve, edhe do të mirrni eshtërat' e mia së këtëjmi. Edhe Iosifi vdiq një qint e njëzet vieç moshë, edhe e vunë ndë një arkë ndë Misir”. (Gjen. 50.. 24-26.)

24. Provimi i Iovit. 1520 P.K.

Nd' atë kohë rronte një njeri, që e kishte emërinë Iov. Ay ishte një njeri shumë i pasurë, edhe fort besëtar. Atë e donin' edhe e kishinë për nder të gjithë. Ay nukë rrinte as ndë Hanaan as ndë Misir, po ndë dhe të Aysitëdhësë, që ishte një pjesë e ati vëndit, që qjuhetë tani Arabi. Ay kishte shtatë bij e tri bija, ata shumë herë mbëlidheshinë ndëpër shtëpit të njërit e të jatrit, e bëninë gosti, edhe si mbaroneshinë ditt' e gostisë, Iovi ngrihej heret ndë mëngjes, e bënte kurban për djemt e ti, se mos kishinë fëjyerë mbë Perëndinë.

Satanai foli keq për Iovnë, se besa e ati nuk' ishte me gjithë zëmërë, po ay i shërbente Perëndisë, sepse Perëndia ia bënte mbarë punëtë. Edhe Perëndia e la Satanënë ta provonte, që të shihte se e donte me të vërtetë Perëndinë Iovi. Kështu Perëndia e la Satanënë t'i marrë Iovit gjithë ç'kishte, po vetëmë Iovit mos i bënte keq.

Një ditë, të bijt' e ati e të bijat' e ati po hanin' e po pininë verë ndë shtëpi të vëllait parë. Edhe erdhi një i laim te Iovi, e tha: Qet'ishinë tuke ngarë, edhe gomarëtë po kullotinë për-anë atyreve, edhe ranë Saveanët' e i rrëmbyenë, edhe shkuanë shërbëtorëtë ndëpër gojë të thikësë, edhe unë vetëmë shpëtova (e arthçë) t'ap zë ty.

Edhe ky kur ish tuke po folurë, erdhi një tiatërë, e i tha: Ra ziarr Perëndie nga qielli, edhe dogji dhënt' edhe shërbëtorëtë, edhe i hëngrrë; edhe unë vetëmë shpëtova, (e erdha) t'ap zë ty.

Edhe ky kur ishte tuke po folurë, erdhi edhe një tiatërë, e i tha: Haldheanëtë bërë tri tufash, uturnnë mbi kamillat, edhe i rrëmbyenë, edhe shkuanë ndëpër gojë të thikësë shërbëtorëtë, edhe unë vetëmë shpëtova, (e arthçë) të ap zë ty.

Edhe ky kur ish tuke po folurë, erdhi një tiatërë, e tha: Bijt' e tu edhe bijat' etua te po hanin' e te po pininë verë ndë shtëpi të vëllait parë, erdhi një er' e madhe nga shkretëtira mb'-at'-

anë, edhe i ra të katrë kandevet shtëpisë, edhe ra mbi fëmijët, edhe vdiqnë; edhe unë vetëmë shpëtova, (e erdha) të ap zë ty.

Atëhere Iovi u ngrit e shqeu rrobën' e ti, edhe rruajti kryet' e ti, edhe ra për dhe e adhuroi, edhe tha: Lakuriq dolla nga barku i s'imëje, edhe lakuriq do të këthenem atie: Zoti i dha, edhe Zoti i mori, qoftë bekuar' emëri i Zotit.

Ndër gjithë këto Iovi nukë fëjeu, as nuk' i dha marrëzi Perëndisë". (Iovi 1.. 1-22.) Iovi nukë dinte për ç'punë e la Perëndia t'i bijnë mbë krye këto të zeza, po ay e dinte, se Perëndia ia pat dhënë të gjitha përpara, edhe ay munt t'ia mirrte prapë të gjitha, kur ta shihte me udhë.

Po Satanai për-së-ri fliste keq për atë, e thosh, se ndë pat hequrë keq ndë kurm të ti, do të kishte nemurë Perëndinë. Edhe Perëndia e la Satananët' i bënë keq Iovit ndë kurmt; veç mos i marrë jetënë. Edhe Satanai i ra Iovit me plagë të keqe, që prei shollësë këmbëvet, ngjer ndë majë të krejsë, edhe ay nukë ndiente vetëmë të dhëmburat' e plagëvet, po e kishinë të ndyrë edhe miqt' e ti. Po Iovi tha: "Do të marrëmë vetëmë të miratë nga Perëndia, e nukë do të presëmë edhe të këqiatë".

25. Iovi edhe miqt' e ti. 1520 P.K.

Erthnë tre miqt' e Iovit për të parë e për të ngushulluar' atë. "Edhe kur ngritnë sytë për së largu, edhe nuk' e ngjohnë, ngritnë zën' e qjanë, edhe shqyenë gjithë-se-cili rrobën' e ti, edhe derthnë pluhurë mbi krerët e tyre për qiell. Edhe ndenjnë bashkë me atë për dhe shtatë ditt e shtatë nett, edhe asnjë nuk' i foli një fjalë ati, sepse shihinë se të dhëmburit e ati ishte fort i math".

Edhe Iovi kur po priste t'i flisinë ndonjë fjalë për të ngushulluar' atë, ata zunë t'i flisinë keq. Ata kujtoninë, se Iovi po hiqte mb' atë mëndyrë, sepse s'kishte qënë njeriu i mirë, sikundrë patnë kujtuar' ata kurdo për atë, po thoshinë se ay pasëka qënë ipokrit gjithë monë – a se pasëka bërë pshehurazi ndonjë punë fort të keqe, - e përandai po e munduaka tani Perëndia për fajet e ti. Ata i thanë Iovit, se të pate qënurë njeri i mirë, do të kishte ndihurë Perëndia, edhe e këshilloninë të pendonetë për të këqiat' e ti.

Iovi u përgjeq miqet, e u tha, se s' kishte faj. Ay e dinte, se s'kishte bërë ndonjë faj, për sa ata i vininë barr' ati. Ay tha, se nga një herë shumë të këqia bijenë mbë kryetë të njerëzëvet mirë, edhe u lutej miqet t'u dhëmbetë për atë, edhe rëkonei se s'kishinë të dhëmburë për atë. Ay thirri Perëndisë t'i dalë zot, e thoshte: "Edhe ndë më vraftë, unë do të shpërenj mb' atë".

Edhe Iovi tha: -

"Oh të shkruheshinë fjalët' e mia, e të shtypeshinë ndë vivli!

Të gërvishteshinë mbë shkëmb të gurit me pëndë të hekurit e të plumit për gjithë monë!

Sepse e di se rron Shpërblyesi im, edhe do të ngrihetë ndë kohëra të pastaimë mbi dhet;

Edhe passi të vdiqetë ky kurmi im bashkë me lëkurënë t'ime, për-së-ri do të shoh Perëndinë me mishnë t'im.

Unë vetë do ta shoh atë, edhe syt' e mi do ta vënë re, e jo tiatërë, ndonëse veshnjët' e mia tretenë ndë gjit t'im".

Po miqt' e ati qëndronin' e thoshinë, se ishte fajtuar, edhe si u hëngrë shumë ndër mest atyreve, Perëndia hyri ndër mest, edhe dëftheu të pa-numëruarënë madhërin' e ti, edhe të pa-kërkuarshimënë diturin' e ti. Edhe që t'i mbushte mëndëjenë Iovit sa i pa-ditur' është ndër sy të

Perëndisë, e pyeti mbë shumë punë për krijesën' e botësë, e për detn' e math, e për shtëzët, edhe se qysh i përmba ato Perëndia.

Iovi u përgjynj, edhe rrëfeu me gojë sa i pa-vëjyer' e i poshtërë ishte ndër sy të madhit edhe të shënjtëruarit Perëndi. Perëndia priti rrëfimn' e ati, edhe pëlqeu gjithë të përgjynjurit' e ati. Pasandy qërtoj të tre miqt' e ati për gjykimn' e shtrënguarshim që bënë kundër ati, edhe u tha të bënjenë kurban për fajet e tyre, edhe urdhëroi Iovnë të lutetë për ata që t'u falenë fajet' e atyre. Edhe Perëndia e bëri mirë për-së-ri Iovnë, edhe i dha Iovit dy herë më shumë, se sa pat përpara, edhe bekoi të pastaimet' e Iovit më tepërë se të paratë. Iovirroipastai edhe një qint e dyzet viet.

26. Egjypti a Misiri.

Nukë shkoi shumë kohë si u përdanë njerëzitë nga Vavelli. Mitzraimi i biri Hamit nguli fushën' e Nilit, ati lumit math ndë Egjypt, që buron nga kërthijëza e Afriqisë. Që atëhere Egjypti u quajt nga Israilitëtë Mitzraim, edhe nga Arapëtë qjuhetë ngjer mbë sot Misir. Nili është fort një lum i math ndër gjithë lumërat e botësë, edhe ecën 3000 mila nga lëqeret' e Avyssinisë, e derdhetë ndë Det të Bardhë. Gjith' ay vënt që lak ky lumë, 500 mila e përpjetë për së gjati, qjuhet' Egjypt a Misir, po fusha që lagetë nuk' është më shumë se dy a tre mila e gjërë, edhe 80 mila lark detit, lumi ndahetë dy rremash, edhe te derdhetë ndë det shtie ndër mest një dhe me tri faqe, përandai qjuhet' ay vënt Dhelta, sepse i përgjan shkronjësë Δ.

Edhe këtu mb' anët të lindurit diellit ka qënurë dheu i Gesenit, atie ku rrinin' Israilitëtë. Ndonëse nukë bije shi kurrë ndonjë herë ndë Misir, po ay dhe ngjometë mot për mot nga Nili, i cili zë të vërshonjë [të derdhetë] ndë muaj të qershorit, edhe gjithë-një vinjenë tuke shtuar' ujërat' e lumit, ngjer ndë vieshtë të parë, kur mbulon ujëtë gjith' atë dhe, edhe pastai shteret' ujëtë për një muaj. Të vërshuarët' e lumit bëhetë prei shirrash që bijen', e prei borrash që tretenë ndëpër malet e Avyssinisë. Vendësit' e kanë fort për nder ujëtë, edhe Egjyptianët' e vietër' e lusinë për perëndi.

Mitzraimi duketë se do të ketë qënur' ay njeri që e qjuanin' Egjyptianëtë Minës, i cili mbëretëroi 2300 viet përpara Krishtit; qyteti që pat ndenjur' ay qjuhej Nof a Memfidhë, që sot është një fshat i vogëlë përmbi Kairënë. Një tjetër qytet i math ka qënurë Zoani ndë dhe të Gesenit, që sot është një fshat i vogëlë i Sanit; edhe një tiatërë qytet ka qënur' Oni, që qjuhej Qytet i Diellit, atie ku pat ndenjur' i ati së shoqesë Iosifit. Pakëzë përmbi qytetn' e Mimfidhësë janë pyramidhet' e mëdha, male ndërtuarë me gurë, më i madhi nga ata është ngrehurë përmbi dhet me katër faqe, gjithë-se-cila faqe është e gjërë 740 këmbë, edhe maja është 480 këmbë e lartë. Duanë të thonë se (360,000) tre qint e gjashtë-dhietë mijë vetë kanë punuarë njëzet viet për të ndërtuar' atë, edhe munt të jetë ndërtuarë përpara Avraamit, 1921 viet përpara Krishtit. Këta male të mëdhenj ndërtuarë me dorë, janë bërë për varre, që të virinë mbëretëritë brenda.

Të tiera punë të Egjyptit jan' Ovelisqëtë, ca shtylla të larta me katër faqe, e me një majë ndë kryet, mbushurë gjithë faqetë me shkronja, posi gjithë të tieratë punët' e Egjyptit. Shumë këso shtyllash i kanë marrë nga Egjypti, e i kanë prurë ndëpër të tiera qytete, si ndë Romë, e ndë Konstantinopolë, e ndë Paris, e gjetëk.

Shkronjatë që gjëndenë punërat e Egjyptit thuhënë hieroglifike, edhe janë posi figure shtëzësh e shpesësh e shtërpinjsh e të tiera gjërësh, të cilat'i kishinë për shkronja Alfavite. Këto farë shkronjash janë fort të vietëra, edhe i kanë përndorurë ngjer ndë kohë të Romanëvet, po që atëhere u harrua të sgjedhuritë, edhe për 2000 viet e tëhu asnjeri s'munt t'i këndonte, po ka gjashtë-dhietë që mundi t'i sgjedhë Jungu nga Anglia edhe Qapollioni nga Franca, që kurë u

gjënt guri i Rosetësë me tri të Shkruara përmbi atë, këta dy vetë muntë t'i këthenjën shkronjatë hieroglifike.

Ndë një kohë pa dalurë karta, Egjyptianët shkruaninë mbi fletat të papyrit që mbin ndë buzë të lumit Nilit. Edhe ca këso fletëra të papyrit të shkruara, tri mijë vieç të vietëra, gjendenë ndëpër varre të vietërë, me të cilat mbështillinë të vdekuritë. Sepse Egjyptianët' e vietër' e kishinë zakon të vallsamosinë kurmat' e të vdekurët, e t'i ruaninë ndër arka të gurta gdhëndurë prei shqembesh guri. Këta kurma të vdekurish qjuhenë Mumie, edhe sot mbë këtë kohë gjendenë me mijë kësij kurma të vdekurish pa treturë, mbështuellë me pëlhurë të hollë e lidhurë me fletëra të papyrit shkruarë e me peta t'arta. Këtu është një figure arke, që virinë të vdekuritë nd' atë. Kurmat' e Iakovit e të Iosifit kanë qënë vallsamosurë.

Egjyptianët' e vietërë dininë astronomi fort mirë, edhe ngjihinë sa ditt kishte viti i diellit, e ngjihinë kur mbuloneshinë dielli e hëna, e ngjihinë udhën' e yjëvet, po me gjithë këtë dituri që kishin' Egjyptianëtë, ata ishin' Idhullatrë. Priftërit' e atyre mësoninë të dituritë se është vetëmë një Perëndi, po llauzë e mësoninë të adhuronjënë njerës e shtëzë e dru të ngjoma, kaqë shumë perëndira kishinë; edhe perëndirat' e atyre nuk' ishinë vetëmë burra e gra, po kishinë për perëndira edhe krokodhila, që Iovi i qjuan leviathan, e macenë, e Ividhënë (një zok lumi), e sqifterin' e gjnkallën' e qepënë. Kan' e kishinë për perëndi të parë, që e qjuaninë Apidhë, edhe e ruaninë brenda ndë një tempullë të bukurë ndë qytet të Memfidhësë, rrethuarë nga priftërit', e adhuruarë nga gjëndëja. Kur ngorthte ay kau, vallsamosinë kurmin' e ati, edhe gjithë priftëritë visheshinë me lëkurra leopardhali, edhe e bininë ndë varr, bërë ndë shkëmp guri, edhe e vininë brenda ndë një arkë të mermertë fort të bukurë. Afërë qytetit Memfidhësë gjendenë shumë këso arka të gurta plot me kurma të vdekurish, e me eshtëra krokodhillash e shtëzësh e shpesësh e shtërpinjsh, e ç' do farë gjëje që i kishinë për shënjtëra; edhe këta varre janë përndarë gjat' e gjërë afëro shtatë mijë kutë. Mbë këtë figure që shihni, është shkruarë një tempullë i Egjyptianëvet vietërë, që ka një ovelisk (shtyllë guri), e një pyramidhë, e ca figure të mëdha me njerës e me perëndira.

Ndër gjithë qytetet e Egjyptit Noi a No-ammoni ka qënurë me emërë, Grekët' i thoshinë Thivë këti qyteti, edhe duanë të thonë se kishte paturë një qint dyer për të hyrë brenda. Ishte krye-qyteti i Misirit Epërë, a i vëndit Pathresë, edhe ndë kohë të Iosifit ishte fort i math. Sot mbë këtë ditë gjendenë të rrenuarat' (gërmadhatë) e ati qyteti, edhe nga këto merretë vesh sa i math, e sa i bukurë, e sa i çudiçim ndë gjithë botënë pat qënurë' ay qytet. Ndë këtë qytet gjëndetë tempulli i Karnakut që ka 134 shtylla të gurta ndë 16 sërë, edhe gjithë-se-cila është 43 këmbë e lartë, e nëntë këmbë e trashë, po ndë sërët të mesëme shtyllatë janë 72 këmbë të larta, e 11 ½ këmbë të trasha, edhe të gjitha shtyllatë janë mbuluarë me shkronja hieroglifike. Këtu është shkruarë figureja e tempullit Dhendherahësë.

Egjypti pat qënurë me emërë për dhen' e mirë, e për kuajt, e për qerret, e për punët' e duaret që bënte, e për diturinë që ka paturë. Shkronja e Shënjtëruarë përment luftëratë që ka bërë Egjypti me Vavyllonën' e me Ninevin' e me Ethiopinë, sikundrë edhe me Israilitët.

Mbëretërit' e Egjyptit vietërë qjuheshinë Faraonë, që do me thënë rigë a mbëretë, edhe kanë pasë mbëretëruarë ngjer ndë kohë të Aleksandhrit math, 330 viet përpara Krishtit. Pastai Egjypti ra nd' urdhërë të Romanëvet, ndë ditt të perandorit Iuliut Cesarit, pasandaj ra ndë dorë të Halifëvet 640 viet pas Krishtit, edhe që atë herë e ngjer mbë sot ka mbeturë ndë dorët të Arapëvet e të Turqëvet Muhametanëvet.

Të këtillë gjëndëje ka paturë Egjypti, që Perëndia dërgoi llausn' e ti Israilinë të rrininë ndër ata. Edhe nuk' është për të çuditurë, sepse Iosifi desh të vëllezëritë të rrininë ndë dhe të Gesenit,

që të mos kishinë shoqëri me ata idhullatërë; edhe përandai Iakovi edhe Iosifi të dy lanë fjalë të vihenë ndë varr ndë dhe të Hanaanit.

Këto dy figure idhullash të mëdha gjënden' afërë Thivësë; nga këto kupëtojmë ç'farë punërash të trasha e të rënda punonin' Egjyptianët' e vietërë.

Egjypti zihetë n'gojë shumë herë ndë Shkronjë të Shënjtëruarë, edhe profitëritë kanë folurë që përpara për shumë punëra, sikundër për bekim e për mallëkim, edhe shumë fjalë t'atyre kanë dalurë, edhe për ca fjalë të tiera po presëmë me shpëresë që të mbushenë.

27. Moisiu. 1571-1531 P.K.

Tani na po zëmë istorin' e të bijvet Israilit.

Fëmijt' e të dy-mbë-dhietë vëllezëret u shtuan' e u shumuanë kaqë fort, sa pas ca brezash Israilitët' u bënë një llaus i math nga ato të dy-mbë-dhietë fara. Po pas vdekëjesë Iosifit s'ishinë gjith' aqë mirë si përpara. Israili kur sbriti ndë Misir, Perëndia i qe zotëruarë se: "Do të bënë ty një llaus të math", edhe Perëndia s'doli nga fjala e ti. Po ata si u shtuan' e u bënë të fortë, mbëretërit' e Misirit kishinë frikë nga ata. Ndë Misir hipi një mbëret i ri, që nukë ngjihte Iosifnë, edhe ay merrte ndëpër këmbë Israilitëtë posi shërbëtorë, edhe i nxitoninë mbë punë të rënda për mbëretërinë. Një tiatërë mbëret urdhëroi të vritenë gjithë sa meshkuj lindinë nga Evrejët, që të mbesinë vetëmë femëratë. Ay urdhëroi Egjyptianëtë të rrëmbeninë gjithë meshkujtë që lindinë prej gravet Evrenjet, e t'i hidhinë ndë lumët.

Nd' atë kohë një grua Israilite polli një dialë të bukurë. Ajo e mpëshëhu atë tre muaj, edhe passi s'munt ta mpëshihte më shumë, ajo bëri një shportë, edhe vuri dialënë nd' atë, edhe e hodhi ndë lumët. Atëhere erdhi e bija e Faraonit të lahej ndë lumët të Nilit, edhe kur pa shportënë tuke lundruarë mbi ujët, urdhëroi një shërbëtorë ta marrë. Edhe kur e hapnë, panë një djalë të bukurë brenda tuke qjarë. Edhe ajo e muar, e tha: "Ky është nga djemt' e Evrenjet". Atëhere u afrua e motëra e foshnjesë që ruante dialënë për së largu, e i tha: "A do të vete të thërres një grua nga Evrejët, që t'i apë sisë dialit?" Ecë, i thotë zonja. Edhe vashëza vate me vrap, e pru t'ëmënë. Kështu e ëma e dialit u bë mëndesha e së bijësë mbëretit. Edhe zonja pastai mori dialënë ndë pallat të saj, edhe si u rrit, i mësoi gjithë diturin' e Egjyptianëvet. Ajo ia vuri emërinë Moisi, që do me thënë "nxierrë nga ujëtë". (Të Dalëtë. 2.. 5-10.)

Nd' atë kohë Israilitëtë gjithë-një shtrëngonëshinë ndë punë. Moisiu kur u bë burrë, nuk' e bënte vetëhenë për Israilit, po për të birin' e së bijësë Faraonit. Po ati i vinte keq kur shihte gjëndëjen' e ti ndë mundim e ndë shtrëngim. Një ditë ay duall jashtë, edhe kur pa një Egjyptian që rrihte një Israilit, ay vate t'i ndihnjë Israilitit, edhe vrau Egjyptianinë. Ay kujtonte se të vëllezëritë do t'e merrinë vesh, se Perëndia kishte për shpëtuar' ata me anë të dorës' ati, po ata nuk' e muarrë vesh. Kur ndigjoi mbëreti këtë, Moisiu iku, e vate ndë dhe të Madhianëvet, andej nga ishte Avraami, edhe rrinte ndë shkretëtirët afërë Detit Kuq. Ndë një pus ndë këtë shkretëtirë ay u dolli zot shtatë të bijavet Raguilit a Iothorit, priftit Madhianëvet, kundër ca barive, që nuk' i lininë të nxirinë ujë. Nga këjo punë ay u ngjoh me Iothornë, tanë e vashëzavet, i cili ishte i pari i Madhianëvet, edhe prifti i Perëndisë. Ay i dha për grua Sepforënë, një nga të bijat' e ti, edhe e vuri të ruanjë dhëntë. Kështu i biri i një zonje mbëretëreshe u bë bari ndë dhe të huaj, posi atërit' e ati, që kishinë qënurë njëherë. Ay ruante dhënt' e të viehërrit, edhe s'kishte mall për pallatet e Misirit.

Le të ndigjojmë qysh thotë Dhiata e Re për Moisinë, edhe do të na dëftonjë për ç'punë ay sgjodhi këtë jetë të ungjëtë. "Me anë të besësë Moisiu si u bë i math, mohoi t'i thonë i biri së bijësë Faraonit, sepse sgjodhi më tepërë të heqë keq me llausn' e Perëndisë, se të ketë fitim faji

për pakëzë herë; tuke kujtuarë dhunën' e Krishtit për më të madhe pasëje, se thesarëtë ndë Egjypt, sepse vështronte mbë shpagimin' e pagësë". (Evr. 11.. 24-26.)

Moisiu kishte qënë mësuarë nga e ëma që i pat dhënë qjumështë, të vështronte për ndëjesën' e fajevet, edhe për shpëtimn' e shpirtit, me anë të madhit edhe të lavduarit Shpërblyes që kishte për t'ardhurë, edhe ay i besonte të zotuarit Perëndisë, se Mesia kishte për të lindurë nga fara e Avraamit. Përandai ay sgjodhi të jetë një Israilit i vobek e i përbuzur' e i ndiekurë, se një zotëri Egjyptian me gjë e me nder ndën' urdhërë të ti.

28. Moisiu përpara Faraonit. 1531-1491 P.K.

Moisiu ishte dyzet vieç kur iku nga Misiri; ay ruajti dhëntë dyzet viet ndër mest të Madhianëvet, po mundimi i Israilitëvet edhe s' ishte mbaruarë. Një ditë kur ishte tuke kulloturë dhëntë ndë shkretëtirët ndaj malin' e Horivit, ay pa një ferrë te po digjej ndë flakët, e ziarmi nuk' e hante. Ay kur u kthye që të shohë, doli një zë nga ferra, edhe e thirri: "Moisi, Moisi." Edhe ay tha: "Këtu jam." Zëri bërtiti: "Mos u afro këtu, sbath këpucëtë prei këmbësh tua, sepse nd' atë dhe që shkel ti, është vënt i mirë". Ani tha: "Unë jam Perëndia i t'yt-et Perëndia i Avraamit, Perëndia i Isaakut, edhe Perëndia i Iakovit. Edhe Moisiu mpëshehu faqen' e ti, sepse kishte frikë të shtinte sytë te Perëndia. Edhe Zoti tha: Pashë mundimn' e llauzit' t'im që është ndë Misir, edhe sbrita të shpëtonj ata nga duart' e Egjyptianëvet, edhe t'i nxier nga ay dhe, e t'i shpie ndë një dhe të mirë e të gjërë, ndë një dhe që rrieth qjumësht' e mialtë. Eja pra këtu, edhe do të të dërgonj te Faraoni, edhe do të nxierç nga Misiri llausnë t'im, të bijt' e Israilit." (Të Dalëtë 3.. 1-10)

Këjo qe një pun' e madhe. "Edhe Moisiu iu përgjeq Perëndisë: Kush jam unë, që të vete te Faraoni, e të nxier të bijt' e Israilit nga Misiri? Edhe Perëndia tha: Me të vërtetë unë do të jem bashkë me ty." Po Moisiu tha: "Ata s' do të më zënë besë, as nukë do të ndigjonjënë zënë t'im, sepse do të thonë: Zoti nuk' u duk te ti. Edhe Zoti i tha ati: Ç' është ajo që ke ndë dorë? Edhe ay tha: Shkop. Edhe Zoti tha: Hidh-e përdhe. Edhe ay e hodhi për dhe, edhe u bë gjarpërë, edhe Moisiu iku përpara prei ati. Edhe Zoti i tha Moisiut: Ndej dorënë tënde, edhe zër-e për bishti; edhe ay ndeu dorën', edhe e zu, edhe u bë shkop ndë dorë t'ati. Pasandy Zoti i tha ati: Vërë dorënë ndë gjit t'ënt. Edhe ay vuri dorënë ndë gjit të ti, edhe kur e nxori, ja dor' e ati tek u bë e kromosurë posi bora. Edhe Zoti tha: Vërë për-së-ri dorënë ndë gjit t'ënt. Edhe ay vuri dorënë ndë gjit të ti, edhe kur e nxori nga gjiri ti, ja tek u bë posi mishi i ati. Edhe Zoti tha: Ndë mos të zënçinë besë ty, as ndë mos ndigjofshinë zën' e shenjësë parë, do t'i besonjënë zërit shenjësë dytë; edhe ndë mos u besofshinë këtyre dy shenjeve, as ndë mos dëgjofshinë zënë tënt, të març ujë nga lumi, edhe ta derthç për dhe, edhe ujëtë që të març nga lumi, do të bëhetë gjak mbi dhet. Edhe Moisiu i tha Zotit: Të lutem, Zot, unë s' kam gojë të flas, as që die, as që pardie, as që mb' atë herë kur i fole shërbëtorit t'yt, po jam i belbër' e gjjuhë-shkurtërë. Edhe Zoti i tha ati: Cili i ka dhënë gojën njeriut? A cili e ka bërë të pa-gojin', a të shurdhin', a atë që sheh, a të verbërinë, a nukë jam unë Zoti? Shko pra tani, edhe unë do të jem bashkë me gojënë tënde, edhe do të mësonj ç'ke për të folurë." Ani Zoti tha: "Nuk' është yt-vëlla Aaron Leviti? Ja te po të del përpara, ti pra dot'i flaç ati, edhe do t'i vësh fjalëtë ndë gojë, edhe ay do t'i flasë llauzit ndë vënt teje." (Të Dalëtë 4.. 1-17.)

Edhe kështu u bë. Moisiu edhe Aaroni mbëlohnë pleqt' e Israilit, edhe u thanë atyre, se Perëndia do t'i nxierë nga Misiri. Pastai ata vanë te mbëreti, e i thanë: "Kështu thotë Zoti Perëndia i Israilit: Dërgo llausnë t'im, që të kremtëronjënë për mua ndë shkretëtirët. Edhe

Faraoni tha: Cili është Zoti, t'i ndigjonj zënë, që të dërgonj Israilnë? Nukë ngjoh Zonë, as s'kam për të dërguar' Israilnë”.

Edhe që atë ditë Faraoni urdhëroi t'i vënë Israilit barrë më të rënda se përpara. Edhe tha: “Mos i epni këti llauzi më kashtë posi die e pardie, që të bënë pëqisa, le të venë vetë ata, edhe le të mbledhënë kashtë, po t'i viri ata të bënë aqë pëqisa, sa bënë përpara”. (Të Dalëtë 5.. 1-9) Moisiu me të vërtetë bëri çudi me shkopr' e ti përpara Faraonit, po ati nuk' iu duknë për punë të mëdha, sepse bënë të tilla punë edhe magjistarët' e Misirit. Faraoni passu s'donte të ndigjonte, atëhere Perëndia bëri çudi të frikëshime ndë Misir me anë të Moisiut, edhe dërgoi plagë mbi llaunë njërenë pas jatrësë.

Aaroni ndejti shkopr' e ti mbi lumët të Nilit, edhe ujët' u bë gjak. Shtatë ditt lumi rrithte gjak, kaqë sa s'munt të pinte ujë as njeri, edhe gjithë pishqet' e lumit ngorthnë. Ajo qe plag' e parë. Po Faraoni s'lëshonte llaunë të shkoninë.

Pasandaj Aaroni ndejti dorënë mbi ujërat e Misirit: edhe duallnë bretëkosa, edhe mbuluanë dhen' e Misirit, edhe rynë ndëpër shtëpit e atyreve, e ndëpër shtratërat e atyreve, e ndëpër furrat e atyreve, e ndëpër magjet e bukësë. “Atëhere Faraoni thirri Moisin' e Aaronë, e tha: Iu lutni Zotit të ngrerë bretëkosatë prei meje, edhe prei llauzit t'im, edhe do të dërgonj llauzë, që t'i bënë kurban Zotit”. (Të Dalëtë 8.. 9-15.) Edhe Moisiu iu lut Zotit, edhe gjithë bretëkosatë ngorthnë për një ditë, edhe i mbëllohnë qipi (grumbullë) kaqë shumë, sa u qelp dheu nga ato. Po faraoni ashpëroi zemërën' e ti, e nukë lëshonte të bijt' e Israilit të shkoninë.

Atëhere Aaroni ndejti shkopr' e ti, edhe gjithë pluhuri i dheut u bënë morra, që plagosinë njerës e shtëzë. Magjistarëtë thanë: “Ky është gishti i Perëndisë”. Po Faraoni ashpëroi zemërën' e ti edhe më.

Pas morrash erthnë miza qëns mbi dhet, kaqë sa ngordhë bagët' e fushësë, kuajt' e gomarët' e kamillat' e qet' e dhëntë. Po zemër' e mbëretit mbeti po e ashpërë.

Atëhere Moisiu mbushi duartë me hi, edhe e përndau nd' erët ndër sy të mbëretit: edhe u mbushnë me dregëza gjithë njerëzit' e shtëzët.

Përherë Moisiu dëftonte kohënë, kur kish për të zënë plaga, e kur ish për të mbaruarë, po Faraoni përherë ashpëronte zemërënë, posa shkante plaga.

Pas kësai Moisiu ndejti shkopr' e ti ndë qiell, edhe Zoti lëshoi vetëtimëra e një breshërë të math, që s'pat rënë kurrë ndonjë herë ndë dhe të Misirit. U thyenë drurë, e u vranë njerës e bagëti ndëpër fushat nga breshëri. Atëhere Faraoni dërgoi me vrap për Moisinë e për Aaronë, edhe u tha atyre: “Këtë herë fëjeva. Iu lutni Zotit që të pushonjë bubullimat' e mëdha e breshëri”. (Të Dalëtë 9.. 28.) Edhe Moisiu doli jashtë qytetit, edhe ndejti duart' e iu lut Zotit, edhe pushuanë bubullimat' e breshëri. Po Faraoni për-së-ri ashpëroi zemërën' e ti posi përpara.

Atëhere fryjti një erë prei së lindurit diellit, e pru karcalecë, e u mbush gjithë dheu, edhe hëngrë gjithë ç'pat lënë breshëri pa prishurë. Për-së-ri Faraoni iu lut Moisiut e Aaronit: Të lutem, ndëje-më fajne veç këtë herë”. Atëhere Zoti dërgoi një erë të fortë prei së perënduarit diellit, e hoqi karcalecët, e i hodhi ndë Det të Kuq. Po Faraonit nuk' iu sbut zemëra.

Moisiu ndejti dorënë ndë qiell, edhe u bë një errësir' e madhe mbë gjithë dhen' e Misirit tri ditt, kaqë sa s'munt të shihet njëri tiatrinë, edhe asnjeri nuk' u ngrit nga vëndi që kishte ndenjturë. Po ndë dhe të Gesenit, atie ku rrinë Israilitëtë, ishte dritë.

Po Faraonit edhe s'ishte sbuturë zemëra, edhe i tha Moisiut: “Ikë prei meje, ruaj vetenë, të mos më shohç më sytë, sepse atë ditë që të më shohç sytë, ke për të vdekurë”. (Të Dalëtë 10.. 28.)

Pun' e Faraonit u bë fort e madhe tani. Atëhere Zoti i tha Moisiut: “Do të bije edhe një plagë mbi Faraonë edhe mbi Misirë, pastaj do t’u lëshonjë juve së këtejmi; do t’u lëshonjë juve, edhe me të vërtetë do t’u dëbonjë juve fare së këtejmi, sepse do të dërgonj një ëngjëllë prishës ndëpër Misir, i cili do të prishnjë gjithë djemt’ e parë”. Urdhëroi Israilitëtë të bënenë gati për udhë, edhe të bënjënë një të kremte, e të piekënë një qengq për shtëpi; qengji duhej të ishte i pastër, edhe kur ta therinë, të lyeninë me gjaknë të dy shtyllat’ e derësë, edhe prakn’ e derësë ndëpër gjithë shtëpit’ e Israilitëvevet, që kur të shkonjë ëngjëlli që prish ndëpër dhet, të kapërcenj shtëpitë që janë pikaturë me gjak, edhe të mos vrasë atie djemt’ e parë. “Edhe kështu kini për të ngrënë qengjinë”, thotë Zoti, “Ngjeshurë brezatë tuaj, e mbathurë këpucëtë ndë këmbët tuaj, edhe me stap ndë dorë tuaj, edhe ta hani atë me nxitim: është pashka e Zotit. Edhe gjaku do të jetë te ju për shenjë mbi shtëpit tuaj atie ku rrini; edhe kur të shoh gjaknë, do t’u kapërcenj juve, edhe plaga nukë do të jetë për ju, që t’u prishnjë juve”. (Të Dalëtë 12.. 3-13.)

Kur erdhi koha që qe urdhëruarë, Israilitëtë të gjith’ ishinë bërë gati për të ikurë. Ndë mes-natë shkoi ëngjëlli që prishte, edhe vrau gjithë djemt’ e parë të Egjyptianëvevet, që nga i biri Faraonit ngjer mbë të birë e të vobegut shërbëtuar, edhe gjithë këlyshat’ e parë të bagëtivet. Atëhere u bë një vajë e një të qjarë ndër Egjyptianët, edhe Faraoni e gjithë shërbëtorët’ e ati dridheshinë nga frika. Edhe Egjyptianëtë dërguanë llaunë jashtë me nxitim të math, sepse thoshinë, se “Të gjithë do të vdesëmë”. Kështu Israilitëtë iknë nga dheu i shërbesësë, edhe muarrë me vetëhe miaft argjënt e ar, e enë të pa-çëmuarshime, e rroba, të cilat’ i patnë marrë nga Egjyptianëtë. Gjithë-se-cili mori brumin’ e bukësë me vetëhe, sepse s’kishinë kohë ta piqinë.

Ç’farë vaje e të bërtiturë do të jetë bërë atëhere, kur u ngrit Faraoni e gjithë shërbëtorët’ e ati, e gjith’ Egjyptianëtë ndë mes-natë, e panë se: “Nuk’ ishte ndonjë shtëpi, që s’kishte një të vdekurë!” (Të Dalëtë 12.. 30.) Edhe ç’gëzim të math do të kishinë patur’ Israilitëtë, kur panë se gjaku i qengjit që patnë lyerë dyertë me atë, i ruajti nga vrasëj’ e ëngjëllit që prishte! Djemthit’ e mi, ay gjak donte të dëftente gjakn’ e Qengjit Perëndisë që u derth për ne. Të Krështerët’ e vërtetë munt të thonë: “Krishti pashka jonë u bë kurban për ne”. (Korinth. 5.. 7.) Edhe me anë të besësë është ay i pa-çëmuari gjak që do të shpërblenjë e do të shpëtonjë ata prei ati zemërimit math që do të bierë mbi ata që s’u penduan’ e s’i besuanë, atë ditë kur të gjykonjë Perëndia botënë me drejtëri.

Posa ndigjoi Faraoni se Israilitëtë kishin’ ikurë, ay thirri shpejt ushtërin’ e ti, edhe i ndoq prapa, edhe i harriu ndë buzë të Detit Kuq. Israilitët’ u frikësuanë, kur panë ushtërin’ e Egjyptianet ndek i harrinë. Edhe Moisiu u tha llauzit: “Mos kini frikë, Zoti do të luftonjë për ju, edhe ju do të prëhi”. Sa-do-mos ata gjëndeshinë ndë një vënt fort të keq: përpara atyre ishte det’ i thellë, atej e për këtë rrëpira malesh, edhe prapa atyreve ushtëria e Egjyptianëvevet. “Edhe Zoti i tha Moisiut: Përse më thërret mua? Thuaj të bijet Israilit të prinjënë”. – Ku? Brenda ndë det? – Po: “tashti do ta marrënë vesh Egjyptianëtë se unë jam Zoti, kur të lavdonem mbi Faraonë, e mbi qerrat e ati, e mbi kalërin e ati”.

Atëhere Zoti bëri të frynjë një er’ e fortë gjith’ atë natë, që këtheu prapë ujëratë, edhe thau detnë ngjer ndë fumt. Edhe ndër mest të dy ushtëriavet ay vuri një shtyllë reje, që ndriste prei anës’ Israilitëvevet, e u bënte dritë, edhe prei anësë tiatër’ i fshihte ata nga Egjyptianëtë. Kështu natën’ ata shkuanë ndëpër mes të detit, edhe ujërat’ ishinë bërë posi mur mbë të diathtë e mbë të mëngjërë t’ atyre.

Edhe Faraoni u lëshua pas atyre, edhe kur u sbardhëlye, Israilitëtë kishinë kapërcyerë detnë mb’-at’-anë, po Egjyptianët’ ishinë ndë mest të detit. Atëhere Zoti përzieu Egjyptianëtë me ziarr nga reja, kaqë sa bërtitnë nga frika: “Le t’ikëjmë prei sysh Israilit, sepse Zoti po lufton

Egjiptianët për ata”. Edhe Zoti i tha Moisiut: “Ndej dorënë tënde mbi det”, edhe ujërat’ u derthnë mbi Egjiptianët, edhe u mbytnë të gjithë brenda ndë det, e nukë shpëtoi asnjë nga ata. (Të Dalëtë 14.. 10-28.)

Atëhere Moisiu edhe gjithë llauzi i Israilit i kënduanë Perëndisë një kënkë lavdimi.

Iehovahu është fuqia ime edhe kënkë ime,

Edhe ay u bë shpëtimi im.

Ay është Perëndia im, edhe do t’ë lavdonj,

Perëndia i t’im-et, edhe do t’ë lartonj.

Edhe Mariama profitëresha, e motër’ e Moisiut edhe e Aaronit, mori një daulle ndë dorë, edhe gjithë gratë bënë valle pas asai me daulle, e ia thërritnë kënkësë, e thanë:

Këndoni Zotit: se u lavdua me lavdim,

Hodhi ndë det kalën’ edhe kalorësinë.

Kështu u mbarua puna, edhe Zoti bëri të mirrej vesh, se vetëmë Perëndia i Israilit ishte një Perëndi i vërtetë edhe i gjallë, edhe se perëndirat’ e Egjiptianet ishinë të kotë, edhe s’mundinë t’u ndihinë atyre që e lusinë. Ç’të dënuarë qe këta për idhullatrinë e për të keqenë ndër gjithë kombet e ndër gjithë motet!

30. Israili ndë shkretëtirët. 1491 P.K.

Udha prei Misirit për të vaturë ndë dhe të Hanaanit bije ndëpër shkretëtirë. Atie s’kishte ara, as dhe ndën’ ujë, posi ndë Misir; kaqë ditt udhë s’kishte asgjë, veç rërë: s’kishte kronje – s’kishte bar të ngjomë - s’kishte as një gjurmë këmbë – s’kishte as një shtëpi njeriu. Pas tri ditë udhë prei Detit Kuq, Israilitëtë gjetnë një pus me ujë, po ujët’ ishte i hidhurë, e s’mundinë ta pininë. Atëhere llauzi iu rëkua Moisiut. Edhe Moisiu i thirri Zotit, edhe Zoti i dëftoi ati një dru, të cilën’ ay e hodhi nd’ ujë, edhe u bë i ëmbëlë. “Sepse unë jam Zoti që të shëron ty”, i tha Zoti llauzit. (Të Dalëtë 15.. 23-26.)

Ata për-së-ri zunë të qjahrenë se s’kishin’ as bukë as mish. Atëhere Perëndia bëri të bijenë trumba shkurtëzash, edhe nesëret ndë mëngjes lëshoi mbi dhet një farë gjëje të rrumbullakët’ e të imëtë posi brymë. Ç’farë gjëje ishte ajo pra? Israilitët’ia vunë emërinë Ç’farë gjëje – Evraisht Manna, sepse nuk’ e ngjihinë se ç’ishte. Atëhere Moisiu tha: “Këjo është buka që u dha juve Zoti të hajni”. (Të Dalëtë 16.. 13-15.) Ajo ishte e vogëlë posi koqe gruri, e ëmbëlë posi mialtë, edhe e shishime posi miell i hollë.

Atyre për-së-ri u shter ujëtë, edhe zunë për-së-ri të rëkoneshinë. Moisiu i thirri Zotit, edhe Zoti e urdhëroi të marrë stapn’ e ti, e t’i bierë shkëmbit gurit. Moisiu i ra shkëmbit gurit, edhe shkëmbi gurit nxori ujë. (Të Dalëtë 17.. 6.) Sa rrall’ e dinë për të mirë njerëzitë këtë të paçëmuarë dhuratën’ e Perëndisë që bën të dalë ujë i këthiellëtë prei shkëmbenjsh guri!

Pas pak kohe erthnë Amalikëtë të luftoninë kundër Israilit. Moisiu dërgoi Iisun’ e Naviut kundër atyre, edhe ay vetë vate e ndënji ndë majë të një kodre, edhe ndejti duartë te Perëndia e falei. Edhe Moisiu sa mbante duartë hapëtë përpietë, Israilitëtë mundinë, po kur lëshonte duartë tatëpietë, Amalikëtë mundinë. Atëhere Aaroni edhe Huri i mbaninë duartë Moisiut që të mos lodhetë, edhe kështu Israilitëtë muntënë Amalikëtë.

Po tashti lypsetë të dëftejmë, si gjinte Moisiu udhënë ndëpër shkretëtirët. Reja edhe ziari që shkonte përpara Israilitëvet kur shtinë Detn’ e Kuq nukë pat ndalurë kurrë, edhe Perëndia i hiqte udhënë llauzit gjithë monë, sepse ditënë printe përpara atyre një shtyllë reje, edhe natënë një shtyllë ziari.

31. Të dhënët' e Ligjësë. 1491 P.K.

Mbë të katrëtinë muaj, si iknë nga Misiri, llauzi Israilit erth ndë shkretëtirët të malit Sinait. Nd' ato fusha të bukura plot me bar të ngjomë ndë rrëzë të këti mali, aty ata ndenjën një vit të tërë bashkë me grigjërë. Atë vit vunë ndë sërë farat' e fëmijt' e Israilit, numëruanë llaunë, edhe vunë mbi ata krerë e të parë e gjykatëse. Numëri i njerëzet Israilit ishte afëro gjashtë qint mijë, edhe numër' i tërë bashkë me grat e me djemt do të kishte qënurë afëro tre miliunj. Kështu Perëndia u dha atyre ligjënë (nomnë), si kishinë për të punuarë, e si kishinë për të bërë ndë jetët të tyre, edhe këtu Israilitët' u vunë veç, që të jenë për llaun' e Perëndisë.

Israilitëtë posa ngulnë ushtërin' aty, Moisiu hipi ndë mal të Sinait. Edhe Zoti i tha ati: “Le të bënëti gati llauzi për të tretënë ditë, sepse të tretënë ditë Zoti do të sbresë mbë malt të Sinait, përpara gjithë llauzit, edhe ke për të vënë sinuar për qark llauzit, sepse kush t'i përkasë malit, do të vritetë fare”. (Të Dalëtë 19.. 10-13.)

Kur erdhi e treta ditë, mali u mbulua me re të dëndura, edhe gjëmoninë bubullima e vetëtima, e një zë i math trumbete. Edhe gjithë mali i Sinait ishte plot me tym, edhe zër' i trumbetësë sa vinte, klithte më fort. Moisiu ndenji ndë malt përpara Perëndisë, edhe gjithë llauzi ndenji përposh me rroba të pastra, tuke frikësuarë e tuke dridhurë.

Të Dhietë Urdhërimetë.

Edhe Perëndia foli gjithë këto fjalë, tuke thënë:

Unë jam Zoti Perëndia yt, që të kam nxierrë nga dheu i Misirit, nga shtëpia e shërbesësë.

1. Mos kesh të tierë perëndira, veç meje.

2. Mos bëjsh për vetëhenë tënde idhullë, as të shëmbëllyerë ndonjë gjëje që është lart ndë qiell, a që është poshtë ndë dhet, a që është ndër ujërat përposh dheut; mos i adhurojsh, as t'u lutesh, sepse unë Zoti Perëndia yt jam Perëndi zilitar, që paguanj fajet' e atrëvet mbë djemt, ngjer mbë të tretinë edhe të katrëtinë bres atyreve që më mërztinjenë, edhe bënj përdëllim mbë mijëra brezash atyreve që më duanë edhe ruanjenë porosit' e mia.

3. Mos marrç emërin' e Zotit Perëndisë tënt mbë të kotë, sepse Zoti nukë do të nxierrë pa faj atë që merr emërin' e ati mbë të kotë.

4. Kujto ditën' e Savvatësë, për të shënjtëruar' atë. Gjashtë ditt puno, edhe bën gjithë punërat' e tua, po e shtatta ditë është Savvat' e Zotit Perëndisë tënt; nd' atë ditë mos bëjsh as ndonjë punë, as ti, as yt'-bir, as jot-bijë, as shërbëtori yt, as shërbëtoreja jote, as bagëtia jote, as i huaji yt, që është përbrënda dyeret tua, sepse për gjashtë ditt Zoti bëri qiellnë edhe dhenë, detnë, edhe gjithë sa janë nd' ato, edhe të shtattënë ditë pushoi, përandai Zoti bekoi ditën' e Savvatësë, edhe e shënjtëroi.

5. Ndero tët-atë e tët-ëmë, që të bënësh jetë-gjatë mbi dhet, që të ep Zoti Perëndia yt.

6. Mos vraç.

7. Mos kurvërojsh.

8. Mos viethç.

9. Mos bëjsh dëshmi mbë të rrem kundrë të afërmit tënt.

10. Mos dëshërojsh shtëpin' e të afërmit tënt; mos dëshërojsh gruan' e të afërmit tënt, as shëbëtorin' e ati, as shërbëtoren' e ati, as kan' e ati, as gomarn' e ati, as ç'do gjë që është e të afërmit tënt. (Të Dalëtë 20.. 1-17.).

Edhe gjithë llauzi pa vetëtimatë, edhe malë tuke nxierrë tym, edhe ndigjuanë bubullimatë, edhe ndenjën lark. Edhe i thanë Moisiut: “Ti na fole neve, edhe do të ndigjojmë, edhe le të mos

na flasë Perëndia, që të mos vdesëmë”. (Të Dalëtë 20.. 10.) Edhe Zoti i tha Moisiut: “Paçinë një të tillë zemërë, që të më kenë frikë e të ruanjënë urdhërimet’ e mi, që të bëhetë mirë për ata, edhe për djemt e tyre për gjithë monë”.

Edhe Moisiu hipi ndë majë të malit ndë mest të revet, edhe ndenji atie dyzet ditt e dyzet net. Edhe Zoti si mbaroi të foluritë me Moisinë, i dha dy rrasa të gurta për dhiatë, shkruarë me gishtin’ e Perëndisë.

Pastai Moisiu sbriti nga mali, tuke mbajturë ndë dorë të dy rrasat’ e dhiatësë, që i pat shkruarë Perëndia. Po mjerë, se ç’pa Moisiu, kur erdhi afër’ ushtërisë! Llauzi kishte bërë një idhullë viçi, edhe ishinë tuke karcyerë rreth e rrutull’ ati me lodra e me kënkë. Atëhere Moisiu u zemërua fort, edhe hodhi tej rrasat’ e gurit nga duartë, edhe u thyenë përposh malit. Edhe ay i tha Aaronit: “Ç’ të bëri ty ky llaus, kaqë sa të bijesh mbi ata një faj të math? Edhe Aaroni i tha: Le të mos ndizetë zemërimi i t’im zot; ti e ngjeh llauzë, se ka rënë ndë të keqet, sepse më thanë: Na bën perëndira, që të prinjënë përpara nesh, sepse ky Moisiu, ay njeriu që na nxori prej dheut Egjyptit, nukë dimë se ç’u bë; edhe un’ u thash’ atyre: Kush të ket’ ar, le ta heqë; edhe ata ma dhanë, atëhere un’ e hodha ndë ziarm, edhe dolli ky viç”. (Të Dalëtë. 32.. 19-24.)

Edhe Moisiu mori viçinë që patnë bërë, edhe e doq ndë ziarm, edhe e thërmoi edhe e bëri pluhurë, edhe e hodhi nd’ ujë, edhe ua dha të bijvet Israilit ta pijnë”. Edhe Moisiu i tha Perëndisë: “Ky llaus ka bërë një faj të math, edhe bënë për vetëhe të tyre perëndira t’artë, po tashti nd’ua ndëjefsh atyre fajinë: - po ndë mos, të lutem, shuaj-më nga vivlia jote që shkrove”. Edhe Zoti i tha Moisiut: “Kush të ketë fëjyerë kundrë meje, këtë do ta shuanj nga vivlia ime, përandai tashti ecë, u dëfte udhënë llauzit atie ku të thashë; na ëngjëlli im do të prinjë përpara teje, po ndë ditët të shpagimit t’im, kam për të shpaguar’ atyre fajinë mbi ata”. (Të Dalëtë 32.. 20, 31-34.) “Edhe Zoti i tha Moisiut: Pre për vetëvetëhenë dy rrasa të gurta, posi të paratë, edhe kam për të shkruarë mbi rrasat ato fjalëtë që ishinë mbë rrasat të para që theve, edhe bënu gati ndë mëngjes, edhe hipë ndë mëngjes mbë malt të Sinait, edhe rri atie përpara meje ndë majë të malit”. (Të Dalëtë 34.. 1, 2.)

Kështu Moisiu qe për-së-ri dyzet ditt e dyzet net bashkë me Zotnë ndë malt; edhe gjith’ atë kohë ay as hëngri as piu. Edhe Zoti shkroi mbi dy rrasat fjalët’ e dhiatësë – të dhiet’ urdhërimetë.

32. Ligja qytetore. 1491 P.K.

Perëndia kur shpëtoi llausn’ e Israilit nga Faraoni, edhe i nxori nga Misiri, nga dheu i shërbesësë, ati i pëlqeu të jetë ay vetë mbëreti i atyre, edhe u dha atyre një ligjë (nom) si duhej për ata, për të vënë ndë sërë punët’ e jetës’ atyre. Ligja ndërmest të tiera punësh, u mësonte njerëzet si të ruaninë jetën’ e kurmin’ e gjënë, u mësonte detyrënë burravet e gravet, përindevet e djemvet, zotëriveret e shërbëtorëvet, u mësonte Israilitëvet të ngrënë’t e të veshuritë, u mësonte si të punoninë dhenë, edhe si t’i mbajinë kafshat’ e gjalla.

Do të zënjë shumë vënt ndë këtë vivli të vogëlë të dëftejmë për gjithë punërat e kësai ligje që shkruante, po kaqë të turpëshim e të mençim e të dreitë ishin’ ata ndë punët, edhe kaqë fort ndanin’ ata nga ligjat’ e atyre të tierëvet kombevet vietërë, që Moisiu mburrei t’i thoshte llauzit: “Cili komp është kaqë i math, që ka urdhërata e gjyqe të dreita, posi gjithë këjo ligjë, që po u vë përpara jush sot?” (Ligj’ e dytë 4.. 8.)

Israilitët’ e vietërë kishinë një nom fort të shënuarshim për atë që të vriste ndonjë njeri pa dashur’ e pa ditur’ e pa pasurë mëri ati përpara: të ikte me vrap, e të hynte brenda mbë ndonjë nga ata së shtatë qytetetë, që qjuheshinë qytetet’ e të dalurit zot. Sepse nd’atë kohë e kishinë zakon, kur vritej ndonjë njeri, më i afërmi fis i ati do të vriste gjakëtorinë, e të mirrte gjaknë, po

shumë herë vrisin' edhe njerës pa faj që nuk' ishinë gjakëtorë, kur vritei ndonjë njeri pa dashurë. Përandai kur kodiste (gjante) një e këtillë punë, ay që kishte bërë gjak ikënte me vrap të hynte brenda mbë ndonjë nga ata të gjashtë qytetet' e të dalurit zot, që të shpëtonjë nga duart' e ati që e ndiqte mb' udhë ta zinte për të marrë gjaknë, edhe ndë e harrinte e hynte brenda nd' atë qytet, arëniku s'munt ta vriste më atë, përveç gjykatësevet e ati qyteti, kur ta gjykoninë, e të merrinë vesh, se me të vërtetë kishte vrarë tiatërinë tuke dashurë. Tre qytete, Vasora e Ramotha e Golana, ishinë mb'-at'-anë lumit Iordhanit nga len dielli, edhe Kedhesa e Syhema e Hevrona, mbë-kët'-anë lumit Iordhanit nga perëndon dielli. Rrugat' (dhromet') e këtyre qytetevet ishinë ndërtuarë mirë, edhe kishinë ngrehurë shtylla të gurta vënt mbë vënt për shenjë, që të gjenin' udhën' ata që kishinë rënë mbë gjak.

Kështu edhe na fajtorëtë, sa herë të fëjejmë mbë Perëndinë, të ikëjmë me vrap, e t'i bijemë ndër këmbë Krishtit, përpara se të na e harrinjë i dreiti gjyq i Perëndisë, e të na mundonjë. (Evre. 6.. 18.)

33. Ligja e lutëjesë.

Të vërtetëtë lutësit' e Perëndisë, që kurë se ra poshtë i pari përindi ynë, e kishinë pasurë zakon gjithë monë të bëninë kurban për fajet e tyre, edhe për shpëresënë që kishinë mbë përdëllim të Perëndisë, me anë të Shpëtimtarit që u qe zotuar' atyre. Ata e bëninë këtë me urdhërë të Perëndisë, po na nuk' e gjejmë shkruarë gjëkund, se kishinë qenë urdhëruarë kohëra e vënde veç-anë për kurbanet. Mbë ç'do vënt që rrinin' e punoninë, atie ngrihinë therore për Perëndinë, edhe bëninë kurban, edhe Perëndisë i pëlqente besa e atyreve. I ati fëmijvet bënte kurban për vetëvetëhen' edhe për fëmijët e ti, sikundrë edhe fëmijëtë kur doninë, munt të bëninë kurban për vetëvetëhenë, posikur pat bërë edhe Aveli, kur ishte gjallë Adhami.

Po tashti llauzi i Perëndisë që kishte për të qënurë një komp i ndarë veç, ndënë një qyverni të re, Perëndia desh të bënjë ligjë, për të vënë ndë sërë kurbanet' edhe dhuratat' e tiera që kishinë për të bërë. Fara e Leviut, që nga ajo kishte dalë Moisiu, u vu veç nga farat' e tiera, edhe kësai fare i u dhanë të tiera punëra e të tiera shërbime për të bërë. Të bijt' e Moisiut nukë muarrë punë për të bërë veç nga të tieratë fara. Po Aaronit të vëllait, edhe të bijvet ati iu dha priftëria, edhe prej farësë Leviut dilinë mieshtrit' e miekësit' e kërret' e llauzit.

Aaroni vetë u vajua (u lye me vaj) për krye-prift, edhe u vesh me rroba priftërie, edhe u ndërtua një tendë e bukurë që t'i falenë Perëndisë. Ndë arkë t'artë, që ishte vënë brenda ndë kamare të tendësë, që thuhei Shën-vëndi, ishinë vënë të dy rrasat' e gurta, që kishte shkruarë Perëndia ligjën' e ti mbi ato.

Ndë këtë figure duketë Aaroni veshurë me rrobat e priftërisë, tuke vënë të dy rrasat' e gurit ndë arkët të dhiatësë. Mbulesa e asai arke ishte prej ari të ngrirë, edhe qjuhei Shpërblim. Përmbi atë mbulesën' e arkësë ishinë bërë dy Heruvimë me fletët hapurë, tuke vështruarë ndër sy njëri jatinë. Përmbi këtë mbulesën' e artë do të derdhei pakëzë gjak kurbanit të kremten' e së Madhesë Ditësë Ndëjesësë. Ndë kamaret përjashta që thuhei Vëndi-mirë, krye-prifti binte qem (thymiamë) bashkë me të falura përdita përpara Perëndisë.

Ndë këtë figure janë shënuarë gjith' ato enë që gjendeshinë ndë kamaret përjashta tendësë, që thuhej Vëndi-mirë. Ato ishinë kandileja e artë me shtatë drita, truveza e përaruarë me dy-mbë-dhietë bukë, shtëmba e artë që kishte brenda Mannënë, trumbetat' e argjëntta që u bininë për të kremte, edhe të pesë vivliat' e Moisiut. Këtu është shënuar' pllaka me dy-mbë-dhietë gurë të paçëmuarë që e varte ndë kraharuar krye-prifti, edhe legeni i ramtë për të larë, edhe theroreja që digjeshinë kurbanëtë mbi atë. Rreth e rrotullë tendësë ishte një hobor i math, nd' atë ishte

theroreja që digjinë kurbanët' e dhuratatë, këtu priftëritë birinë kurbanëtë, edhe aty vetëmë munt të bëneshinë kurbanëtë.

Për mëngjes e për mbrëma bënei kurban një qenq; edhe për të shëtunë bënei dy herë aqë. Sepse për ç'do dialë që të lintte ndë Israilë, do t'i bëneshinë dy kurbane Perëndisë – një kurban për të diegurë, edhe një kurban për faj. Për ç'do të kromosurë që të shëndoshei, prifti do të bënte kurban dy qëngjëra, po ndë ishinë fort të vobegë, së paku do të bëneshinë kurban dy zoq turtujsh. Për ç'do faj që bënei pa diturë, do të bënei një kurban për faj, pas fuqisë që të kishte ay njeriu që bëri fajinë. Për ç'do faj që bënei me të diturë vetë, e për ç'do faj të tierësh që nuk' i dëftente, e për të tiera faje kundër ligjësë lutëjesë, ishte për të bërë një kurban. Përveç këtyre, do të bëneshinë kurbane kafshash të gjalla për dialën' e parë që lintte, edhe do të bëneshinë të tierë kurbane për ditt të kremteje e për ditt të shënuara. Kaqë sa numëri i kurbanevet' që bëneshinë mbi therorenë ishte fort i math. Ç'farë të parë të frikëshim do të ketë qenurë! Ç'mendime të frikëshim do t'i bijnë ndër mënt njeriut! Vall' i pëlqente Perëndisë vrasëja e këtyre kafshave të gjalla? Munt të hiqte fajet' e njerëzet gjaku i kafshavet gjalla? A nuk' e merrte me mënt këtë ndonjë Iudhë besëtar? Po me këto kurbane Perëndia dëftente mërinë që kishte për fajinë, edhe nevojën' e shpërblimit, për të falurë fajetë. Perëndia dëftente dreitërin' e ti se nukë linte faj pa e munduarë, edhe përdëllimnë që kishte për të kursyerë shpirtëratë me kurbanet e të tierëvet.

Këndo, o dialëthi im i dashurë, kartënë mbi Evrej, edhe do të shohç, se ligja e lutëjesë ishte “një hie punësh të mira që kishinë për të ardhurë”, edhe do ta gjejsh shpërfaqurë mirë, se si të shënjtëuarshimitë njerëzit' e moçim vështroninë me anë të kurbanevet e me anë të ligjësë lutëjesë për të lavduarshiminë Shpërblimtar, krye-priftin' e llauzit ti, Qengjin' e Perëndisë, i cili kishte për të ngriturë fajetë me kurbanin' e vetëvetëhesë. Këtu është bekimi që i dha llauzit prifti Aaron, edhe të bijt' e ati:

“Zoti të bekoft' e të ruaitë,

Zoti ndrittë faqen' e ti mbi ty, e të përdëlleftë,

Zoti ngrittë syt' e ti mbi ty, e të dhashtë paqim”.

Tri herë ndë vit kishinë të kremte të mëdha, ndër ato ditt gjithë meshkujtë duhej të vininë. E kremteja e Pashkësë, për të përmendurë të ikuritë nga Egjypti, - e kremteja e Pendikostisë, për të përmendurë ligjënë që u dha ndë mal të Sinait, - edhe e kremteja e tendavet. Këto tri të kremte zininë n'gojë edhe të punuarët' e dheut, passi ngulnë ndë Hanaan. Për Pashkë do të viheshinë mbi therorenë dorëza kallinjsh elbi që piqeshinë më përpara, sepse dit' e kësai së kremteje binte ndë kohë të korrurit elbit. Pastai bije e madheja Dit' e Ndëjesësë mbë dhietë ditt të shtattit muaj. (Të Madhenë Ditën' e Ndëjesësë krye-prifti do të hynte ndë Shën-vendinë të derthte gjak kurbanin për fajet e ti edhe për fajet e llauzit; me këtë dëftente të vetëmen' udhën' e shpëtimit me anë të gjakut Krishtit që kishtë për të ardhurë.) E kremteja e Pendikostisë qjuhej e kremteja e së zënit të korrit, sepse atëhere mbaronei të korrët' e elbit e zihei të korrët' e grurit. Edhe së pastaimi ishte e kremteja e Tendavet mbë katër-mbë-dhietë ditt të shtattit muaj, e cila ishte edhe e kremteja e të faluritë ndersë pas të vielurit. Ndër ditt të kremtevet nukë bëninë punë, veç të parën' edhe të pastaimenë ditën' e së kremtesë punoninë. Iudhenjtë mbanë këto të kremte ngjer mbë sot. Këto të kremte e këto urdhërime të ligjësë i kishte vënë Perëndia që të ndante llauzi i Israilit nga llauzërët' e tierë, si një llauz i shënjtëuarshim, edhe si një qishë e Perëndisë që ishte ndë botët, edhe për të dëftyerë me formë e me shëmbëllesë punën' e Shpërblimtarit, edhe lavdinë edhe bekimn' e ungjillit.

34. Mali i Sinait edhe Shkretëtira.

Shkretëtira që rrinin Israilitët nd' atë kohë nuk' ishte një fushë me rërë, po ishte një vënt me shkëmbe gurësh, e me male, e një vënt i thatë; po mbë ca vënde kishte edhe fusha të bukura me bar të ngjomë. Hunda e mali Sina hyn ndërmest dy grykavet Detit Kuq, edhe është' afro dy qint mila i gjatë, e një qint e pesë-dhietë mila i gjerë. Prei anësë borësë vëndi është' i ungjët' e shesh, po prei anësë mes-ditësë ka shumë male të mëdhenj, edhe ca male janë nëntë mijë këmbë të lartë. Kudo është shkretëtirë, bar i ngjomë e dru gjëndenë mbë pak vënde, atie ku rriedhënë kronje e përrënj, edhe atie mbëlidhenë barinjte e udhëtarëtë. Sot mbë këtë ditë nukë gjëndenë më tepërë se gjashtë mijë vetë ndë këta vënde, po ndë një kohë munt të kenë qenurë më tepërë.

As ndonjë mali tashti nuk' ithonë Sina a Horiv, edhe nukë dihetë me të vërtetë cilit mal i patnë thënë Sina ndë një kohë. Shumë njerës kujtonjënë se është' ay mali që e ka emërinë sot Sebell Musa, a Ras-es-Sufsar i njëresë majësë malit, edhe Horiv i thoshin' asai faqesë malit që ngrihetë dreitë përpietë një mijë e pesë qint këmbë. Ndë rrëzët të këti mali është' edhe një fushë, aty ku do të kenë qenë mbëledhur' Israilitët për të ndigjuarë zën' e Perëndisë, edhe së andejmi do të kenë parë vetëtimat' e shkrepëtiratë ndë majë të malit. Po shumë njerës të diçim që i kanë kërkuar' ata vënde, kujtonjënë se mali i Sina do të ketë qenurë ay mali që i thonë sot Sebell Serball, i cili duketë të jetë me të vërtetë pas shkronjash që këndojmë, edhe maja e këti mali është plot me shkronja të vietëra ndëpër gurët.

Rrëzat' e këtyre maleve janë plot me shkronja të vietëra shkruarë ndëpër gurë e ndëpër shkëmbe, edhe tuke bër udhë ndërmest të këtyre maleve, kudo do të shohç kësoj shkronjash, përandai i thonë një vëndi aty Vadi Mokatteb, që do me thënë Pyll i Shkruarë. Këtu është një figure me asoj shkronjash. Ca njerës të ditçim besonjënë se i kanë shkruar' Israilitët, kur rrinin ndëpër shkretëtirat, edhe kujtonjënë se kanë mundurë t'i këthenjënë ato shkronja, po ca të tierë nukë zënë besë, po thonë se i kanë shkruarë Nabatheanëtë, një farë gjëndëje nga Arabia, që kanë qenurë katër qint viet pas Krishtit. Po ndonëse këto mendime janë ndarë mbë dysh, munt të themi se i kanë shkruar' Israilitët.

Sa çudi e madhe do të ketë qenur' atëhere, kur pat ndenjurë kaqë viet një komp i math ndërmest këtyre maleve, tuke ngrënë bukë prei qiellit, e tuke pirë ujë prei gurit, e tuke hequr' udhën' ati një shtyllë reje ditënë, e një shtyllë ziarmi natënë! Pa dëgjoni tashti këto dy urata që thoshte Moisiu, kur ngrihei lart reja, edhe llauzi nisei të bënte udhë:

“Ngreu, o Zot, edhe u përndafshin' arëmiqt' e tu, edhe ikshinë prei faqesë s'ate ata që të kanë mëri ty!”

edhe kur ungjey reja, edhe llauzi rrinte të prehei, ay thoshte:

“Këthehu, o Zot, mbë shumë mijë vetë të Israilit!”

(Numër. 10.. 35, 36.)

35. Varret' e atyre që dëshëruanë të ngrëna. 1490 P.K.

Israilitëtë passi ndenjënë një vit afërë malit Sina, edhe krentëruanë ditën' e vitit që patnë shpëtuarë nga shërbesa e Egjyptit, shtylla e resë u ngrit përpietë prei Tendësë Deshmimit, edhe llauzi po bënei gati për të ikurë. Atëhere gjithë llauzi gëzonei, sepse kishinë për të vaturë ndë një vënt që rrithte qjumësht' e mialtë. Po gjajtnë ca punëra të tiera ndërmest të këtyre.

Israilitëtë posa bënë tri ditt udhë, edhe u ftoh zemëra atyre. Gjëndëja dëshëronte për të ngrënë gjellë të tiera, ata qjajin' e thoshinë: “Kush do të na apë mish për të ngrënë? Bijemë ndë mënt pishqetë, që hanim dhurëti ndë Misir, e trangujtë (krastavecat') e piepërit' e qepët' e hudhratë, po tashti na u tha shpirti, s'kemi (tiatërë gjë) ndër syt t'anë, veç këtë mannë”. (Numër. 11.. 4-6.) Edhe Zoti i tha llauzit: Shënjtëroni vetëhenë për nesërë, edhe do të hajni mish: - nukë do të hajni

një ditë, as dy ditt, as pesë ditt, as njëzet ditt, (po do të hajni) një muaj të tërë, ngjer sa t'u dalë për hundësh, e t'u ndyhetë, sepse nuk' e zutë për gjë Zonë që është ndërmest jush, po qjatë përpara ati, tuke thënë: Përse të ikëjmë nga Misiri? Edhe Moisiu tha: Llauzi, që jam unë ndërmest t'atyre, janë gjashtë qint mijë kambësorë, edhe ti thua, se do t'u ap atyre mish për të ngrënë një muaj të tërë.” “Edhe Zoti i tha Moisiut: Sos u vogëlua dora e Zotit?”. (Numër. 11.. 18-23.) Kështu Moisiu përbëloth të bijt' e Israilit.

“Edhe fruiti një erë prei Zotit, edhe pru shkurtëza nga deti, edhe i hodhi ndë ushtërit [ndë fushatët] (që ishte) afro një dit' udhë mbë-kët'-anë, e një dit' udhë mb'-at'-anë, rreth e rrotull' ushtërisë; edhe ishin' afro dy kut përmbi faqet të dheut. Edhe u ngritnë gjithë llauzi, gjith' atë dit' e gjith' atë natë, edhe gjithë ditënë tiatërë, edhe mbëlothnë shkurtëzatë. Edhe kur kishinë mishnë ndër dhëmbët pa përtypurë, u ndes zemërimi i Zotit kundrë llauzit, edhe Zoti i lëshoi llauzit një plagë fort të madhe”. (Numër. 11.. 31-34.) Edhe shumë vetë që hëngrë, vdiqnë edhe i varruan' [i shtinë ndë dhet] aty, përandai ia vunë emërin' ati vëndi “Varret' e atyre që dëshëruanë të ngrëna”.

36. Përgjonjësitë. 1490 P.K.

Kur erdhi llauzi ndë shkretëtirët të Faraonit, Moisiu dërgoi njerës të përgjoninë vëndin' e Hanaanit, - nga një burrë prei ç'do fare. Këta shkuanë për mes dheut anësë borësë ngjer mb' anë të mes-ditësë. Edhe ishte ndë kohët kur kishinë zënë të piqeshinë rrushtë, edhe ata këputnë një hardhi me pupa rrushi, edhe e ngritnë dy vetë mbë kraha varurë mbë stap, prunë me vetëhe edhe shegë e fiq e të tiera pemë t'ati vëndi. Pas dyzet ditç ata erthnë prapë ndë ushtëri, edhe thanë: “Vam nd' atë vënt që na dërgove, edhe është me të vërtetë një dhe që rrieth qjumësht' e mialtë, edhe ja pema e ati (vëndi), po llauzi, që rri nd' atë dhe, është i fortë, edhe qytetetë janë rrethuarë me mur, (edhe janë) fort të mëdhenj. Edhe atie pam gjigantëtë, të bijt' e Anakut, edhe na dukeshim ndër sy (t'atyre) posi karcaleca, edhe ata kështu na shihinë neve”. (Numër. 13.. 27, 28-33.)

Edhe gjithë përbëledhëja ngrit zën' e bërtiti, edhe llauzi qjau gjith' atë natë. Edhe gjithë të bijt' e Israilit murmurisinë kundrë Moisiut e kundrë Aaronit, edhe gjithë përbëledhëja u tha atyre: Të donte Zoti, të kishim vdekurë ndë Egjypt! A të dojë Zoti, të vdesëmë ndë këtë shkretëtirë! E përse na pru Zoti ndë këtë dhe që të bijemë ndënë thikët, e të na rrëmbenenë grat' e djemtë? Nuk (është) më mirë për ne të këthenemi ndë Egjypt? Edhe i thoshte njëri jattrit: Le të vëmë një të parë, edhe letë këthenemi ndë Egjypt.

Atëhere Moisiu edhe Aaroni ranë me faqe për dhe përpara gjithë përbëledhëjesë të bijvet Israilit. Edhe Iisui i biri Naviut, edhe Halevi i biri Iefonniut, ata që përgjuanë vëndinë, grisnë rrobat' e tyre, edhe i thanë gjithë përbëledhëjesë të bijet Israilit: Ay dheu që vam për të përgjuarë, (është) fort një dhe i mirë, ndë na pëlqeftë Zoti, atëhere do të na bierë nd' atë dhe, edhe do të na e apë atë dhe që rrieth qjumësht' e mialtë, veç mos ngrini krye kundrë Zotit, as mos kini frikë për llausnëe ati dheu, sepse ata janë bukë për ne, mbulesa e atyre u hoq sipër' atyre, edhe Zoti (është) bashkë me ne, mos u kini frikë atyre. Edhe gjithë përbëledhëja tha t'i vrasënë me gur' ata.

Atëhere u duk lavdia e Zotit mbi Tendët të Deshmimit, edhe mbë gjithë të bijt e Israilit. Edhe Zoti i tha Moisiut: Ngjer kurë do të më zemëronjë ky llaus? Edhe ngjer kurë nukë do të më besonjëne, me gjith' ato shenje që kam bërë ndë mest t'atyre? – Sikundrë më kini folurë ndë vesh, kështu me të vërtetë do t'u bënë juve: - mishratë tuai do të bijenë ndë këtë shkretëtirë, edhe bijtë tuai do të sillenë andej e këtej dyzet viet ndë shkretëtirët”. (Numër. 14.. 1-28. 32, 33.)

Kështu pra gjithë llauzi që kishte qenurë njëzet vieç kur duallnë nga Egjypti, kishinë për të vdekurë ndë shkretëtirët, përveç Iisuit edhe Halevit, edhe të bijt' e Israilit kishinë për të mbeturë ndë shkretëtirët edhe tri-dhiet' e nëntë viet.

Më të shumënë kohë ata kishinë ngulur' ushtërinë ndë shkretëtirat të Sinait, e ndë shkretëtirat të Kadhisit, e ndë Faran, atie ku ndenjën shumë viet. Ata patnë ngulur' ushtërinë mbë njëzet vënde, kur ishinë mb' udhë dyzet viet.

37. Murmurimi i Israilit. 1471 P.K.

Po këjo nukë qe e para herë që ngritnë krye Israilitëtë. Një prei të parësh fëmijëvet farësë Leviut, Koreu, i kushëri Moisiut, u bë bashkë me Dhathanë e me Avironë, që ishinë krerët' e farësë Ruvinit, edhe ngritnë krye kundrë Moisiut e kundrë Aaronit. Ata thoshinë për Moisiun e për Aaronë se janë madhështorë, edhe lypëninë prei atyre gjithë përmbëledhëja të ketë piesë nd' urdhër' e ndë priftëri. Edhe Moisiu tha: Ecëni nesërë me qemnë (thymiamënë) tuaj përpara Zotit, edhe Zoti do të dëftenjë atë që të ketë sgjedhurë.

Edhe Koreu përmbëlodhi gjithë llauzë përpara tendësë. Edhe Moisiu i tha llauzit: “Ndahi për njëherë nga tendat' e këtyre njerëzëve të pa-besë, edhe mos i prekni as ndonjë gjëje që është' e atyre, që të mos humbasni ndë mest të fajevet atyre”. (Numër. 16.. 26.) Edhe u hap dheu, e përpiu Korenë e Dhathanë e Avironë, edhe gjithë ata që ishinë bashkë me ata, edhe dolli ziarr prei Zotit, edhe hëngri të dy qint e pesë-dhietë vetëtë që prunë qemnë”. (Numër. 16.. 35.) Po me gjithë këtë, llauzi murmuriste kundrë Moisiut e kundrë Aaronit, edhe i përflisinë se këta bënë të vritenë ata njerës. Atëhere Zoti i lëshoi llauzit një plagë, edhe vdiqnë katër-mbë-dhietë mijë e shtatë qint vetë.

Llauzi s'kishte ujë ndë Kadhis, edhe ata u zunë me Moisinë. Edhe Zoti tha: “Mer shkopnë, edhe thirre bashkë përmbëledhëjenë, ti edhe Aaroni yt-vëlla, edhe i fol-i gurit përpara atyre, edhe do të apë ujërat' e ti. – Edhe Moisiu e Aaroni thërritnë bashkë përmbëledhëjenë përpara gurit, edhe u tha atyre: Pa dëgjoni tashti, ju o të pa-ndigjuarshim, t'u nxiermë juve ujë prei këti guri; edhe Moisiu ngriti dorën' e i ra gurit dy herë me shkopnë, edhe dolli shumë ujë, edhe piu përmbëledhëja edhe kafshat' e gjalla. Edhe Zoti i tha Moisiut e Aaronit: Sepse nukë më besuatë, që të më shënjtëroni përpara Israilit, për andai ju s'keni për të prurë këtë përmbëledhëje nd' atë dhe që u dhash' atyre”. (Numër. 20.. 7-13.) Ati vëndi ia vunë emërinë Meriva, që do me thënë, ujët' e të përqeshurit.

38. Gjarpëri i ramtë. 1452 P.K.

Mbë të dyzettinë vit, kur ishte tuke bër' udhë llauzi për qark dheut Edhomitëvet, llauzi murmurisi për-së-ri, e tha: “S'ka bukë e s'ka ujë, edhe shpirtit t'ynë i ndyhetë preikësai buke të lehtë (të mannësë). Edhe Zoti dërgoi gjërpënj flake mbi llauzë, edhe shumë llaus prei Israilit vdiq. Edhe llauzi erthnë te Moisiu e i thanë: Fëjyem, sepse folëm kundrë Zotit edhe kundrë teje: - lut-i-u Zotit të ngrerë gjërpënjtë prei nesh. Edhe Moisiu u lut për llauzë. Edhe Zoti i tha Moisiut: Bën për vetëhenë tënde një gjarpërë flake, edhe vër-e atë mbi drut, edhe cilinë ta kafshonjë (gjarpëri), edhe të shtierë sytë mb' atë do të rronjë. Edhe Moisiu bëri një gjarpërë të ramtë edhe e vuri mbi drut, edhe gjarpëri kur kafshonte ndonjë, edhe ky shtinte sytë mbi gjarpërin' e ramtë rronte”. (Numër. 21.. 5-9.)

Kur qe ndë dhet Zoti ynë Iisu-Krishti, e dëftoi hapëtë punën' e këti gjarpëri, se u bë për shenjë të vdekëjesë ti ndë kryqt, si Shpëtimtar i njerëzet. Edhe ay tha: “Posi Moisiu që ngriti lart

gjarpërinë ndë shkretëtirët, kështu duhetë të ngrihetë lart edhe i bir' i njeriut, që të mos vdiretë gjithë-kush t'i besonjë, po të ketë jetë të pa-sosurë". (Ioanni. 3.. 14, 15.)

39. Vdekëja e Aaronit. – Vallaami. 1452 P.K.

Mbë të mbaruarit të dyzet vietet zunë të pushtonjënë Hanaanë. Israilitëtë prishnë Aradhinë mbëretin' e Hanaanit ndë Orma, afërë Vir-saveesë.

Tuke shkuarë më tutie prei anësë borësë, edhe tuke qerthulluarë gjithë dhen' e Edhomit e të Moavit, kur erdhi përmbëledhëja ndë mal të Orit, ndë dhe të Edhomit, Zoti urdhëroi Moisinë të bierë ndë majë të malit Aaronë edhe të birin' e ati Eleazarinë, sepse atie Aaroni do të vdiste për fajinë që bëri ndë Meriva. Kështu pra të tre vetëtë hipnë bashkë. Edhe Moisiu passi i sveshi rrobat' e priftërisë të vëllait, edhe ia veshi Eleazarit, Aaroni vdiq atie. Edhe gjithë shtëpia e Israilit mbajti zi tri-dhietë ditt për Aaronë. Kështu Aaroni vdiq si njeri që qe, po si prift nukë vdiq, edhe për këtë ay ishte një shëmbëlles' e Messisë, që është prift ndë jetët të jetëvet.

Israilitëtë vranë Sionë, mbëretin' e Amoritëvet, edhe Ogunë, mbëretin' e Vasanësë; edhe ata ngulnë ushtërinë ndë fushat të Moavit, e ndëpër buzat të Iordhanit. Po Vallaku, mbëreti i Moavitëvet dërgoi njerës te një magjistat, që e kish emërinë Vallaam, t'i thotë: "Ec e më mallëko këtë llaus, sepse ata janë shumë më të fortë se unë". Vallaku i dërgoi njerës për-së-ri Vallaamit, edhe i dërgoi njerës më të mëdhenj se të parëtë, edhe iu zotua Vallaamit t'i epte shumë dhurëti. Tani Vallaami e dinte fort mirë se s'donte Perëndia të vinte atie, sepse Zoti i pat thën' ati të bekonte Israilinë, po Vallaami donte të vinte, për dhurëtitë që i kishte zotuarë Vallaku, edhe Perëndia e la atë të vejë. Edhe ëngjëll' i Zotit i dolli përpara mb' udhë, edhe gomareja kur pa ëngjëllin' e Zotit me një shpatë ndë dorë, u këthye prapë prei udhësë, e s'donte të ecënte. Vallaami nuk' e shihte ëngjëllinë, po ngiste gomarenë të ecënjë, atëhere gomareja ra mbë gjunjë, po Vallaami më fort e ngiste të ecënjë. Atëhere Zoti i çeli gojënjë gomaresë, edhe ajo foli me gojë posi njeri: "Ç'të kam bër' unë ty që më rreh?" Atëhere Zoti i çeli sytë Vallaamit, edhe pa ëngjëllinë. Edhe ëngjëlli i tha ati: "Shko bashkë me njerëzit, ç'të them ty, atë ke për të folurë." (Numër. 22.. 5-35.)

Edhe Vallaami erdhi te Vallaku, edhe bëri kurban bashkë me atë mbë një vënt të lartë, atëhere ay zuri të flasë, e tha: "Qysh të mallëkonj atë që s'mallëkon Perëndia? A qysh të nëm atë që s'nëmi Zoti? Na te jam urdhëruarë të bekonj, edhe e ka bekuarë, edhe unë s'munt ta këthenj." Edhe ay i bekoj ata tri herë. Edhe Vallaku i tha Vallaamit: "Unë të thirra të mallëkojsh arëmiqt' e mi, edhe ti na te i bekovë ata tri herë ngjer tani. Unë thashë se kam për të nderuarë ty me nder, po na Zoti te të ka lënë prapa nga nderi." (Numër. 24.. 10, 11.)

Edhe Vallaami u këthye prapë ndë dhe të ti. Po ay i mësoi Moavitëtë e Madhianitëtë të bënënjë llausn' e Israilit të fëjenjë, tuke thërritur' ata ndër të kremte idhullatrie, e mbë të tiera punëra të liga, përandai Perëndia u lëshoi një plagë, edhe vdiqnë shumë vetë.

40. Vdekëja e Moisiut. 1451 P.K.

Prej gjith' atyre njerëzevet që nxori Moisiu nga Egjypti, kur e harrinë nd' atë dhe që u qe zotuar' atyre Zoti, vetëmë dy vetë kishinë mbeturë të gjallë, Iisui edhe Halevi; gjith' ata pleqt' e lashtë kishinë vdekurë mb' udhë. Së pastaimi Zoti i tha Moisiut: "Hipë ndë këtë mal të Avarimit, ndë malt të Nevoit, që është ndë dhe të Moavit, kundruell Ierihosë, edhe vërë re dhen' e Hanaanit që po u ap të bijet Israilit për të pushtuarë: - (sepse) ti s'ke për të hyrë nd' atë dhe që po u ap të bijet Israilit." (Ligj' e Dytë 32.. 49-52. 34.. 4-10.)

Atëhere Moisiu i la shëndet llauzit, edhe u pru ndër mënt atyre gjithë të mirat' e Perëndisë, e u zu n'goje atyre gjith' urdhërimet' e ati; bekoj ata që t'i ruaninë, e mallëkoi ata që t'i prishinë, pastai u pru ndër mënt atyre atë fjalën' e madhe që u qe zotuar' atyre Perëndia përpara ndë mal të Sinait: "Zoti Perëndia juai do t'u ngrerë juve ndër vëllezërit tuai një Profit posi mua, ati do t'i ndigjoni." Po tuke diturë me anë të Frymësë Perëndisë, se llauzi do të harronte Zotnë, e do të ngrinte krye kundër ati tuke vaturë pas idhullatrisë, e tuke bërë të tierë faje të mëdhenj, edhe se do të binte mbi krye t'atyre zemërimn' e Perëndisë, për punë të dhiatësë që do ta prishinë, përandai Moisiu foli këto fëjalë të mëdha e fort të bukura, që gjëndenë ndë Ligjë të Dytë, Krye 32.

"Mba vesh, o qiell, se do të flas,
Edhe ndigjo, o dhe, fjalët' e gojësë s'ime.
Mësimi im do të pikonjë posi shiu,
Fjala ime do të sbresë posi vesa,
Posi shiu i hollë mbi barin' e ngjomë,
Edhe posi pikat' e shiut mbi gjethet e barit,
Sepse do të lavdonj emërin' e Zotit.
Epni madhëri Perëndisë tuai.
Shkëmbi gurit! Punët' e ati janë të kulluara,
Sepse gjith' udhët' e ati janë gjyqe (të drejtë).
Perëndia është besëtar, tek ay s'ka të shtrembërë,
Ay është i drejt' e i mbarë."

Këjo kënk' e mirë ishte një profiti për llausnë që do të ngrinte krye ndë dhe të ti, edhe për mundimnë që do të merrte, edhe së pastaimi do të përndareshinë ndëpër gjithë kombet, e do t'i ndiqinë gjithë bota. Ndë sërë 21 profiteps se Israili do të hidhei tej për shumë kohë, edhe se Perëndia kishte për të sgjedhurë një tiatërë llaus nga kombet. Po ndë funt u ep bekim Israilit edhe gjithë botësë. Moisiu u mëson të bijet Israilit këtë kënkë, që të jetë një deshmi për Perëndinë mbë ç' do herë kundër atyreve që të ngrininë krye, edhe kështu u ka koditur' atyre ngjer mbë këtë ditë të sorme.

Atëhere Moisiu hipi ndë malt, edhe vdiq atie, edhe Zoti e vuri ndë dhet, edhe asnjeri nukë di se ku është varri i ati. Moisiu qe një qint e njëzet vieç plak, kur vdiq.

Moisiu shkroi pesë vivliat' e para të Dhiatësë Vietërë, që qjuhenë nga Iudhenjtë Ligja (Nomi), që janë më të vietëra se gjithë istoriat' e botësë. Moisiu shkroi edhe nëntë-dhietë psallmë, edhe ca njerës kujtonjënë se ay ka shkruar' edhe vivlin' e Iovit.

41. Iisui, edhe të shkelurit' e Ierihosë. 1451-1426 P.K.

Sikundrë Perëndia qe bashkë me Moisinë, kështu ay pasandaj ishte bashkë edhe me Iisunë. Sikundrë Moisiu u hoqi udhën' Israilitëvet ndëpër Det të Kuq, kështu edhe Iisui u hoqi udhën' atyre ndëpër lumët të Iordhanit. Ujërat' e lumit u shkëputnë, të ecurit' e lumit ndaloi prei anësë sipërme, edhe ujërat' u mbëlohnë posi mur ngjer sa shkoi llauzi mb'-at'-anë lumit.

Po Israilitëtë kishinë për të marrë Ierihonë, që ishte një qytet i fortë. Zoti tha: "Shih, të dhashë ndë dorë Ierihonë, edhe rigën' e asai." Pas urdhërit Zotit, priftëritë shkuanë për qark qytetit, tuke mbajtur' arkën' e Dhiatësë, edhe me trumbeta të bririt ndë dorë; edhe burrat' armatosurë shkoninë përpara e prapa atyreve. Kështu bënë gjashtë ditt. Mbë të shtattënë ditë priftërit' u ranë trumbetavet, edhe Iisui i tha llauzit: "Brohorini, sepse Zoti u dha juve qytetnë." (Iisui i Naviut 6.. 1-16.) Edhe llauzi posa ndigjoi zën' e trumbetavet, brohoriti me zë të math,

edhe ranë muret' e qytetit prej vetiu, edhe ata hynë brenda ndë qytet: “edhe shkuanë ndëpër gojë të thikësë burrat' e grat' e të rijt' e pleqt' e qet' e dhënt' e gomarëtë që ishinë ndë qytet.” (Iisui i Naviut 6.. 20, 21.)

Nga ky fat i keq që i gjeti vëndësit' e qytetit Ierihosë, shpëtoi vetëmë një grua bashkë me njerëzit' e saj, Raava me tanë e me t'ëmënë e me të vëllezërit e me gjithë njerëzit e shtëpisë, e me gjithë ç'kishte, sepse ajo fshehu dy vetë që pat dërguarë Iisui për të përgjuarë qytetn' e Ierihosë. Këtë ajo e bëri, sepse i pat besuarë Perëndisë Israilit, edhe i ishte mbushurë mëndia, se ay do të luftonte për llaun' e ti, edhe kishte për të mundurë gjith' arëmiqt' e atyre. (Iisui i Naviut 6.. 25. 2.. Evrenjtë 11.. 13.)

42. Gavaonitëtë. 1451 P.K.

Mb' ato anë rrinin' edhe të tierë njerës që kishinë frikë nga Israilitëtë. Këta erthnë e lithnë fjalë me Iisunë, që të shpëtoninë prej thikës' Israilitëvet. Ata ishinë vëndësit' e Gavaonësë, “Të cilëtë kur ndigjuanë se ç'i bëri Iisui Ierihosë e Gaisë, bënë punë me dinakëri, muarrë thasë të vietërë mbi gomarët e tyre, calikë vere të vietër' e të grisur' e të thururë, edhe mbathnë këpucë të vietëra e të anëruara, edhe veshnë rroba të vietëra, edhe gjithë buka që kishinë marrë për udhë ishte e thatë edhe e thërrmuarë.” (Iisui i Naviut 9.. 3-15.) Edhe ata erthnë te Iisui, e i thanë se kan' ardhurë prej një dheu të largë, kaqë sa janë grisurë rrobatë, e është thërrmuarë buka prej udhësë largë. Edhe ata thanë, se kan' ardhurë të lithnjënë fjalë me Iisun' e me Israilitët, që të jenë miq, e të kenë paqtim ndërmest t' atyre. Iisui u besoi fjalëvet atyre, edhe pa pyeturë Perëndinë, lidhi fjalë me Gavaonitët të kenë paqtim ndërmest t' atyre.

Pas tri ditç u muar vesh gënjeshtër. Israilitëtë panë se Gavaonitët' ishinë fëqinjë, edhe se rrininë ndërmest t' atyre. Atëhere Iisui nukë desh t'i prishnjë ata, sepse u pat dhënë besënë, po u mori atyre qytetetë, edhe Gavaonitët' “i bëri të presënë dru e të mbanjën' ujë për Israilitët e për theroren' e Zotit.” Edhe kështu ata mbetnë shërbëtorët' e Israilitëvet bres pas brezi. (Iisui i Naviut 9.. 27.)

43. Të pushtuarët' e Hanaanitëvet.

Perëndia i ndihte Iisuit ngjer sa pushtoi e vrau tri-dhiet' e një mbëretërë, që kishinë mbretërrira të vogëla ndë dhe të Hanaanit. Kur u bë një luft' e madhe ndë fushë të Aiallonit, dielli edhe hëna ndaloi me fjalë të Iisuit, ngjer sa Perëndia vrau Amoritëtë me gurë rrufeje.

Pas pak vieç Iisui pushtoj gjith' atë dhe, edhe zu t'u ndanjë dhenë të dy-mbë-dhietë faravet Israilit. Farën' e Ruvinit edhe farën' e Gadhit edhe gjymësën' e farësë Manassiut i nguli mb'-at'-anë lumit Iordhanit, edhe të tieratë nëntë farat' e gjymësë i nguli ndërmest të Iordhanit e detit. Farësë Leviut nuk' i dha dhe fare, po i dha qytete për të ndenjurë ndërmest gjithë faravet tiera. Tenda edhe Shënjtëroreja, bashkë me arkën' e Dhiatësë, u vunë ndë Sillo.

Iisui passi u bë një qint e dhietë vieç plak, edhe mbaroi gjithë punëtë, mbëloth bashkë gjithë Israilinë ndë Syhem, që t'u linte shëndet, se kishte për të vdekurë. Atëhere ay u pru ndër mënt atyre përdëllimn' e Perëndisë, edhe u tha atyre të jenë besëtarë e të ndigjuarshim. “Kini frikë Zotit, edhe lutni atë me zemërë të këthiellët' e të vërtetë. – Edhe ndë mos u pëlqeftë juve të lutni Zotnë, sgjithni sot atë që të dojni të lutni: - po un' edhe shtëpia ime, do të lusëmë Zonë.” Atëhere gjithë llauzi u përgjeq e tha: “Qoftë lark, të lëmë Zotnë, e të lusëmë perëndira të tierë!” (Iisui i Naviut 24.. 14-16.)

Ju munt të mendoni keq, për ç'punë Zoti urdhëroi Israilitët të vrisinë gjith' ata kombe, e t'u pushtonin' atyre dhen' e qytetet' e gjënë që kishinë. Perëndia bëri këtë kështu, sepse gjith' ata kombe kishinë mohuarë fare të vetëmin' edhe të vërtetinë Perëndi, edhe kishinë bërë perëndira të tierë për vetëhen' e tyre, të cilët'i lusin' e u shërbeninë; edhe mbë gjith' udhët e mbë gjithë punët ishinë bërë kaqë fort të këqinj, sa më s'munt t'i duronte Perëndia. Mbë të tiera kohëra, Perëndia kur desh të bënte gjyqin' e drejtë, e të mundonte botënë për të këqiat, ay i pat munduarë me përmbytëje uji, posi ndë kohë të Noesë, e me shi ziarmi, posi Sodhomën' e Gomorënë, po tani ay vuri llausn' e Israilit të shkonjë ndëpër gojë të thikësë këta idhullatrë, edhe kështu të mbaronjë fjalënë që u pat zotuar' atërvet atyre për dhenë që do t'u epte ndënë pushtet.

44. Gjykatësitë. – Gjedheoni. 1249 P.K.

Passi vdiq Iisui, Israilitët nukë qëndruanë ndë besët. Ata shumë herë vanë pas perëndirash tierë, do me thënë pas idhullash atyre kombevet që ishinë përçark atyre. Atëhere Zoti i lëshoi ndë dorë t'arëmiqet. Edhe sa herë pendoneshinë nga fajetë, Zoti i shpëtonte ata me anë krerësh e gjykatësish që vinte mbi ata, të cilëtë mbëretëroninë mbi një farë a mbi shumë fara.

Një herë, Madhianitët hynë ndë dhe të Hanaanit, edhe prishnë arat' e vëreshtëratë, e rrëmbyenë gjithë gjën' e gjallë. Shtatë viet kështu bëninë mot për mot, edhe s'gjëndej njeri t'i dëbonte ata. Atëhere Perëndia nxori Gjedheonë, një dialë të ri nga fara e Manassiut. “Edhe ëngjëll' i Zotit iu duk ati, e i tha: Zoti është bashkë me ty, o i fortë me fuqi. Edhe Gjedheoni i tha ati: O zoti im, ndë qoftë Zoti bashkë me ne, përse pra na gjenjënë gjithë këto (të këqia)? Edhe ku jan' ato çudit' e ati, që na dëftyen' atëritë tanë? – Edhe Zoti shtiu sytë mb' atë e tha: Shko me këtë fuqinë tënde, edhe do të shpëtonjë Israilnë nga duart' e Madhianitëvet: a nukë të kam dërguarë ty unë? Edhe ay i tha ati: O zoti im, me se do ta shpëtonj Israilnë? Ja shtëpia ime tek është më e vobekëta ndërmest (farësë) Manassiut, edhe unë jam më i vogëli ndë shtëpi të t'im-et. Edhe Zoti i tha ati: Po unë jam bashkë me ty, edhe ti ke për të ranë Madhianitëvet posi një burri.”(Gjykatësitë 6.. 12-16.)

Atëhere Gjedheoni rrëzoi poshtë theroren' e idhullësë Vaallit, që e kishte ngrehur' i ati, edhe preu drut' e pyllit afërë theroresë. Këjo ish një trimëri e madhe për Gjedheonë, sepse gjith' ata që lusin' idhullatë, kërkoninë ta vrisin' atë, po i ati Gjedheonit tha: “Vallë doni ju të mirrni shpagim për Vaallnë? – Ay ndë qoftë perëndi, le të marrë shpagim për vetëvetëhenë.”

Po Gjedheoni lypi një shenjë nga Perëndia, që të vërtetonetë, se e kishte vënë Zoti për të shpëtuar' Israilnë. Ay tha: “Ja unë te do të vë lëmshin' e leshit ndë lëmët: ndë raftë vesa vetëmë mbi lëmshit të leshit, edhe gjithë dheu të jet'i thatë, atëhere do ta ngjoh, se do të shpëtonjë Israilnë me dorënë t'ime.” Edhe kur u ngrit nesëret me natë, “troku lëmshin' e leshit, edhe shtrydhi vesënë prej lëmshit leshit, (edhe mbushi) një legen plot me ujë.” Pastai Gjedheoni i lypi Perëndisë edhe një herë tiatërë: “Të lutem, le të provonj edhe këtë herë lëmshin' e leshit: le të bënetë tani i thatë vetëmë lëmshi i leshit, edhe gjithë dheu le të lagetë me vesë.” Edhe Perëndia kështu bëri atë natë, edhe u bë i thatë vetëmë lëmshi i leshit, edhe gjithë dheu ishte lagurë me vesë.” (Gjykatësitë 6.)

Atëhere Gjedheoni u ngrit, e mbëlodhi tri-dhiet' e dy mijë ushtëtorë preifarash Israilitëvet. Edhe pas urdhërit Perëndisë, ay i tha ushtërisë: “Kush të ketë frikë le të këthenetë prapë, që të mos u shtierë frikën' edhe të tierëvet.” Me këtë fjalë që foli ay, njëzet e dy mijë vetë u këthyenë prapë, e iknë. Edhe Zoti i tha Gjedheonit: “Ky llaus është shumë, sbrit-i ata nd' ujët, edhe atie do t'i sgjeth për ty.” Kështu ay sbriti llausnë nd'ujët. Edhe Zoti i tha Gjedheonit: “Gjithë-kush të lllapnjë ujëtë me gijuhën' e ti, posi qen, ta vesh veç atë, edhe gjithë-kush t'ungjentë mbë gjunjë

për të pirë.” “Edhe numëri i atyre që lllapnë me duart n’gojë, ishinë tre qint burra, po gjithë të tierëtë u ungnë të pinjënë ujë. Edhe Zoti i tha Gjedheonit, Me këta tre qint burra që lllapnë ujëtë do t’u shpëtonj juve, edhe do të t’ap ndë dorë Madhianitëtë, po gjithë të tierëtë le t’ikënjënë gjithë-se-cili ndë vënt të ti.” Kështu Gjedheoni mbajti vetëmë tre qint vetë, edhe të tierët’ilëshoi të ikënjënë, që të mos thonë pastai Israilitëtë, se shpëtuam me duart t’ona.

Gjedheoni ndau të tre qint vetëtë tri tufash, edhe gjithë-se-kujt i dha nga një trumbetë ndë dorë; edhe kështu si u bënë gati të gjithë, erthnë ndë mes-natë, pa parë ata ushtëria e Madhianitëvet, pastai zunë t’u bijenë trumbetavet, për shenjë të luftësë, tuke thënë: “Shpata e Zotit, edhe e Gjedheonit.” Ata kur panë arëmiqtë me hunj pishe te ndrisinë nd’ erët, e me uturimn’ [buçimn’] e trumbetavet, e me zën’ e shtëmbavet balte tek i thyeninë, u ngritnë nga gjumi me frikë të madhe, edhe kaqë fort ishinë trubulluar’ e habiturë, sa kujtoninë shokët’ e tyre për arëmiq, edhe vrisinë shoku shokun’ e ti. Atëhere Israilitëtë sbrinë prei malit Gallaadhit e ndoqnë arëmiqtë, edhe vranë gjithë Madhianitëtë, edhe muarrë shumë plaçëka. (Gjykatësitë 8.. 22, 23.)

45. Rutha. 1322-1312 P.K.

Pas shumë luftërash që koditnë, po dëftejmë punët’ e një shtëpie ndë një fshat. Ndë kohë të Gjykatësë, ishte një shtëpi nd’ atë dhe. Një burrë nga Vithleema vate bashkë me të shoqenë Naominë edhe me dy të bijtë ndë Moavë, edhe nguli atie. Këta të dy të bijtë muarrë atie dy gra Moavitesha, Orfanë edhe Ruthenë. I ati atyre vdiq, pastai vdiqnë edhe dy të bijtë; edhe Naomia desh të këthenei ndë dhe të Israilit posi një plak’ e ve që ishte; deshnë t’i ngjiteshinë prapa edhe të dy të rat’ e asai. Ajo u tha atyre të rrininë ndë dhe të tyre, edhe kështu Orfaja mbeti, “po Rutha tha: Mos më ngut të lë ty, a të këthenem prapë prei teje, sepse atie ku të veç ti, do të vete edhe unë, edhe atie ku të mbetesh ti, do të mbetem edhe unë; gjëndëja jote është gjëndëja ime, edhe Perëndia yt është Perëndia im: atie ku të vdeç do të vdes, edhe do të varronem.” (Rutha 1.. 1-18.)

Kur erdhi Naomia ndë Vithleemë mezi e ngjohnë gjëndëja. “Këjo është Naomia? - thoshinë (gratë): edhe ajo u thoshte atyre: Mos më thojni Naomi, (që do me thënë e pëlqyerë,) po më thojni Mara, (që do me thënë e hidhurë.) – Sepse ika plot (së këtejmi), edhe Zoti më këtheu sbrazëtë.” (Rutha 1.. 19-22.) Ishte ndë kohë të korrit elbit, edhe Rutha vate ndëpër arat të mbëlithte kallinj. Edhe Perëndia kështu pat urdhëruarë që të shkonte ndëpër arët të një të pasuri që e kishte emërinë Voozi, i cili ishte fisi i të shoqit Ruthësë që pat vdekurë. Voozi kur erdhi nd’ arë, pyeti korrësitë, cila është ajo. Pastai ay erdhi, e i foli me të mirë Ruthësë, edhe i tha asai: “Unë kam marrë vesh fort mirë, se ç’i ke bërë s’at-viehërre pas vdekëjesë t’yt-shoq. Zoti të shpagoftë punënë, edhe paga jote qoft’ e plotë prei Zotit Perëndisë Israilit, që erdhe të mbulonesh ndënë fletët t’ati.” Pastai u tha djemvet ta marrënë me të mirë, edhe të lënë të bienë ca koqe gruri që t’i mbëledhë ajo. (Rutha 2.. 3-12.)

Rutha i tha së viehërrësë se ç’i tha Voozi. “Edhe Naomia i tha asai: Ay njeri është fisi ynë nga më t’afërmit’ e fisravet t’onë: qoftë bekuarë Zoti që nukë la mbë-nj’-anë përdëllimn’ e ti nga të gjallët’ e nga të vdekuritë.” (Rutha 2.. 19, 20.)

Voozi kur pa ndë gjithë kohë të korrit, se Rutha ishte një grua e urtë, e desh atë. Po ndër Israilitët ishte një zakon, kur vdiste ndonjë njeri pa lënë bij, duhej ta merrte për grua të venë më i afërmi fisi i ati. Përandai e viehërri i dëften se resë gjithë se si ishte puna, edhe Rutha i ra ndë këmbë Voozit, pas zakonit vëndit, edhe ay e mori për grua, passi u mbarua të korrëtë.

Këjo Moaviteshë e varfërë u bë e gjysheja e mbëretit Dhavidh, për të cilin kemi për të shkruarë shumë pastai. Perëndia i fali asai një dialë, që ia thoshin emërin' Ovidh. "Edhe Ovidhit i lindi Iesseu," që ishte i ati i mbëretit Dhavidh.

Kështu Rutha ka qenë nga përintë e të hieruarshimit Birit Dhavidhit, Zotit Iisu-Krisht, që Iudhenjtë e Gjëntarëtë u bënë një me anë të vdekëjes' ati, edhe përdëllimi i ati u shtri mbë gjith' ata që i besuan' emërit ati, edhe me anë t'ati do të shpëtonenë shumë vetë që s'kanë të numëruarë nga gjithë kombet' e gjëndëjet' e llauzet' e gjuhëratë.

46. Ilei edhe Samuilli. 1171-1095 P.K.

Pas shumë gjykatësish, Ilei krye-prifti u bë gjykatës ndë Israil. Kështu duhej të bënei gjithë monë pas ligjësë Moisiut. Tenda ishte ndë Sillo, edhe Israilitëtë mbëlidheshin' atie për ditë të kremtesh. Ilei një ditë pa një grua te po falej brenda ndë tendët; ay e pa atë te kishte ngulurë sytë, edhe te po i luaninë buzëtë, po zëri nuk' i ndigjonej, sepse ajo fliste ndër vetëhe me zemërë të saj. Edhe Ilei ia bëri pa udhë asai gruasë mjerë. Ajo i lutei Perëndisë t'i falte një dialë, sepse ajo kishte shumë viet që ishte martuarë, e s'kishte piellë kurrë. Ilei kur e mori vesh këtë nga gruaja, i tha asai: "Shko ndë paqtim, edhe Perëndia i Israilit të faltë ç'lypën." Edhe Anna iku së andejmi, edhe faqenë nuk' e kishte më të vrërëtë, sepse ajo ia çeli zemërënë Perëndisë. Zoti ia ndigjoi lutëjen' asai, edhe i fali asai një dialë, edhe ia vu emërinë Samuill, që do me thënë Lypurë nga Perëndia. (1. Samuill. 1.. 9-20.)

Pas ca vieç, përintë prunë me vetëhe dialënë ndë Sillo për ditë të kremte, edhe e ëma ia dha ndë dorë priftit t'a ketë kujdes. Mot për mot, kur vininë ata për ditë të kremte, shihinë dialënë. Edhe pas pak kohëje, Perëndia vetë i foli dialit, edhe e bëri profit. Të bijt' e krye-priftit Ofneiu edhe Fineesi, ishinë fort të prapë e të këqij, të cilëtë ndyrinë Shën-vëndin' e Perëndisë me punëra të këqia që punoninë. Ilei shumë herë u tha të bijet, se mbë këtë mëndyrë që punonin' ata, i bënë faj Perëndisë, po ay ishte i butë, e nuk' i shtrëngonte as nuk' i mundonte ata sikundrë duhej t'ua bënte, posi përint edhe posi gjykatës që ishte.

Një natë, Zoti thirri: "Samuill". Diali u ngrit e vate te Ilei, sepse kujtoi se e thirri Ilei. Këjo u bë kështu tri herë, atëhere Ilei e mori vesh se ishte Zoti, edhe i tha ati: "Ndë të thërritë për-së-ri t'i thuash: Folë, Zot, sepse shërbëtori yt ndigjon."

Për-së-ri u ndigjua zër' i Zotit: "Samuill, Samuill", edhe Samuilli tha: "Folë, Zot, sepse shërbëtori yt ndigjon." Atëhere Zoti tha: "Ja unë te do të bënj një punë ndë Israil, që kush ta ndigjonjë atë do t'i uturinjë [buçinjënë] veshëtë. – Do të bënj kundrë Ileiut gjith' ato që i fola për shtëpin' e ati, sepse i dhashë zë ati, se unë do të gjykonj shtëpin' e ati gjithë monë për pa-udhërinë, sepse tuke diturë se të bijt' e ati prunë mallëkim mbë vetëvetëhet, e nuk' i përmbëlodhi ata." (Samuill. 3.. 2-14.)

Nesëret Ilei pyeti Samuillnë: "Ç'fjalë të foli Zoti ty? Të lutem, mos fsheç (gjë) prei meje." Edhe Samuilli i dëfteu të gjitha Ileiut. Edhe Ilei tha: "Ay (është) Zot, le të bënjë ç't' i pëlqenjënë syt' e ti."

Fjala e Perëndisë që foli nukë ra poshtë pa mbaruarë. Pas pak koheje u bë një luftë. Filistinëtë muntinë Israilitëtë, edhe pleqt' e Israilitëvet ndë vënt që të luftoninë trimërisht, ata nxuarrë ndë ushtërit arkën' e Perëndisë. Dy priftërit' e ri mbanin' arkënë. Ilei, nëntë-dhiet' e tetë vieç plak, ndenji ndë derët të qytetit për të marrë vesh se ç'do të bënei. Një i laim erdhi me rroba të grisura e me faqe të vrërëtë. Ilei e pyeti ç'u bë ndë luftë. I laimi u përgjeq: "Israili u thye nga Filistinëtë, të dy bijt' e tu u vranë, edhe arka e Perëndisë u zu." Ilei kur ndigjoi këtë, ra prapëtë nga vëndi, edhe iu këput qafa, e vdiq. (1. Samuill. 3.. 17, 18: 4.. 13-18.)

Filistinëtë prun' arkën' e Perëndisë ndë Azotë, edhe e vunë ndë shtëpi të idhullës' atyre Dhagonit. Të dytënë ditë ndë mëngjes Dhagoni u gjënt rrëzuarë për dhe përpara arkësë, thyerë kryet' e duartë. Atëhere ata prun' arkën e Perëndisë ndë Akkaron, po edhe atie bëri çudi të frikëshime. Pas shtatë muajsh ata këthyenë prapë arkën' e Perëndisë ndë vënt të saj. Po Filistinëtë kishin ndën' urdhërë Israilinë njëzet viet. Edhe gjith' atë kohë Israili hoqi keq.

Këtu është shkruar' idhulla e Dhagonit, gjymësa peshk e gjymësa njeri, që ra përmbys e u thye ndë tempullë të ti, përpara arkësë Perëndisë Israilit.

Po Samuilli passi i pru ata prapë te Perëndia i atërvet tyre, Perëndia ua bëri mbarë atyre, të marrënë prapë qytetetë që ua patnë pushtuarë Filistinëtë. Samuilli vu një gur për kufi [sinor] ndë dhe të Filistinëvet, edhe shkroi mbi atë: "E'ven-ezer" [Gur i ndihmësë], që do me thënë: "Ngjer këtu na ndihu Zoti." Samuilli urdhëroi me urtësi e me drejtëri, edhe qe më i miri nga të gjithë gjykatësitë që patnë urdhëruarë ndë Israil.

47. Samuilli edhe Saulli. 1095-1079 P.K.

Kur u plak Samuilli, u dha urdhërë të bijet të gjykonjënë llauzë, po ata ranë pas lakëmimit, e nuk' ecnë mirë, edhe i prishnë punënë t'et. Atëhere u mbëlohnë gjithë pleqt' e faravet Israilit, edhe erthnë te Samuilli ndë Rama, t'i thon ati, se ata nukë doninë më t'i urdhëronjënë, po dëshëroninë të kenë një mbëret. Samuillit nuk i pëlqeu këjo, po Perëndia i tha ati: "Ndigjo-i zënë llauzit për gjithë ç'të thonë ty, sepse nukë të kanë hedhurë tej ty, po më kanë hedhurë tej mua që të mos mbëretëronj mbi ata." (1 Samuill 8.. 1-7.)

Nd' atë kohë një njeri nga fara e Veniaminit, që ia thoshin' emërinë Keis, humbi ca gomare, edhe ay dërgoi të birë Saullinë, bashkë me një shërbëtuar, për të kërkuar' ato. Kur erthnë ata afërë qytetit Ramasë, atie ku rrinte Samuilli, i ra ndër mënt shërbëtorit të pyesë profitnë t'u dëftente vëndinë ku ishinë gomaretë. Ishte atë ditë që i u sbëlua profitit: "Ja ay njeriu që të thashë për atë, ky do të urdhëronjë llauznë t'im." Samuilli i tha Saullit: "edhe për gomaret që të kanë humburë tani tri ditt, mos ki kujdes për ato, se u gjëtnë; edhe mbë cilin' është gjithë dëshërimi i Israilit? As po nuk' është mbë ty, edhe mbë gjithë shtëpin' e t'yt-et?" Saulli nukë mori vesh përse fliste kështu, po nesëret me natë, profiti doli bashkë me atë, edhe e mori atë mbë-nj'-anë, edhe mori një kupë me vaj, edhe ia derdhi mbi kryet, pastai e puthi e i tha: "A nukë të ka vajuarë [lyerë me vaj] Zoti për të parë mbi trashigimn' e ti?" Saulli pastai vate ndë shtëpi, edhe nuk' i dëfteu gjë asnjëriu, ngjer sa ta nxirte për faqe Samuilli vetë.

Pas pak koheje, Samuilli mbëlodhi gjithë llauzë, edhe u nxori përpara atyre mbëretn' e ri. Edhe ata kur e panë, bërtitnë të gjithë me një zë: "Rroftë mbëreti!"

Shpejt pasandy Saulli bëri luftë, edhe mundi Ammonitëtë, edhe shpëtoi Gallaadhinë prei pushtetit atyre, edhe kështu gjithë kombi iu fal ndersë ati për trimërinë. Po Saulli nukë ruajti urdhërimet' e Perëndisë. Mbë një luftë kur mundi Amalikëtë, nuk' i vrau të gjithë, sikundrë ishte urdhëri i Perëndisë, po i fali jetënë mbëretit edhe gjithë gjësë gjallë, edhe desh të bënte kurban prei atyre kafshavet gjalla që pat urdhëruarë Zoti t'i vriste. Edhe Samuilli erdhi të piqetë me atë, edhe i tha: "Sos i pëlqenjënë Perëndisë (kurbanëtë) të diegurë të gjithë, edhe kurbanëtë, më tepërë se t'i ndigjonjç zënë Zotit? Ja të ndigjuarëtë (tek është) më të mirë, se kurbanit, të ndigjuarëtë (është më të mirë,) se të majturit' e deshëvet, sepse të pa-ndigjuarëtë (është posi) faji i magjisë, edhe dhuna (është posi) pa-besëria e (posi) idhullatria; edhe sikundrë ti hodhe tej fjalën' e Zotit, edhe ay të ka hedhurë tej ty nga mbëretëria." (1 Samuilli. 9.., 10.. 1-24: 15.. 22, 23.)

48. Dhavidhi kur ishte bari. 1063 P.K.

Samuilli vate ndë Vithleemë, te Iesseu i bir' i Ovidhit, dialit asai Ruthësë mjerë, sepse Zoti i tha ati: “Unë kam gjeturë për vetëhenë t’ime një mbëret ndër të bijt’ e Iesseut.” Samuilli thirri Iessenë bashkë me të bijt një ditë të kremte për kurban, që t’i shihte ata, edhe të vajonte fshehurazi atë që të s’gjithte Perëndia. Të shtatë të bijt’ e Iesseut shkuanë përpara ati, edhe Samuillit i pëlqyenë fort, po as ndonjë nga ata s’kishte sgjedhurë Zoti. Samuilli pyeti Iessenë, ndë kishte edhe të tierë djem. Iesseu tha: Ka mbetur’ edhe më i vogëli jashtë ndëpër fushat tuke kulloturë dhëntë, për atë nukë na ra ndër mënt. Dërguanë fjalë me vrap të vinte, edhe kur erdhi, e panë se ishte një dialosh “qime-kuq, e sy-bukurë, e faqe-hieshim. Edhe Zoti tha: Ngreu, e vajo atë, sepse ky është.” (1 Samuilli. 16.. 12.) Atëhere Samuilli mori brinë me vaj, edhe vajoj atë ndë mest të vëllezëret.

Që mb’ atë ditë Fryma e Zotit erdhi e mbeti mbi atë. Po Fryma e Zotit iku nga Saulli, edhe ay s’kishte të prëjturë. Ay donte ndonjë njeri t’i binte harpësë, e të këndonte, kur vinte frym’ e keqe mbi atë. Një nga shërbëtorët’ e ati i tha, se bir’ i Iesseut, një dial’ i urtë e trim, i bije fort mirë harpësë. Shpejt dërgoi e prunë Dhavidhë, edhe Saulli e vinte t’i bierë harpësë.

Munt të jetë, se Dhavidhi që kur se ishte tuke kulloturë grigjën’ e dhënet ndëpër kodrat të Vithleemësë, do të kishte ngjohurë Zotnë për Perëndi të përdëllyershim që fal fajetë, edhe do ta kishte sgjedhurë për Perëndin’ e ti, që t’i shërbente e ta donte me gjithë zemërë. Përandai u mësua të këndonte: -

Zoti është bariu im: s’do të më shteretë gjë.

Më vuri të rri ndë kullota të ngjoma,

Më hoqi udhënë ndë ujëra të prëjturi.

Më pruri shpirtinë ndë vënt.

Më hoqi udhënë ndëpër ruga dreitërie, për punë të emërit ti.

Sepse edhe ndë shkofsja për mes hiesë vdekëjesë,

Nukë do të kem frikë për ndonjë të keqe, se ti je bashkë me mua:

Purteka jote edhe shkopi yt, ato më ngushullonjënë. (Psallmë 23.)

Munt të jetë për-së-ri, se Dhavidhi do të kishte kënduarë këtë kënkë, kur ka ruajturë grigjën’ e dhënet natënë: -

O Zot Zoti ynë, sa i çudiçim është emëri yt mbë gjithë dhenë!

Se u lartua madhëria jote përmbi qiejt,

Kur vështron qiejtë, punën’ e gishtrëvet tu,

Hënënë edhe yjtë, që themelove ti!

Ç’është njeriu, që t’e kujtonjç?

A i bir’ i njeriut, që t’e vështronjç? (Psallmë 8.)

Posi Samuilli, kështu edhe Dhavidhi u sgjoth profit nga Perëndia që kur ishte dial’ i ri. Lum ata që ngjohënë Perëndinë që mbë të vogëlë, edhe e kanë për atë e për udhë-heqës!

49. Dhavidhi edhe Goliathi. 1063 P.K.

Pas ca koheje për-së-ri luftuanë me Filistinët. Atëhere Dhavidhi ishte këthyerë ndë Vithleemë, po të vëllezëritë më të mëdhenjtë vanë me ushtërin’ e Saullit. I ati dërgoi Dhavidhë ndë ushtërit të shohë të vëllezëritë. Kur erdhi ay ndë ushtërit, pa ushtëtorëtë te po luftonin. Edhe kishte dalë nga ushtëria e Filistinëvet një gjigant (burrë i gjatë) i armatosurë, i cili thërriste: Kush të jetë trim ndër Israilitët le të dalë të luftonjë një me një me mua. Mbëreti Saull i zotonei ati

njeriu që të vriste gjigantinë, t'i epte të bijënë për grua, edhe shtëpia e t'i atit ati të jetë e lirë ndë Israil. Tani Dhavidhi e ndigjoi këtë, edhe ay nukë vintej ndër mënt ato që kishte zotuarë t'apë mbëreti, po ati i vinte keq shumë, si të mos gjëndej ndonjë Israilit që të vinte shpëresënë mbë Zotnë, e të luftonte me Filistinët. Atëhere ay i dërgoi fjalë mbëretit, se do t'i dalë përpara gjigantit. Mbëreti nuk' e linte, po i thoshte: "Ti je çun i vogëlë, e ay është një burrë luftëtar që prej dielmërisë ti." "Edhe Dhavidhi tha: Zoti që më shpëtoi prej gojësë leonit, edhe prej gojësë ariut, ky do të më shpëtonjë edhe prej dorësë këti Filistinit." Saulli e armatosi atë me armët e tia, e i vu mbë krye një përkrenare të ramtë, e i veshi një thurake, e i ngjeshi shpatënë, po Dhavidhi hoq armëtë, sepse s'ishte mësuarë me ato, e i vininë të rënda, e s'muntej të ecënte; edhe ay mori stapnë ndë dorë, edhe sgjodhi pesë gurë të rumbullakëtë, edhe një hobe, edhe kështu i doli përpara gjigantit me hobe e me stap ndë dorë.

Gjiganti kur pa këtë çun të vogëlë që i doli përpara, e shau atë, e tha: "Qën jam unë, që vien tek unë me stap? Eja tek unë, edhe do të ap mishërat' e tua shpeset qiellit, e bishavet pyllit." Edhe Dhavidhi i tha Filistinit: "Ti vien kundrë meje me shpatë e me shtijëzë e me mburonjë, po unë vinj kundrë teje mb' emërit të Zotit fuqivet, Perëndisë ushtërivet Israilit, të cilatë ti nuk' i zure për gjë." Edhe Filistini kur iu afërua Dhavidhit, ky hodhi një gurë me hobe, e ia mbërtheu brenda ndë trut, edhe ay ra me faqe për dhe i vdekurë. Atëhere Dhavidhi mori shpatën' e Filistinit, edhe i preu kryetë me shpatën' e ati. (1 Samuill. 17.. 32-51.)

Filistinëtë kur panë se ç'u bë, i mori frika, e iknë, edhe Israilitët'i ndoqnë prapa ngjer ndë qytetet t'atyre.

Saulli pyeti Dhavidhë: "I bir' i kujt je, o dialë? Edhe Dhavidhi u përgjeq: I bir' i shërbëtorit t'yt Iesseut Vithleemitit." (1 Samuill. 17.. 57, 58.) Edhe Saulli kur mbaroi së foluri, zëmëra e Ionathanit të birit Saullit u ngjit pas zemëresë Dhavidhit, edhe Ionathani, e desh atë posi shpirtin' e ti." (1 Samuill. 18.. 1.) Edhe Ionathani, i bir' i mbëretit, i fali Dhavidhit rrobat' e tia, e shpatën' e ti, e hargun' e ti, e bresn' e ti, edhe Saulli nuk' e la Dhavidhë të këthenetë më ndë shtëpi të t'et, po e mbajti me vetëhe, edhe e bëri të parë mbi ushtëtorët.

50. Të ndiekurit' e Dhavidhit. 1063-1056. P.K.

Israilitëtë kur këtheneshinë ndë shtëpi prej luftësë, si muntnë Filistinëtë, gratë delinë përpara tuke karcyerë e tuke kënduarë: "Saulli vrau një mijë vetë, e Dhavidhi dhietë mijë vetë".

Kur ndigjoi këtë mbëreti u hidhërua fort, e tha: "Ç'(i lypsetë) më ati, veç mbëretëria?" Mbëreti kur shihte, se llauzi e donte fort Dhavidhë, kaqë më fort e kishte cmir, ngjer sa së pastaimi kërkonte ta vriste. Një ditë Dhavidhi kur po i binte harpësë përpara ati, Saulli solli me shtijëzë mb' atë. Pastaidërgoi njerës ta vrisinë ndë shtëpi, po e shoqeja Mihalla, që ishte e bija e Saullit, e sbriti nga parathireja, edhe ay shpëtoi e iku.

Ionathani shumë herë i lutej t'et, të mos e vdiqte atë, po Saulli i tha të birit, se e ka vënë ndër mënt ta vrasë Dhavidhë. Ionathani i tha Dhavidhit, të ikënjë prej këti vëndi. Dhavidhi atëhere vete te mbëreti Filistinëvet, edhe mori me vetëhe shpatën' e Goliathit, po të parët' e Filistinëvet e shikoninë me sy të keq, edhe mezi shpëtoi kryetë nga ata.

Dhavidhi tani rrinte ndëpër shkrepat e ndëpër shpellat e ndëpër malet e Iudhesë. Edhe ishinë mbëledhurë pas Dhavidhit afëro gjashtë qint burra, bashkë me pleqt e me grat e me djemt, edhe shumë nga këta ishinë miqt' e fisi i Dhavidhit, edhe për këtë punë i ndiqte ata Saulli. Sepse kaqë zemërim të math kishte Saulli kundrë Dhavidhit, sa një ditë urdhëroi të vritetë krye-prifti bashkë me tetë-dhiet' e katërë priftërë të tierë, sepse i kishte dhënë bukë Dhavidhit pa ngjohur' atë. Përveç këtyre ay urdhëroi të prishinë qytetin' e priftërëvet, edhe të shkonjëndë ndëpër gojë të

thikësë burrat' e grat' e djemt' e bagëtitë, edhe kështu Perëndia mori shpagim prej gjithë fëmijvet Ileiut, sikundrë pat thënë përpara. Vetëmë një njeri shpëtoi, e erdhi te Dhavidhi, ky ishte Aviathari, i cili pastai u bë krye-prift.

Dhavidhi edhe si iku, e kishte për mik të mirë Ionathanë; edhe sa-do që ndiqej Dhavidhi prej Saullit, po ay e donte atë, edhe e ngjijhte për mbëretn' e ti e për viehërrin' e ti e për të dashurin' e ti.

Pak kohë pasi u vranë priftëritë, Saulli doli me tri mijë vetë që të zënjë Dhavidhë ndëpër malet e Iudhesë. Edhe një ditë Saulli hyri ndë një shpellë që të prëhej, atie ku ishte fshehurë brenda Dhavidhi bashkë me njerëzit e ti. Edhe njerëzit' e Dhavidhit kur panë Saullnë te po flinte brenda ndë shpellët, thanë: “Ja (tek erdhi ajo) dita që të pat thënë Zoti: Ja unë te do të ap ty ndë dorë arëmiknë tënt, edhe bën-ia ati si të duketë mirë. Atëhere Dhavidhi u ngrit e i preu fshehurazi pëqin' (e rrobësë) Saullit. Edhe u tha njerëzet ti: Qoftë lark prej meje, o Zot, t'i bën unë këtë punë t'im-zoti, të lyerit Zotit, të vë dorënë t'ime mbi atë, sepse është i lyeri Zotit. Edhe Dhavidhi ndali njerëzit' e ti me (këto) fjalë, edhe nuk' i la të ngrihenë kundrë Saullit. Edhe Saulli si u ngrit prej shpellësë, mori udhën' (e ti). Pastai u ngrit edhe Dhavidhi, e doli prej shpellësë, edhe i bërtiti prapa Saullit, e tha: Zoti im, o mbëret. Edhe Saulli kur këtheu kryetë prapa të shohë, Dhavidhi ra me faqe përdhe, edhe i u fal ndersë. Ani Dhavidhi i tha Saullit: Përse ndigjon fjalët' e njerëzet që thonë: Ja Dhavidhi që do të keqenë tënde? Ja këtë ditë panë syt' e mi me ç'mëndyrë të dha Zoti ndë dorët t'ime sot ndë shpellët, edhe (ca më) thanë të vras ty, po unë të kurseva edhe thashë: S'do të vë dorënë t'ime mbi t'ëm-zot, sepse është i lyeri Zotit. Shi pra, ata im, shih këtë pëqinë e rrobësë s'ate ndë dorët t'ime.” Atëhere Saulli tha, “Ti qenëke më i dreitë se unë.” (1 Samuill 24.. 4-17.) Kështu Saulli u këthye ndë shtëpi të ti me turp.

Po nukë shkoi shumë kohë, edhe Saulli doli për-së-ri kundrë Dhavidhit, edhe nguli ushtërinë ndë kodret të Ehelasë. Atëhere Dhavidhi edhe Avisai hynë natënë ndë mest të ushtërisë: “edhe Saulli po flinte brenda ndë hendek, edhe kishte ngulurë shtijëzënë ndë dhet afërë kresë, edhe Avenirri edhe gjëndëja po flininë rreth e rrotull' ati. Atëhere Avisi i tha Dhavidhit: Perëndia të ka lëshuarë ndë dorë arëmiknë tënt sot, tashi pra le t'i bije ati me shtijëzënë.” Po Dhavidhi i tha Avisait: “Mos e vra atë, sepse cili është ay që vë dorën' e ti mbi të lyerin' e Zotit, edhe të jetë pa faj?” Edhe Dhavidhi mori shtijëzënë' edhe anën' e ujit afërë kresë Saullit. Atëhere Dhavidhi iku mb'-at-anë, e vate e ndenji mbë një majë mali për së largu, edhe bërtiti me zë të math: “Avenir! Avenir!” Krye-ushtëtori i Saullit u ngrit prej gjumit, e tha: “Kush je ti, që thërret mbëretnë?” Dhavidhi i tha ati: “A nuk je ti një burrë trim? E kush është si ti ndër Israil? Përse pra nukë ruan t'ët-zot mbëretnë? Sepse hyri një njeri prej gjëndëjesë për të vranë mbëretnë t'ët-zot. – Edhe tashi, shihni ku është shtijëza e mbëretit, edhe ana e ujit, që ishte afërë kresë ati.” Edhe Saulli ngjohu zën' e Dhavidhit, edhe tha: “A zëri yt është, o biri im Dhavidh?” Edhe Dhavidhi tha: “Zëri im është, zoti im o mbëret. – Përse ndiek kështu zoti im shërbëtorin' e ti? Sepse ç'të kam bërë unë? A ç'e keqe gjëndetë ndë dorët t'ime? – Mbëreti i Israilit ka dalurë të kërkonjë një plesht, posi ay që ndiek thëllëzënë ndëpër malet”. Atëhere Saulli tha: “Fëjeva, këthehu, o biri im Dhavidh, se s'kam për të bërë keq më ty, sepse shpirti im pasëka qenurë shumë i ndershim sot ndë syt të tu.” Po Dhavidhi nukë zinte besë t'i bierë ndë dorë, sepse ia ngjijhte zemërën' ati. Ani Dhavidhi tha: “Ja shtijëza e mbëretit, le të vinjë ndonjë dialë, edhe le ta marrë.” Kështu Dhavidhi mori udhën' e ti, edhe Saulli u këthye ndë vënt të ti. (1 Samuill. 26.. 5-25.) Këjo qe e pastajmeja herë që u panë ndër sy Dhavidhi me Saullinë. Saulli nukërroi shumë viet pasandy.

51. Vdekëj' e Saullit. – Dhavidhi bënëte mbëret. 1056 P.K.

Atëhere Dhavidhi iku me gjashtë qint vetë ndë dhe të Filistinëvet, sepse kishte frikë, se mos bierë ndë dorë të Saullit ndonjë ditë. Edhe Aghusi, mbëreti i Gathësë, i dha qytetn' e Siklagësë, edhe ndenji atie bashkë me të shokët e me fëmijt të ti afro një vit e gjymësë.

Edhe të parët' e Filistinëvet poqnë ushtëriatë bashkë që të luftoninë kundrë Israilitëvet, edhe Aghusi i tha Dhavidhit: “Ti do të veç bashkë me mua ndë luftë”. Kështu Dhavidhi vate bashkë me Aghusnë. Po ata të tierëtë të katërë të parët' e Filistinëvet patnë frikë prei ati, edhe Dhavidhi u këthye prapë ndë shtëpi. Po ç'çudi të frikëshime pa ay të tretënë ditë, kur erdhi ndë Siklagë, gjeti qytetnë rrëzuar' e diegurë fare! Amalikët' e kishinë rrëzuarë, edhe kishinë rrëmbyerë grat' e fëmijt' e gjithë gjënë. Ndonëse njerëzit' e Dhavidhit ishinë lodhurë prei udhësë largë, po ata u ranë prapa e ndoqnë viedhësitë, edhe gjithë natënë ecnë ndëpër shkretëtirët, edhe pa sbardhurë drita ua harrinë atyre. Ata ishinë përndarë mb'-at'-anë e mbë-kët'-anë tuke ngrënë e tuke pirë e tuke karcyerë, sepse kishinë marrë shumë plaçëka nga dheu i Filistinët e nga dheu i Iudhesë. Edhe Dhavidhi u ra atyre, e i vrau, edhe mori prapë gjithë plaçëkatë që kishinë rrëmbyerë.

Po ndër gjithë këtë kohë ç' ishte bërë ndë Gellvue? Israilitëtë ishinë mundurë nga Filistinëtë, Ionathani ishte vrarë, edhe të dytë të bijt' e tierë të Saullit ishinë vrarë, edhe Saulli ra mbi shpatët të ti, e vrau vetëhenë.

Dhavidhi posa u këthye prei luftës' Amaliqitëvet ndë Sikllagë të rrëzuarë, ay ndigjoi prei një Amaliqiti mortëjen' e Saullit, edhe të prishurit' e ati. Ay njeriu kishte dalë jashtë ndë fushët të luftësë, edhe gjeti kurmn' e mbëretit vrarë, edhe mori rrobën' e mbëretërisë edhe kurorënë prei kryesë ati, edhe ia pru Dhavidhit, e i tha se e vrau ay vetë. I mjeri njeri kujtoi se do të mirrte ndonjë pagë të madhe me këtë gënjeshtë. Po Dhavidhi grisi rrobatë, e bëri vajë të madhe, edhe i tha ati: “Qysh nukë pate frikë të vësh dorënë tënde mbi atë, e të vraç të lyerin' e Zotit? – Gjaku yt qoftë mbi kryet t'at, sepse goja jote deshmoi kundrë teje”. (2. Samuilli 1.. 2-16.) Edhe Dhavidhi urdhëroi ta vrasën' atë.

Dhavidhi tashi u këthye ndë dhe të ti bashkë me njerëzit e ti, edhe erdhi ndë Hevronë. Ay u dërgoi dhurëti gjithë pleqëvet dheut Iudhesë prei plaçëkavet që kishte marrë nga Amaliqitëtë. Njerëzit' e Iudhesë e sgojthnë atë për mbret. Po Aveniri bëri mbëret për Israilnë, Isvosthenë, të birin' e Saullit. Kështu Israili kishte dy mbëretërë, po këjo qe për pak kohë. Isvostheu u vra nga shërbëtorit' e ti, edhe sgojthnë Dhavidhë për mbëret përmbi gjithë Israilnë.

Dhavidhi donte të bënte Ierusalimënë për krye-qytet të mbretërisë ti, po Sioni, an' e sipërme e këti qyteti, ishte ndënë pushtet të Ivusevet, edhe ua mori atyre. Atëhere ay ngrehu qytetnë, edhe ndërtoi atie një pallat për të ndenjurrë vetë. Kështu ay madhoi edhe ndreqi anën' e poshtërme të qytetit.

Pastai Dhavidhi bëri vënt edhe për arkën' e Perëndisë, që kishte mbeturë pesë-dhietë viet ndë Kiriath-iareim, nd' atë vënt që kurë se e patnë këthyerë prapë Filistinëtë. Atëhere e prunë me gëzim të math ndë Ierusalimë, edhe e vunë ndë një vent që pat bërë Dhavidhi për atë. Po Tenda e Vietërë edhe theroreja mbetnë ndë Gavaon, edhe atie bëneshinë kurbanetë për ditë, edhe mbaheshinë gjithë të kremtet' e mëdha ngjer sa u ndërdua Tempulla prei Solomonit.

Dhavidhi bëri shumë luftëra, edhe shtriu sinoret' e mbëretërisë ti që prei Detit Bardhë nga perëndon dielli, ngjer ndë lum të Efratit nga len dielli, edhe prei Dhamaskësë nga an' e borësë ngjer ndë Misir nga an' e mes-ditësë. Edhe me gjithë këto luftëra të pa-numëruara që bëneshinë, llauzi shkante më mirë ndën' urdhërë t'ati, se kur ishte ndën' urdhërë të gjykatëset, kështu edhe gjith' ata kombe që qenë pushtuarë – Syrianët' e Edhomitët' e Moavit' e Filistinët' – ishinë të lumurë, sa kohë qenë ndën' urdhërë të Dhavidhit.

Nd' atë kohë Dhavidhi bëri faj me Vith-saveenë, të shoqen' e Urisë krye-ushtëtorinë e ushtërisë ti, edhe për këtë punë ay urdhëroi Ioavinë krye-ushtëtorinë e math, kur të luftoninë të venë Urinë ndë ballë të luftësë, që të vritej nga arëmiqtë. Do t'i kishte rënë ndër ment Dhavidhit, se kështu ia pat bërë Saulli edhe ati, po Perëndia e pat ruajtur' atë. Po ay s' mendoi as pak për këtë, sepse dashuria e Vith-saveesë i kishte verbuarë sytë, edhe Perëndia la Urinë të vritetë. Për një vit të tërë, Dhavidhi nuk' u pendua për fajinë.

Atëhere Perëndia dërgoi profiitë Nathan tek ay t'i thotë: “Ishinë dy njerës ndë një qytet, njëri i pasurë e tiatëri i vobek. I pasuri kish fort shumë grigjëra dhensh e bagëti. Po i vobegu s'kish tiatërë gjë veçe një dele të vogëlë, të cilën' e pat blerë, edhe e u shqente; edhe u rrit bashkë me atë, edhe bashkë me djemt e ati: hante prei bukës' ati, e pinte prei qeftit ati, e flinte ndë gjith' t'ati, edhe e kishte posi bijë. Edhe erdhi një udhëtar tek i pasuri, edhe ati iu kursye të marrë prei grigjërash dhenvet ti, e prei bagëtivet ti, që t'ia gatnjë udhëtarit që erdhi tek ay, po mori delen' e të vobegut, edhe e gatoi për atë njerinë që erdhi tek ay. Edhe Dhavidhit iu ndes zemërimi fort kundër ati njeriut, edhe i tha Nathani: Rron Zoti, ay njeri që bëri këtë është për të vrarë, edhe do t'ia paguanjë delenë katër për një, sepse bëri këtë punë, edhe nuk' iu dhëmp. Edhe Nathanë i tha Dhavidhit: Ti (je) ay njeriu. Kështu thotë Zoti Perëndia i Israilit: Unë të leva (të vajova) ty mbëret mbi Israilit, edhe unë të shpëtova ty prei dorësë Saullit. – Përse hodhe poshtë fjalën' e Zotit, edhe punove të keqenë ndër sy t' ati? Vrave me shpatë Uri Hettainë, edhe i more gruan' ati për vetëhenë tënde, edhe atë e vrave me shpatën' e të bijvet Ammonit”. (2. Samuilli 12.. 1-14.)

Atëhere Dhavidhi e ndieu se pat bërë faj, edhe iu thye zemëra, edhe rrëfeu me gojë të ti: “Fëjeva mbë Zotnë”. Atëhere Nathani i tha Dhavidhit: “Zoti ta ka falurë fajinë, s'ke për të vdekurë, po preikësai pune (që bëre) i dhe shkak arëmiqet Zotit të nemënë, përandai çuni që të lindi ka për të vdekurë fare”. (2. Samuilli 12.. 10-14.)

Istoria këtu na mëson, se i dreiti edhe i shënjtëruari Perëndi nukë lë faj ndë llaus të ti pa munduarë. Njerëzitë ndë dalçinë prei udhësë dreitë, e të bënë faj, Zoti punon shumë punë të frikëshime që t'i bierë ata ndë pendim, edhe heth barrën' e fajit mbë qafë t'atyre. Dhavidhi thotë ndë një psallmë, kur flet për Perëndinë, se ç'u bën njerëzet: “U bëre ndë ata Perëndi falës, po more çpagim për punërat' e atyreve.” (Psallmë 99..8.)

Shtatë ditt Dhavidhi rrinte për dhe tuke agjëruar' e tuke qjarë, e tuke luturë Zotit për jetën' e dialit. Nd' atë kohë ay foli një psallmë pendimi që gjëndetë ndë Psalltir, për ngushullimn' e ç'do fajtori që i është thyerë zemëra: “Përdëllye-më, o Perëndi, pas të madhit përdëllimit tënt, edhe pas të shumëtit të dhëmpshuravet tua, shuaj pa-udhërit' e mia. Laj-më tepërë prei pa-udhërisë s'ime, edhe qëro-më prei fajit t'im. Se unë ngjoh pa-udhërinë t'ime, edhe faji im është përpara meje kurdo. Te ti vetëmë fëjeva, edhe bëra të keqenë përpara teje. – Krijë zemërë të këthiellëtë tek unë, o Perëndi, edhe përtëri përbrënda meje frymë të dreitë. (Psallmë 50 [51.. 1-4,10.)

53. Avessallomi. 1023 P.K.

Vdekëja e foshnjesë ti qe vetëmë të nisurit' e hidhërimevet Dhavidhit. Ati i ranë mbë krye shumë punë më të hidhura. Avessallomi, i bir' i Dhavidhit, vrau të vëllan' Ammonë. Për këtë punë Dhavidhi s'donte t'i shihte sytë të birit, përandai Avessallomi e vu ndër mënt të nxierë tanë nga shkëmbi i mbëretërisë. Aqitofeli, që ish më i madhi i shërbëtorëvet Dhavidhit, u ngjit pas Avessallomit, edhe shumë gjëndëje u bë bashkë me atë. Nukë gjëndej tiatërë njeri më i bukurë se Avessallomi ndër gjithë Israilitë, edhe për punë të bukurisë të gjith' e doninë, po ay bënte edhe shumë mieshtëri që të ngjitej zemëra e llauzit pas ati. Një ditë pa priturë erdhi zëri ndë

Ierusalimë, se Avessallomi u bë mbëret ndë Hevronë. Posa ndigjoi këtë fjalë Dhavidhi bërtiti: “Ngrih, le t’ikëjmë, sepse s’munt të shpëtoimë nga Avessallomi.” Mbëreti doli nga qyteti sbathur’ e me krye të mbuluarë, e vate ndë përrua të Qedhronit, edhe lart ndë Mal të Ullivet, edhe gjithë llauzi me krye të mbuluarë i ngjiteshinë prapa mbëretit tuke qjar’ udhësë. Një fis i Saullit, që e kishte emërinë Simei, doli e hithte me gurë, edhe e mallëkonte. Edhe Avisai, i bir’ i Seruiasë, desh të vejë e t’i presë kryetë, po Dhavidhi i tha, “Letë mallëkonjë, sepse Zoti i tha ati, Mallëko Dhavidhë. Cili do të thotë pra: Përse bëre kështu?” Dhavidhi iku ndë Mahanaim.

Avessallomi pushtoi shkëmbin’ e t’et ndë Ierusalimë, edhe nukë mendonte tiatërë gjë veçe të urdhëronjë llausn’ e Israilit, të bininë tan’ a të gjallë a të vdekurë. Po gjith’ ata njerës që ishinë besëtuarë u mbëllohnë rreth e rrotullë Dhavidhit, edhe Ioavi doli me një ushtëri të fortë kundër atyre që kishinë ngriturë krye. Ata nuk’ e lanë mbëretinë plak të dalë bashkë me ata, sepse thoshinë: “Tashi (ti je) dhietë mijë (herë më i fortë) se na, përandai tashi është më mirë të na ndihç neve nga qyteti.” Edhe ata kur duallnë të luftoninë, Dhavidhi urdhëroi kreret’ e ushtërisë, e u tha: “Të më shpëtoni dialënë, Avessallomnë.”

Gjith’ ushtëria e atyre që kishinë ngriturë krye u muntë. Avessallomi tuke ikurë me vrap mbi mushkët ndëpër mes të pyllit, u zu për flokësh ndëpër degat të një lisi, edhe mushka iku, edhe e la varë ndë drut.

Një ushtëtuarë kur pa atë tek ish vierrë mbë drut, i tha krye-ushtëtorit, edhe Ioavi i tha ati: “Përse nuk’ e vrave atë, (ta rrëzonje) për dhe? Do të kishiem falurë ty dhietë (siklla) argjëndi edhe një bres.” Po ushtëtori i tha Ioavit: “Edhe një mijë (siklla) argjëndi të ishinë numëruarë ndë pëllëmbët t’ime, nukë do të kishnjem vënë dorënë t’ime mbi të birin’ e mbëretit, sepse na e ndigjuam të gjithë kur urdhëroi mbëreti ty edhe Avisainë edhe Ittainë, edhe tha: “Ruhi mos përkasë asndonjë dialënë, Avessallomnë.” Atëhere Ioavi tha: “Unë s’kam nge të shkonj kohënë kështu bashkë me ty, edhe mori ndë dorë tri shëgjeta, edhe ia mbërtheu ndë zemëret të Avessallomit, atie ndek ish gjall ndë mest të lisit.”

Të tillë mortëje mori ay bir i pa-ndigjuarshim! Edhe të tillë fat të keq do të kenë ata që nukë ndigjonjën’ urdhërimet’ e Zotit, edhe nukë nderonjënë përintë. Le të ruhenë djemt’ e ri, të mos bënëjënë të atillash, që të mos i gjënjënë të atillash të zeza.

Kur doli zëri, se u muntë ata që kishinë ngriturë krye, mbëretit nuk’ i erdhi mirë, sepse ishte vrarë i biri. Ay qjante e bërtiste me zë të math, e thoshte: “Avessallom, biri im, biri im! Të donte Zoti, të vdesë unë për ty!” (2 Samuilli 18..) Atëhere kur u përhap fjala ndëpër gjith’ dhen’ e Iudhesë, se u muntë arëmiqtë, u mbëlloh gjithë llauzi i Israilit me gëzim të math, edhe prunë Dhavidhë ndë Ierusalimë, edhe e vunë për-së-ri ndë shkëmp të mbëretërisë. Edhe mbëretëria e Israilit qëndronte e fortë, sa ishte gjall Dhavidhi.

“Edhe Avessallomi kur ishte gjall, pat ngrehurë një shtyllë për vetëvetëhenë ndë Fushë të Mbëretit, sepse tha: S’kam bir që të kujtonjë emërinë t’im; edhe i vu emërin’ e ti shtyllësë, edhe ngjer sot mbë këtë ditë i thonë Shtylla e Avessallomit.” (2 Samuilli 18.. 18.) Këtu është shkruarë figureja e shtyllësë, sikundrë gjëndetë tashi.

54. Murtaja ndë Israil. 1017 P.K.

Pas vdekëjes’ Avessallomit të përzierët’ edhe s’kish pushuarë. Më përpara, një njeri prei farësë Veniaminit, që e kishte emërinë Seva, i ra trumbetësë, e tha: “Na s’kemi piesë te Dhavidhi, s’kemi trashigim tek i bir’ i Iesseut.” Po Ioavi i prishi ata me vrap. Atëhere u bë të përzierë brenda ndë fëmijët të Dhavidhit. Ioavi donte të bënëj mbëret Adhonianë, që të zirte këmbën’ e t’et të Dhavidhit, po profiti Nathan nukë la të bënei, edhe Sollomoni, më i vogëli i

djemvet Dhavidhit, u bë mbëret. Po para se të hipënte Sollomoni ndë shkëmp të mbëretërisë, koditi (gjau) një çudi e frikëshime.

Atëhere Dhavidhi desh të numëronte gjithë llaunë e Israilit, që të dinte sa burra munt të dilinë ndë luftë, ndonëse këjo punë ishte kundër ligjësë (nomit) Moisiut, po ay urdhëroi kryeushtëtorë Ioavinë të shkonjë ndëpër gjithë dhen' e Iudhesë, e të numëronjë gjithë farat' e Israilit. Ioavi bashkë me të tierë, vanë edhe bënë pas urdhërit mbëretit, edhe pas nëntë muajsh u këthye Ioavi bashkë me shokët e ti, edhe i pru mbëretit numërin' e llauzit, po Dhavidhi pastai e mori vesh se bëri keq, edhe u pendua. Atëhere Perëndia dërgoi profitnë Gadh te Dhavidhi, i cili i tha mb' emërit të Zotit: “Kam për të dhënë ty tri kafsha, gjith për vetëhe një nga këto, edhe e kam për të bërë. (A do) të bënetë zi buke tri viet ndë dhet tat? Apo tre muaj të ikënç prei sysh arëmiqvet tu, edhe të ndiqesh? Apo të jetë murtajë tri ditt ndë dhet tat?” Dhavidhi tha: “Jam fort shtrënguarë: më mirë le të bije ndë dorë të Zotit, sepse përdëllimet' e ati janë shumë, po letë mos bije ndë dorë të njeriut.” Kështu Perëndia dërgoi murtajë ndë Israil, kaqë sa vdiqnë shtatë-dhietë mijë vetë prei Dhanit ngjer ndë Vir-savee. Edhe ëngjëlli kur shtriu (ndehti) dorënë të prishnjë Ierusalimënë, Perëndia u pendua për të keqenë, edhe i tha ëngjëllit që prishte llaunë: “Miaft më: ndal tani dorënë tënde.” (2 Samuilli 24..) Edhe ëngjëlli i Zotit ishte ndaj lëmën' e Orna Ievuseut. Edhe Dhavidhi vate e ngrehu atie një therore për Zonë, edhe bëri kurbane të diegurë, edhe kurbane paqtimi. Kështu Perëndia kurseu dhenë, edhe ndali murtajënë.

Dhavidhi vuri gjashtë mijë të parë mbi llaunë, të cilët' i sgjodhi nga Levitetë, pas ligjësë (nomit) Moisiut; edhe Levitet' e tierë i ndau njëzet e katërë tufa, të jenë për punë të tempullit, gjithë-se-cila tufë kishte një mijë vetë; edhe vuri vallen' e tempullit, që kishte katërë mijë kënkëtorë, ndarë njëzet e katërë tufash, të cilët' ishinë nga të bijt' e Asafit, edhe mbi ata ay vu të parë kënkëtorinë Iedhuthun, edhe qitharornë Aiman. Edhe për këtë punë Dhavidhi shkroi shumë psallmë a kënkë të shënjtëruarshime me anë të Frymësë Perëndisë. Ndër këto psallmë Dhavidhi shkroi shumë punë të mëdha për shpërbliim' e Krishtit, që shpërente gjithë llauzi i Zotit që kur se u ngreh bota. Të ardhurit' e Krishtit ndë botët, e jeta e ati, e vdekëja, e të ngjalluritë, e të hipuritë lart ndë qiell, e laimësia e ati, se ay ishte edhe profit edhe prift edhe mbëret, shoqëria bashkë me llaun' e Perëndisë, edhe bekimi i llauzit me anë t'ati, të thirrët' e gjëntarëvet, lavdia i kishësë që kishte për të ardhurë, edhe i pa-sosuri bekim i gjithë të shpërblyerëvet – gjithë këto kafsha zihenë n'gojë ndë Psalltir të Dhavidhit.

Sikundrë Dhavidhi kur hipi ndë shkëmp, bëri më të parënë punë, qysh t' i shërbente Shënjtëroresë, kështu edhe ndë ditë të pleqërisë pat kujdes po për atë punë. Përpara gjithë të parëvet mbëretërisë, edhe përpara krerëvet llauzit, Dhavidhi la mbëretërinë ndë dorë të Sollomonit të birit, edhe i la fjalë ati përmbi të gjitha të ndërtonjë shtëpin' e Perëndisë, që e kish paturë ndër mënt ay vetë ta bënte. Edhe i dha ati ar e argjënt e rame e hekurë, që i pat mbëledhurë që përpara për këtë punë; i dha edhe shumë enë të arta e të argjëntta, që pat urdhëruar' ay të bënëshinë, i dha edhe shumë landë e gurë; pastaiurdhëroi gjithë llaunë, po më fort të pasuritë, për të prurë dhurëti ar e argjënt e gurë të pa-çëmuarë për ndërtesënë.

55. Sollomoni. 1015-975 P.K.

Sollomoni ishte më i math se të gjithë mbëretëritë nd' atë kohë. Sa mot ngjati mbëretëria e ati, gjithë llauzi panë ditt të bardha. Gjith-se-cili flinte pa frikë, e rrinte ndënë piërgullin' e ti e ndënë drun' e fikut ti. Po dituria e ati ishte më e madhe se gjëja. Pak kohë pasi hipi ndë shkëmp, Perëndia iu duk nd' ëndërrë, e i tha: “Lypë ç' do të ap ty?” Sollomoni tha: “Ti i ke bërë përdëllim të math shërbëtorit t'yt Dhavidhit t'im-et; edhe unë jam një çun i vogëlë, edhe nukë di (si) të dal

e (si) të hynj, edhe shërbëtori yt është ndë mest të llauzit tënt që sgjodhe, një llauzi të madhi që s'munt të ngjihet' e të numëronetë nga të shumëtë; ep-i pra shërbëtorit tënt një zemërë të mençime për të gjykuarë llausnë tënt, që të ndanj të mirënë prei së keqesë, sepse cili munt të gjykonjë këtë llausnë tënt të madhinë? Edhe Zotit i pëlqeu fjala, sepse Sollomoni lypi këtë punë. Edhe Perëndia i tha ati: Sepse lype këtë kafshë, edhe nukë lype për vetëhe jetë të gjatë, po lype për vetëhe mënt për të kuptuarë gjyq, ja te bëra pas fjalësh tua: ja te të dhashë një zemërë të mënçime e të kupëtuarshime, që s'ka qenurë përpara tiatërë njeri posi ti, as nukë do të ngjalletë pas teje tiatërë njeri posi ti; po të dhashë edhe ç'nukë lype, edhe gjë e lavdi, që s'ka për të qenë asndonjë ndër mbëretërit posi ti mbë gjithë ditt e tua; edhe ndë ecësh nd' udhët të mia, tuke ruajturë urdhërimet' e mi e porosit' e mia, sikundrë eci Dhavidhi yt-atë, atëhere kam për të ngjaturë ditt' e tua.”

Ndonëse këjo qe një ëndërrë, po prei punësh që u bënë, u muar vesh se ajo ëndërrë qe prei Perëndisë. Sollomoni ka pasur' emërë të math për diturin' e për gjën' e për lavdinë, se askurrë tiatërë mbëretë ndonjë herë. Magjet' (barkat') e ati shkoninë ndë Hindi nga Det'i Kuq. Mbëretër' erthnë prei së largu për të parë atë, e për të ndigjuarë diturin' e ati. Fjalëtë që ka folur' ay, janë kaqë të vërteta e kaqë të mençime, sa u apënë mënt e mësonjën' edhe të diturit' e të pa-dituritë.

Për të ndigjuarë fjalën' e t'et, Sollomoni ndërtoi tempullinë ndë Ierusalimë: një ndërtesë kaqë të madhe, e kaqë të bukurë, që s'gjëndej tiatërë posi ajo ndë botët. Edhe passu u mbarua, u hap për të luturë të lartinë Perëndi. Priftëritë prunë arkënë, edhe e vunë te Shën-vëndi. Edhe Sollomoni passu bëri një uratë të madhe, sbriti ziarr nga qielli, edhe dogji kurbanetë që ishinë mbi therorenë, edhe lavdia e Zotit mbushi shtëpinë. Kështu i pëlqeu Perëndisë të dëftente me këtë çudi, se priti dhuratat' e shërbëtorëvet ti. Këtu është shkruarë figureja e theroresë që digjinë kurbanetë mbi atë, mb' atë formë që e pat bërë Sollomoni, sikundrë besonjënë shumë njerës.

Asgjë nukë janë më të mëdhat' e më të bukuratë ndërtesat' e botësë, përpara madhërisë edhe lavdisë Perëndisë! Kështu ndieu Sollomoni, kur tha me zemërë të përunjë: “A ka për të ndenjurë me të vërtetë Perëndia bashkë me njerëzit mbi dhet? Ja qielli, edhe qielli i qiejevet nukë janë mjaft të nxënë ty, sa më e vogël' është këjo shtëpi që të ndërtova ty!” (2 Kohëratë 6.. 18.)

Gjith' ajo mëndëja e madhe që pat Sollomoni, nukë mundi ta ruanjë të mos bierë ndë faj. Ay kishte ndë shtëpi të ti shumë bija mbëretërisë, ndërmest të atyre ishin' edhe zonjat' e Hanaanit, e të Sidhonësë, e të Tyresë, e të Egjyptit, e të tierëve, që kishinë prurë bashkë me vetëhe besat' e rreme ndë Ierusalimë, të cilat'i muarrë mëntë Sollomonit të bierë ndë Idhullatri. Kështu më i mençimi i gjithë mbëretërevet prishi dhiatënë që pat bërë Perëndia me Israilnë. Edhe preikësa të rrëzuarësë Sollomonit mirretë vesh sa fort prishetë njeriu i mirë, ndë pastë shoqëri me njerës të këqij; merretë vesh edhe më, se duhetë një ndihmë më e madhe se mëndëja e njeriut, kundrë së ligësë. Këjo është mëndëja e vërtetë që na mëson të falemi: “Ndih-më, edhe do të shpëtonj.” (Psallmë 119.. 117.)

56. Të ndarët' e mbëretërisë. 975 P.K.

Pas vdekëjesë Sollomonit, Israilitët' u mbëlohnë bashkë ndë Syhem. Rovoami u bë mbëretë përnjëherë. Po nukë punoi posi një mbëretë që duhetë të jetë i ati llauzit, po punoi posi një zotëri i keq që urdhëron me të shtyrë frikënë. Përandaiata i thanë: “Yt-atë na e rëndoi sgjedhënë, tani pra letëso ti atë shërbesën' e ashpërë të t'yt-et, edhe atë sgjedhën' e rëndë që vu mbi ne, edhe do të shërbeimë ty.” Po Rovoami u tha atyre: Im-atë u rëndoi juve sgjedhënë, po unë do t'ua bënë juve më të rëndë; im-atë u mundoi juve me shqepë, po unë do t'u mundonj juve me akrepa.”

I marri bir' i të mënçimit Sollomon kujtoi se do t'u shtinte frikën llauzit me këto fjalë të hidhura, po ata përnjëherë e kupëtuanë fjalënë, e thanë: “Ç'piesë kemi na te Dhavidhi? (s'kemi) asndonjë trashigim tek i bir' i Iesseut: te tendat' e tua, o Israil, tani shih për shtëpinë tënde, o Dhavidh.” (Mbëretëritë 12.. 4-16.)

Të dhietë farat' e Israilit u ndanë prei Iudhësë, edhe ngrehnë mbëretëri veç, që thuhei Mbëretëria e Israilit, a Mbëretëria e Samarisë, sepse Samaria ishte krye-qyteti kësai mbëretërie. Ata sgjothnë Ierovoamnë për mbëret, edhe vetë Perëndia i la të bënjenë kështu, sepse Rovoami kur desh të vinte e të luftonte me të dhietë farat, Perëndia dërgoi një profit, e i tha mbëretit edhe gjithë llauzit: “Mos hipëni, as mos luftoni kundër vëllezëret tuai të bijet Israilit, le të këthenetë gjithë-se-cili ndë shtëpi të ti, sepse këjo punë u bë prei meje.” Edhe të gjithë u këthyenë ndëpër shtëpit pas urdhërit Perëndisë. Të dy farat' e Iudhësë e të Veniaminit mbetnë veç ndën' urdhërë të shtëpisë Dhavidhit, edhe ngrehnë mbëretërin' e Iudhësë.

57. Ierovoami edhe profiti. 975 P.K.

Ierovoami doli jashtë udhësë Perëndisë. Ay bëri dy viça t'artë për të lutur' ata, - njërinë ndë Vethill, e tiatërinë ndë Dhan – edhe urdhëroi llausnë të mos venë më ndë Ierusalimë për ditë të kremtesh. Atëhere Perëndia dërgoi një njeri nga Iudha ndë Vethill, i cili bërtiti kundër theroresë që pat ngrehurë Ierovoami: “O therore, therore, kështu thotë Zoti, ja te do të lintnjë një dialë ndë shtëpi të Dhavidhit, që do t'ia thon' emërinë Iosi, edhe do të thernjë mbi ty priftërit' e vëndevet lartë, që ty monjënë mbi ty, edhe do të digjen' eshtëra njerëzish mbi ty.” Edhe që ta marrë vesh llauzi, se ay ishte dërguarë nga Perëndia, ay bëri një çudi atë ditë, edhe tha: “Këjo është shenja, që foli Zoti: ja theroreja te do të plasnjë, edhe do të derdhetë hiri që është mbi atë.” Ierovoami kur ndigjoi këto fjalë, ndeu dorën' e ti, e tha: “Ziri atë.” Edhe u tha dora e ati që e ndeu mbi atë, kaqë sa s'munt ta mbëlithte më pas vetëhesë. Theroreja plasi, edhe hiri, që ish mbi atë, u derth. Edhe mbëreti i tha njeriut Perëndisë: “Të lutem, luti Zotit Perëndisë tënt, edhe falu për mua, që të më vinjë dora ndë vënt për-së-ri.” Edhe njeriu i Perëndisë iu lut Zotit, edhe mbëretit i erdhi dora ndë vënt posi përpara. (1 Mbëretëritë 13..)

Njeriu i Perëndisë pasi mbaroi punën, që e pat urdhëruarë Zoti, u këthye ndë shtëpi të ti. Po një profit plak nga Vethilli vate me vrap pas ati, edhe e gënjeu me fjalë, edhe e bëri të këthenet' e të hajë bukë ndë shtëpi t'ati, kundër urdhërimit Perëndisë. Pastai ay tuke vatur' udhësë, i doli përpara një leon, edhe e kafshoi me dhëmbë, edhe e la të vdekurë bashkë me gomar' e ti për-anë, ngjer sa erdhi ay profiti plak nga Vethilli, edhe vuri ndë dhet atë profitnë që pat gënjerë.

Po që kur se Ierovoami nukë pat hequrë dorë nga këto punë të këqia, Israilit nuk' i vijinë mbarë punëtë. Për gjithë monë ishinë të përziera. Posa virei një mbëret i ri ndë shkëmp, vinte një tiatër' e sbriste atë, edhe vriste gjithë fëmijët' e ati, edhe këti kështu ia bënte një tiatërë më keq. Edhe jo vetëmë gjithë mbëretëritë shkoninë pas udhësë Ierovoamit, tuke luturë viçat' e artë, po fusinë dalë nga dalë edhe gjith' idhullat' e kombevet tierë.

58. Profiti Ili. 910-896 P.K.

Gjithë mbëretërit' e Israilit pas Ierovoamit ishinë të pa-besë, po më i keq se gjith' ata që Ahaavi. E shoqja e ati Iezavella, një zonjë Sidhoniane, ndërtoi një tempullë të bukurë

për idhullat e Sidhonësë. Ajo mbante katrë qint e pesë-dhietë priftërë të Vaallit, që ish perëndia e diellit, edhe katrë qint priftërë të Astartësë, perëndieshësë hënësë, që lutej ndëpër pyje të errëta me punë të ndyra. Gjith' ata që lusinë Perëndin' e Israilit ndiqeshinë, edhe profitërit' e ati vriteshinë. Po ndër gjithë shërbëtorët e Ahaavit, ishte një njeri që i kishte frikë Perëndisë, të cilin' e qjuanin' Ovadhi; ky pshehu profitërit' e Zotit, që t'i ruante ata, mos i vrisinë shërbëtorët' e Iezavelësë. Ay i pshehu ata ndër shpella, edhe u epte atyre buk' e ujë.

E keqeja ish përndarë nd' atë kohë mbë të katrë anët e dheut, përandai Perëndia dërgoi profitin' Ili. Ay doli përpara mbëretit, e tha: "Rron Zoti Perëndia i Israilit, që rrij përpara ati, se s'do të bierë as vesë as shi këto viet, po na kështu pas fjalësë s'ime." Passi nukë ra shi, nuk' u bë as grur' as bar i ngjomë, edhe u bë një zi e madhe mbë gjithë dhenë. Profiti u psheh ndë përrua të Herithit, edhe atie korbat'i bininë buk' e mish mëngjes për mëngjes e mbrëmie për mbrëmie, edhe pinte ujë prei përroit. Edhe së pastaimi passi u tha përroi, Zoti i tha ati: "Ngreu, e ecë ndë Sarepta, edhe rri atie; ja tek urdhërova atie një grua të ve të ushqenjë ty." Kur erdhi ay ndë derët të qytetit, ja tek ish një grua tuke mbëledhurë shkarpa. Profiti i lypi asai pakëzë ujë, edhe ajo kur vate të bierë, ay i tha asai: "Të lutem, bier-më një copë bukë ndë dorë." Po ajo tha: "Rron Zoti Perëndia yt, s'kam bukë, veç një grusht miell ndë shtëmbët, edhe pakëzë vaj ndë botilet; edhe ja te po mbëleth dy shkarpa, që të vete e të bënj për vetëhenë t'ime, edhe për t'ëmbir, që të hamë atë, e të vdesëmë. Edhe Iliu i thaasai: Mos u frikëso; ec'e bënj si të thashë, po prei ati bën për mua më përpara një kulaç të vogëlë, edhe bier-ma, edhe pastai bën edhe për vetëhenë tënde, edhe për tët-bir, sepse kështu thotë Zoti Perëndia i Israilit: "shtëmba e miellit s'do të sbrazetë, edhe botileja e vajit s'do të shtëretë ngjer (mb' atë) ditë kur të lëshonjë shi Zoti mbi faqet të dheut." (1 Mbëretëritë 17.. 7-14.) Edhe Iliu hante bashkë me të ven' e vobekëtë, edhe ndenji bashkë me atë më tepërë se një vit. Edhe mielli ndë shtëmbët nukë mbaronej, as vaji ndë botilet nukë shterei.

Passi s'kish ranë shi tri viet e gjymës, Zoti i tha Iliut: "Ecë e iu dëfte Ahaavit, edhe do të siell shi mbi faqet të dheut." Edhe Ahaavi kur pa atë tuke ardhurë, i tha: "Ti je ay që përzien Israilnë?" Edhe Iliu u përgjeq: "Nukë përziej unë Israilnë, po ti, edhe shtëpia e t'yt-et, sepse ju latë urdhërimet' e Zotit, edhe vattë pas Vaallit."

Atëhere Iliu i tha Ahaavit: "Tashi pra, dërgo e mbëlith gjithë Israilnë ndë mal të Karmillit, bierë edhe të katrë qint e pesë-dhietë profitërit' e Vaallit, edhe të katrë qint profitërit' e pyjevet, që hanë ndë truvezët të Iezavellësë. Edhe Ahaavi dërgoi e mbëlodhi gjithë të bijt' e Israilit edhe profitëritë ndë mal të Karmillit.

Atëhere Iliu erdhi e i tha gjithë llauzit: Ngjer kur çaloni ndërmest dy mëndëjesh? Zoti ndë qoftë Perëndi, iu ngjitni pas ati, po ndë qoftë Vaalli, iu ngjitni pas këti. Edhe llauzi nuk' iu përgjeq ati as mbë ndonjë fjalë. Atëhere Iliu i tha llauzit: Unë vetëmë kam mbeturë profit i Zotit, po profitërit' e Vaallit janë katrë qint e pesë-dhietë burra: le të na apënë pra dy viça, edhe le të sgjedhënë njërinë viç për vetëhen' e atyre, edhe le ta copëtonjën' atë, edhe le ta venë mbi drut; edhe do të bënj gati viçinë tiatërë, edhe do ta vë mbi drut, edhe nukë do të vë ziarm; edhe thërritni emërin' e perëndiravet tuaj, edhe unë do të thërres emërin' e Zotit; edhe ay Perëndi që të ndigjonjë me ziarm, ky qoftë Perëndi. Edhe gjithë llauzi u përgjeq, e tha: Fjal' e mirë. Atëhere Iliu u tha profitëvet Vaallit: Sgjithni një viç për vetëhenë tuaj, edhe bënëni gati ju më përpara, sepse ini shumë, edhe thërritni emërin' e perëndiravet tuaj, po mos viri ziarm. Edhe ata muarrë viçinë që u dhan' atyre, edhe e bënë gati, edhe thërrisin' emërin' e Vaallit që ndë mëngjes ngjer ndë

mest të ditësë, tuke thënë: Ndigjo-na, o Vaall; po s'kishte as zë, as të gjegjurë; edhe ata bridhinë përquark theroresë, që kishinë ndërtuarë. – Atëhere Iliu i tha gjithë llauzit: Afrohi tek unë. Edhe gjithë llauzi u afrua tek ay. Edhe ay ndreqi theroren' e Zotit, që ishte rrëzuarë. Edhe Iliu mori dy-mbë-dhietë gurë, pas numërit të dy-mbë-dhietë faravet të bijvet Iakovit, mbë të cilinë pat ardhurë fjala e Zotit, e i pat thënë: Emëri yt do të thuhetë Israil; edhe ndërtoi gurët' e theroresë mb' emërit të Zotit, edhe bëri një hendek përquark theroresë, që nxinte dy matës fare. Edhe vuri qipi drutë, edhe copëtoj viçnë, edhe e vu mbi drut. Edhe tha: Mbushni shtatë shtëmba me ujë, edhe i derthni mbi kurban që do të digjetë i tërë, edhe mbi drut. Edhe tha: Derthni për së dyti, edhe ata derthnë për së dyti. Edhe tha: Derthni për së treti, edhe ata derthnë për së treti. Edhe ujëtë ecëte përquark theroresë, po edhe hendeku u mbush me ujë. Edhe atë herë kur kish për të prurë dhuratënë, u afrua profiti Ili, e tha: Zot, Perëndia i Avraamit, e i Isaakut, e i Israilit, le të mirretë vesh sot, se ti je Perëndi ndë Israil, edhe unë shërbëtori yt, edhe pas fjalësë s'ate bëra gjithë këto punë; ndigjo-më, o Zot, ndigjo-më, që ta ngjohë ky llaus, se ti, o Zot, je Perëndia, edhe u këtheve atyre zemërenë prapa. Atëhere ra ziarm nga Zoti, edhe përpiu kurbanë e drut' e gurët' e baltënë, edhe la ujëtë që ishte ndë hendek. Edhe kur pa gjithë llauzi, ranë me faqe (për dhe), e thanë: Ay Zot është Perëndi! Ay Zot është Perëndi! Edhe Iliu u tha atyre: Zeri profitërit' e Vaallit, edhe le të mos shpëtonjë asnjë nga ata. Edhe i zun' ata, edhe Iliu sbriti ndë përrua të Kisonit, edhe i theri ata atie. Edhe Iliu i tha Ahaavit: Ha e pi, sepse është zë shumë shiu. Edhe Ahaavi hipi të hajë e të pijë, edhe Iliu hipi ndë majë të (malit) Karmillit, edhe u kurrus mbë dhe, e vuri faqen' e ti ndërmest të gjunjëvet ti, edhe i tha shërbëtorit ti: Hipë tashi, e shih nga deti. Edhe ay hipi e pa, edhe tha: Nuk' është asgjë. Edhe ay tha: Hipë për-së-ri, (ngjer) mbë shtatë herë. Edhe mbë të shtatënë herë tha: Na te po hipën nga deti një re e vogëlë, sa një pëllëmbë njeriu. Edhe (ay) tha: Hip' e i thuai Ahaavit: Bën gati qerrenë, edhe sbrit, që të mos të ndalë shiu. Edhe përnjëherë u vrarua [u vrej] qielli prei revet e prei erësë, edhe ra një shi i math." (1. Mbëretëritë 18.. 1-45.)

59. Ohozia edhe krye-ushtëtorët' e ti. 896 P.K.

Mbëreti Ohozi, i bir' i Ahaavit, ishte sëmure, edhe ay dërgoi njerës të pyetinë Veel-zevulinë, perëndin' e Filistinëvet, vallë kur do të shëndoshetë. Iliu vate pas urdhërit Perëndisë, e përpoq me njerëzit, e u tha: “A nuk' është Perëndi ndë Israil, që vij të pyetni Veel-zevulinë, perëndin' e Akkaronësë? Tashi pra kështu thotë Zoti: S'ke për të sbriturë nga ay shtrat, që ke hipurë, po ke për të vdekurë fare.” Edhe njerëzit' u këthyenë prapë, e i thanë mbëretit, se ç'u pat thënë ay njeri. Mbëreti i pyeti ata: Ç'farë njeriu ish ay që tha këto fjalë? Ata i than' ati, se ish një njeri veshurë me lëkurë të leshtë, edhe ngjeshurë me një rryp lëkure ndë mest. Edhe ay tha: “Është Ili Thesviti.”

Edhe ay dërgoi një krye-ushtëtuar me pesë-dhietë vetë që ta bijen' atë lidhurë. Iliu ishte tuke ndenjurë mdë majë të një kodre, edhe krye-ushtëtori i tha ati: “Ti, o njeriu i Perëndisë, mbëreti ka thënë: Sbrit poshtë.” Iliu i tha: Ndë qofsha njeriu i Perëndisë, le të sbresë ziarm nga qielli, edhe le të diegë ty edhe të pesë-dhietëtë.” Edhe u bë ashtu si tha. Edhe mbëreti dërgoi një tiatërë krye-ushtëtuar me pesë-dhietë vetë, po sbriti ziarm nga qielli, edhe doq edhe atë bashkë me të pesë-dhietët. Pastai erdhi një i tretë, edhe i ra ndër këmbë Iliut, e tha: “Të lutem, o njeriu i Perëndisë, le të kursenetë ndër sy të tu jeta ime, edhe jeta e këtyre të pesë-dhietë shërbëtorëvet tu.” Atëhere Iliu vate bashkë me atë te

mbëreti, e i tha: “Kështu thotë Zoti, sepse dërgove njerës të pyeç Veel-zevulinë, perëndin’ e Akkaronësë, sikurse nuk’ ishte Perëndi ndë Israil për të kërkuarë fjalën’ e ati, përandai s’ke për të sbriturë nga ay shtrat, që ke hipurë, po ke për të vdekurë fare.” (2. Mbëretëritë 1.. 2-16.) Kështu Ohozia vdiq, edhe nukë la dialë prapa.

60. Elisseu. 896-838 P.K.

Me urdhërim të Perëndisë, Iliu la mbë këmbë të ti Elissenë. Elisseu pa Ilinë tuke hipurë ndë qiell ndëpër një erë të fortë mbë një qerre flake, edhe fryma e fuqia e Iliut erdhi mbi atë. Ndë Vethill, atie tek ish ngrehurë viçi artë, ca djem të këqij përqeshnë profitnë e i thanë: “Hipë, o krye pa qime.” Edhe Elisseu, që dinte se kur është koha për të duruarë, e kur për të mënduarë, i mallëkoi ata mb’ emërit të Zotit. Edhe atie duallë dy arinj nga pylli, edhe hëngrë dyzet e dy çuna. (2. Mbëretëritë 2.. 23, 24.)

Elisseu kur vate njëherë ndë një skoli profitërish, e veja e një profiti i tha: “Më vdiq burri, - edhe erdhi hua-dhënësi të marrë të dy djemt’ e mi për shërbëtorë.” Elisseu i tha asai: “Ç’ke ndë shtëpi?” Edhe ajo tha: “S’kam asgjë ndë shtëpi, veç një anë vaji.” Ay i tha: “Ec’ e u huaj enë prej gjithë fëqinjëvet përjashta, enë të smbrazëta, mos u huaj pak; pastai hyr’ e mbyll derënë prapa teje e prapa bijvet tu, edhe derth (vajinë) ndëpër gjith’ ato enët, edhe vër’-i mbë-nj’-anë ato që të mbushenë.” Edhe ajo bëri ashtu si e urdhëroi, edhe mbushi shumë enë. Pastai ajo i thotë të birit: “Bier-më edhe një tiatër’ anë.” Edhe i biri i tha asai: “S’ka (më) tiatër’ anë.” Edhe vaji ndaloi. Edhe ajo erdhi e i tha njeriut Perëndisë. Edhe ay i tha: “Ec’ e shit vajinë, edhe laj detyrënë tënde, edhe rro ti edhe djemt’ e tu me atë që të mbesë.” (2. Mbëretëritë 4.. 1-7.)

61. Neemani. 894 P.K.

Neemani, i pari i ushtërisë mbëretit Syrisë, ishte një njeri i math e i nderëshim, po ay kishte kromënë, një sëmundë të ndyrë. E shoqja e Neemanit kishte një shërbëtoje të vogëlë, marrë rop nga Iudhea. Edhe shërbëtoreja e vogëlë tha: “Të ishte im-zot përpara profitit që është ndë Samari! Sepse do t’i shëronte ati kromënë.” I thanë këto fjalë Neemanit, edhe kaqë mbë sy të mirë e kishinë atë Israiliteshë, sa Neemani e ndigjonte atë. Kështu ay bëri udhë, e erdhi ndë dhe të Israilit bashkë me kuaj e me qerre, edhe qëndroi ndë derët të Elisseut. Edhe Elisseu i dërgoi një të laim t’i thotë: “Ec’ e lahu shtatë herë ndë Iordhan, edhe do të të vinjë për-së-ri mishi yt, edhe do të qëronesh.” Kur ndigjoi këtë Neemani, u zemërua e tha: “Na, unë thoshnjem, se do të më dalë (përpara), edhe do të qëndronjë, e do të thërresë emërin’ e Zotit Perëndisë ti, edhe do të verë dorën’ e ti mb’ atë vënt, edhe do të shëronjë kromënë. Avana i edhe Farfari, lumërat’ e Dhamaskësë, sos nukë janë më të mirë se gjithë lumërat’ e Israilit? Nukë munt të laheshe un’ atie, edhe të qëronesh? Edhe u këthye, e iku zemëruarë. Edhe shërbëtorët’ e ati u afruanë edhe i folnë e i thanë: Ata im, profiti ndë pat thënë për ndonjë punë të madhe, a nukë do t’ë kishnje bërë? Sa më fort tashi që të thotë: Lahu edhe qëroju. Atëhere sbriti edhe u kreth shtatë herë ndë Iordhan, pas fjalësë njeriut Perëndisë: edhe mishi i ati u bë posi mish diali të vogëli, edhe u qërua. Edhe u këthye te njeriu i Perëndisë, ay edhe gjith’ udhëtarët’ e ati, edhe erdhi e qëndroi përpara ati, e tha: Na tashi tek e ngjoha, se s’qenëka Perëndi ndë gjithë dhenë, veç ndë Israil, përandai tashi të lutem, prit këtë dhurëti prej shërbëtorit t’yt.

Edhe ay tha: “Rron Zoti, përpara të cilit rri, (se) s’do t’ë pres. Edhe ay e nguti ta presë, po ay nukë desh.” Edhe ay i tha ati: “Ecë ndë paqtim.”

Po Gieziu, shërbëtori i Elisseut, dëshëronte për argjënt e për ar, e për rroba të bukura; edhe ay vate prapa Neemanit. “Edhe Neemani kur pa (atë) tuke ecurë, u hoth nga qerreja t’i dalë përpara, edhe i tha: A je mirë? Edhe ay tha: Mirë, im-zot më dërgoi të them: Na këtë herë tek erthnë tek unë, nga mali i Efraimit, dy djem prej të bijvet profitëvet: të lutem, ep-u atyre një tallant argjëndi, edhe dy palë rroba. Edhe Neemani tha: Merr me gjithë zemërë dy tallanda argjëndi, bashkë me dy palë rroba; edhe ua vuri mbë kraha të dy shërbëtorëvet ti, edhe i mbaninë përpara ati. Edhe kur erthnë ndë Ofill, i mori nga duart’ e atyre, edhe i ruajti ndë shtëpi, edhe lëshoi burratë, e iknë. Edhe ay hyri e ndenji përpara të zot. Edhe Elisseu i tha ati: Nga (vien) Giezi? Edhe ay tha: Shërbëtori yt, nukë vate askundi. Edhe ay i tha ati: Nukë vate zemëra ime (bashkë me ty), kur u këthye njeriu prej qerresë ti të dalë përpara? (A është) kohë të marrç argjënt, a të marrç rroba e ullishta, e vëreshtë, e dhen, e qe, e shërbëtorë, e shërbëtorë? Përandai krroma e Neemanit do të ngjitetë ty, edhe farësë s’ate për gjithë monë. Edhe ay doli jashtë prej ati i krromosurë posi bora.” (2. Mbëretëritë 5.. 1-27.)

“Mbëreti i Syrisë kur luftonte kundrë Israilit, edhe bënte këshille bashkë me shërbëtorët e ti, e thoshte: Mb’ aqë ç’vënt e mb’ aqë ç’vënt do të ngul ushtërinë. Njeriu i Perëndisë i dërgonte mbëretit Israilit, e i thoshte: Ruhë mos veç mb’ atë vënt, sepse Syrianëtë kanë ngulur’ ushtërinë atie. Edhe mbëreti i Israilit dërgonte mb’ atë vënt që i thoshte njeriu i Perëndisë, edhe porositte për atë, edhe u ruajt prej andy jo një herë e dy herë. Edhe iu përzie zemëra mbëretit Syrisë për këtë punë, edhe thirri shërbëtorët’ e ti, e u tha atyre: Nukë do të epni zë, cili nesh (është) bashkë me mbëretin’ e Israilit? Edhe një nga shërbëtorët’ e ati i tha: Asnjeri, zoti im, o mbëret, po profiti Elisse, që është ndë Israil, i ep zë mbëretit Israilit për ato fjalë që flet (ti) ndë kamaret të shtratit t’yt. Edhe ay tha: Veni e shihni ku është, që të dërgonj ta zë atë. Edhe ata i dhanë zë, e i thanë: Na (tek është) ndë Dhothan. Edhe ay dërgoi atie kuaj, e qerre, e ushtëri të madhe, të cilët’ erthnë natënë, e qerthëlluanë qytetnë. Edhe shërbëtori i njeriut Perëndisë kur u ngrit ndë mëngjes, e doli, na ushtëria te kishte qerthëlluarë qytetnë me kuaj e me qerre. Edhe shërbëtori i ati i tha: O zot! Ç’të bëjmë? Edhe ay tha: Mos u frikëso, sepse më të shumëtë (janë) bashkë me ne, se bashkë me ata. Edhe Elisseu u fal, e tha: Zot, të lutem, çil-i sytë këti, që të shohë. Edhe Zoti i çeli sytë shërbëtorit, e pa, edhe na mali (tek ish) plot me kuaj e me qerre ziarmi përçark Elisseut. Edhe sbritnë tek ay (Syrianëtë), Elisseu iu fal Zotit, e tha: Të lutem, verboje këtë llaus. Edhe i verboi ata, pas fjalësë Elisseut. Edhe Elisseu u tha atyre: Nuk’ është këjo udha, as (nuk’ është) ky qyteti; eni pas meje, edhe do t’u bije juve tek ay njeriu që kërkoni. Edhe i pru ata ndë Samari. Edhe kur erthnë ndë Samari, Elisseu tha: Çil-u sytë këtyre, o Zot, që të shohnjë. Edhe Zoti u çeli syt’ atyre, edhe panë, edhe na tek ishinë ndë mest të Samarisë. Edhe mbëreti i Israilit kur pa ata, i tha Elisseut: T’i vras, t’i vras, o ata im? Po ay tha: Mos i vra; do t’i kishnje vrarë ata, kur t’i kishnje marrë rop me shpatënë tënde e me harkunë tënt; ver’-u buk’ e ujë përpara atyre, edhe le të han’ e le të pinë, e le të venë tek i zoti tyre. Edhe u vu përpara atyre miaft ushqim; edhe passi hëngrë e pinë, i lëshuan’ ata, edhe iknë tek i zoti tyre. Edhe nuk’ erdhi më ushtëria e Syrisë ndë dhe të Israilit.” (2 Mbëretëritë 6.. 8-23.)

Perëndia dërgoi një profit nga Israili tek Assyrianët. Ninevia , krye-qyteti i Assyrisë, ishte një qytet fort i math e i bukurë.

Edhe erdhi fjala e Zotit te Ionai, i bir' i Amathiut, e i tha: Ngreu, e shko ndë Ninevi, nd'atë qytetn' e math, edhe bërtit kundër atyre, sepse pa-besëria hipi përpara meje. Edhe Ionai u ngrit që të ikënjë ndë Tharsis prei sysh Zotit, edhe sbriti ndë Ioppë, edhe gjeti një lundrë për Tharsis, edhe pagoi navllënë, edhe hyri nd' atë, që të ikënjë bashkë me ata ndë Tharsis prei sysh Zotit. Po Zoti ngriti një erë të madhe mbi det, edhe u bë një thëllim i math ndë det, edhe lundra ishte mbë rrezik për të thyerë. Edhe detarët' u frikësuanë, edhe gjithë-se-cili thërritte perëndin' e ti, edhe hothnë ndë det plaçëkatë që ishinë ndë lundrët, që të letësonej nga ato. Edhe Ionai sbriti ndë gufomë të lundrësë, edhe ra, e flinte (një gjumë të) rëndë. Edhe qyvernitari i lundrës' u afrua tek ay, e i tha: Përse fle ti? Ngreu, e thërrit Perëndinë tënt, se mos na kujtonjë Perëndia, e të mos humbasëmë. Edhe gjithë-se-cili i tha t'afërmit ti: Eni, e le të shtijemë shortë, që ta ngjohëmë, për punë të kujt (erdhi) këjo e keqe mbi ne. Edhe shtynë shortë, edhe shorta i ra Ionait. Atëhere i than' ati: Na thuai tashi, për ç'punë (erdhi) këjo e keqe mbi ne? Ç'është puna jote? Edhe nga vien ti? Cili është vendi yt? Edhe prei ç'gjëndëje je ti? Edhe ay u tha atyre: Unë jam Evre, edhe lus Zotnë Perëndin' e qiellit, i cili bëri den' edhe tokënë. Atëhere i mori një frik' e madhe njerëzitë, edhe i than' ati: Ç'është këjo që bëre? Sepse e ngjohnë njerëzitë, se iku prei sysh Zotit, sepse (ua) kish dëftyer' atyre (këtë). Edhe ata i than' ati: Ç'të bëimë ty, që të pushonjë deti prei nesh? Sepse deti po bënte valë më tepërë. Edhe ay u tha atyre: Më ngreni, e më hithni ndë det, edhe deti do të pushonjë prei jush, sepse e ngjoh, se për punët t'ime (u bë) ky thëllim i math mbi ju. Po njerëzitë lundruanë fort, që të këtheneshinë ndë tokët, po nukë mundinë, sepse deti bënte valë më tepërë kundër atyreve. Përandai thërritnë Zonë, e thanë: Të lutemi, o Zot, të lutemi, le të mos humbasëmë për jetën' e këti njeriu, edhe mos na vërë mbë qafë gjak të pa-faj, sepse ti, o Zot, bëre si deshe. Edhe ngritnë Ionanë, edhe e hothnë ndë det, edhe deti ndaloi zemërimn' e ti. Atëhere i mori një frik' e madhe njerëzitë prei Zotit, edhe i prunë kurban Zotit, edhe than' urata.” (Ionai 1..)

“Edhe Zoti urdhëroi një peshk të math të përpijë Ionanë. Edhe Ionai ishte ndë barkut të peshkut tri ditt e tri net. Edhe Ionai iu fal Zotit Perëndisë ti nga barku i peshkut, edhe tha: Thërrita Zotnë ndë shtrëngim t'im, edhe më ndigjoi; thërrita nga barku i varrit, edhe ndigjoi zënë t'im. Sepse më hodhe ndë të thellat, ndë zemërë të detit, edhe më qerthëlluanë rriedhietë; gjithë thëllimet' e tua edhe valët' e tua shkuanë përsipër meje. Edhe unë thashë: U hodha tej prei sysh tu, po do të shtije sytë për-së-ri ndë tempullinë tënt të shënjtëruarinë. Ujëratë më qarkuanë ngjer ndë shpirt, avyssa më mbyti, barërat' e detit u mpështuallnë për qark kresë s'ime. Sbrita ndë malet të pastaim, shulet [romanët', llozet'] e dheut (janë) përmbi mua gjithë-herë, po jeta ime hipi nga të vdierrëtë, o Zot Perëndia im. Edhe kur nukë kishte mbeturë tek unë shpirti im, kujtova Zotnë, edhe të faluritë t'im hyri te ti, ndë tempullinë tënt të shënjtëruarinë. Ata që ruanjënë kotësira gënjeshttrash heqënë dorë prei përdëllimit tyre. Po unë do të bënj kurban ty bashkë me zë lavdimi: do të paguanj gjith' ato që u fala; shpëtimi (është) nga Zoti. – Edhe Zoti urdhëroi peshkun' e math, edhe vulli Ionanë mbi tokët.” (Ionai 2..)

“Edhe erdhi fjala e Zotit te Ionai për së dyti, e tha: Ngreu, e shko ndë Ninevi, nd' atë qytetn' e math, edhe leçit atie atë të leçiturë që do të flas unë ty. Edhe Ionai u ngrit, e vate ndë Ninevi pas fjalësë Zotit; edhe Ninevia ishte një qytet i math fort, tri ditt udhë. Edhe Ionai zuri të shkonjë ndëpër qytet një dite udhë, edhe leçiti i tha: Edhe dyzet ditt, edhe Ninevia do të rrëzonenë. Edhe njerëzit' e Ninevisë i besuanë Perëndisë, edhe leçitnë të

agjëroninë, edhe u veshnë me thasë të mëdhenj e të vogjilë, sepse fjala harriu te mbëreti i Ninevisë, edhe u ngrit prei shkëmbit ti, edhe hoqi stolin' e ti që kishte mbi vetëhe, edhe u mbulua me thes, edhe ndënji mbi pluhurit. Edhe u leçit e u bë e diturë me urdhërë të mbëretit e të mëdhenjvet ati, (edhe) u fol: Njerëzit' e bagëtitë, qett' e dhëntë, të mos ngjironjën' asgjë, as të mos kullosënë, as të mos pijn' ujë, po njerës e bagëti të mbulonënë me thasë, edhe të bërtasënë fort te Perëndia; edhe gjithë-se-cili le të këthenetë prei udhësë keqe, edhe prei së shtrembërësë që është ndë duart t'atyre. Kush e di, se këthenet' e pendonetë Perëndia prei mërisë e prei zemërimit ti, edhe nukë humbasëmë? Edhe Perëndia pa punët' e atyre, se u këthyenë prei udhësë keqe, edhe Perëndia u pendua për të keqenë, që tha t'u bënë atyre, edhe nuk' e bëri." (Ionai 3..)

"Edhe Ionai u hidhërua fort, edhe u zemërua. Edhe i u fal Zotit, e tha: Nuk' ishte këjo fjala ime, kur ishnjem po ndë dhethit t'im? Përandai e vura ndër mënt të ikënj ndë Tharsis, sepse e diem, se (ti je) Perëndi i përdëllyeshim e zemërë-gjërë e përdëllim-math, edhe që pendone për të keqenë. Edhe tani, o Zot, të lutem, ty, merr-më shpirtinë, sepse është më mirë për mua të vdes, se të rronj. Edhe Zoti tha: A është mirë të zemëronesh? Edhe Ionai dolli jashtë qytetit, edhe ndenji mb' anë të qytetit prei së lindurit diellit, edhe atie bëri një kasolle për vetëhe, edhe rrinte ndënë hie t'asai, ngjer sa të shihte se ç'do të bënei ndë qytet. Edhe Zoti Perëndia urdhëroi një kungullë, edhe e bëri të hipënjë përmbi Ionanë, që të bënë hie sipërë kryesë ati, që ta letësonjë atë prei shtrëngimit ti. Edhe Ionai u gëzua fort për kungullinë. Edhe Zoti urdhëroi një krymp, kur sbardhi drita nesëret, edhe hëngri kungullinë, edhe u tha. Edhe posa lindi dielli, Perëndia urdhëroi një erë të nxehtë prei së lindurit diellit, edhe dielli binte mbi krye të Ionait, kaqë sa i ra të hollëtë, edhe kërkonte me zemërë të ti të vdiste, edhe tha: Është më mirë për mua të vdes, se të rronj. Edhe Perëndia i tha Ionait: A është mirë të zemëronesh për kungullinë? Edhe ay tha: Është mirë të zemëronem ngjer mbë vdekëjet. Edhe Zoti tha: Ti u hidhërove për kungullinë që nuk' u mundove për atë, as nuk' e bëre atë të rritetë, që ay biu për një natë, edhe hipi për një natë. Po unë nukë duhei të hidhëronesh për Ninevinë, qytetn' e math, që janë më shumë se dy-mbë-dhietë qint mijë njerës, të cilëtë nukë ndanjënë të diathtën' e tyre prei së mëngjërësë tyre, janë edhe shumë bagëti." (Ionai 4..)

63. Mbëretëria e Assyrisë – Ninevia. 2218-625 P.K.

Tani do të flasëmë pak fjalë për Assyrianët që muarrë rop të dhietë farat' e Israilit, edhe për krye-qytetn' e atyre Ninevinë, që ishte më i vietëri qytet edhe me emërë të math ndë botët. Na folëm përpara ndë të Lindurit, kryetë 10, se Nevrodhi, i bir' i Husit, edhe i nipi Hamit, ishte një gjahtuar egrësirash, edhe ngrëhu një mbëretëri ndë Vavyllonë, ndaj lumn' e Efratit. Ay pasandy vate e nguli ndë dhe të Assurit, e ndë Assyri, edhe ngrëhu qytetn' e Ninevisë, ndaj lumn' e Tigrit, edhe të tierë qytete ndë mbëretëri të Assyrisë. Istoria e kësai mbëretërie është fort e errëtë, edhe nukë përmendetë për shumë viet, po na e dimë se Ninevia ka qenurë më e madhe se gjithë qytet' e tierë, ndonëse mbëretëritë s'patnë ndenjurrë përherë nd' atë qytet vetëmë. Po së pastaimi Ninevia u bë i pari qytet asai më të vietërësë mbëretërisë Vavyllonësë a Halldhesë.

Mbëretërit' e Assyrisë e kishinë zakon të shënoninë gjithë ato punëra që bënëshinë ndë mbëretërit t'atyre ndë rrasa të gurit shkruarë me figure njerëzish e shtëzësh, e qytetesh, e luftërash, e punë bese, e gjahu, edhe me një farë shkronjash që thuhënë Gjahtore. Tani ndë këto kohëra, tri-dhietë viet e tëhu, kanë zënë të këndonjë këto farë

shkronjash njerëzit' e ditçim. Me mijë të tillash shkronja gjendenë sot mbë këtë ditë ndëpër të rrenuarat' [gërmadhatë] e qytetit Ninevisë, e ndëpër vënde të tierë. Vëndi i qytetit Ninevisë pat qenë harruarë fare, as njeri nukë dinte se ku ka qenë vëndi i këti qyteti, ngjer sa e gjeti vëndinë zotëri Votta, konsolli i Francësë, mbë 1842 viet, edhe zotëri Lljajardi, një Engles, mbë 1845, zu të gërmonjë ato kodra që janë ndë ball të qytetit Musullit, a të Nevrodhit, sikundrë e ka emërinë. Tuke gërmuarë ndëpër ata vënde – ç'të shohç? – na u gjënt një krye i math i gurtë, latuarë [skalisurë] ndë shkëmp të gurit! kryet' e kishte posi njeri, shtatin' e kishte posi leon, e me fletë posi shqiponjë [shkabonjë]. Pastai u gjëntnë shumë këso figuresh: ca e kishinë shtatinë posi leon, e ca të tiera e kishinë shtatinë posi ka, po të gjitha e kishinë kryetë si njeri, e me fletë ndë kraha. Edhe shumë rrasa guri të shkruara u gjëntnë mbë shumë vënde aty-drejti, të cilat'ishinë mbuluarë ndënë dhet dy mijë e pesë qint viet. Këtu është shkruarë një figure kafshe të gjallë, që e ka kryetë si njeri, e kurmnë si leon, e krahinë si shpes. Këjo figure këtu, sikundrë edhe ajo me krye njeriu, e me kurm kau, e me fletë shpesi, edhe të tiera këso kafshësh kështu, munt t'i kenë pasurë për figure Heruvimësh të dyeret Paradhisit Edhemit, që kishinë ndigjuarë nga goja e pleqëvet parë. Këto farë figuresh i vininë ndëpër dyert e pallatevet për ruanjëse, që të ruaninë mos hynjë njeri brenda.

Shumë të tillash figure tani i kanë prurë ndë Llundrë e ndë Paris, e ndëpër tierë qytete, edhe i ruanjënë për të parë, e për të marrë vesh zakonet' e ati llauzi të moçim, që ka ndenjurë nd' atë qytet me emërë të math, sot tri mijë viet përpara. Mbë një vënt, brenda ndë pallatet të Kojungjikut, u gjëntnë më shumë se dhietë mijë rrasa balte të diegura [tuvlla], shkruarë plot me shkronja; duketë se këto rrasa balte të diegura, do të kenë qenurë vivliat' e atyre, a punët' e mbëretërisë shënuarë mbi ato.

Qyteti i Ninevisë ishte gjashtë-dhietë mila i math t'i bijeç rreth e rrotullë, edhe ish rrethuarë me një mur një qint këmbë të lartë, edhe kaqë të gjerë, sa munt të shkoninë tri qerre bashkë përmbi murt; edhe përmbi murt ishinë ngrehurë një mijë e pesë qint pyrgje, për të ruajturë qytetnë. Po përbrenda këtyre mureve ishinë vëreshta, e ara, e qipshtëra, e fusha me bar të ngjomë për gjën' e gjallë. Pallatet' e mbëretit, e vëndet' e urdhërit, ishinë fort të mëdha e të bukura, e shkruarë përmbi ato istorin' e mbëretërisë. Po ndë këto figure shihet' e mirretë vesh sa fort të këqij ishinë ata njerës. Këto figure që janë shkruarë këtu, të cilatë janë gjendurë ndë qytet të Ninevisë, dëftonjënë se fjalët' e profitit Amos duallnë të gjitha – “Zoti Perëndia bëri be për shënjtërit të ti, edhe ja te do t'u vinjënë ditt juve, (o Israil,) që do t'u zënë juve me grepa, edhe fëmijëtë tuaj me grepa pishqesh.” (Amos 4.. 2.) Kështu thotë edhe Naumi – “Leoni (mbëreti i Ninevisë) çori miaft për këlysh e ti, edhe mbyti për leonëshën' e ti, edhe mbushi shpellat' e tia me gjah, edhe vëndet' e ti me rrëmbesë. (Naum 2.. 12.) Edhe këtu mbë këtë rrasë guri që shohëmë shkruarë ca njerës, me atë mëndyrë që dukenë, munt të themi përnjëherë, se këta janë më të vërtetë Iudhenjtë që u muarnë rop. Sa çudi e madhe është, këta gurë mbuluarë ndënë dhet kaqë mijë viet, sot dalënë për faqe, e na vërtetonjënë fjalët' e Shkronjësë Shënjtëruarë!

Sa bukuri e gjë të madhe kishte ay qytet, kaqë të këqia të mëdha kishte, edhe mbë ca punëra duketë se bënëni posi Sodhoma e Gomorra, përandai nuk' është për të çuditurë, përse Ionai kishte frikë të vij atie, e t'i thosh llauzit të pendoneshinë.

Nukë dihetë se kur zu të bënet' i math e i fortë qyteti i Ninevisë, po ishte krye-qytet i një mbëretërie të madhe ndë dittë të Ionait, 862 viet para Krishtit. Po ndriçimi i Assyrisë ishte ndë dittë të Sennahirimit, 710 viet para Krishtit, i cili e bëri të pasur' atë me plaçëkat që rrëmbëu prei atyre vëndesh të tierë që ishinë rreth e rrotullë, edhe ndërtoi ato

pallatet' e mëdha të Kojungjikut. Po së pastaimi Midhët' edhe Vavyllonasitë u bënë bashkë kundër Ninevisë, edhe e prishnë atë farë, edhe lumi i Tigrit rrëzoi një anë të murit, edhe mbyti qytetnë, edhe mbëreti Sarakos a Sardhanapal i vu ziarrinë pallatit ti, edhe u doq brenda. Këjo u bë 625 viet para Krishtit, edhe që atëhere Ninevia nuk' u zu n'gojë më.

Figuret' e Ninevisë që gjëndenë shkruarë mbi rrasat vërtetonjënë shumë punëra që zë n'gojë Shkronj' e Shënjtëruarë, po ndër gjith' ato, ata lavdonjënë mbëretërit' e tyre e perëndirat' e Assyrisë. Sa çudi e madhe është, se Perëndia i vërtetë, i madhi jetësë, nxori ndër dritët nga dheu ato punëra të moçime, që ishinë harruarë kaqë mijë viet, për dëshmi të së vërtetësë fjalësë ti.

64. Robëria e të dhietë faravet Israilit. 771-740-721 P.K.

Pas Ahaavit, dy-mbë-dhietë mbëretër' urdhëruanë ndër mbëretërit të dhietë faravet Israilit, po mbëretëria e atyre që e shkurtërë. Njëri vriste tiatërinë, e bënei mbëret ndër vënt t'ati. Mier' ati vëndi që ndërronenë shpejt krerëtë! Erthnë Syrianët' e plaçëkitnë vëndin' edhe e shkretuanë. Po gjëndëja nukë vinte mënt. Profitëritë gjithë-një i qartoninë, po gjëndëja ra më thellë ndër idhullatri e nd' errësirë. Së pastaimi Assyrianëtë, një komp luftëtar e i fortë, erthnë e pushtuanë vëndinë, edhe bënë gjëndëjenë të paguanjënë të dhëna. Osieu, mbëreti i Israilit, lidhi fjalë me Sallmanasarinë, mbëretn' e Assyrisë, po pastai ay doli nga fjala. Atëhere Sallmanasari erdhi ndër dhe të Israilit me ushtëri [fushatë] të madhe, edhe prishi Samarinë, edhe mori me vetëhe shumë gjëndëje, e i përndau ndëpër Armeni, e ndëpër të tierë vënde të mbëretërisë ti. La pak gjëndëje vetëmë të rrinë ndër dhe të tyre, edhe ndër vënt t'atyre që shkuli prei dheut atyre, Sallmanasari dërgoi të tierë njerës nga Syria, e nga Mesopotamia, e nga të tierë vënde, edhe i nguli nd'atë vënt që shkretoi. Edhe që ndër krye të herësë kur ngulnë atie, ata nuk' i patnë frikë Zotit. Përandai Zoti lëshoi leonë ndër ata, e hëngrë shumë vetë prei atyre. Atëhere ata dërguanë te mbëreti i Assyrisë t'e pyetinë për këtë punë, edhe mbëreti urdhëroi, të vejë një prift, që e kish prurë nga Samaria, e të rrijë atie, e t'i mësonjë ata t'i kenë frikë Perëndisë. Me gjithë këto, ata gjith-një lusinë perëndirat' e tyre, pas mëndyresh' atyre kombevet që ishinë rreth e rrotull atyreve.

Kështu u mbarua mbëretëria e të dhietë faravet Israilit. Ata Israilitët' e pakë që patnë mbeturë, u përzienë me ata kombe idhullatrë që ngelnë atie, edhe që atëhere doli ky komb' i Samaritanëvet.

65. Mbëretërit' e herëshim të Iudhësë. 975-698 P.K.

Passi u nda mbëretëria, ndenjënë ndër shkëmpt të Dhavidhit njëzet mbëretërë ndër Ierusalimë për tre qint e shtatë-dhiet' e dy viet; edhe mbëretëria e Iudhësë ngjati një qint viet pas atyre të dhietë faravet. Po edhe pas Dhavidhit mbëretëruanë më shumë mbëretërë të pa-besë e të këqij, se të mirë. Emërat' e të tillëve njerëzish të mirë, si Iosafati e si Ezeqia, ndritnjënë ndër istorit posi yje të rrallë ndër mest të errësirësë.

Ahazi ngrehu theroret' e Vaallit ndëpër udhët të Ierusalimësë, edhe ay mbylli dyert' e shtëpisë Zotit; kështu tempulli i Perëndisë ishte për ca kohë i shkretë, posi një shtëpi që i ka vdekur' i zoti.

Ezeqia një bir besëtar i të pa-besit Ahaz, hapi për-së-ri dyert' e tempullit, edhe qëroi Ierusalimënë nga idhullatë. Ay theu edhe atë gjarpërin' e ramtë, që pat ngriturë lart ndë drut Moisiu, kur ishte ndë shkretëtirët, sepse qe ruajturë ngjer mb' atë kohë. (2 Mbëretëritë 18.. 4.) Sepse Israilitët'i bininë qem (thymiamë) kësai cope të ramtë, edhe e lusinë për gjë të shënjtëruarë; ata kujtoninë se gjarpëri i ramtë u shëronte plagën' Israilitëve, e jo ay Iehovahu vetë. Passi bëri këtë punë të mirë e të nevojëshime, Ezeqia dërgoi kartë, e thërriti të dhietë farat' e Israilit të këthenenë prapë ndë besët të Perëndisë atëravet atyre, edhe të vinjënë të kremtëronjënë pashkëtë. Këjo punë koditi [gjau] ndë ditt të këti mbëreti, kur u bënë rop të dhietë farat' e Israilit prei Assyrianëve; edhe me mijë Israilitë erthnë ndë dhe të Iudhësë, e u pshehnë ndë mbëretërit të Ezeqisë. Ezeqia, tuke shpëryerë mbë fuqit të Perëndisë Israilit, ngriti krye kundër Assyrianëve, edhe nukë desh t'u paguante të dhëna atyre. Përandai, mbë të katër-mbë-dhietinë vit të mbëretërisë Ezeqisë, Sennahirimi mbëreti i Ninevisë, dërgoi një ushtëri të madhe, edhe pushtoi gjithë qytetet' e Iudhësë, edhe qerthulloi Ierusalimënë. Po ay kur foli keq kundër Perëndisë gjallë, Ezeqia grisi rrobat' e tia, edhe iu lut Perëndisë Israilit. Atëhere ëngjëlli i Zotit ra ndë ushtëri të Assyrianëve, edhe vrau për një natë një qint e tetë-dhiet' e pesë mijë vetë: edhe ç'të shohç! Ndë mëngjes ishinë shtrirë për dhe të gjithë të vdekurë.

Ndë këtë figure këtu shohëmë Assyrianëtë te kanë qerthulluarë një qytet, edhe luftonjënë t'e pushtonjënë. Gjith' ato frika që gjajtnë atëhere nd' atë dhe, edhe se si i shpëtoi Zoti nga duart' e arëmiqet, i ka shkruarë fort bukurë profiti Isai. (Isaia 10.. 5-34.) Ndëpër gurët të Ninevisë gjëndenë shkruarë gjith' ato luftëra që bëri Sennahirimi ndë dhet të Israilit, po se si e prishi Perëndia, këtë nuk' e kanë shënuar' Assyrianëtë. A nuk' është këjo një dëshmi e vërtetë, për gjithë sa shkruan Shkronj' e Shënjtëruarë?

Kështu Perëndia shpëtoi mbëretërin' e Iudhësë, edhe mbëretn' e mirë Ezeqinë, që të dëftente të madhenë fuqin' e ti, edhe prishi ushtërin' e madhështorit mbëretit Assyrisë, që të rrëzonte idhullatrinë. Psallm' e dyzet e katërtë munt të jetë shkruarë kur dërgoi krye-ushtëtorët' e ti Sennahirimi që t'i flisinë keq Zotit edhe shërbëtorit ati Ezeqisë, edhe Psallmatë 73, 75, 76, do të jenë shkruarë passi u prish ushtëria e Assyrianëve.

Perëndia është' i ngjohurë ndë Iudhërit, emër' i ati është' i math ndë Israil.

Edhe tend' e ati është ndë Salimë, edhe të ndenjurit' e ati ndë Sionë.

Atie theu shigjetat' e hargjevet, mburonjënë, edhe shpatënë, edhe luftënë.

Ti je fort më i ndriçurë se malet' e rrëmbimit.

Zemër-ashpërët' u ropnë, fjetinë gjumën' e tyre, edhe asnjë prei burravet fortë s'gjeti duart' e ti.

Prej qërtimit tënt, o Perëndia i Iakovit, ranë ndë gjumë edhe qerra edhe kali.

Ti je i frikëshim, edhe kush do të qëndronjë përpara teje, kur të zemëronesh? (Psallmë 76.. 1-7.)

Këtu kam shkruarë figuren' e një ushtëtori me shtijëzë e me mburonjë, me hark e me ber (me shëgjetë), posikur luftoninë nd' atë kohë pa dalur' armët' e ziarrit; shih edhe qerrën' e luftësë, sepse njëherë moti trimat' e luftëtarët' e mëdhenj patnë luftuarë hipurë mbi qerrët.

Nd' atë kohë Ezeqia u sëmur fort, atëhere erdhi profiti Isai, e i tha: "Vërë mbë vënt punët' e shtëpisë s'ate, sepse ke për të vdekurë, edhe s'ke për të rruarë (më)." Atëhere Ezeqia iu lut Zotit me lott, t'i ngjasë jetënë. Edhe Zoti i tha Isaisë, tuke dalurë nga shtëpia: "Këthehu, e thuaj Ezeqisë: Kështu thotë Zoti Perëndia i Dhavidhit t'yt-et, ndigjova të lutëritë t'at, edhe pashë lott' e tu, na te kam për të shtuar' edhe pesë-mbë-

dhietë viet ndë jetët tënde.” Edhe Isaia e mësoi të vërë fiq mbi plagët, edhe pas tri ditç u shërua, edhe vate ndë tempullë që t’i falei ndersë Perëndisë që e shëroi.

66. Të pastaimitë mbëretërit’ e Iudhësë. 698-588 P.K.

Pas vdekëjesë Ezeqisë hipi ndë shkëmpt i biri Manassiu, një mbëret i keq, i cili mbëretëroi më tepërë se pesë-dhietë viet, edhe prishi gjith’ ato punë të mira që pat bër’ i ati, edhe këtheu gjëndëjenë për-së-ri ndë idhullatri.

Ky bir i keq ati farë mbëreti të mirë mbushi gjith’ udhët’ e Ierusalimësë plot me gjak foshnjesh pa faj, tuke bërë kurban ata përpara idhullësë Mollohut, perëndisë Sidhonianëvet; kështu edhe të birë e ti e bëri të shkonjë ndëpër mes të ziarrit. Këtu ndë këtë figure shohëmë ç’farë punërash të frikëshime punonin’ ata idhullatrët’ e moçim. Pak kohë përpara vdekëjesë ay u pru lidhurë ndë Vavyllonë. Atie iu thye zemëra ati, e iu ulut Perëndisë vërtetë, edhe Zoti i ndigjoi të lutëritë, edhe u vu për-së-ri ndë mbëretëri të ti.

Amoni, i bir’ i Manassiut, ishte më i keq se gjith’ ata që patnë mbëretëruarë përpara ati, po ay nukë ngjati shumë, sepse pas dy vieç e vranë shërbëtorët’ e ti. Ndë këmbë t’ati u vu Iosia, një dialë tetë vieç i vogëlë.

Edhe Iosia bëri atë që ishte e pëlqyerë ndë sy të Zotit, edhe eci pas udhësë Dhavidhit. Ay kur ishte dial’ i vogëlë, tetë viet pas mbëretëris’ ati, zu t’i bierë prapa punësë Perëndisë; edhe dy-mbë-dhietë viet pas mbëretëris’ ati, ay qëroi Ierusalimënë edhe gjithë Iudhënë nga idhullatë, edhe bëri të ndërtonetë për-së-ri shtëpia e Zotit. Edhe tuke qëruarë tempullinë, gjetnë një vivli të vietërë, harruar’ e lënë mbë-nj-anë që ndë kohë të Manassiut; ajo vivli ishte Shkronja e Shënjtëruarë, do me thënë Nomi i Moisiut. Këtë vivli e prunë edhe e kënduanë përpara mbëretit, i cili kur ndigjoi se ç’ishte shkruarë brenda, kaqë fort e mori frika e u habit, sa grisi rrobat’ e tia. Edhe ay dërgoi njerës te Olldha profitëresha, e u tha atyre: “Shkoni, e pyetni Zotnë për mua, edhe për ata që kanë mbeturë ndë Israili e ndë Iudhë për fjalët’ e kësai vivlie që u gjënt, sepse është’ i math zemërimi i Zotit që u derth mbi ne, sepse atëritë tanë nukë ruajnë fjalën’ e Zotit, që të punoninë pas gjith’ atyre që janë shkruarë ndë këtë vivli.” Edhe ajo u tha atyre: “Kështu thotë Zoti Perëndia i Israilit. Thojni ati njeriut që u dërgoi tek unë, kështu thotë Zoti: Na unë te do të lëshonj të këqia mbi këtë vënt, edhe mbi vëndësit e ati, gjith’ ata mallëkime që janë shkruarë nd’ atë vivli që u këndua përpara mbëretit Iudhësë, sepse hoqnë dorë prei meje, edhe u doqnë qem perëndiravet tierë, që të më zemëronjënë për gjithë punët e duaret tyre, përandai do të derdhetë zemërata ime mbi këtë vënt, edhe nukë do të shuhetë. Po mbëretit Iudhësë, që u dërgoi të pyetni Zotinë, kështu t’i thojni ati: Kështu thotë Zoti Perëndia i Israilit, për ato fjalët që ndigjove, sepse zemëra jote u sbut, edhe u përungj përpara Perëndisë, kur ndigjove fjalët’ e ati kundrë këti vëndi, edhe kundrë vëndëset ati, edhe u përungje përpara meje edhe grise rrobat’ e tua, edhe qjave përpara meje, përandai edhe unë ndigjova, thotë Zoti: na unë te do të mbëleth ty tek atërit’ e tu, edhe do të mbëlidhesh ndë varr tënt me paqtim, edhe syt’ e tu nukë do të shohënë gjith’ ato të këqia që do të lëshonj mbi këtë vënt, edhe mbi vëndësit e ati.” (2 Kohëratë 34.. 14-28.)

Tani Iosia dëshëronte më fort që të punonte Israili pas nomit Moisiut. U mbëlloth gjithë pleqësia e gjëndëjesë, edhe u këndua vivlia përpara atyre, edhe mbëreti lidhi fjalë përpara Zotit bashkë me gjithë gjëndëjenë. Ay dërgoi urdhërë mbë gjith’ anët e Iudhësë, edhe rrëzoi therorenë që ishte ndë Vethil, edhe nxori eshtëra të vdekurish nga varretë,

edhe i dogji mbi therorenë, pas fjalësë Zotit që pat thënë me anë të njeriut Perëndisë ndë kohë të Ierovoamit.

Po pasi vdiq Iosia, gjithë punëratë që pat bër' ay u prishnë. Dy të bijt' e ati edhe dy të nipërit' e ati hipinë ndë shkëmp të mbëretërisë, njëri pas jatërit, ndërmes pak kohëje, edhe të gjith' ata u rrëzuanë nga shkëmbi, edhe atëhere koditnë shumë punëra me shenjë, të cilatë dëfteninë, se ishte afërë koha e gjyqit.

67. Profitëritë.

Gjithë këto shenje i sgjidhin' e i dëfteninë profitëritë. Shumë fjalë që kanë folur' ata, gjendenë shkruarë ndë Vivllët. Puna e atyre ishte të mësoninë gjëndëjenë të ngjihinë Perëndinë, edhe të ndalinë të këqiatë që bëneshinë shumë herë edhe nga mbëretërit' edhe nga priftëritë. Perëndia ngriti të tillë njerës ndë mbëretërit të dhietë faravet Israilit e të Iudhësë, edhe prei dorësë parë edhe prei dorësë dytë. Isaia edhe Dhaniili ishinë prei gjak mbëretërie. Ieremia edhe Ezeqiili ishinë prei rrënjësë priftërisë. Iliu e Elisheu e Ionai e Mihaiu ishinë prei dorësë mesëme. Amosi ishte një lopar.

Kur ishte mbëretëria e Vavyllonës' e vogël' edhe pa emërë, Isaia profitepsi se do të shtonei e do të madhoni shpejt, edhe se do të pushtonte shumë dhëra, edhe së pastaimi se do të prishei prei një bir mbëreti nga Persia, që do t'ia thoshin' emërinë Qyro.

Ieremia profitepsi për të prishurit' e Ierusalimësë prei Halldheanëvet, edhe dëftu përpara, sa viet kishte për të mbetur' e shkretë Ierusalima, edhe shtynte gjëndëjenë ndë pendim, që të mos u vinte prishëja.

Ezeqiili profitepsi për Israilitët, se do t'i shkulinë prei dheut atyre, e do t'i ngulinë ndë Armeni, e do të mbesin' atie një qint viet, edhe ay vetë, sikundrë edhe gjithë Iudhenjtë, shpëreninë për të prishurit' e mbëretërisë Vavyllonësë prei anësë Perëndisë; edhe ay u tha atyre, të mos presënë se do të ngrihetë për-së-ri mbëretëria e Israilit, po të presënë se edhe sa njerës që të kenë mbeturë ndë dhe të tyre, shpejt kanë për të ardhurë ndë dhe të huaj. Po Israilitët nuk' i besuan' Ezeqiilit, posi gjëndëja e Iudhësë që nuk' i pat besuarë Ieremisë.

Ato fjalë që kanë folurë profitëritë janë fort të mëdha. Ieremia ndë një vënt flet mbë këtë mëndyrë: “Sbrita ndë shtëpi të shtëmbarit, edhe ja te po bënte punë mbi rrotovilet. Edhe iu prish ana që po bënte prei balte, ndë dorë të shtëmbarit, edhe për-së-ri e bëri atë një tiatër' anë, sikundrë i pëlqeu shtëmbarit ta bënte. – O shtëpia e Israilit, nukë munt t'u bënj unë juve posi ky shtëmbari? thotë Zoti. Ja posi balta ndë dorë të shtëmbarit, kështu (ini edhe) ju ndë dorët t'ime, o shtëpia e Israilit.” (Ieremia 18.. 3-6.) Një herë ay bleu një shtëmbë balte nga shtëmbari, edhe e theu përpara pleqëvet Israilit, e përpara priftërevet, edhe tha: “Kështu thotë Zoti i fuqivet: Kështu do të thyenj këtë gjëndëje, edhe këtë qytet, posikur të thyenj njeri anën' e shtëmbarit, që s'munt ta ndreqnjë më për-së-ri: – edhe shtëpit' e Ierusalimësë, edhe shtëpit' e mbëretërvet Iudhësë do të ndyhenë, bashkë me gjithë shtëpit që kanë diegurë qem mbi kulmit atyre gjith' ushtërisë qiellit, edhe që u kanë prurë dhurata të pikaturi perëndiravet tierë.” (Ieremia 19.. 11-13.)

Po më të mëdhatë profiti ishinë për të ardhurit' e Shpëtimtarit. “Për të cilinë bënëjenë dëshmi gjithë profitëritë.” (Punët 10.. 43: Sbulesa 19.. 10.) Kishinë profitepsurë, se ay do të dilte prei brezit Dhavidhit. (Isaia 11.. 1: Ieremia 23.. 5.) Edhe ishte sbuluar' e shpërfaqurë se ay do të ishte edhe Perëndi edhe njeri. Isaia fliste për atë kështu: “Perëndia i fortë, i Ati jetësë pa-sosurë, Kryet' e paqimit.” (Isaia 9.. 6.) “Zoti dreitëria jonë.”

(Jeremia 23.. 6: 33.. 16.) Emëri i ati do të thuhej Emmanuil, a Perëndia bashkë me ne (Isaia 7.. 14.); edhe ati i virinë gjith' emërat' Perëndisë. Ay iu duk profitit Isai mbë një të parë, sikur ishte posi njeri, po me madhëri posi Perëndi. “Pashë Zonë tuke ndenjorë mbë një shkëmp të lartë e ngriturë lart, edhe pëqir' i ati mbushi tempullinë. Sipër' ati rrininë Serafimë, gjithë-se-cili kishte nga gjashtë fletë; me të dyjat mbulonte faqen' e ti, edhe me të dyjat mbulonte këmbët' e tia, edhe me të dyjat fluturonte. Edhe njëri i bërtiste tiatërit, e thoshte: Shënjt, shënjt, shënjt (është) Zoti Savaoth (i fuqivet), gjithë dheu (është) plot me lavdin' e ati.” (Isaia 6.. 1-3.)

Profitepsnë për Messinë, se do të lindte ndë Vithleemë e se do të bënte çudi të mëdha, do t'u çilte sytë të verbëret, e do t'u epte veshëtë të shurdhëtë, edhe se “i çali do të hidhej posi dreri, edhe gjuha e të belbërit do të këndonte.” (Isaia 35.. 5, 6.), se ay “do t'u epte zën' e mirë të vobekëvet, e do të shëronte zemër-thyerëtë.” (Isaia 61: 1.), edhe se “do të kulloste tufën' e ti posi bari, edhe do të mbëlithte qëngjatë me krahën' e ti, edhe do t'i mbante ndë gji të ti.” (Isaia 40.. 11.) Profitëritë kanë profitepsurë për pësimet e për vdekëjen' e Shpëtimtarit, kaqë sbuluar' e kaqë këthiellëtë, sa kur këndojmë ato profiti, na dukenë se po flasënë për ca punëra që ishinë bërë, e jo për ato punëra që do të bëneshinë pastai. Kishinë folurë përpara për atë, se ay ishte “një njeri me shtrëngime, e i provuarë me sëmundëje”, se ay “do t'ishte plagosurë për fajet t'ona, e hequrë keq për pa-udhërit t'ona”, “se do t'epte shpirtin' e ti ndë vdekëjet, e do të numëronej me të pa-udhët, edhe ay do të mbante fajet' e të shumëve, edhe do të laimësonte për të pa-udhët.” Mbë këtë mëndyrë flet për vdekëjen' e ati: “u pru posi qëng mbë të therët, edhe posi dash pa zë përpara ati që e qeth, kështu nukë hapi gojën' e ti.” (Isaia 53..) Edhe gjith' ato punë që koditnë mbë vdekëjet t'ati, e mbë të varruarët t'ati, e mbë të ngjallurit t'ati, e mbë të hipurit mbë qiell, janë folurë fort këthiellëtë. Zënë n'gojë edhe për Frymën' e Shënjtëruarë që qe zotuarë, edhe thonë përmbi të gjitha, se ka për të ardhurë një kohë, që “dheu do të mbushetë me të ngjohurit të Zotit, posi ujëratë që mbulonjënë detnë.” (Isaia 44.. 3; Ioili 2.. 28, 29; Isaia 11.. 9.)

Kështu i pëlqeu Perëndisë t'i lëshonte një rreze drite gjëndëjesë ti, për ato punë që do të bëneshinë për shpërblim' e math. Edhe kështu besëtarëtë ngushllonëshin' e forconëshinë ndë besët, po të pa-besët'ishinë lënë mbë-nj'-anë pa-përdëllim e pa-ndëjesë.

68. Ropëria e Israilitëvet ndë Vavyllonë. 588 P.K.

Gjith' ato fjalë që profitepsnë profitëritë kundër Israilitëvet, duallë të vërteta së pastaimi, ndonëse ata s'patnë besuarë, a patnë besuarë. Erthnë Haldheanëtë – një gjëndëje e keqe – edhe rrëzuan' e shkretuanë Ierusalimënë, atë qytet të bukurë. Po edhe tani Perëndia bëri gjyqnë dalë nga dalë. Navuhodhonorë, mbëreti i Haldheanëvet, i vu të dhëna dheut Iudhësë, edhe mori me vetëhe mbëretnë Ioakim, edhe dhietë mijë burra që mbanin' armë prei ballit gjëndëjesë, edhe gjithë mieshtrit' e punëtorët' e vëndit. Ay vu një tiatërë mbëret ndë Iudhe: edhe kështu mbëretëria ngjati edhe dhietë viet.

Mbëreti Sedheqi kërkoi ndihmë prei Egjyptianëvet kundër Haldheanëvet, po ushtëria e Haldheanëvet erdhi posi bletë ndë dhe të Iudhesë, edhe qerthëlluanë Ierusalimënë. Iudhenjtë qëndruanë dy viet kundër atyre. Kaqë zi e madhe për bukë u bë brenda ndë qytet, sa e ëma vriste të birrë, edhe i hante mishnë. Së pastaimi arëmiqtë hynë brenda ndë qytet. Sedheqia tuke luftuarë ra ndë dorë të arëmiqet, edhe tani dolli e vërtetë profitia e Ezeqiuilit që pat thënë për atë – se ay do të shkonte ndë Vavyllonë, edhe do të vdiste atie,

po ay nukë do t'ë shihte vëndinë. Haldheanët' i nxuarrë syt' ati, ay nukë pa më tiatërë gjë, veç kur i vranë të bijtë ndër sy t'ati, para se t'ë verbonin' atë, edhe pasandy e prunë të verbërë pa sy ndë Vavyllonë. Qyteti i Ierusalimësë edhe tempulli u plaçkitinë edhe u doqnë, edhe prunë gjithë kafshët' edhe enët' e tempullit ndë Vavyllonë, edhe i vunë ndë tempullët të Vellit. Gjithë gjëndëjen' e Israilit e shkullnë prei vëndit, edhe e përndanë ndëpër mbëretërit të Vavyllonësë, lënë ndë Iudhe vetëmë ca shtëpi të para, edhe pak gjëndëje të vobekëtë, edhe kështu duallë të vërteta fjalët' e profitëvet.

Ndërmest atyre njerëzëvet parë që mbetnë ndë dhethit të tyre, ishte Gedhallia, të cilinë mbëreti i Vavyllonës' e bëri qyvernitar mbi Iudhenë. Po Iudhenjt' e vranë këtë njeri besëtar. Profiti Ieremi iu lut mbëretit Vavyllonësë t'ë lërë të mbesë ndë dhethit të ti, edhe atëhere ay shkroi Vivlin' e të Qjarit ndërmest gurëvet e gërmadhavet Ierusalimësë që kish mbetur' e shkretë.

69. Dialoshat' e Evrevet. 607-580 P.K.

Tani na duhetë të marrëmë vesh, se Iudhenjt' ishinë ropërit' e Vavyllonaset, edhe ata u shërbenin' atyre, e bëninë gjithë ç'të doninë. Po Perëndia ndë zemërim të ti bëri përdëllim, edhe "bëri që t'u dhëmbenë atyreve që i muarrë rop." Ca prei atyre hipnë mbë këmbë të madhe. Me gjithë këto, Iudhenjtë s'munt t'ë harroninë dhethin e tyre që kishinë lindur' atie, edhe Ierusalimën' e dashurë, edhe të lavduarshiminë tempullë që ish rrëzuarë tani; edhe arëmiqtë kur u thoshin' atyre të këndonjënë kënkë, ata përgjegjeshinë: "Qysh të këndojmë kënkën' e Zotit ndë dhe të huajt?" Ani këtheneshin' e thoshinë vetëhesë: "Ndë të harrofsha Ierusalimë, m'u harroft' e diathëta dorë! M'u ngjittë gjuha ndë gurmast, ndë mos të kujtofsha; ndë mos vënça më përpara Ierusalimënë ndë kryet të gazit t'im!" (Psallmë 137 [136].)

Navuhodhonorori kish vënë ca djem Iudhenjsh të mësonen' e të nxënë këndim e dituri; ndërmest të këtyre ishin' edhe Dhaniili e Sedhrah e Misahu e Avdhenegoi. Ata e kishinë për të keq të haninë nga ato gjellë që u dërgonte Navuhodhonorori prei truvezësë ti, të cilatë munt të kishinë qenurë mish kurbanit të idhullavet, po ata haninë vetëmë koqe farash e bar të ngjomë, edhe ndë vënt të verësë pinin' ujë. Edhe Perëndia u epte atyre shëndet, e ishinë më të shëndoshë e më të bukurë se gjithë djemt' e tierë; edhe kur erdhi koha t'i nxirinë përpara mbëretit, ata ishinë më të mençim e më të ditçim se gjithë të tierëtë.

Pastai mbëreti i hipi ata mbë shkallë të lartë, edhe kishinë kaqë nder' e fuqi të madhe, sa munt t'i bëninë mirë kombit tyre, edhe të përndaninë besën' e të vërtetit Perëndi ndërmest të idhullatrëvet.

Nga gjith' ato plaçëkatë që kish rrëmbyerë Navuhodhonorori prei së katër' anësh dheut, urdhëroi të bënetë një idhull' e artë gjashtë-dhietë kut e lartë, e gjashtë kut e gjërë. Atë ditë kur kishinë për të luturë këtë idhullë, një leçitës thoshte me zë të math: "Juve u urdhëronjënë, o gjëndëje, e kombe, e gjuhëra, sa-kaqë-heresh kur të ndigjoni zën' e trumbetës' e të fyllit e të qitharës' e të samvykës' e të psaltirit e të zërit dreitë, e ç' do farë musiqie, të bini për dhe, e të lutni idhullën' e artë, që ka ngrehurë mbëreti Navuhodhonoror; edhe kush të mos bierë e të mos e lutnjë, atë herë do të hidhetë ndë mest të furrësë që digjetë ziarm." (Dhaniili 3.. 4-6.)

Atëhere i thanë mbëretit se gjithë gjëndëja kur ranë për dhe, edhe lutnë idhullën' e artë, vetëmë Sedhrah e Misahu e Avdhenegoi qëndruanë mbë këmbë, e nukë ranë për

dhe të lutinë idhullën' e artë. Edhe Navuhodhonorori urdhëroi t'i bienë përpara ati, edhe u tha atyre: "A me të vërtetë, o Sedhrah, e o Misah, e o Avdhenego, nukë lutni perëndirat' e mi, edhe nuk' i fali idhullës' artë që ngreha? – Cili (është') ay Perëndi që do t'u shpëtonjë juve prej duarsh mia?" Edhe ata u përgjegjinë e i thanë mbëretit: "Perëndia ynë, që lusëmë na, është' i zoti të na shpëtonjë nga furra që digjetë ziarm, edhe do të na shpëtonjë prej dorësë s'ate, o mbëret. Po edhe ndë mos (qoftë kështu), ta març vesh, o mbëret, se na nukë lusëmë perëndirat' e tu, as nuk' i falemi asai idhullës' artë që ngrehe."

"Atëhere Navuhodhonorori u mbush me zemërim, edhe iu ndërrua fytyra kundrë Sedhrahut e Misahut e Avdhenegoit; (edhe) foli e urdhëroi të diegënë furrënë shtatë herë më fort, se sa ish diegurë. Edhe urdhëroi më të fortëtë burrat' e ushtërisë ti, të lithnjënë Sedhrahun' e Misahun' e Avdhenegonë, e t'i hedhënë ndë furrë që digjei ziarm. Atëhere njerëzit' i lithnë ata bashkë me të veshurat' e atyre, e me të mbathurat' e atyre, e me kësulat' e atyre, e me rrobat' e atyre, edhe i hojnë ndë mest të furrësë që digjei ziarm. Edhe urdhëri i mbëretit pasi ishte i shtrënguarë, furra u doq kaqë fort tepërë, sa flaka e ziarmit dogji ata njerëzitë që ngritnë Sedhrahun' e Misahun' e Avdhenegonë. Edhe këta tre njerës, Sedhrah e Misahu e Avdhenegoi ranë lidhurë ndë mest të furrësë që digjei ziarm. Atëhere mbëreti Navuhodhonoror u habit, edhe u ngrit shpejt, e foli e u tha njerëzëvet mëdhenj: A nukë hodhëm na tre vetë lidhurë ndë mest të ziarmit? Edhe ata u përgjeqnë, e i thanë mbëretit: Po, o mbëret. (Edhe) ay u tha atyre: Ja unë te po shoh katërë vetë të sgjidhurë tuke ecurë ndë mest të ziarmit, edhe nuk' u bënë dam atyre; edhe faqeja e të katërtit (është) posi bir Perëndie. Atëhere Navuhodhonorori u afrua ndë grykët të furrësë që digjei ziarm, edhe foli e tha: Sedhrah, Misah, Avdhenego, o shërbëtorët' e Perëndisë lartë, dilni jashtë, e eni (këtu)! Atëhere Sedhrah e Misahu e Avdhenegoi duallë jashtë nga mesi ziarmit. Atëhere u mbëlthnë krerët' e dheut, e qyvernitarët' e krye-ushtëtorët' e të mëdhenjt' e mbëretit, edhe pan' ata njerëzitë që nuk' u bëri gjë ziari kurmavet atyre, as nuk' u dogji atyre një qime të kresë, edhe të veshurit' e atyre nuk' u ndërrua, as erë ziarmi nukë shkoi mbi ata. (Atëhere) Navuhodhonorori foli e tha: "Qoftë bekuarë Perëndia i Sedhrahut, e i Misahut, e i Avdhenegoit, që dërgoi ëngjëllin' e ti, edhe shpëtoi shërbëtorët' e ti, që shpëryenë mb' atë, edhe nuk' i ndigjuanë fjalësë mbëretit, edhe dhanë ndë dorë kurmat' e atyre, që të mos lusnjënë as të mos i falenë tiatërë perëndie, veç Perëndisë atyre. Përandai bënj urdhërë, se gjith' ajo gjëndëje, e komp, e gjuhë, që të flasë keq për Perëndin' e Sedhrahut, e të Misahut, e të Avdhenegoit, do të copëtonetë, edhe shtëpit' e atyre do të bënenë vënde plehesh, sepse nuk' është tiatërë Perëndi, që munt të shpëtonjë kështu. Atëhere mbëreti vu mbë shkallë më të madhe Sedhrahun' e Misahun' e Avdhenegonë ndëpër dhe të Vavyllonësë." (Dhaniili 3.)

70. Mbëretëria e Halldhesë – Vavyllona. 2247-538 P.K.

Vavyllona, i pari qytet, ndërtuarë pas përmytëjesë, duanë të thonë se është ngrëhurë prej Ninit, i cili munt të ketë qenurë Nevrodhi, që do me thënë Shqip, Krye-lartë. Ay duketë ta ketë ngrëhurë këtë qytet ndaj pyrgun' e Vavellit, edhe Semiramidha, e shoqeja e ati, do ta ketë qarkuarë me mur. Ay pyrg më përpara ka qenë ngrëhurë për një shenjë madhërie, pastai aty kanë luturë yjet' e qiellit, edhe së pastaimi aty kanë luturë Vellin' a Vaallinë me ç' do punëra të këqia e të ndyra. Me të vërtetë Vavyllonasitë kanë pasë hipurë natënë ndë majet të këti pyrgu për të vënë re e për të vështruar' yjet' e qiellit se si

ecënjën' e se si shkonjënë, kur lintjën' e kur perëndonjënë, sepse ata kanë qenurë astronomë të mëdhenj, edhe i kanë pasë ranë prapa fort kësai diturie. Vavyllona ka qenë ngrehurë për-anë atyre lumëravet mëdhenj të Efratit e të Tigris. Këta lumëra piqeshinë me hendekë e me vija, që i kishinë bërë njerëzit' atëhere për të lundruar' e për të ujiturë dhenë. Këto fusha ndën' ujë epinë shumë drithë, e bëninë shumë pemë. Ndë këtë vënt bënei shumë tregëti ndëpër lumërat me lundra, e ndëpër tokët me kafshë të gjalla. Vavyllona ka pasur' emërë të math për pëlhurrat' e mira e për rrobat' e bukura e për plafat që bënte, edhe duanë të thonë, se ndë Vavyllona më përpara ndreqnë matësat' e drehemetë për të matur' e për të peshuarë.

Po me gjithë këto të mira që kish falurë Perëndia mb' atë vënt, gjëndëja luste idhulla, e bënte punëra të këqia e të ndyra. Duanë të thonë, se idhullatria erdhi ndë Greqi e ndë Romë herën' e parë nga Vavyllona.

Vavyllona kishte hipurë ndë madhëri t'asai ndë kohë të Navuhodhonorit, i cili rrëzoi Ierusalimënë, e prishi mbëretërin' e Iudhesë, edhe mori rop Israilitët' e i pru ndë qytet të ti. Për këtë pat profitepsurë Isaia para një qint vieç, se do të bënei. Ay profiti vetë zu n'gojë edhe emërin' e Qyrosë mbëretit Persisë, se kish për të pushtuarë Vavyllonënë, edhe se kish për të lëshuar' Iudhenjtë të shkoninë ndë vënt të tyre, edhe se kish për të prishur' idhullat' e Vavyllonësë; edhe Ieremia profitepsi, se ropëria do të ngjaste shtatëdhietë viet.

Qyteti i Vavyllonësë ishte ndërtuarë me katërë faqe, edhe gjithë-se-cila faqe ish pesëmbëdhietë mila e gjatë. Qyteti ish rrethuarë me një mur 300 këmbë të lartë, e 87 këmbë të gjërë, kaqë sa mbë majë të murit munt të ecininë katërë qerre krahë për krahë, edhe përmbi muret ishinë ngrehurë 250 pyrgje për të ruajturë qytetnë. Rreth e rrotullë murevet qytetit ishte një hendek i gjërë mbushurë me ujë prej lumërash. Të katërë faqet' e qytetit kishin nga 25 dyer të hekurta; përbrenda murevet ishinë 676 rruga të dreita, që ndaninë qytetnë anë mb'anë. Lumi i Efratit, 500 këmbë i gjërë, shkonte për mes qytetit, edhe e ndante dy anësh sa njëra jatëra. Të dy anët' e lumit ishinë ngjeshurë me mur të gjër' e të fortë, që të mos hante dhenë ujëtë, edhe mbë të dy anët e lumit ishinë dy hendekë të thatë, që kur të vërshonte lumi, të derdhej ujëtë brenda nd' ata, e të mos mbyste qytetnë. Përmbi lumt ishte një urë 30 këmbë e gjërë, edhe poshtë lumit ndënë dhet ishte një rrugë mbëluarë përsipër, që hyninë prej pallatit ri që ishte mbë-kët'-anë lumënë, e dilinë ndë pallat të vietërë që ishte mb'-at'-anë lumënë. Po më e çudiçime nga gjithë punërat' e Vavyllonësë ishte kopështi, varurë nd' erët 300 këmbë lart, e 400 këmb' i gjër' e i gjatë, mbushurë me dhe, e mbiellë gjithë ç'farë drurësh, të cilin' e kish bërë Navuhodhonorit për të shoqenë Amitisënë. Gjith' ato ndërtesa ishinë ndërtuarë me pëqisa [tuvlla balte] diegurë ndë furrë, a tharë ndë diell, edhe të gjitha shënuarë me emërin' e mbëretit. Me mijë këso pëqisash gjëndenë sot mbë këtë ditë, edhe shumë nga ato janë të shkruara me shkronja gjahtore, posi ato të Ninevisë. Pas shkronjash që janë gjëndurë ndëpër të rrenuarat e qytetit, mirretë vesh, se nd' atë kopështë vijnë të vdekuritë pastai.

Këtu është figureja e një pëqise [tuvlle balte] nga Vavyllona, shkruarë me shkronja gjahtore, që e kanë majënë posi thump shigjete.

Qyrua, mbëreti i Persisë, mori qytetn' e Vavyllonësë. Ay këtheu rrymin' e lumit, edhe e derdhi nd' ata hendekë të thatë që tham përsipër, pastai ay hyri me gjith' ushtërinë ndëpër zall të lumit që shkonte për mes qytetit, po edhe kështu si e bëri, ay nukë do të kishte hyrë ndë qytet, ndë mos ishinë çelë dyert' e lumit prej së dy anësh për punë të kremtesë Vellit. Ay kur hyri mbrenda, gjeti gjëndëjenë dejtur' e fjeturë, edhe vrau

mbërenë Valltasarinë, edhe pushtoi mbëretërin' e Vavyllonësë, sikundrë e zë n'gojë profiti Dhaniil. Persianët'ishinë ziarr-lutësa [i luteshinë ziarrit], edhe prishnë idhullat' e Vavyllonësë, sepse i mërztinë.

Tre qint e njëzet e tre viet përpara Krishtit, Aleksandrë Maqedhonasi pushtoi mbëretërin' e Persianëve, edhe kur erdhi ndë Vavyllonë, ay gjeti një pyrg astronomie që ishte ngrehurë 1900 viet përpara, për të vënë re, e për të vështruar' yjet' e qiellit; këtu mirretë vesh se ky pyrg do t'ishte ndërtuar 125 viet pas përmytëjesë botësë. Aleksandhri, passi u këthye nga Hindi, vdiq ndë Vavyllonë.

Passi u ngrit shkëmbi i mbëretërisë nga Vavyllona, atëhere ay qytet ra poshtë edhe u shkretua; prei gurësh këti krye-qyteti u ndërtuanë të tierë qytete, Sellefqia e Ktisifoni e All-Madaani e Kufa. Këtu është një figure fort e bukurë, nga ato më të miratë që janë gjëndurë ndëpër të rrenuarat [gërmadhat] e Vavyllonësë. Ç'farë gjëje ka qenë ajo, asnjëri nuk' e di sot, po Beduinët'i thonë Kasr, që do me thënë Thesar.

Ndër gjithë të rrenuarat' e Vavyllonësë më i vietër' është Birs-Nevrodhi, a pyrgu i Nevrodhit që është shkruarë këjo figure këtu. Ca thonë se ky është pyrgu i Vavellit, po rishtazi [tani] kanë gjeturë shkronja mb' atë, që provonetë se është pyrgu i Nebosë ndë Vorsippë. Ky pyrg u ndërtua për-së-ri prei Navuhodhonosorit, i cili thotë se herën' e parë mbeti pa ndërtuarë për punë të gjuhëravet që u përziënë.

Vavyllona ka 1400 viet ngjer tani që ka mbetur' e shkretë pa farë njeriu, pa farë drurësh, pa farë bari të ngjomë, po veç kukuvejash [hurrëvejkash] e egrësirash pylli që gjenden' aty-drejti, edhe më të shumënë piesën' e qytetit e ka mbytur' ujët' e lumit, e mbuluarë ledhi e zalli. Edhe tani ka 2400 viet që duallë të vërteta fjalët' e profitëvet që folnë me anë të frymësë Perëndisë, i cili urdhëron qiellin' e dhen' e detnë, edhe bën gjyq të dreitë mbi të mirët e mbi të këqijt.

71. Dhaniili. 537 P.K.

Sikundrë Navuhodhonosori pat nderuarë Dhaniilinë kur ishte i ri, kështu edhe Valltasari e pat hipurë mbë shkallë të lartë, po Dhariu Midhiani, e ngriti fort lart atë, edhe e bëri të parë mbi të tretën' e mbëretërisë. Përandai gjithë krerët' e mbëretërisë e kishinë cmir Dhaniilinë, edhe mendoneshinë t'e rrëzoninë nga shkalla, po s'munt t'i gjeninë ndonjë faj, përveç sepse i besonte ligjësë Perëndisë ti. Atëhere arëmiqt' e ati i mbushnë mendjenë mbëretit të bënëjë urdhërë, se kush t'i lutetë ndonjë perëndie, a ndonjë njeriu, përveç mbëretit, do të hidhetë ndë gropët të leonëve. Dhaniili nukë ndigjoi urdhërin' e mbëretit, po i lutej Perëndisë ti tri herë ndë ditët, me fletët' e dyervet hapurë prei anësë Ierusalimësë, sikundrë e kish zakon kurdo-herë. Arëmiqt' e ati kur e gjetnë atë tuke falur' e tuke luturë përpara Perëndisë ti, vanë e i dhanë zë mbëretit.

Mbëreti donte ta shpëtonjë Dhaniilinë, po passi kishte bërë një të tillë urdhërë, edhe s'munt të dilte nga fjala, urdhëroi ta hedhënë ndë gropët të leonëve, edhe i tha: "Perëndia yt që lut ti pa pushim, ay do të shpëtonjë ty." Pastai mbëreti mbylli derën' e gropësë, edhe i vuri shenjë me unazën' e ti, po as nukë hëngri, as nukë piu, as nukë fjeti gjithë natënë. Edhe nesëret u ngrit fort shpejt, e vate me vrap ndë gropët të leonëve, edhe thërriti e tha: "O Dhaniili, shërbëtori i Perëndisë gjallë, a të shpëtoi dot prei (gojësë) leonëve ay Perëndia që i lute ti pa pushim?" Dhaniili u përgjeq: T'u ngjattë jeta, o mbëret! "Perëndia im dërgoi ëngjëllin e ti, edhe u mbëçeli gojënë leonëve, edhe nukë më bën' as ndonjë dam." Atëhere mbëreti u gëzua fort, edhe urdhëroi ta nxirrënë Dhaniilinë nga gropa,

edhe të hedhënë ndë gropët ata njerës që kallëzuanë për atë, të cilëtë, posa i hojnë, i copëtuan' e i hëngrë leonëtë.

Atëhere Dhariu bëri këtë urdhërë: “Ndëpër gjithë dhen' e mbëretërisë s'ime le të kenë frikë njerëzitë, e le të dridhenë përpara Perëndisë Dhaniilit, sepse ay (është një) Perëndi që rron edhe mbetëtë për gjithë jetënë, edhe mbëretëria e ati s'do të prisetë, edhe pushteti i ati (do të jetë) ngjer së pastaimi; ay është dëlirës edhe shpëtimtar, edhe ay bën shenje e çudi ndë qiell e mbi dhet, ay shpëtoi Dhaniilinë prei fuqisë leonëve.” (Dhaniili 6.. 10-28.)

72. Mbëretëresha Esthirë. 521-495 P.K.

Assuiri, mbëreti i Persisë, që të gjithë besonjë se ay ka qenë Kserksi që shkeli Greqinë, bëri një gosti të madhe, edhe ftoi gjithë njerëzit' e mëdhenj e krerët' e mbëretërisë ndë Susanë. Aty ku po hanin' e po pininë, mbëreti urdhëroi të dalë përpara mbëretëresha Astinë, që të shohënë bukurin' e asai gjith' ata që ishinë ndenjurë ndë mësallë, po mbëretëresha nukë ndigjoi të dalë përpara, edhe ay e lëshoi mbëretëreshënë. Atëhere prunë gjithë vashëzat' e bukura, për të sgjedhurë më të mirënë për mbëretëshë, edhe mbëretit i pëlqeu Esthira, një Iudheonjë e vobekëtë, po fort e bukurë, e cila rrinte ndë Susanë bashkë me Marodhohanë t'ungjinë. Po mbëreti nuk' e dinte se ajo ishte Iudheonjë.

Marodhohai i ungi asai shkante shpejt ndë derët të pallatit, e pyeste për të mbesënë; edhe një ditë ay ndigjoi dy shërbëtorë që po bëninë fjalë për të vrarë mbretënë. Marodhohai dha zë për këtë, edhe shpëtoi jetën' e mbëretit, edhe mbëreti vrau ata të dy vetë, edhe e shënoi këtë ndë punërat të mbëretërisë.

Nd' atë kohë Aman Agagiti, prei kombit Amalikut, kishte nder të math përpara mbëretit, edhe kur hynte ay ndë pallat, të gjith' i ulinë kryetë, për veç Marodhohait, i cili as kryetë nuk' i ulte, as nuk' e nderonte. Përandai Amani një madhështuar, kërkonte si të prishnjë Marodhohanë bashkë me gjithë kombin' e Iudhenjet. Për këtë punë Amani vate e i mbushi mendëjenë mbëretit të bënë urdhërë të vritenë gjithë Iudhenjtë ndëpër mbëretërit, sepse ata kishinë tiatërë besë, e tiatërë ligjë, e të tierë zakone, edhe ndaninë nga gjëndëjet' e tiera; edhe iu zotua mbëretit t'i apë dhietë mijë tallanda. Edhe mbëreti pa menduarë fare, bëri urdhërë pas fjalës' ati të vritenë gjithë Iudhenjtë ku-do t'ishinë ndëpër gjith' anët e mbëretërisë, edhe i dha unazën' e ti Amanit për të shënuarë kartën' e urdhërit që kishte shkruarë. Kartat' u shkruanë mbë gjithë gjuhërat e mbëretërisë, edhe u dërguanë ndëpër gjith' anët e mbëretërisë.

Kur doli ky urdhërë ndë Susanë, Marodhohai shpejt i dërgoi fjalë mbëretëshës' Esthirë, se ç' ishte për të bërë, edhe e nguste atë t'i lutetë mbëretit të këthenjë prapë këtë urdhërë, sepse nukë do të vrisinë vetëmë gjithë gjëndëjen' e Iudhenjet, po edhe atë, ndonëse ishte mbëretëshë.

Esthira urdhëroi gjithë Iudhenjtë që ishinë ndë Susanë të agjëronjë' e të falenë tri ditt e tri net bashkë me atë, që t'i shpëtonte Perëndia prei fatit keq që po i priste. Esthira veshi rrobat' e mbëretërisë, edhe hyri brenda atie ku po rrinte mbëreti ndërmest të mëdhenjet e ndërmest të ruajtësëvet, ndonëse asnjeri s'munt të hynte atie ku rrinte mbëreti, sepse ishte urdhërë të vritetë, përveç kur ndente shkopr' e artë mbëreti, e thërriste njeri. Edhe mbëreti kur pa mbëretëshënë tuke ndenjurë ndë hoborr, ndejti shkopr' e artë, edhe e thërriti, edhe ajo u afrua, edhe poqi me dorë majën' e shkoprë.

Mbëreti e pyeti atë, ç'dëshëronte? Edhe Esthira iu lut të vinte ay edhe Amani ndë gosti që kishte bërë gati për ata. Ata vanë ndë gosti, edhe mbëreti për-së-ri pyeti Esthirënë, ç'dëshëronte, po mbëretëshsha për-së-ri iu lut ati edhe Amanit, të vininë nesëret mbë të ngrënë ndë pallat t'asai, edhe atëhere ajo do t'i thoshte se ç'dëshëronte.

Atë ditë Amani mbahej mbë të math, se vetëm' ay u thërrit ndë gosti bashkë me mbëretin' e me mbëretëshshënë, po kur dolli prei derësë pallatit, pa Marodhohanë se nuk' i uli kryetë, edhe Amani kaqë fort u zemërua, sa e vuri ndër mënt t'i lutetë mbëretit nesëret të vrasë Marodhohanë.

Atë natë nuk' i erdhi gjumë mbëretit, edhe për të shkuarë kohënë, urdhëroi të këndonë përpara ati gjithë punërat që ishinë bërë ndë mbëretërit t'ati. Edhe tuke kënduarë gjetnë shkruarë, se Marodhohaindigjoi ata dy shërbëtorëtë që do të vrisinë mbëretinë, edhe i shpëtoi jetënë mbëretit. Atëhere mbëreti pyeti: Ç'e mirë i është bërë Marodhohait për këtë? Edhe ata u përgjegjnë: Asgjë. Atëhere mbëreti pyeti: Vallë është njeri këtu? Amani u ndoth aty, sepse kish ardhurë t'i lutetë mbëretit, të vritej Marodhohai. Atëhere mbëreti tha: Le të vinjë këtu Amani. Ay erdhi, edhe mbëreti e pyeti – Ç' duhetë t'i bëjmë ati njeriu që i pëlqen mbëretit ta nderonjë? Amani kujtoi, se mbëreti po thoshte për vetëhen' e ati, edhe ay tha – “Le të bijenë stolin' e mbëretërisë që vesh mbëreti, edhe le të hipënjë nd' atë kalë që hipën mbëreti, edhe le t'i vënë mbë kryet t'ati kurorën' e mbëretit, – edhe le ta bijen' atë ndëpër udhët të qytetit, (edhe) le të leçitnjë një përpara ati, Kështu i bënet' ati njeriu që i pëlqen mbëretit ta nderonjë.” Atëhere mbëreti i thot' Amanit: Ec e bënia kështu Marodhohait, edhe mos mbesë asgjë pa-bërë nga ato që the. Edhe Amani bëri sikundrë u urdhërua, pastai Marodhohai u këthye ndë derët të mbëretit me gëzim, po Amani vate ndë shtëpi të ti me hidhërim.

Posa mbaroi këtë punë Amani, erdhi një njeri t'e thërrësë ndë gosti të mbëretëshshësë. Tuke ngrënë ndë truvezët, për-së-ri pyeti mbëreti: – Ç'kërkon prei meje, o mbëretëshshë Esthirë? Sepse do të ta fal, ngjer ndë gjymësët të mbëretërisë. Edhe Esthira tha: “Ndë paça gjeturë hir përpara teje, o mbëret, edhe ndë i pëlqeftë mbëretit, le të më faletë jeta për këtë që kërkonj unë, edhe jeta e gjëndëjesë s'ime për këtë që kërkonj unë, sepse u shitëm un' edhe gjëndëja ime për humbie, e për të therë e për të vierrë, edhe të ishim shiturë si shërbëtorë e si shërbëtore, do të kishnjem pushuarë, ndonëse arëmiku nukë munt të lajë damn' e mbëretit.” Atëhere mbëreti tha: Cili është' ay që kucoi të bënë këtë? Edhe mbëretëshsha tha: Ky arëmiku edhe njeriu i keq Amani. Edhe mbëreti u ngrit e dolli jashtë me zemërim të math kundrë Amanit, edhe urdhëroi të vrasënë Amanë nd' atë dru që kish bërë gati ay për Marodhohanë. Atëhere mbëreti shkroi kartëra ndëpër gjith' anët e mbëretërisë ti, edhe i shënoi me unazën' e ti, që të mos verë dorë njeri t'u bënë keq Iudhenjet, po të vritenë gjith' arëmiqt' e atyreve. Kështu Iudhenjtë bënë gëzim të math atë ditë, edhe vranë gjith' arëmiqt' e tyre, edhe të dhietë të bijt' e Amanit.

Mbë këtë mëndyrë Iudhenjtë shpëtuanë jetën' e tyre atëhere, edhe ngjer sot mbë këtë kohë kremtëronjënë përënë-vere, e i dërgonjënë dhurëti njëri jatërit, edhe e kanë për një ditë gëzimi. Kështu Perëndia pat kujdes për llaun' e ti, e i ruajtë edhe nd' atë kohë kur i pat për-ndarë ndëpër gjëntarët për fajet e atyre. Këtu është shkruarë figureja e një ndërtesë, që e ka emërinë ngjer mbë sot, Varri i Esthirës' e i Marodhohait.

Shtatë-dhietë viet passi u prish Ierusalima, Qyrua Persiani u bë mbëret i Assyrisë, e i Midhisë, e i Vavyllonësë. Të parin' vitin' e mbëretërisë ti, bëri urdhërë mbë gjithë Israilitët që rrininë ndë mbëretërit t'ati, të këthenenë ndë dhethit të tyre, e të ndërtonjënë për-së-ri qytetnë edhe tempullinë. Kështu bënte urdhërë mbëreti: “Zoti Perëndia i qiellit më urdhëroi t'i ndërtonj ati shtëpi ndë Ierusalimë, që është ndë Iudhet; cili (është) prei jush ndër gjithë llaun' e ati? Perëndia i ati qoftë bashkë me atë, edhe le të hipënjë ndë Ierusalimë, që (është) ndë Iudhet, edhe le t'i ndërtonjë shtëpinë Zotit Perëndisë Israilit.” (Esdhra 1.. 1-3.) Edhe u dha prapë Israilitëvet pesë mijë e katërë qint enë t'arta, që i patnë prurë ndë tempullë të Vavyllonësë.

Gjith' ata që s'patnë harruarë Ierusalimënë, tashti zunë të bënë udhë për dhethin' e tyre. Po një pies' e madhe nga Iudhenjtë kishinë zënë vënt ndë Assyri e ndë Vavyllonë, edhe shumë prei atyre ishinë bërë të pasurë. Edhe gjith' ata që u këthyenë ndë Ierusalimë, ishinë dyzet e dy mijë shpirtë, përveç grarërisë e çilimivet, edhe këtyre u hiqin' udhënë krye-prifti Iisui i biri Iosedhekut, edhe Zorovavelli, që ishte prei rrënjësë Dhavidhit. Atëhere u këndua këjo psallm' e bukurë: (Psallmë 126.)

Zoti kur ktheu prapë skleft' e Sionësë, ishëm si ndëpër ëndërrë.

Atëhere u mbush me gas goja jonë, edhe gjuha jonë me gëzim,

Atëhere thoshnë ndër kombet: Zoti bëri punë të mëdha për ata.

Zoti bëri punë të mëdha për ne: u gëzuam.

Kthe, o Zot, skleftë t'anë, posi përrenjtë ndë anët të mies-ditësë.

Ata që mbiellënë me lot, do të korrnjënë me gëzim.

Ata që venë edhe qjanjënë, tuke mbarturë farë të shtrenjtë,

Këta do të këthenenë me gëzim, tuke mbarturë duarzat' e tyre.

E para punë e atyre ishte të ngrihinë një therore për Perëndinë, edhe të vininë themeli për shtëpin' e Zotit. Priftërit' u ranë trumbetavet për të lavduarë Zotnë, edhe gjithë gjëndëja bërtiti me zë të math, tuke lavdëruarë Zonë, sepse vunë themeli për të ndërtuarë për-së-ri shtëpin' e Zotit. Po shumë nga pleqt' e vietërë, që mbaninë mënt tempullin' e parë, qjanë me vajë të madhe, kur panë se po ndërtoninë këtë tempullë të vogëlë, kaqë sa nukë ndahej zëri të rinjet që bërtisinë nga gëzimi, prei zërit pleqëvet që bërtisinë tuke qjarë.

Ndër gjith' ato të vështira që kishinë për punënë, profitëritë Aggai edhe Zaharia u epinë zemërë e i ngusinë mbë punët. Aggai më fort i ngushllonte ata, e u thoshte, se ndonëse ky tempullë nuk' është gjith' aqë i math e i bukurë, po do të jetë më i lavduarë e më i math se i pari me gjith' atë ndriçim që ka paturë, sepse ndë këtë tempullë të dytë ka për të ardhurë Messia, “Dëshërimi i gjithë kombevet,” edhe do t'e mbushnjë me lavdin' e faqesë ti. Këjo profiti doli e vërtetë, kur erdhi Iisu-Krishti, edhe lëgjiroi brenda nd' atë tempullë të dytë. Këjo punë koditi ndë kohë të Dhariut e të Artakserksit që zunë këmbën' e Qyrosë.

Dhariu dërgoi ndë Ierusalimë Esdhrë shkronjësinë; ay mori me vetëhe nga Vavyllona gjith' ato enët' e tempullit që kishinë mbeturë, edhe ay vuri mbë vënt për-së-ri ndë Ierusalimë lutëjen' e Perëndisë, e priftërinë, e nomnë, që kishinë pasurë përintë të parët' e atyre. Pas kësai Artakserksi dërgoi Neeminë ndë Ierusalimë, i cili ishte verë-qitësi edhe shërbëtori i ati, për të ndërtuarë për-së-ri muret' e qytetit që ishinë rrëzuarë, sepse ata ndonëse kishinë ndërtuarë tempullinë edhe shumë shtëpi, po qyteti nuk' ish qarkuarë me mure. Samaritasitë doninë të punoninë bashkë me ata e t'u ndihinë atyre mbë punët, po Iudhenjtë nukë doninë. Atëhere ata luftoninë të ndalinë të ndërtuarët' e tempullit, edhe

shpifinë fjalë të këqia për ata, edhe shumë herë u përgjajnë me ata, andaj sa kohë ngjati të ndëtuarët' e tempullit, punëtorëtë punoninë me armë ndë dorë, edhe të tierë rrinin' e ruanin' arëmiqtë që të mos u vininë përsipërë.

Nd' atë kohë Neemia ishte qyvernitar ndë Ierusalimë, i cili nukë merrte as ndonjë pagë nga ata, po ushqente me bukë edhe një qint e pesë-dhietë vetë ndë shtëpi të ti. Ay u ndihnte me bukë e me gjellë gjith' atyre që kishinë nevojë, edhe nukë kursenej për farë gjëje: shërbëtorët' e ati punoninë bashkë me gjëndëjenë tuke ndërtuarë muret' e Ierusalimësë. Ay bëri krerët' e gjëndëjesë e të pasurit' e gjëndëjesë të këthenjënë prapë kafshat' e të vobekëvet që i mbaninë penk për detyrat që u kishinë atyre, edhe t'u falinë detyrat' atyre, e të mos ua kërkoninë më.

Të këtillë njerës të mirë ishinë Esdhra edhe Neemia, të cilët' u përpoqnë fort për gjëndëjen' e Israilit që t'i ngulin' e t'i themelosinë ndë dhethit të tyre. Po për të vërtetinë themeltar Zoti pat thënë me anë të profitit Mallahisë: “Na unë te po dërgonj ëngjëllinë t'im, edhe do të bënë gati udhënë përpara meje; edhe Zoti, që kërkoni ju, do të vinjë pa priturë ndë tempullë të ti, po, ëngjëlli i dhiatësë, që do të viri ju na te po vien, thotë Zoti i fuqivet.” (Mallahia 3.. 1.)

74. Që prei Dhiatësë Vietërë ngjer mbë kohë të Krishtit.

Pas profitisë Dhaniilit, lypseshinë të shkoninë katërë qint e tetë-dhiet' e tre viet pasi u ndërtua tempulli për së dyti, që të vinte Krishti. Ndërmest të kësak koheje Iudhenjtë panë ditt të bardha edhe ditt të zeza.

Aleksandri math, mbëreti i Maqedhonisë, pasi pushtoi Persinë, erdhi me ushtërin' e ti ndë Iudhet; krye-ushtëtorët' e ati kujtuanë se do të prishte Iudhenë, po ay u bëri nder të math profitërvet Perëndisë vërtetë, edhe mori me të mirë gjëndëjen' e Israilit. Pas vdekëjes' ati, Ptolemeu, mbëreti i Egjyptit, pushtoi dhen' e Iudhesë, edhe shkuli prei andyj shumë Iudhenj, e i pru ndë Egjypt. Pas vdekëjes' ati hipi ndë shkamt i biri, i cili u bëri shumë të mira Iudhenjet, edhe ky këtheu Shkronjën' e Shënjtëruarë ndë gjuhë Gërqishte.

Më tepërë se një qint viet Iudhenjt ishinë ndënë mbëretërit të Egjyptit, pastai ranë ndën' urdhërë të Antiohut, mbëretit Syrisë. Ky i mudoi fort Iudhenjtë, e i bëri idhullatrë, po shumë nga ata sgjohinë vdekëjenë, se të mohoninë besën' e vërtetë.

Ndë këtë kohë duallnë Makkaveitë, ca trima të fortë, edhe shpëtuënë vëndinë prei urdhërit huaj. Me gjithë këto gjëndëja s'munt të qëndronte vetëmë, përandai kërkuanë ndihmë nga Romanëtë, të cilëtë shkelnë dhen' e Iudhesë, edhe vunë një qyvernitar mbi atë vënt. Riga Irodh, një Edhomit, urdhëronte vëndinë mb' emërit të Romanëvet. Ky ish një njeri i mençim, po i vrazhët' e i ashpërë. Ata që hanin' e pininë bashkë me Irodhinë, i thoshinë me rrena se vuri mbë vënt për-së-ri shkëmbin' e Dhavidhit, po Israilitët' e vërtetë i kishinë mëri, edhe piklloneshinë, sepse ishinë ndënë një urdhërë të huaj, edhe sepse i kish dalurë prei dorësë shkopi Iudhesë. Me gjithë këto, ata panë shenjënë, se ish afuarë koha e të ardhurit Messisë, që pat profitëpsurë Iakovi, i pari përint i atyre, se ay do të mbëlithte llausnë bashkë.

Pas Mallahisë, nuk' erdhi më tiatërë profit t'u apë atyre ngushullim nga an' e Perëndisë, përandai ata dëshëroninë më fort se tiatërë herë për Messinë – të Bir e Dhavidhit – të Lyerin' e Zotit, – për të vënë ndë vënt për-së-ri shkëmbin' e Dhavidhit, edhe (sikundrë shpëreninë) për të dëbuarë Romanëtë prei vëndit atyre. Sa-do-mos

Iudhenjtë nuk' e dininë mirë punën' e Messisë, ata kujtoninë se kish për të ardhurë një njeri i math të dëbonjë të huajtë prej vëndit atyre, e të ngrehnjë shkëmbin' e Dhavidhit ndë Ierusalimë, e të mbëretëronjë këtu ndë dhet; edhe të pakë ishin' ata që po prisinë për "Ngushullimn' e Israilit" me mënt të dëlirë e me zemërë të këthiellëtë. Po edhe passi erdhi Messia, ata nukë muntne t' e merrinë vesh fjalënë që tha ay, se "Mbëretëria ime nuk' është nga këjo botë." (Ioanni 18.. 36.)

75. Gjëndëja e Israilit.

Tashti që mbaruam istorin' e Dhiatësë Vietërë, le të flasëmë edhe për gjëndëjen' e Israilit, që zihetë n' gojë ndëpër gjithë këtë vivli.

Na pam posa fëjeu njeriu i parë, qysh u zotua Perëndia se "fara e gruasë" do të muntnjë Satanë, edhe se do të verë njerinë mbë këmbë të parë për-së-ri. Njerëzitë duhej të kishinë dashurë fort Perëndinë, e t'i kishinë shërbyerë me gjithë zemërë për këta të zotuarë, po kaqë e madhe ishte e keqeja e atyre njerëzet parë, sa Perëndia i farosi me përmytëjenë. Po edhe pas përmytëjesë për-së-ri e keqeja doli për faqe, edhe idhullatria hyri ndër njerëzit, atëhere Perëndia që të ndalte për-së-ri të keqenë, më përpara përzieu gjithënjë e botësë, edhe ndau njerëzitë mbë kombe e mbë gjëndëje e mbë fara, pastai sgjodhi një njeri të mirë e me besë, që t'i dëftente se ç'kish për të bërë, edhe prej farës' ati do të dilte ay që kish për të mundurë Satanë, edhe të vinte njerinë mbë këmbë të parë për-së-ri sikundrë qe zotuarë. Edhe ndonëse Perëndia la kombetë të ecëninë pas udhës' atyre për ca kohë, po ay kish për të mbëledhurë të gjithë së pastaimi, sikundrë merretë vesh prej fjalëvet që pat thënë, "edhe ndë farët tëndë do të bekonenë gjithë kombet' e dheut." (Të Linduritë 12.. 1-3, edhe 22.. 16-18.)

Atë njeri që sgjodhi ishte Avraami, edhe farënë që sgjodhi ishte Isaaku e Iakovi, edhe ay komb' i math që doli prej ati, ndarë dy-mbë-dhietë farash, veç farësë Leviut që ishinë priftëritë. Perëndia iu zotua kësai gjëndëje t'i apë dhen' e Hanaanit, edhe t'i shtonjë posi yjet' e qiellit, e posi rërën' e detit. Ay qe zotuarë se do të ngrinte Shpërblimtarinë ndërmest t' atyre edhe do të bekonte ata, edhe gjith' ata që t' e donin' e të lusinë Perëndinë' e atyre, edhe do t'i ngjilte për gjëndëjen' e ti.

Për të bërë gati udhën' e të ardhurit Shpëtimtarit, Perëndia lidhi fjalë me gjëndëjen' e Israilit ndë mal të Sinait, edhe u dha atyre të Dhietë Urdhërimetë, edhe shumë të tiera porosi, edhe vuri priftërë, edhe ngrehu shënjtëroren' e kurbanet' e të kremtet' e të tiera punëra lutëje, që t'i ndante ata nga kombet' e tierë, që të ruaninë të këthiellëtë besën' e një të vërteti edhe të gjalli Perëndi. Edhe ay u zotua atyre, se ndë ruajçinë nomn' e ati, edhe ndë dashin' atë, edhe ndë i shërbefshinë vetëm' ati, do t'u epte gjithë të miratë ndë dhet të Hanaanit, po ndë ngricinë krye kundrë ati, do të sillte ndë dhet t' atyre sëmundëje e zi buke, e murtajë, edhe do të sillte arëmiq t'u bënë keq atyre; po edhe ndë mos urtësoneshinë ndo pak, do t'i përndante ata ndëpër botët, e do të prishte e do të shkretonte vëndin' e atyre, edhe do të rrëzonte qytetet' e atyre, edhe do t' e bënte dhen' e atyre të thatë posi hekurë. (Levitiku 26, edhe Ligj' e dytë 28.)

Përandai i bëri të gjitha ato që u tha atyre. Ay u dha atyre dhen' e Hanaanit, i shumoi e i rriti e i bëri një komp të math, u fali gjithë të miratë, e ua bëri mbarë gjithë punëtë; edhe posi një at' i mençim, i mundonte sa herë ngrinë krye. Edhe dërgoi shumë profitërë kohë mbë kohë që t'i qërtonte për fajet, e t'i këthente mb' udhë të dreitë, e t'i binte ndë pendim; po kur nukë ndigjoninë, atëhere i lente të bënëshinë rop ndë Assyri e ndë

Vavyllonë. Edhe passi u penduanë, e kërkuanë faqen' e Zotit, ay i pru për-së-ri ndë dhe të Hanaanit, e u ngrehu qytetetë për-së-ri, e tempullin' e lutëjesë, edhe i shpëtoi prei shumë arëmiqsh; edhe passi u mbush koha, Perëndia dërgoi Zotnë Iisu-Krisht, i cili lindi ndë Vithleemë të Iudhesë prei farësë Dhavidhit, nd' atë vit që pat profitepsurë Dhaniili për atë (Dhaniili 9.. 24-27). Po Israilitëtë, sikundrë e dimë prei Dhiatësë Re, nuk' i besuanë Messisë, po e zun' edhe e vranë, sikundrë ua patnë bër' edhe profitevet; edhe kështu Perëndia më ndë funt dërgoi Romanëtë, shtatë-dhietë viet pas Krishtit, ndë kohë të Titosë, të cilëtë rrëzuanë Ierusalimënë, edhe muarrë rop njerëzitë. Që atëhere e ngjer mbë sot gjëndëja e Israilit është përndarë mbë të katër anët e dheut ndërmest të gjithë kombevet, edhe shahen' e shtyhen' e mundonenë prei gjithë kuit, edhe vështronenë si një gjëndëje e huaj ndarë veç prei gjithë njerëzish, po me gjithë këto, "ata janë të dashurë për punë të atërvet." (Romanët 11.. 28.)

Dhiata e Vietërë është plot me profiti për punë të Israilit, edhe ngjer mbë këtë ditë Iudhenjtë janë deshmitarët' e Perëndisë mbë gjithë kombet për nomn' e Zotit që kanë ndë dorë, sepse prei istoris' atyre provonet' e dreita, edhe dalënë të vërteta profititë që ka folurë Moisiu 3319 viet përpara.

Iudhenjtë janë përndarë ndëpër gjithë dherat, edhe gjithë-ku-do i kanë mëri e i marrënë me të keq, po të Krështerët' e vërtetë gjan t'i marrënë me të mirë e t'i duanë, sepse prei atyre kanë lindurë profitët' e apostojt' e Zotit Krisht. Na duhetë t'i lutemi Zotit, t'u shtierë Iudhenjet mendëjen' e mirë të këthenen' e t'i besonjë në Messisë që erdhi ndë botët për ata edhe për gjithë kombet, sepse është shkruarë: "Të bijt' e Israilit do të mbesënë shumë ditt pa mbëret, e pa të parë, e pa kurbane, e pa figure, e pa Efodh, e pa Terafim. Pastai do të këthenenë të bijt' e Israilit, edhe do të kërkonjë Zotnë Perëndin' e tyre, edhe Dhavidhinë mbëretin' e tyre; edhe do të druanjë Zotnë edhe të mirën' e ati ndë ditt të pastaimë." (Osia 3.. 4, 5.) Edhe apostoli Pavllë na mëson kështu – "Edhe të rrëzuarët' e atyre ndë (qoftë) pasëje bote, edhe të shterët e atyre pasëje kombesh, sa më tepërë (do të jetë) të mbushurit' e atyre?" Edhe për-së-ri thotë – Sepse të hedhuritë tej e atyre (është) të paqtuarët' e botësë, ç' do të jetë të priturit' (e atyre), veçe se jetë së vdekurish?" (Romanët 11.. 12-15.) Për gjithë këto fjalë që janë shkruarë, kush t'i ketë besuarë Krishtit, le të mos pushonjë tuke luturë kështu – "Daltë shpëtimi i Israilit nga Siona!" (Psallmë 14.. 7.), sepse kur të këthenenë të gjithë Israilitëtë, atëhere do të mbushetë me gëzim bota e tërë.

76. Vivlla, a Shkronja e Shënjtëruarë.

Pas gjith' atyre të pa-numëruaravet dhurëti të dashurit Birit ti, më e pa-çimuara gjë, që u ka dhënë Perëndia njerëzet, është Shkronja e Shënjtëruarë – fjal' e ti që është shkruarë. Edhe posi Zoti ynë Iisu-Krishti lindi nga gjëndëja e Israilit, kështu edhe Vivlla u shkrua prei njerëzish shënjtëruarë nga shtëpia e Israilit, të cilëtë folnë sikundrë qenë mësuarë prei Frymësë Shënjtëruarë.

Ndë Shkronjë të Shënjtëruarë janë shkruarë të vërtetatë fjalët' e Perëndisë që nukë ndërronen' as nukë këthenenë, të cilat' ua ka dhënë njerëzet që të gjenjen' udhën' e dreitë e të kenë ndëjesë e paqtim ndë dhet, edhe të trashigonjë në gëzimn' e pa-sosurë ndë qiell me anë të Iisu-Krishtit. Me këto fjalë që janë shkruarë ndë Shkronjë të Shënjtëruarë Fryma e Shënjtëruarë i ndricon mendëjenë njeriut, e i qëron zemërënë, e i përtërin shpirtinë, edhe i dëften udhën' e dreitë besëtarit, përandai Perëndia ka urdhëruarë

Israilitëtë kështu: – “Edhe këto fjalë që po të thom unë sot, t’i ruajsh ndë zemërët tënde, edhe t’ua mësojsh me kujdes djemvet tu, edhe për këto të flaç kur të rrish ndë shtëpit tënde, e kur të ecënish mb’ udhë, e kur të bijesh (të flesh), e kur të ngrihesh (nga gjumi).” (Ligj’ e dytë 6.. 6, 7.) Kështu thotë edhe Dhavidhi: – “Nomi i Zotit (është’) i këthiellëtë.” (Psallmë 19.. 7-11.) Edhe e tërë psallma e një qint e nëntë-mbë-dhiettë dëften sa të vëjyera janë fjalët’ e Zotit. Edhe gjithë monë mbëretërit’ e mirë, posi Iosafati e Ezeqia e Iosia, kur kanë dashurë të mësoninë gjëndëjenë ndë frikë të Perëndisë e ndë punë të mira, u epinë ndë dorë Shkronjën’ e Shënjtëruarë t’ e këndoninë.

Tashti le të flasëmë pak fjalë për këtë vivli të çudiçime.

Ndonëse Vivlla është një vivli e tërë, po nd’ atë janë mbëledhurë shumë vivlia, shkruarë prei shumë vetësh. Ndë Dhiatët të Vietërë janë mbëledhurë tri-dhiet’ e nëntë vivlia, shkruarë prei njëzet e katërë vetësh, që u dim’ emëratë, edhe munt të kenë qenur’ edhe të tierë vetë që kanë shkruarë, të cilëvet emëratë nukë zihenë n’gojë. Vivlla nuk është shkruarë mbë një kohë, po për shumë viet, e për shumë kohëra e mote: Vivlia e të Lindurit është shkruarë prei Moisiut 1491 viet para Krishtit, po Mallahia, i pastaimi profit, shkroi 397 viet para Krishtit, do me thënë, 1094 pas Moisiut. Ata njerës që kanë shkruarë Vivllënë ndaninë njëri prei tiatërit nga puna e nga mendëja e nga shkalla: njëri ishte bari, e tiatërë i diçim, e tiatërë ishte luftëtar, dy të tierë ishinë gjykatësë, e dy të tierë ishinë mbëretërë, e dy të tierë ishinë priftërë, e shumë të tierë ishinë njerës të poshtërë. Këta njerës prei kaqë duarsh, edhe vdekurë kaqë viet njëri pas tiatërit, shkruanë një vivli që nukë ndan as mbë mendëjet, as mbë fjalët, as mbë punërat, të cilëtë lavdoninë një Perëndi të vetëmë, edhe profitepsinë për një Shpëtimtar të math që kish për të ardhurë; edhe gjithë fjalët’ e atyre duallnë të vërteta, kur erdhi Messia ndë botët. Këtu merretë vesh fort mirë, se ata s’kanë qenë mësuarë prei mendëjesë njeriut, po shkruan’ edhe folnë për ato punëra që ua sbuloi Perëndia me anë të Frymësë Shënjtëruarë. Vivlla është më e vietërë se gjithë vivliat’ e botësë, nd’ atë gjëndenë shkruarë gjith’ ato që janë të nevojëshime të dijë njeriu; gjithë ç’tregon këjo vivli, janë të vërteta e të dreita pa rrena e pa gënjeshtër.

Vivliat’ e Vivllësë munt të ndahenë dy pjesash të mëdha – njëra pjesë është histori, e tiatra pjesë kënkëri.

A. Vivliat’ e istorisë – janë të pesë vivliat’ e Moisiut, që thuhënë Ligja (Nomi) a Pentatefku, pastai Iisui i Naviut, e Gjykatësetë e Rutha, e dy të Samuilin, e dy të Mbëretëravet, e dy të Kohëravet, e Esdhra, e Esthira, e Neemia.

B. Vivliat’ e kënkërisë – munt të ndahenë për-së-ri tri pjesash.

1. Vivliat’ e kënkavet – janë më të shumatë Psallmëtë, e Kënka e Kënkavet, edhe të Qjarat’ e Ieremisë.

2. Vivliat’ e mësimin – janë Iovi, e Lëgjiratat’ e Sollomonit, e Klisari. Nukë dihetë se kush e ka shkruarë vivlin’ e Iovit: munt ta ketë shkruarë Moisiu. Shumë njerës të diçim besonjëne, se këjo vivli është më e vietërë se gjithë Vivlla.

3. Vivliat’ e profitisë – janë Isaia, e Ieremia, e Ezeqiili, e Dhaniili, e Osia, e Ioilli, e Amosi, e Avdhiu, e Ionai, e Mihaia, e Naumi, e Avvakumi, e Sofonia, e Aggaiu, e Zaharia, e Mallahia.

Kështu munt të ndahetë Vivlla, po edhe ndë vivliat të istorisë gjëndenë mjaft profiti, edhe ndë vivliat të profitivet gjëndetë mjaft histori, edhe ndër gjithë këto vivlia gjëndetë mjaft profiti.

Tashti gjithë bota i ka detyrë këti kombit Evrevet, sepse ka ruajturë fjalën' e Perëndisë të shkruarë ndë kartët. Gjithë vivliat' e Dhiatësë Vietërë janë shkruarë ndë gjuhë Evraishte, përveç ca krerëve të Dhaniilit e të Esdhrësë që janë shkruarë Halldheisht ndë gjuhë të Vavyllonaset. Evrejtë pasi u këthyenë prei ropërisë Vavyllonësë, kishinë harruarë gjuhën' e tyre, e flisinë Halldheisht; për këtë punë Evrejtë patnë shkruarë Halldheisht, nd' atë gjuhë që fliste gjëndëja atëhere. Pastai Aleksandhri, mbëreti i Maqedhonisë, kur pushtoi anët' e të lindurit diellit, përndau Gërquishtenë ndëpër ata vënde, përndaj Evrejt' e diçim këthyenë këto vivlia ndë gjuhë Gërquishte. Shtatëdhiet' e dy vetë të diçim kanë këthyerë Shkronjën' e Shënjtëruarë ndë gjuhë Gërquishte, përandai thuhetë Të këthyerët' e të Shtatëdhietëve, a sepse u bë me urdhërë të pleqërisë Aleksandhrisë, të cilët'ishinë shtatëdhietë vetë. Të pesë vivliat' e Moisiut edhe Lëgjiratat' e Solomonit u këthyenë ndë kohë të Ptolemeut Sotir, 285 viet para Krishtit, edhe 170 viet para Krishtit u këthyen' edhe gjithë vivliat' e tiera të Dhiatësë Vietërë. Pentatefku edhe Lëgjiratat' e Solomonit janë këthyerë fort mirë, po Psalltiri edhe vivliat' e tiera mbë shumë vënde s'merrenë vesh këthiellëtë. Shumë mirë u bë për botënë që u këthye Shkronj' e Shënjtëruarë ndë tiatërë gjuhë, sepse u çeli sytë njerëzet mbë të katër anët e dheut që të ndigjonjënë zën' e Ungjillit, edhe t'i besonjënë Zotit Krisht, Shpëtimtarit t'ynë. Kështu edhe pastai zunë të këthenjënë Dhiatën' e Vietërë edhe Dhiatën' e Re ndë shumë gjuhëra të tiera, edhe si doli për faqe mieshtëria e shtypashkronjësë, 1440 pas Krishtit, atëhere u mbush bota me vivlia; po që kur se u ngrëh Shoqëria e Vivlësë ndë Engëllterë, 1804 pas Krishtit, Dhiat' e Vietërë edhe Dhiat' e Re është këthyerë ndë 205 gjuhëra të huaja ngjer mbë sot. Dashtë Zoti, që ta këndonjënë Shkronjën' e Shënjtëruarë gjithë bota, këtë dhurëti të pa-çimuarë që ua ka dhënë Perëndia njerëzet për të dëftyerë udhën' e jetësë pa-sosurë!

FUNDI.

P.K.	Mbëretërit e gjith' Israilit	Viet	Profitëritë	P.K.
1096	Saulli	40	Samuilli	1096
1056	Dhavidhi	40	Nathani, Gadhi.	1056
1016	Sollomoni	40		1016

Mbëretëria e Iudhesë			Mbëretëria e Israilit			
	Mbëretëritë	Viet	Profitëritë	Mbëretëritë	Viet	Profitëritë
975	Rovoami	17	Semaia, Idhdhoi	Ierovoami I	22	Ahiai. 975
958	Aviami	3				
955	Asai	41	Azaria, Anania	Nodhavi	2	954
				Voasai	24	Iiui. 953
				Iliei	2	930
				Zimvri	7 dit.	929
				Arriu	12	925
914	Iosafati	25	Iiui, Iaaziilli	Ahaavi	22	Illiu, Mahaia 918
				Ohozia	2	Elisseu 898
822	Iorami	8		Iorami	12	896
885	Ohozia	1				
884	(Gothollia)	6		Iui	28	884
878	Ioasi	40	Zaharia I			
				Ioahazi	17	856
839	Amasia	29		Ioasi	16	Ionai 841
				Ierovoami II	41	Osiea, Amosi 825
810	Ozia	52	Ioilli, Zaharia II			
				Zaharia	1/3	773
				Zallumi	1/12	772
				Menaimi	11	772
				Fakeia	2	761
758	Iothami	16	Isaia, Mihaia	Fekai	20	759
742	Ahazi	16		Osiei	9	730
726	Ezekia	29	Naumi	Ropëira		721
698	Manassiu	55				
643	Amoni	2				
641	Iosia	31	Sofonia, Ieremia			
610	Ioahazi	¼				
610	Ioakimi	11				
607	Ropëria I		Dhavidhi			
599	Ioaheni	¼	Avvakumi			
599	Ropëria II		Ezekiili			
599	Zedhekia	11	Avdiu			
588	Ropëria III					
535	Të ndërtuarët' e Ierusalimësë për-së-ri. Agaiu, Zaharia III, edhe Mallahia, Profitëritë.					

Të rrëzuarët' e Ierusalimësë prei Titosë, 70 viet pas Krishtit.

LEKSIKOGRAFIA

Adhuroj, *adoro*, λατρευω.
adhurim, λατρεία.
akrep-i, σκορπιος.
andai, οθεν, διατουτο.
anë-a, μερος, μελος.
 πληθυντ. anë-të.
anë-a, αγγειον. πληθυντ. enë-të.
ani, επειτα.
ashpërë, *asper*, σκληρος.
atë-i και atë-a, πατηρ.
 πληθυντ. atërë-të, πατερες.
varroj, ενταφιαζω, θαπτω.
vdier, φθειρω. μετοχ. vdierrë.
Vëndi mirë, τοπος ιερος.
 2) το Ιερον του Ναου.
verë-a, θερος. përanë-verë, εαρ.
verë-qitës-i, οινοχοος.
vërshoj ρημ. ουδ. πλημμυρω.
vërshim-i, πλημμυρα.
vërtetoj, βεβαιω.
vërtetonem, βεβαιουμαι.
i vobek-gu, πτωχος.
 πληθ. të vobekë-të.
e vobekëtë-a, πτωχη.
 πληθ. të vobekëta-të.
vobëzi-a, πτωχεια.
vobezonem ρημ. ουδ. πτωχευω.
vrazhëtë, θρασυς.
bari-u, ποιμην.
ber-i, βελος.
besëtar-i, πιστος.
borë-a (dëborë και vdorë), χιων.
brohoroj ρ. ουδ. αλαλαζω.
bukë-riekës-i, αρτοποιος.
burk-gu, δεσμοτηριον, φυλακη.
 πληθ. burgje-të.
gjëndëje-a, *gens, gentis*, γενος,
 φυλον, εθνος, λαος, οχλος.
gjëntar-i, εθνικος.
gjinkallë-a, τεττιξ, Lat. *cicada*,
 Ital. *cicala*.
grop-i, αγκιστριον.
grigjë-a, *grex, gregis*, ποιμνη.
dhanës-i η dhënës-i, δοτηρ.

dhiatë-a, διαθηκη.
Dhiata e Vietërë, η Παλαια Διαθηκη
Dhiata e Re, η Καινη Διαθηκη.
dam-i, βλαβη, ζημια, ιδε dënoj.
dëlir, ελευθερω. 2) καθαριζω.
dëlirem, ελευθερουμαι.
 2) καθαριζομαι.
dëlirës-i, ελευθεροτης.
dënoj, δαμαω, δαμναω, *damno*,
 καταδικαζω.
dënim-i, καταδικη, ιδε dam-i.
dënuarë, καταδικασμενος.
detar-i, ναυτης.
detyrë-a, χρεος.
detuar-ori, χρεωστης.
deshmoj, μαρτυρω.
deshmi-a, μαρτυρια.
deshmim-i, μαρτυριον.
deshmitar-i, μαρτυς.
dëshëroj, *desidero*, επιθυμω.
dëshërim-i, επιθυμια.
dinak-u, πανουργος.
dinakëri-a, πανουργια.
dobi-a, οφελος, κερδος.
dorë-dhënës-i, εγγυητης
 δια τοπραγμα.
dorë-zënës-i, εγγυητης
 δια τοατομον.
dritar-i, φωστηρ.
dru-ja, ξυλον. dru-ri, δενδρον.
ëmë-a, μητηρ. πληθ. ëma-të.
i epër-i, ο ανω. e epër-a, η ανω.
thëllim-i, θυελλα.
therore-ja, θυσιαστηριον.
thesar-i, θησαυρος.
thurake-ja, θωραξ.
Jehova, το ονομα του θεου του
 Ισραηλ.
kant-di, Ital. *canto*, γωνια, ακρα.
keth-dhi, και eth-dhi, εριφιον.
këndit, fjalë turke [kandëm]
 ιδε gënjej.
kënkëri-a, ποιησις, ποιημα.
këshille-ja, *consilium*, συμβουλη.

këshilloj, συμβουλευω.
 këshillës-i, συμβουλος.
 klisar-i, εκκλησιαστης.
 koditi, συνεβη.
 të koditurë, συμβαν.
 komp-bi, εθνος. πληθ. kombe-të.
 kujdes-i, φροντις, επιμελεια.
 kujdestar-i, φροντιστης, επιμελητης,
 οικονομος.
 kundruell, επιρημ. αντικρυ.
 kurban të diegurë, ολοκαυτωμα.
 kurban raqtimi, θυσια ειρηνικη.
 kreth, παθητ. kridhem, καταδυω, βυθίζομαι,
 βουτω εις το νερον.
 kremtëroj, εορταζω.
 krijonj, *creo*, δημιουργω.
 krijesë-a, δημιουργια.
 krijetar-i, *creator*, δημιουργος.
 krijetyrë-a, *creatura*, πλασμα.
 krye-atë-i, πατριαρχης.
 krye-qytet-i, μητροπολις,
 πρωτευουσα πολις.
 krye-lartë-i, αλαζων.
 krye-ushtëtuar-ori, αρχιστρατηγος.
 krye-prift-i, αρχιερευσ.
 qafoj, αγκαλιαζω.
 qem-i, θυμιαμα.
 qëndresë-a, στερεωμα.
 të qënurë, υπαρξις.
 qeft-i, ποτηριον, [κευθ-οσ].
 qytet-i, *civitas, civitatis*, πολις.
 i laim-i η laimës-i, βρεσβυς, μεσιτης.
 laimësi-a, πρεσβεια, μεσιτεια.
 laimësoj, πρεσβευω, μεσιτευω.
 landë-a, ξυλεια, ξυλικη.
 latoj, γλυφω.
 lëgjiroj, ομιλω. lëgjiratë-a, ομιλια.
 lëqer-i, λιμνη.
 letësoj, ελαφρωνω.
 leçit, κηρυττω.
 të leçiturë, κηρυγμα.
 leçitës-i, κηρυξ.
 ligjë-a, *lex, legis*, νομος.
 ligjë-dhënës-i, ο διδων νομον.
 ligja qytetore, νομος πολιτικος.
 ligja e lutëjesë, νομος θρησκευτικος.

i lirë, ευθηνης, 2) ελευθερος.
 të lirë, ευθηνεια. 2) ελευθερια.
 lironem, ευθηνω. 2) ελευθεροω.
 lironem, ευθηνουμαι. 2) ελευθερουμαι.
 lundrë-a, πλοιον. lundroj, πλεω.
 lus, lut, lut, λατ-ρευω.
 lutem, λιτομαι, λισσομαι, δεομαι,
 παρακαλω.
 lutëje-a, λατρεια.
 të luturë, λιτη, δεησις, παρακαλησις.
 luftëtar-i, πολεμιστης.
 madhështonem, υπεριφανευομαι.
 madhështi-a, υπεριφανεια.
 madhështuar-ori, υπεριφανος.
 mandorle-ja, αμυγδαλη.
 marrëzi-a, αφροσυνη.
 mbëçel, mbyll, αποφιμοω.
 mburoj, υπερασπιζω.
 mburonem, υπερασπιζομαι.
 mburonjës-i, υπερασπιστης.
 mburonjë-a, ασπις.
 mëndeshë-a, η τροφος.
 mëndyrë-a, τροπος.
 miek-u η miekës-i, ιατρος.
 miekësi-a, ιατρεια.
 miekësoj, ιατρευω.
 mieshtëri-i, *magister*, Ital. *maestro*, τεχνητης,
 διδασκαλος.
 mieshtëri-a, τεχνη.
 moshë-a, ηλικια. [ιδη mot-i, χρονος.]
 moshatar-i, συνηλιξ.
 ngjijroj, γενομαι, ngjirim, γευσις.
 ngushulloj, *con-solor*, παρηγορω.
 ngushëllonem, παρηγορουμαι.
 ngushullim-i, παρηγορια.
 ngushullimtar-i, παρηγορος.
 ndaj, παρα, πλησιον.
 ndal, εμποδιζω.
 të ndalë, εμποδιον.
 ndaloj, σταματω.
 ndonëse, μολονοτι.
 udhë-heqës-i, οδηγος.
 ujdhësë-a, νησος.
 ujit, ποτιζω. (επι φυτων και χορτων).
 ungjilluar-ori, εθαγγελιστης.
 ushtëtuar-ori, στρατιωτης.

ushtëri-a, στρατος, στρατευμα.
 raqtoj και raqsoj, *pax, pacis*, ειρηνευω.
 raqtim-i και raqsim-i, ειρηνη.
 i pa-udhë-i, αδικος.
 pa-udhëri-a, αδικια.
 paralindës-i, πρωτοτοκος.
 paralindëje-të, πρωτοτοκια.
 paraudhës-i, προδρομος.
 pardie, προχθες.
 pa-priturë, απροσδοκητως, εξαφνα.
 pëqi-ri, κρασπεδον.
 pëqisë-a, πλινθος.
 pendonem, *poenito*, μετανοω.
 pendim-i και pendesë-a, μετανοια.
 përandai, διατουτο.
 peranduar-ori, *imperator*, αυτοκρατωρ, εξ
 ου και mbëret, βασιλευς.
 përaroj, χρυσοω.
 përbetonem και përgjëronem [*juro*]
 και bënj be, ομνω.
 vë mbë be, ορκιζω.
 përgjoj, κατασκοπευω.
 përgjonjës-i, κατασκοπος.
 përdëllej, ελεω.
 përdëllim-i, ελεως.
 përdëllimtar-i, ελεημων.
 përint-di, *parens, parentis*, γονευς.
 përdor, μεταχειριζομαι.
 përkrenare-ja, περικεφαλαια.
 përmbytëje-a, κατακλεισμος.
 përmment, μνημονευω.
 përungjem, ταπεινουμαι.
 i përungjëtë, ταπεινος.
 përfilas, κατηγορω.
 piesë-a, μερισ, τμημα.
 Angl. *piece*, Ital. *pezzo*.
 pësoj, Ital. *peso, pesare*, ζυγιαζω, σταθμιζω.
 peshim-i, ζυγιασμα, σταθμησις.
 të pikaturë, ραντισμος.
 pikllim-i, πικρια, λυπη.
 pikllonem, πικραινομαι, λυπουμαι.
 plaf-i, εφαπλωμα.
 prek-prek-prek, και përkas-
 përkët-përkët, απομα, εγγιζω.
 μετοχ. përkaturë και prekurë.
 prinj, prin, prin. prijëmë, prini,

prinjënë, προβαινω, προπορευομαι,
 προηγουμαι.
 rame, Ital. *rame*, χαλκος.
 i-e ramtë, χαλκους.
 rigë-a, *rex, regis*, βασιλευς.
 rishtazi, επιρημ. νεωστι.
 ruanjës-i, φυλαξ.
 rrasë-a, πλαξ πετρας.
 (ιδε Ελλη. λαας.)
 rreth-pres, περιτεμνω.
 rreth-presëje-ja, περιτομη.
 të rrënuara-të, ερειπια.
 sa-kaqë-herë, παρευθυς.
 sbuloj, ξεσκεπαζω, αποκαλυπτω.
 sbulesë-a, αποκαλυψις.
 sulem, ορμω.
 Shën-vëndi, τα Αγια των Αγίων του Ναου.
 shenjë-a, σημειον, *signum*.
 shënoj, σημειω, *signo*.
 shënjtërore-ja, αγιαστηριον.
 shërbëtuar-ori, θεραπων, *servus*, υπηρετης.
 shërbëtore-ja, υπηρετρια.
 shërbej, υπηρετω.
 shërbesë-a, υπηρετησις.
 shërbëtyrë-a, δουλεια.
 shëfrefj, *suffro*, υποφερω.
 duroj, *duro*, υπομενω.
 shijë-a, νοστιμαδα, γευσις ηδυσ.
 i-e shishim, νοστιμος, ευχυμος, ηδυσ.
 shkak-u, αφορμη.
 shkronjë-a, γραμμα, γραφη.
 shkronja gjahtore, γραμματα κυνηγευτικα.
 Shkronja e Shënjtëuarë, η Αγια Γραφη.
 shkronjës-i, γραμματευς.
 shkurtëzë-a, ορτυξ. 2) λαχος.
 shortë-a, *sors, sortis*, κληρος.
 shpellë-a, σπηλαιον.
 shpërblej, λυτροω.
 shpërblim-i, λυτρωσις.
 shpërblyes-i, λυτρωτης.
 shterem και shteronj, στερω.
 shtërpinj-të, ερπετα.
 shtijëzë-a, λογη.
 shtyllë-a, στυλος.
 shtypa-shkronjë-a, τυπογραφια.
 tempullë-i, *templum*, ναος.

tietërazi και tiatërazi, αλλεως.
trathtoj, *trado*, προδιδωμι.
trathtim-i, προδοσια.
trathtuar-ori, *traditor*, προδοτης.
tregoj, δηγουμαι.
trek-gu, αγορα.
tregjetoj, εμπορευομαι.
tregjети-a, εμποριον.
tregjetar-i, εμπορος.
truvezë-a, τραπεζα.
tymoj, καπνιζω.
i cili, ο οποιος. e cila, η οποια.
të cilëtë, οιτινες.
të cilatë, αιτινες.
cmir-i, φθονος.
yl-ver-i και yl-ber-i, ιρις, ουρανιον τοξον.
fëqinjë-a, *vicinus*, γειτων.
falemi ndersë, ευχαριστω.
Fryma e Shënjtëruarë, το Αγιον Πνευμα.
hark-u, *arcus*, τοξον.
harkëtuar-ori, τοξοτης.
heret, επιρ. εωθινως, ορθριως, προωρα.
hie-ja, θεος, [ιε-ρος]. hietë, θεοι
μυθολογικοι [ιε-ροι]. 2) hietë,
φασματα, σκιαι, πνευματα.
3) σκια, ελλειψις φωτος,
κοινως ισκιος. 4) σεμνοτης,
ευσχημοσυνη, ευπρεπεια.
hier-i-a, θεοτης.
i-e hieruarshim, θειος.
hir-i, χαρις.
hobe-ja, σφενδονη.
erëra të mira, αρωματα.
botë-a, κοσμος. dhe-u, γη.
tokë-a, ηπειρος, η στερεα γη.
bishë-a, θηριον. shtësë-a, ζων.
bagëti-a, κτηνος.
kafshë e gjallë, φορτηγικον ζων.
gjë e gjallë, εμψυχον.
të lindurit' e diellit, η
të lerët' e diellit, ανατολη.
të perënduarët' e diellit, δυσις.
an' e borësë, βορρας
an' e mes-ditësë, μεσημβρια.

KATRË PËRGJËMIME

për

ÇUNAT' E VOGJILË

Dy për Emërat' e Shkronjësë,

edhe Dy për

Besimin' e Krishtit
edhe Detyrënë

Këthyerë prej
Konstandinit Kristoforidhit
Elbasanasit.

KONSTANTINOPOL.

1872.

DY PËRGJËMIME

PËR EMËRAT' E SHKRONJESË.

I. PREI SHKRONJESË VIETËRË.

1. Cili ishte Adhami?
I pari njeri, që bëri Perëndia, edhe i at' i gjithë njerëzet.
2. Cila ishte Eva?
E para grua, edhe e ëm' e gjithë njerëzet.
3. Cili ishte Kaini?
I pari bir' i Adhamit, që vrau Avelë të vëllanë.
4. Ç'ishte Aveli?
Më i mirë se Kaini, përandaj Kaini e mërzipte.
5. Cili ishte Enohu?
Një njeri, që e pëlqeu Perëndia, e cili u muar lart ndë qiell pa vdekurë.
6. Cili ishte Mathusalla?
Më i vietri njeri, që gjejmë shkruarë për atë, një mijë vieç plak.
7. Cili ishte Noeja?
Një njeri i mirë, i cili shpëtoj nga përmbytëja, kur u mbyt bota.
8. Cili ishte Iovi?
Më i duruarshimi njeri, për sa voj e hoqi.
9. Cili ishte Avraami?
I at' i besëtare, edhe miku i Perëndisë, i cili la dhen' e ti prej urdhërit Perëndisë, edhe erdhi e ndenji ndë dhe të Hanaanit, që ia pat zotuarë Perëndia ati, edhe farës' ati.
10. Cili ishte Melhisedheku?
Mbëret' i Salimit, edhe prifti, që bekoj Avraamnë.
11. Cili ishte Ismaili?
I bir' i Avraamit prej shërbëtores' Agarësë, që e dëboi bashkë me t'ëmënë, edhe prej farës' ati kanë dalë Arapëtë.
12. Cili ishte Isaaku?
I bir' i Avraamit, pas të zotuarit Perëndisë.
13. Cila ishte Sara?
E shoqeja e Avraamit, edhe e ëm' e Isaakut.
14. Cili ishte Lloti?
Një njeri i drejtë, i cili shpëtoj, kur u prish Sodhoma.
15. Cili ishte Isafi?
I vëllaj i Isaakut, më i madhi, i cili shiti paralindëjet' e tia për një kupë gjellë.
16. Cili ishte Iakovi?
I vëllaj i Isaakut, më i vogëli, i cili mori bekimin' e t'et.
17. Cila ishte Reveka?
E shoqeja e Isaakut, edhe e ëm' e Iakovit.
18. Ç'ishte Israili?

Një emër' i ri, që i vu Perëndia Iakovit.

19. Cili ishte Iosifi?

I bir' i Iakovit, po të vëllezërit' e shitnë, sepse e mërztinë, po Perëndia e bëri njeri të math përmbi gjithë dhen' e Misirit.

20. Cili ishte Iudha?

Një nga të bijt' e Iakovit, që qe profitepsurë, se Krishti kish për të lindurë prej farës' ati.

21. Cilët' ishinë të dymbëdhietë kryetarët?

Të dymbëdhietë bijt' e Iakovit, edhe atrët e farës' Israilit.

22. Cili ishte Faraoj?

Mbëreti i Misirit, i cili u mbyt në Det të Kuq.

23. Cili ishte Moisiu?

Shpëtimtari edhe ligjë-dhënësi i llauzit Israilit.

24. Cili ishtej Aaroni?

I vëllaj i Moisiut, i cili qe i pari kryepriift i Israilit.

25. Ç'ishinë priftëritë?

Ata që bëninë kurban Perëndisë, edhe u mpësoninë njerëzet ligjënë.

26. Cili ishte Iothori?

Një priift a zotëri i Madhiamit, i vjerr' i Moisiut.

27. Cilët ishinë Nadhavi edhe Aviudhi?

Dy priftërë, të bijt' e Aaronit, të cilët u doqnë me ziarr prej qielli, sepse bënë kurban me tiatrë ziarr, që nukë pat urdhëruarë Perëndia.

28. Cili ishte Koreu?

Një njeri i keq, të cilin' e përpiu dheu, sepse u bë priift pa urdhërë të Perëndisë.

29. Cili ishte Iisui i Naviut?

Ay që la Moisiu në këmbët të ti pas vdekëjesë, i cili hoqi udhën' Israilit në dhet të zotuarit.

30. Cili ishte Vallaami?

Një profit i Idhollollatrëvet, i cili donte të mallëkonte Israilë, po Perëndia e shtrëngoi t'e bekonjë.

31. Cili ishte Samsoni?

Më i forti njeri, i cili vrau një mijë armiq me një nofullë.

32. Cili ishte Ilei?

Një plak i mirë, po Perëndia u zëmërua mbë atë, sepse nukë ndali djemt' e ti nga të këqiatë.

33. Cili ishte Samuilli?

Profiti, që e thirri Perëndia, kur ishte dial' i vogëlë.

34. Ç'ishinë Profitëtë?

Njerës, që u pat dëftyerë Perëndia t'u thoshinë njerëzet punëtë që do të bënëshinë.

35. Cili ishte Dhavidhi?

Një njeri, që eci mbë udhët të Perëndisë, edhe tek qe bari (kullotës) u bë mbëret.

36. Cili ishte Goliathi?

Gjiga (njeri shtat-math), që vrau Dhavidhi me hobe.

37. Cili ishte Avesallomi?

I bir' i Dhavidhit, i cili ngriti krye mbi t'anë, edhe u vra varurë mbë një dru.

38. Cili ishte Sollomoni?

I bir' i Dhavidhit, mbëret' i Israilit, edhe më i mënçuri se gjithë njerëzitë.

39. Cila ishte Iezavela?

E shoqja e Ahaavit, edhe mbëretësh' e Israilit, që vrau profitët' e Perëndisë.

40. Cili ishte Iosia?

Një mbëret fort i ri, i cili kishte frikë Perëndinë.

41. Cila ishte Esthira?

Një grua Iudheonjë, edhe mbëretësh' e Persisë, e cila shpëtoj Iudhetë nga të vrarëtë.

42. Cili ishte Isaia?

Një profit që foli për Iisu-Krishtinë më shumë se të tierëtë.

43. Cili ishte Ilia?

Një profit, që u muar ndër qiej me qere të ziarrtrë.

44. Cili ishte Elissai?

Profiti, që përqeshnë djemtë, edhe ay i mallëkoj, e i çau ariu.

45. Cili ishte Gjeziu?

Shërbëtor' i profitit, që foli gënjeshtër, edhe e zu kroma.

46. Cili ishte Dhaniili?

Një profit, që shpëtoj nga goja e leonëve, sepse iu lut Perëndisë.

47. Cili ishte Ionai?

Profiti, që ndënji tri dit e tri net ndë barkut të peshkut.

48. Cilët ishinë Sedhrah, e Misahu, e Avdhenegoi?

Tre djem Iudhenj, të cilët' u hothnë ndër furrë të ndezurë, sepse nukë dojnë t'i faleshinë idhullësë, po s'u doqnë.

49. Cili ishte Navuhodhonor?

Madhështori mbëret' i Vavyllonësë, i cili u çmënt, e mori pyllë.

50. Cili ishte Valltassari?

I prapësmi mbëret i Vavyllonësë, i cili atie ku kishte ndënjurë, pa një dorë pas murit që shkruante, edhe u vra atë natë.

51. Cili ishte Dhariu?

Mbëret' i Midhevet e i Persrëvet, që hodhi Dhaniilë ndë gropët të leonëve, edhe pastaj hodhi ata që kallëzuanë keq për atë.

52. Cili ishte Qyrua?

Mbëret' i Persisë, që urdhëroi Iudhenjtë të ndërtoninë qytetnë edhe kishënë përsëri.

53. Cili ishte Zerovavelli?

Qivernitar' i Iudhesë, pas shërbesësë, i cili ndërtoj qishën' e dytë.

54. Cili ishte Ezra?

Shkronjësi, që pruri prapë enët' e qishësë nga Vavyllonia, edhe mpësoj llauznë t'i lutenë Perëndisë.

55. Cili ishte Neemia?

Një tiatërë qivernitar' i Iudhesë, që ndërtoj përsëri muret' e Ierusalimit, edhe urdhëroj të ruhej dit' e Savvatësë.

56. Cili ishte Mallahia?

I prapësmi profetet, që qe afro 400 viet para Krishtit, i cili profitepsi për të ardhurit' e Krishtit, edhe për para-udhësin' e ati Ioann Pakëzorinë.

II. PREI DHIATËSË RE.

1. Cili ishte Iisu-Krishti?
I biri Perëndisë, edhe shpëtimtar' i njerëzet.
2. Cila ishte Vërgjërësha Marie?
E ëm' e Iisu-Krishtit.
3. Cili ishte mieshtri Iosif?
Ay që qe vluarë me vërgjërëshënë Marie.
4. Cilët' ishinë Iudhenjtë?
Far' e Avraamit e e Isaakut e e Jakovit, të cilët' i pat zgjedhurë Perëndia për llaun' e ti.
5. Cilët' ishinë gjëntarëtë?
Gjithë kombet e tierë, që s'ishin Iudhenj.
6. Cili ishte Qesari?
Mbëret' i Romësë që urdhëronte gjithë dhenë.
7. Cili ishte Irodhi i math?
Riga i Iudhësë, që vrau gjithë djemt' e Vitheemit, që të vritej edhe Krishti ndër ata.
8. Cili ishte Irodhi tiatërë?
Riga i Galilesë, që i preu kryetë Ioann Pakëzorit.
9. Cili ishte Ioann Pakëzori?
Profiti, që dëfteu Iudhenjet, se erdhi Krishti.
10. Cila ishte Elissaveta?
E ëm' e Ioann Pakëzorit, edhe e kushërir' e vërgjërëshësë Marie.
11. Cili ishte Simeoni?
Plaku që mori ndë dorë Krishtinë ndë kishët, edhe u fal ndersë Perëndisë, sepse pa shpëtimtarinë.
12. Cila ishte Irodhiadha?
E shoqja e të vëllait Irodhit, së cilësë e bija kërceu mirë përpara Irodhit, edhe lypi prej ati kryet' e Ioann Pakëzorit.
13. Cilët' ishinë dishepujt' e Krishtit?
Dymbëdhietë vetë, që i vijnë pas Krishtit.
14. Cili ishte Nathanaili?
Një dishepull i Krishtit, që kishte zëmrenë të këthiellëtë.
15. Cili ishte Nikodhimi?
Një dishepull i frikëçim, që erdhi natënë te Krishti.
16. Cili ishte Zakheu?
Një burr' i shkurtërë, që hipi mbi drut për të parë Krishtinë.
17. Cila ishte Marie Magdhalina?
Një grua fajtoe, që i lau këmbëtë Krishtit me lot, edhe ia fshiu me flokët.
18. Cili ishte Llazari?
Miku i Krishtit, të cilin' e ngjalli katrë diç të vdekurë.
19. Cila ishte Martha?
E motër' e Llazarit, që bëri gosti Krishtit.
20. Cila ishte Maria, e motër' e Marthësë?

Gruaja, që cgjodhi më të mirënë piesë, se e motëra, sepse ndenji e ndigjoi fjalët' e Krishtit.

21. Cilët' ishinë Apostojtë?

Ata të dymbëdhietë dishepujtë, që cgjodhi Krishti për të leçiturë Ungjillnë.

22. Cili ishte Simon Petrua?

Ay apostolli, që mohoj Krishtinë, edhe u pendua.

23. Cili ishte Ioanni?

I dashuri apostoll i Krishtit, që i ra ndë krahëruar.

24. Cili ishte Thomai?

Ay apostolli, që nukë besonte, se u ngjall Krishti, pa mos parë atë.

25. Cili ishte Iudha?

Ay dishepulli i keq, që trathtoj Krishtinë me të puthurë.

26. Cili ishte Kajafa?

Krye-prifti, që mendoj Krishtinë.

27. Cili ishte Pontiu Pillati?

Qivernitari i Iudhesë, që urdhëroj të kryqësonej Krishti.

28. Cili ishte Varavvaj?

Viedhësi, që shpëtuanë Iudhenjtë, kur dhanë ndër duar Krishtinë për të kryqësuarë.

29. Cili ishte Iosif Arimatheasi?

Një njeri i pasurë, që vu ndë varrt Krishtinë.

30. Cilët ishinë të katrë Ungjillorëtë?

Matheu, Markua, Llukaj edhe Ioanni, të cilëtë shkruanë jetënë edhe vdekjen' e Krishtit.

31. Cili ishte Varnavva?

Një njeri, që shiti dhen' e ti, edhe u bë shok me Pavlinë ndë të leçiturit të Ungjillit.

32. Cili ishte Anania edhe Sapfira?

Një njeri me të shoqenë, që vdiqnë përnjëherë, sepse folnë gënjeshtërë.

33. Cili ishte Stefani?

I pari njeri, që u vra me gurë për punët të Krishtit.

34. Cili ishte Filippi?

Një prej shërbëtorëvet e leçitëset Ungjillit.

35. Cili ishte Pavli?

Një dialosh, i cili përpara ndiqte të Krishterëtë, po pastaj u bë apostoll i Krishtit.

36. Cili ishte Gamaliili?

Një njeri i diturë, që mpësoj Pavlinë.

37. Cila ishte Dhorkadha?

Një grua e mirë, që bënte pëlhurë për të varfërit, edhe u ngjall së vdekurish.

38. Cili ishte Elymai?

Një njeri i keq, që u verbua, sepse fliste kundër Ungjillit.

39. Cili ishte Apolloi?

Një leçitës i math i Ungjillit.

40. Cili ishte Eftihiu?

Një dialosh që e zu gjumi tek faleshinë, edhe ra poshtë e u vra.

41. Cili ishte Timotheu?

Një dialosh, që pat mpësuarë shkronjat' e shënjtëruara që ndë dialëri.

42. Cili ishte Titua?

Një tiatrë leçitës i Ungjillit, i mpësuarë nga Pavli.

43. Cilët ishinë Akuili edhe Prisqilla?

Një burrë me të shoqenë, që u ndihne apostojet Krishtit ndë të leçiturit e Ungjillit.

44. Cili ishte Agripa?

Një rigë, që për pakëzë desh u bë i Krishterë.

45. Cili ishte Filimoni?

Një miku i Pavlit, që ndë shtëpit të ati pat ndënjurë Pavli.

46. Cili ishte Onisimi?

Një shërbëtor i Filimonit, që iku prej ati ndë Romë, edhe u këthye prapë prej Pavlit tek i zoti.

DY PËRGJËMIME

PËR MPËSIMIN' E KRISHTERË

EDHE DETYRËNË.

PËRGJËMIM' I PARË.

1. A munt të më thuash, o dialë, kush të bëri ty?

I madhi Perëndi, që bëri dhen' edhe qiellë.

2. Ç'bën Perëndia për ty?

Ay më ruan nga e keqeja dit' e natë, edhe bën kurdo mirë për mua.

3. Ç'lypsetë të bëjsh ti për Perëndinë, që është kaqë i mirë për ty?

Më përpara duhetë t'e njoh, edhe të bënj punëra, që t'i pëlqenjënë.

4. Ku është shkruarë për Perëndinë?

Ndë Shkronjat e Shënjtëruara.

5. A ke mpësuarë ti, se si është Perëndia?

Perëndia është frymë, edhe na ndonëse nuk' e shohmë, po ay na sheh; ay ngjeh të gjitha, edhe munt të bënjë të gjitha.

6. Ç'duhetë të bënjç, që t'i pëlqejsh Perëndisë?

Duhetë të bënj detyrë mbë Perëndinë edhe mbë njerëzit.

7. Ç'është detyra jote mbë Perëndinë?

Detyra ime mbë Perëndinë është: t'i kem frikë, e t'e lavdonj, e t'e nderonj, e t'i lutem, e t'i shërbenj.

8. Cila është detyra jote mbë njerinë?

Detyra ime mbë njerin' është: të ndigjonj përintë, të flas të vërtetë për herë, edhe të dua të gjithë.

9. Ç'të mirë shpren ti prej Perëndisë, ndë bëfsh këto?

Atëhere do të jem i dashur' i Perëndisë.

10. Po ndë mos paç frikë Perëndinë, e ndë mos e daç, e ndë mos bëfsh punëra të mira?

Atëhere do të jem dial' i keq, edhe Perëndia do të zëmëronete mbë mua.

11. Ç'frikë ke ti, ndë u zëmëroftë Perëndia?

Sepse ay munt të vrasë kurminë t'im, edhe të mundonjë shpirtinë t'im pas vdekëjesë.

12. Po ke bërë ti ndonjëherë punë, që të zëmëronç Perëndinë?

Po, kam frikë se shumë herë fëjeva mbë Perëndinë, edhe ndeza zëmërimn' e ati.

13. Ç'kupëton ti, se është faji?

Faji është: të bënç punëra, që nukë do Perëndia, a të mos bënç ato që ka urdhëruarë.

14. Ç'duhetë të bënç, që të shpëtonç nga zëmërim' i Perëndisë, për fajet që ke bërë?

Duhetë të hidhëronem për fajet që kam bërë, edhe t'i lutem Perëndisë të m'i falnjë, edhe të ruhem të mos bënç më faj.

15. A do të të ndëjenjë ty Perëndia, ndë iu luç?

Shpërenj mbë përdëllimn' e ati, se do të më ndëjenjë, për sa bëri e voj Krishti për ne.

16. A e njeh ti cili është Krishti?

I biri Perëndisë, që cbriti prej qiellit të shpëtonjë njerëzitë nga fajetë.

17. Ç'bëri Krishti për të shpëtuarë njerëzitë?

Mbaroj ligjën' e Perëndisë, edhe na mpësoj të bëjmë edhe na kështu.

18. Ç'voj Krishti për ne?

Ay vdiq për fajtorët, që nukë ruajtinë ligjën' e Perëndisë.

19. Ku është Krishti tani?

Ay u ngjall nga të vdekuritë, edhe hipi ndë qiell, që të bënçë gati vënt për gjith' ata, që i shërbenjënë Perëndisë, edhe duanë birn' e ati Iisu-Krishtinë.

20. A munt vetë vetiu t'i shërbenç Perëndisë, edhe t'a duash?

Jo, nukë munt vetëvetiu, po Perëndia do të më ndihnjë me anë të Frymësë Shënjtëruarë, ndë ia lypça.

21. A do të vinjë përsëri ndonjëherë Krishti?

Krishti do të vinjë përsëri, edhe do të thërresë gjithë botënë, që t'i gjykonjë për gjithë sa kanë punuarë.

22. Për ç'punë do t'i gjykonjë?

Që t'ua shpaguanjë të mirëvet e të këqinjet pas punëvet që kanë punuarë.

23. Ç'do të bënetë puna jote atëhere, ndë qofsh i keq?

Do të mundonem ndë ziarrt të pa-shuarë gjithë jetën' e jetësë.

24. Po ndë qofsh i mirë, ku do të veç?

Do të vetë ndë qiell, e do të rri bashkë me Perëndinë gjithë jetën' e jetësë.

PËRGJËMIM' I DYTË.

1. Dialëthi im, a e di, se ç'je ti?

Unë jam krijesë e Perëndisë, sepse ay më ka bërë edhe shpirtin' edhe kurminë.

2. Qysh e di ti, se ke shpirt?

Sepse gjenj një farë gjëje ndë vetëhenë t'ime, që mendonet', e kupëton, e do, e gëzonet', e hidhëronetë, të cilatë kurmi s'munt t'i ketë.

3. Nga ndan shpirti prej kurmit?

Kurmi është prej mishi e prej gjaku, edhe ka për të vdekurë, po shpirti është frymë, edhe nukë vdes kurrë.

4. Për ç'punë të bëri ty Perëndia kështu, me kurm e me shpirt?

Që t'ë njoh, e t'i shërbenj kështu ndë dhet, për të ndenjturë bashkë me atë ndë qiell pas vdekjesë.

5. Qysh munt të mpësonjç, që të njohç Perëndinë, e t'i shërbenjç?

Nga Shkronjat' e Shënjtëruara të së Vietrës' edhe së Resë Dhiatë, që janë fjalët' e Perëndisë.

6. Qysh shkruanjënë shkronjatë, se është Perëndia?

Perëndia është Frymë, pa të nisur' e pa të sosurë, fort i mënçur' e i fuqishim, fort i shënjtëruar' e i përdëlllyeshim, fort i drejtë e i vërtetë.

7. Ç'është Perëndia te njerëzitë?

Perëndia është krijetari ynë, i cili na dha të qënuritë, e na ruan gjithënjë, e na bën mirë kurdo; ay është Zoti ynë tashti ndë këtë jetë, edhe gjykatësi ynë ndë jetët që vien.

8. Si të mpësonjënë Shkronjatë ty t'i shërbenjç Perëndisë?

Lipsetë t'i shërbenj Perëndisë, tuke ruajturë porosët e ati, do me thënë, të bënj gjith' ato punë, që kërkonenë prej meje, edhe të largonem nga gjith' ato që janë të ndalura.

9. Ç'porosi ka lënë njerëzet Perëndia?

Ay dha Iudhenjet të Dhietë Porositë, që janë shkruarë ndë Dhiatë të Vietërë, të cilatë janë mbëledhurë mbë dy porosi ndë Dhiatë të Re.

10. Thuaj për gojë të Dhietë Porositë.

Cila është e para?

Unë jam Zoti Perëndia yt, që të kam nxierrë nga dheu i Misirit, nga shtëpia e shërbesësë.

Mos kesh të tierë perëndira, veç meje.

11. Cila është e dyta?

Mos bëjsh për vetëhenë tënde idhullë, as të shëmbëllyerë ndonjë gjëje që është lart ndë qiell, a që është poshtë ndë dhet, a që është ndër ujërat përposh dheut; mos i adhurojsh, as t'u lutesh, sepse unë Zoti Perëndia yt jam Perëndi zilitar, që paguan fajet' e atrëvet mbë djemt, ngjer mbë të tretinë edhe të katërtinë bres atyreve që më mërëzitinjënë, edhe bënj përdëllim mbë mijëra brezash atyreve që më duanë edhe ruanjënë porosët' e mia.

12. Cila është e treta?

Mos març emërin' e Zotit Perëndisë tënt mbë të kotë, sepse Zoti nukë do të nxierrë pa faj atë që merr emërin e ati mbë të kotë.

13. Cila është e katërta?

Kujto ditën' e Savvatësë, për të shënjtëruar' atë. Gjashtë ditt puno, edhe bënj gjithë punërat e tua, po e shtatta ditë është Savvat' e Zotit Perëndisë tënt; nd'atë ditë mos bëjsh as ndonjë punë, as ti, as yt bir, as jot-bijë, as shërbëtori yt, as shërbëtoreja jote, as bagëtia jote, as i huaji yt, që është përbrënda dyeret tua, sepse për gjashtë ditt Zoti bëri qiellnë edhe dhenë, detnë, edhe gjithë sa janë nd'ato, edhe të shtattënë ditë pushoj, përëndaj Zoti bekoj ditën' e Savvatësë, edhe e shënjtëroj.

14. Cila është e pesëta?

Ndero tët'atë e tët-ëmë, që të bënesht jetë-gjatë mbi dhet, që të ep Zoti Perëndia yt.

15. Cila është e gjashta?

Mos vraç.

16. Cila është e shtatta?

Mos kurvërojsh.

17. Cila është e tetta?

Mos viethç.

18. Cila është e nëntta?

Mos bëjsh dëshmi (martyri) mbë të rrem kundrë rë afërmit tënt.

19. Cila është e dhietta?

Mos dëshërojsh shtëpin' e të afërmit tënt, mos dëshërojsh gruan' e të afërmit tënt, as shërbëtorin e ati, as shërbëtoren' e ati, as kan' e ati, as gomarn' e ati, as ç' do gjë që është e të afërmit tënt.

20. Ç' është të mbëledhurit' e këtyre të dhietë porosive, shkruarë ndë Dhiatët të Re?

Të mbëledhurit' e këtyre të dhietë porosive është: "Të duash Zonë Perëndinë t'ënt me gjithë zëmrë, edhe të duash të afërminë t'ënt posi vetëhenë tënde".

21. Ç' do me thënë: Të duash Perëndinë me gjithë zëmrë?

Të duash Perëndinë me gjithë zëmrë, do me thënë: Të kesh mëndjenë gjithënjë tek ay, edhe të duash të mirën' e ati përmbi të gjitha, edhe t'i pëlqejsh ati përherë.

22. Si munt të dëftejsh dashurinë, që ke mbë Perëndinë?

Tuke lutur' ati gjithënjë, e tuke bërë gjithë sa ka porositurë, e tuke duruarë ç' do të keqe, që na bie mbi krye.

23. Ç' të luturë kërkon prej nesh Perëndia?

Të ndigjonj të shënjtëruarënë fjalën' e ati, e t' e lavdonj për madhërin' e ati, e t' i lutem përditë për përdëllimn' e ati, e t' i falem ndersë për të mirat që na bën.

24. Ç' do me thënë: Të duash të afërminë tënt posi vetëhenë tënde?

Të duash të afërminë t'ënt posi vetëhenë t'ënde, do me thënë: T'u bëjsh të tierëvet atë që do t' i, të bënjenë ata ty.

25. Si munt të dëftenjç dashurinë, që ke mbë të afërmit?

Tuke nderuarë, e tuke ndigjuar' ata që janë më të mëdhenj se ti; tuke folurë të vërtetënë, e tuke u bërë mirë gjithë njerëzet, miq qofshinë a armiq, të afërmë qofshinë a të huaj.

26. A nuk i ke ruajturë ti porosit' e Perëndisë, edhe ke fëjyerë mb' atë?

Zëmëra më thotë, se s' kam ruajturë porosit' e Perëndisë, edhe se kam fëjyerë mb' atë me mënt, e me fjalë, e me punë.

27. Qysh e di ti se ke fëjyerë mbë Perëndinë me mënt, e me fjalë, e me punë?

Sepse më kanë shkuarë ndëpër mënt mendime të këqia, e kam folurë fjalë të këqia, e kam bërë punëra të këqia.

28. Ç' vëjen të të bënë për fajetë që ke bërë?

Për fajetë që kam bërë, më vëjen zëmërimi e mallëkimi i Perëndisë fuqi-math.

29. Aq i math është zëmërimi i Perëndisë, që ke kaqë frikë prej ati?

Zëmërimi i Perëndisë është fort' i math, sepse mundon fajtorëtë ndë këtë jetë, edhe pas vdekëjesë nd' atë jetë që vien.

30. Qysh munt të shpëtonjç prej zëmërimit Perëndisë për fajetë që ke bërë?

Perëndia është e përdëlllyershim, edhe dërgoj Iisu-Krishtinë ndë botët, që të shpëtonjë gjithë fajtorëtë, sikundrë na mpëson Ungjilli.

31. Ç' është Ungjilli?

Ungjilli është Dhiat' e Re, që ep zën' e mirë për shpëtimn' e njerëzet me anë të Iisu-Krishtit.

32. Cili është Iisu-Krishti?

Iisu-Krishti është i bir' i Perëndisë, që ishte me Perëndinë para se të ngrihej bota, po cbriti nga qielli, edhe mori mish prej Vërgjërëshësë Marie, edhe u bë njeri.

33. Është Perëndi Iisu-Krishti, sikundër edhe njeri?

Po, Iisu-Krishti është Perëndi edhe njeri, sepse perëndëria u poq me njerëzinë ndë kurmt të Iisu-Krishtit, edhe emër' i ati është Emmanuil, që do të me thënë: Perëndia bashkë me ne.

34. Ç'bëri Iisu-Krishti ndë dhet, për të shpëtuarë fajtorët?

Ay u dëfteu njerëzet dashurimn' e Perëndisë me anë të Ungjillit, edhe bëri vetëvetëhenë, pasqyrë shënjtërie për punët' e mira që bëri, edhe u fali fajetë njerëzet me anë të gjakut ti, që derdhi.

35. Qysh mundej Krishti t'u falte fajetë njerëzet me anë të gjakut ti, që derdhi?

Njerëzitë ishinë dënuarë të vdisninë për fajetë, po Krishti, i cili ishte i biri Perëndisë edhe pa faj, vdiq për fajetë t'ana, që të na çpërblenjë me gjakn' e ti, edhe të na apë jetë të pa-sosurë.

36. A me të vdekurit' është tashti Krishti?

Jo, ay u ngjall prej së vdekurish të tretënë ditë, edhe hipi ndë qiellt e ndenji mbë të diathtët të Atit.

37. Ç'po bën tashti Krishti ndë qiell?

Ay lajmëron tek Ati, të jetë i përdëlljershim mbë njerëzit, edhe qivernon gjithë kafshatë për të mirën' e atyreve.

38. Ç'duhetë të bëjsh, që të ndëjenjë ty Perëndia?

Duhetë të pendonem për fajetë që kam bërë, e t'i rrëfenj përpara Perëndisë, e të lypinj ndëjesë prej ati, e t'i besonj Krishtit për Shpëtimtarinë t'im.

39. Ç'do me thënë, të pendonesh për fajetë që ke bërë?

Të pendonem për fajetë që kam bërë, do me thënë: Të mos bënj më punëra të këqia, edhe të më vijë keq, sepse hidhërova Perëndinë për punërat e këqia që bëra, edhe të mërzit ç'do punë që nuk' i pëlqen Perëndisë, edhe të kem kujdes që të mos hidhëronj më Perëndinë me punëra të këqia.

40. Ç'do me thënë: T'i besonjç Krishtit për Shpëtimtarinë t'ënt?

T'i besonj Krishtit për shpëtimtarinë t'im, do me thënë: Të besonj se Krishti është Shpëtimtari i fajtorëvet, edhe të var vetëhenë t'ime tek ay, edhe të shpërenj mb'atë, se munt të më shpëtonjë.

41. Për ç'punë shpëren ti, se ke për të shpëtuarë nga zëmërim' i Perëndisë?

Ndë u pendofsha për fajetë, edhe të shpërenj mbi Krishtinë, Perëndia thotë ndë Shkronjë të Shënjtëruarë, se do të na ndëjenjë fajetë, e do të na shpëtonjë shpërtratë.

42. As po nuk' është zëmra jote fajtoje prej vetiu, edhe munt të pendonesh ti nga fajetë, e të shpërenjç mbë Krishtinë?

Na kemi zëmëra fajtoje, edhe s'munt të bëjmë ndonjë gjë të mirë prej vetëvetiu, po Perëndia na është zotuarë të na apë Frymën' e Shënjtëruarë ndë ia lypshim, e cila përtërin zëmratë t'ona, edhe na ndih të bëjmë mirë.

43. Si duhetë t'i falesh Perëndisë, që të ndigjonjë ty?

Mbë gjithë të falturat t'ona, e mbë gjithë uratat t'ana duhetë të lypëmë ndëjesë nga Perëndia mb'emërit të Iisu-Krishtit, sepse na jemi fajtorë, e s'kemi bërë ndonjë të mirë.

44. Ndë paç bërë dashurimn' e Perëndisë, e ndë i paç shërbyerë Krishtit mbë këtë jetë, ç'shpëren ti pas vdekëjesë?

Si të vdes, shpirti im vete te Perëndia, edhe shpërenj, se do të jetë bashkë me Perëndinë e me Krishtinë.

45. Po nukë pret ti ndonjë tiatërë të mirë pastaj?

Po, shpërenj, se kurmi im do të ngjalletë e do të piqetë me shpirtinë t'im ndë ditët të gjyqit.

46. Kurë ka për të ardhurë këjo dit' e gjyqit, që thua, se kurmi yt është për të ngjallurë prej së vdekurish?

Mbë të mbaruarit e botësë, Iisu-Krishti ka për të ardhurë përsëri, për të gjykuarë të gjallë e të vdekurë, atëhere gjithë të vdekuritë do të ngjallenë përsëri.

47. Qysh ka për të gjykuarë Krishti botënë?

Ay ka për të vënë gjithë të drejtëtë mbë të diathtë, e gjithë të këqijtë mbë të mëngjërë, edhe ua ka për të çpaguearë të gjithëve pas punësh që kanë bërë.

48. Pas gjyqit ku kanë për të vaturë të këqijtë?

Të këqijtë kanë për të vaturë ndë pisët të ziarrit, edhe janë për të munduar' atie bashkë me diallë e me frymat' e këqia gjithë jetën' ejetësë.

49. Po të drejtëtë ku kanë për të vaturë?

Iisu-Krishti do të marrë të drejtëtë ndë Paradhis lart ndë qiell, që të jenë bashkë me Perëndinë e me engjëjt' e ati gjithë jetën' e jetësë lumurë ndë gëzim të pa-sosurë. Amin.

[Fjalorth shqip-greqisht]

Përgjërimit, κατηγορις.
përgjëmoj, κατηγοω.
i cili, ο οποιος.
e cila, η οποια.
të cilëtë, οιτινες.
të cilatë, αιτινες.
përmbytëja, κατακλεισμος.
shërbenj, δουλευω.
pendonem, μετανοω.
shërbëtori, δουλος.
trathtoj, προδιδωμι.
shërbëtore-ja, δουλη.
trathtim-i, προδοσια.
shërbesa, δουλεια.
trathtuar, προδοτησ.
paralindëjetë, πρωτοκια.
ungjillorëtë, ευαγγελισται.
krye-atë, πατριαρχις.
përdëllenj, ελεω.
krye-atrëtë, πατριαρχει.
përdëllim-i, ελεος.
ligja, νομος.
përdëllershim, ελεημων.
ligjë-dhënës, ο διδων νομοω.

krijoj, δημιουργω.
krye-prift-i, αρχιερευς.
krijesa, δημιουργημα.
ndal, εμποδιζω.
krijetar-i, δημιουργος.
të ndalurë, εμποδιον.
të qënuritë, υπαρξισ.
madhështonem, υπερηφανευομαι.
adhuronj, λατρευω.
madhështuar, υπερηφανος.
dënoj, καταδικαζω.
qytet, πολις.
i lajmi dhe lajmës-i, πρεσβυς, μεσιτης.
shkronjësi-i, γραμματευς.
lajmësi-a, πρεσβεια, μεσιτεια.
paraudhës-i, προδρομος.
lajmësoj, πρεσβευω, μεσιτευω.

Përgjërimit-i, κατηχησις.
gjëntar-i, εθνικος.
përgjëmoj, κατηχω.
falemi ndersë, ευχαριστω.
i cili, ο οποιος.
dishpull-i, μαθητης.
e cila, η οποια.
dishpujtë, μαθηται.
të cilëtë, οιτινες.
leçit, κηρυττω.
të cilatë, αιτινες.
leçitës-i, κηρυξ.
përmbytëja, κατακλεισμος.
mohoj, αρωοθμαι.
shërbenj, δουλευω.
pendonem, μετανωω.
shërbëtori, δουλος.
trathtoj, προδιδομι.
shërbëtore-ja, δουλη.
trathtim-i, προδοσια.
shërbesa, δουλεια.
trathtuar, προδοτης.
paralindëjetë, πρωτοκια.
ungjillorëtë, ευαγγελισται.
krye-atë, πατριαρχισ.
përdëllenj, ελεω.
krye-atrëtë, πατριαρχαι.

përdëllim-i, ελεος.
ligja, νομος.
përdëllyershim, ελεημων.
ligjë-dhënës, ο διδων νομοω.
krijoj, δημιουργω.
krye-prift-i, αρχιερευς.
krijesa, δημιουργημα.
ndal, εμποδιζω.
krijetar-i, δημιουργος.
të ndalurë, εμποδιον.
të qënuritë, υπαρξις.
madhështonem, υπερηφανευομαι.
adhuronj, λατρευω.
madhështuar, υπερηφανος.
dënoj, καταδικαζω.
qytet, πολις.
i lajm dhe lajmës-i, πρεσβυς, μεσιτης.
shkronjës-i, γραμματευς.
lajmësi-a, πρεσβεια, μεσιτεια.
paraudhës-i, προδρομος.
lajmësoj, πρεσβευω, μεσιτευω.

VIVLIA SHQIP

ndë gjuhë toskërishte, me shkronja
greqishte.

Shiturë ndë Stamboll,
Udha Tahta-kaleh, Numëri 52.

1. Dhiata e Re, Greqisht edhe shqip, lidhurë - - - - -	grosh 5
2. Psalltiri, lidhurë - - - - -	“ 3
3. Istorja e Shkronjësë Shënjtëruarë, lidhurë - - - - -	“ 3
4. Allfavitari - - - - -	“ 1
5. Katër Përgjëmime - - - - -	“ ½

Shtypa-shkronja A. H. Bojaxhian.